


**HENA SPAHIU**

**QYTETI  
ILIRO-ARBEROR  
I  
BERATIT**



930  
581

AKADEMIA E SHKENCAVE  
E REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ARKEOLOGJISË

HËNA SPAHIU

QYTETI  
ILIRO-ARBEROR  
I BERATIT

56090

TIRANE, 1990

**QYTETI  
ILIRO-ARBEROR  
I BERATIT**

HËNA SPAHIU



## **HYRJE**

Studimi i historisë së popullit tonë, kulturës dhe gjuhës së tij kanë qenë dhe janë ndër problemet më të rëndësishme të historiografisë sonë.

Në fushën e studimit të kulturave pre e protohistorike, asaj qytetare ilire dhe mesjetës së hershme janë bërë hapa të rëndësishëm përpara. Studimi i jetës qytetare ilire dhe i vazhdimësisë iliro-arbërore janë probleme të mëdha, të cilave arkeologjia jonë ka vite që iu ka kushtuar dhe po i kushton vëmendje të posaçme. Kërkimet dhe vrojtimet arkeologjike shqiptare në një varg qytezash dhe qytetesh ilire kanë afro tri dekada që kanë filluar e janë shtrirë pothuajse në gjithë territorin e Ilirisë së Jugut dhe në Epir (Rosujë, Xibër, Kala e Irmajt, Prishtë, Symizë, Belsh, Shkodër, Lis, Zgërdhesh, Bylis, Klos, Kaninë, Aulonë, Butrint, Antigone etj.). Ato kanë sjellë të dhëna me rëndësi për ndriçimin e problemit të qytetërimit ilir gjatë periudhës së vendosjes së rendit skllavopronar në Iliri. Të dhënat e gërmimeve dhe studimi i fortifikimeve të këtyre qyteteve kanë bërë të mundur krijimin e një tabloje krejt të re mbi qytetërimin ilir të kësaj periudhe. Ato provojnë se vendbanimet protourbane u krijuan në shek. VII-V p.e.sonë mbi bazën e një zhvillimi të brendshëm ekonomiko-shoqëror i cili përgatiti revolucionin urban, që do të karakterizojë jetën ilire të shek. IV-I p.e.sonë. Mbi një bazë më të gjërë faktike janë shtruar përzgjidhje të një varg çështjesh, siç është ajo e origjinës dhe e formimit të qytetit ilir, fazat e ndryshme të zhvillimit të tij, ka-

rakteri i qytetit, tiparevet themelore dhe të veçanta të tij, kronologjia etj.

Por ky kuadër nuk do të ishte i plotë po të mos ndiqej fati i mëtejshëm i qyteteve në kohën e vonë antike dhe në mesjetë. Shumë nga qytetet tonë antike, veçanërisht qytetet e mëdha e të rëndësishme si Shkodra, Lisi, Dyrrahu, Butroti siç është provuar historikisht dhe arkeologjikisht, falë pozitës së tyre të favorshme gjeografiko-strategjike dhe ekonomike, kanë vazhduar jetën pa ndërprerje ndonëse në rrëthana historike më pak të favorshme dhe me një ekonomi e mënyrë jetese të ndryshuar.

Gërmimet arkeologjike të bëra në një varg qendërbani-mesh të kohës antike të vonë dhe mesjetës së hershme (Shurdhah, Lezhë, Shkodër, Kaninë, Berat, Butrint -Onhezma (Sarandë), Bylis, Pogradec, Blacë, Symizë, Paleokastër, Gjirokastër e Zharrës) dëshmojnë për një popullsi të dendur, e cila i kishte rezistuar politikës asimiluese të Perandorisë Romake dhe në periudhën e kalimit nga sistemi skllavopronar në atë feudal ishte bërë një forcë e gjallë.

Për gjurmimin e problemit të rëndësishëmi të vazhdimësisë iliro-arbërore një vëmendje e posaçme i është kushtuar gërmimeve veçanërisht në ato qytete këu nuk ka pasur ndërprerje të jetës qytetare.

I tillë ka qenë edhe qyteti iliro-arbëror i Beratit, i cili është formuar aty nga fundi i shek. IV, fillimi i shek. III p.e.sonë mbi bazën e një vendbanimi protoqytetar ilir.

Burimet e shkruara dhe dokumentacioni arkeologjik i fituar nga gërmimet e bëra në rrënojat e kalasë së Beratit dëshmojnë për vijimësinë e jetës qytetare gjatë gjithë periudhës antike dhe mesjetare. Shtresat kulturore me depozitimet e periudhave të ndryshme siç janë prodhimet e zejtarisë lokale, qarkullimi monetar si edhe veprimtaria ndërtimore-tregojnë se Berati (Antipatre, Antipagrai, Pulheriopoli, Belgradi) me gjithë zigzagjet e shkaktuara nga ngjarjet historike të kohës vazhdon të jetë në mesjetë një qendër e rëndësishme qytetare, administrativo-üshtarake dhe peshkopale.

Për hartimin e kësaj monografie, që trajton këtë problem, jemi bazuar kryesisht në të dhënët e gërmimeve katervjeçare dhe në burimet historike më kryesore.<sup>2)</sup>

1). Për të dhëna burimore më të hollësishme mbi historinë e këtij qyteti shih: A. Baçe, E. Riza, A. Meksi, *Berati historia dhe arkitektura*, Tiranë, 1988 f. 10-32.

Zhvillimi i qytetit të Beratit në mesjetë dhe vazhdimësia e banimit të tij deri në ditët e sotme e kanë kufizuar mjaft sipërfaqen e lirë të mundshme për gërmimin dhe në këtë mënyrë kanë vështirësuar shtrirjen e gërmimeve arkeologjike në një territor më të gjërë. Kjo gjë nuk ka lejuar tanë për tanë që të rrrohen të dhëna me rëndësi mbi urbanistikën antikomesjetare të këtij qyteti, çka mendojmë se mund të plotësohet në të ardhmen. Mungojnë gjithashtu të dhënat arkeologjike që do të ndriçonin sado pak aspekte të karakterit shoqëror, si p.sh., organizimin shoqëror e politik të këtij qyteti apo ndonjë mbishkrim identifikues që do të kishte vlera autentike të padiskutueshme mbi emrin antik të tij.

Në monografi mbi bazën e rezultateve të këtyre gërmimeve përcaktohen periudhat e ndryshme të banimit duke filluar që nga fundi i shek. VII p.e.sonë (periudha protoqytetare) deri në shek. XV, në fillim të periudhës së pushtimit turk.

Në studim bëhet klasifikimi i gjithë materialit arkeologjik, i shoqëruar me një analizë të hollësishme tipologjike të objekteve, sillen të dhëna krahasuese nga vendgjetje të ndryshme dhe përcaktohet koha e prodhimit të tyre.

Që punimi të bëhet sa më i kapshëm për lexuesin dhe të ketë një lidhje organike, materiali arkeologjik është paraqitur sipas periudhave të ndryshme kronologjike që ndjekin njëra tjetrën, i shoqëruar me të dhënat burimore më kryesore si edhe me dokumentacionin përkatës grafik dhe fotografik.

Në fund të çdo kategorie gjetjesh që analizohen si edhe në fund të kapitujve të veçantë jepen përfundimet përkatëse mbi çështje të karakterit ekonomik e shoqëror dhe kronologjik.

Jemi të mendimit se kjo monografi përbën një kontribut të ri në drejtim të studimit të qytetit iliro-arbëror dhe veçanërisht të dokumentacionit arkeologjik të tij të sjellë nga gërmimet. Megjithatë duhet thënë se brenda mundësive që lejojnë gërmimet relativisht të kufizuara të bëra vetëm në zonat e lira dhe të pabanuara të kalasë është vështirë të zgjidhen të gjitha problemet që lidhen me këtë qytet. Gërmimet arkeologjike, në të ardhmen do ta pasurojnë padyshim me të dhëna të reja tablonë e këtij qyteti dhe nëpërmjet tij të qyteteve iliro-shqiptare me vazhdimësi jete disa mijëra vjeçare.

Në katalogun që shoqëron gjetjet e qeramikës dhe objektet e çdo shtrese apo monedhat shpresoj se studiuesit e ardhshëm do të gjejnë pikë të rëndësishme referimi që do t'u shërbejë në punën e mëtejshme kërkimore shkencore.

Falenderoj me këtë rast shokët e sektorit të antikitetit të vone dhe të mesjetës dhe shokë të tjera të Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike, që me vërejtjet dhe sygjerimet e tyre më kanë ndihmuar gjatë punës për hartimin e kësaj monografie. Për punën e mirë të bërë në terren dhe në kabinet falenderoj gjithashtu punonjësit teknikë (të fototekës, skicotekës, fotografët e QKA) që dhani ndihmesën e tyre për përgatitjen e aparatit shkencor të kësaj monografie.

## KREU I

### I. POZITA GJEOGRAFIKE


Rrënojat e qytetit të fortifikuar iliro-arbëror të Beratit ndodhen përmbi një kodër në bregun e djathtë të lumit Osum (Fig. 1), pikërisht aty ku ai duke kaluar përmes një gryke të ngushtë (Fig. 2) zbret nga zona e thellë malore pér në



Foto 1

Identificati i seguenti  
materiali: legno di  
cavallino, legno di  
cerro, legno di  
merlo, legno di  
pino.

Foto 2



fushë. Kodra mbi të cilën shtrihej qyteti antik është 137 m mbi nivelin e detit, është jugore e saj bie thikë përmbi lumë dhe ka një mbrrojtje natyrore të mirë.

Në anën veriore Kodra zbrët butë dhe lidhet në përmjet një qafe me kodrën e Biftës. Anët lindore dhe perëndimore të saj kanë një pjerrësi prej + $0^{\circ}$ - $45^{\circ}$ . Kalaja e Beratit, zonët e pozitës gjeografike e strategjike mjaft të rëndësishme, gjë që e bën atë të dallojë nga qendra të tjera përreth. Kjo pozitë e lejonte atë të mbronte dhe të kontrollonte kalimin përgjatë lugine së Osumit në rrjedhjen e tij të mesme, nëpërmjet rrugëve kryesore dhe atyre të dorës së dytë që e lidhnin me Ultësirën Brëgdetare dhe me zonat e brendshme të vendit. Nga pikëpamja e pozitës fiziko-gjeografike Berati dhe trethina e tij bën pjesë në zonën kodrinore më të madhe të vendit tonë, që shtrihet midis lumenjve Vjosë dhe Osum-Semanit<sup>2</sup>). Kjo shërben si zonë kalimi nga fusha e Myzëqesë (Ultësirë Perëndimore) për në territoret e Krahinës Malore Jugore dhe ka vëçoritë e veta fiziko-gjeografike që zënë një vend ndërmjetës midis atyre të Ultësirës Perëndimore dhe territoreve malore të lindjes.

Format kryesore të reliëvit të kësaj zone janë kodrat dhe vargjet kodrinore, luginat dhe fushat. Kodrat kanë një lartësi mesatare nga 100-200 m deri në 800-900 m e më tepër, me drejtim të përgjithshëm veri-perëndim jug-lindje.

Relievi i vendit dhe i zonës përreth, ku nuk mungojnë shpatet malore, grykat e ngushta dhe luginat janë të përshtatshme për zhvillimin e kulturave bujqësore, të frutikulturës dhe të blektorisë.

Burimet historike të shkruara, në krahinën e Dasaretisë, ku përfshihej dhe qyteti antik në Kalanë e Beratit, i identifikuar me Antipatrean ilire, përmenden një varg qendrash të banuara<sup>3</sup>. Në lindje të qytetit antik përmenden qytetet e Korragut, Gerunti dhe Orgesi, ende të paindentifierikuara. Njeri nga këto dëshira fundit mendohet se duhet kërkua në kalanë e Prishtës<sup>4</sup> (Rr. i Skraparit). Kërkimet arkeologjike dëshira

2) V. Kristo, *Disa vëçori fiziko-gjeografike të zonës kodrinore midis Vjosës dhe Osum-Semanit* (Disertacion); Tiranë, 1981.

3. Polykius, Historia, V, 103, 2; Tit Livi; Ab Urbe Condita, Libri XXXVII, 27, 2 në; Ilirët dhe Iliria tek Autorët Antikë, Tirane, 1985, f. 59, 107. (Ky vëllim më poshtë do të jepet shkurtimisht: I.I.A.A.)

4. L. Ylli, *Dy kështjella ilire në Prishtë*, «Iliria», 1, 1984, f. 125.

peditat përnjohëse<sup>5</sup> kanë zbuluar përreth Beratit një varg kështjellash dhe vendbanimesh ilire dhe arbërore që tregojnë se qyteti iliro arbëror i Beratit ka qenë përfshire në një zonë me popullim të dendur që nga kohët e lashta. Përballë kalasë

Beratit, ndodhet kalaja ilire e Goricës, në perëndim në Malësinë e Shpiragut janë zbuluar rrënojat e qytetit ilir të Dimalit, në verilindje ndodhet kalaja ilire e Irmajt (Kodrioni ilir) dhe në juglindje Bargullasi (Barguli ilir?). Në afërsi të Beratit ka edhe qendërbanime të tjera të paidentikuara: siç janë kalaja ilire-mesjetare e Tomorit, kalaja ilire e Balibardhës, Vokopola e Terpanit (vendbanim i hapur ilir dhe kala mesjetare); kalaja e kohës antike të vonë të Mbjeshevës, Gradishta e Peshtanit (antike e vonë) etj. (Fig. 3). Është për t'u vënë në dukje këtu pozicioni mbizotëruar i Kalasë së Beratit në lidhje me qendra të tjera të sipërpermendura të kësaj zone.

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare të qyteteve tona antike Juanin rrugët. Në antikitet rrugët kryesore nëpër të cilat lëviznin njerëzit dhe zhvillohej tregtia e mallrave siç dihet, ishin luginat e lumenjve.


Drejtimi kryesor i rrugës natyrore në zonë e Beratit ishte lugina e lumenit Osum, që lidhte qytetin ilir në kalanë e Beratit me qytetet e rëndësishme të Ultësirës Bregdetare (Dimalin, Bylisin, Kaninën, Aulonën, Apoloninë e Dyrrahun) dhe me zonat e brendshme të vendit, me qytete të krahinës së Skraparit, të Tomoricës, Korçës, Kolonjës e Përmetit dhe më tej me Greqinë e Maqedoninë. Në mesjetë rrugët e komunikacionit nuk ndryshuan shumë. Në përgjithësi ato ishin vazhdim i rrugëve antike.

Qyteti arbëror i Beratit në mesjetë lidhej me zonën bregdetare me një rrugë të tërthortë<sup>6</sup> dhe pikërisht me atë që kalonte nga Kanina për në Ballsh, Berat dhe kështjellen e Tomorit, prej nga dilte në lumin e Devollit, në Zvezdë (Deabol) dhe në Ohër.<sup>7</sup>

5) H. Spahi, *Ekspeditë përnjohëse në rrethet e Beratit e të Skraparit*, «Iliria» VII-VIII, 1977-1978, f. 343-348.

6) A. Baçe, *Rrugët shqiptare në mesjetë (shek. VII-XV)*, «Monumentet», 1 1984, f. 59-65.

7) Të dhëna për traktin e rrugës Kaninë-Ballsh dhe Ballsh-Qafë e Sinjës-Berat shih; Po aty, f. 61 literaturën e cituar nga A. Baçe.



## 2. HISTORIKU I KËRKIMEVE DHE STUDIMEVE

Rrënojat e kalasë së Beratit prej kohësh kanë tërhequr vëmendjen e studjuarve dhe udhëtarëve të huaj. Autorë të ndryshëm si Farlati, Pukëvili, Liku, Batifoli, Prashnikeri etj. kanë lënë në studimet e tyre edhe disa shënime të shkurtra pér këtë kala.

Një pjesë e tyre jepin të dhëna që lidhen kryesisht me muret rrëthuese, portat dhe kullat mesjetare si elementë për-

bëres te sistemit te fortifikimit mbrojtës të këtij qyteti. Midis tyre Prashnikeri ka qenë i pari që në substrukcionet e fortifikimeve të këtij qyteti pat vënë re mbeturina ndërtimesh të lashta.<sup>8</sup> Si të tilla ai përmend gjurmët e gurëve kuadratikë të ripërdorur në murin perëndimor të bastionit që përparon drejt jugut. Gjurmët të tilla ai pat vënë re aty këtu në murin lindor dhe afërsisht në mesin e tij ai kishte gjetur ende në këmbë deri në një gjatësi prej afro 6 m linearë një pjesë nga muri i lashtë, i ndërtuar me bloqe të mëdha gurësh. Studiuesi ka vënë në dukje gjithashtu se shtresat e poshtme të kullës së madhe të qoshes verilindore të kalasë dhe muri që formon një oboir përparrë portës së vërtetë ishin ndërtuar në pjesën më të madhe të tyre me material të lashtë. Mbi bazën e këtyre të dhënave Prashnikeri pat shtruar hipotezën se «muret mesjetare, me sa duket, ndjekin kudo konturin antik». Këto të dhëna që kemi prej tij janë me rëndësi, veçanërisht në ato pika ku nuk janë bërë gjermime. Ato kanë ndihmuar në rindërtimin e planimetrisë të këtij qyteti.

Ndër studiuesit e fundit të shekullit të kaluar Pukëvili shënon se njëra nga portat e qytetit ka qenë portë urë,<sup>9</sup> ndërsa Tozer përmend dy radhë muresh, që mbronin kalanë,<sup>10</sup> por që i pat gjetur të rënuar. Mendimi i L. Reit se ndërtimet e bëra në kullën nr. 23 janë të periudhës të hershme bizantine është konsideruar i padrejtë.<sup>11</sup> Për hyrjen E. Çelebiu mendonte se përbëhej nga tri porta 100 hapa larg njëra tjetrës.<sup>12</sup>

Studiues të tjerë të fundit të shekullit të kaluar dhe të fillimit të këtij shekulli, midis tyre i pari Liku, më pas Batifoli, Tomashku, Prashnikeri dhe më vonë Shuflai kanë

8) C. Praschniker — A. Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wjen, 1919, f. 61-65.

9) F.C. Poqueville, *Voyage de la Grèce*, Paris, 1820, vol. I, f. 299.

10) H.F. Tozer, *Researches in the Highlands of Turkey*, London, 1869, vol. I, f. 218.

11) L. Rey, *Guide d'Albanie*, 1930, f. 102; Është fjala për kullën nr. 23, sipas emrimit të A. Baces..., f. 49.

12) E. Çelebiu, «*Shqipëria para dy shekujsh*», (botimi shqip) Tiranë, 1990, f. 55.

shfaqur mendimin e tyre mbi identifikimin e rrënojave të qytetit ilir të Antipatreas me kalanë e Beratit<sup>13</sup>.

Midis studiuesve të sipërpermendur Farlati është i pari që mbron tezën e identifikimit të kalasë së Beratit me Pulheriopolisin të themeluar sipas tij nga Pulheria e motra e Theodhosit II<sup>14</sup>, hipotezë që përkrahej pa baza nga Rikaqis.<sup>15</sup> Përpjekja e parë për t'i parë në një kuadër më të gjerë fortifikimet mbrojtëse të kalasë së Beratit, në periudhën para fillimit të gërmimeve, është bërë nga A. Baçe<sup>16</sup>. Pas vrojtimesh të kujdeshshme në fortifikimet ekzistuese autorë ka mundur të dallojë dhe të analizojë disa periudha ndërtimi, të cilat i lidh edhe me ngjarjet historike të kohës<sup>17</sup>.

### 3. GËRMIMET

Të dhënat e deritanishme kanë qenë të pamjaftueshme për të krijuar një ide mbi zanafillën e jetës në kalanë e Beratit dhe mbi vazhdimësinë e saj. Për të plotësuar këtë boshillëk u organizuan aty gërmime arkeologjike sistematike në vitet 1973-1975 dhe 1978.

Gërmimet e para arkeologjike në këtë qytet të fortifikuar u bënë në vitin 1973.<sup>18</sup> Ato u përqëndruan në sheshin në të

13) W. Leake, *Travels in Northern Greece*, London, 1835, f. 361, B. Batifoli, *Les manuscrits grece de Berat d'Albania et les codex purpurens*, Paris, 1886, f. 7; C. Praschniker — A. Schober, *vep. cit.*, f. 61. W. Tomashék, Pauly — Wissowa, *Real Encyclopädie der classischen Altertums wissenschaft*, Stuttgart 1884-1889, sv. Antipatrea; M. Sufflay, *Städte und Bürgen Albaniens hauptsächlich während des mittelalters*, Wien und Leipzig, 1924, f. 24.

14) D. Farlati, *Illiricum Sacrum-Jacopo Coleti*, Venetiae 1817, vol. III, f. 436.

15) R. Rikaqis, *Istoriki archeologiki qe laografiki pragmateai teu temoton Beration*, Athene, 1911, f. 6.

16) A. Baçe, *Qyteti i fortifikuar i Beratit*, «Monumentet» 2, 1971, f. 43-63.

17) Rreth këtyre problemeve autorë rikthehet edhe njëherë në librin e sipërpermendor. Shih: A. Baçe, A. Meksi, E. Riza; Berati..., f. 33-48.

18) Në këto gërmime përvëç autores morën-pjesë-si-bashkëpunëtore të jashtëm A. Baçe, Sh. Mane, dhe një grup studentësh të Fakultetit Histori-Filologji dhe të Inxhinierisë. Skicat, planimetritë dhe tabelat u përgatitën nga N. Kodheli, I. Zaloshnja, P. Naipi dhe E. Disha, të ellët me këtë rast i falënderoj. Fotografitë janë bërë nga N. Baba, B. Veseli dhe A. Hyka.

djathtë të hyrjes kryesore të qytetit, në pikën B përgjatë murit V, midis kullave nr. 21 e 22 (Fig. 4,5). Një vend tjetër gërmimi u caktua në të majtë të hyrjes kryesore, në pikën C, në murin A në anën e jashtme të murit ilir të krahut të majtë të korridorit të hyrjes. Po në këtë vit u kryen gërmime dhe në pikën A në anën perëndimore të rrëthimit të qytetit, në murin O, midis kullave nr. 14 e 15 (Fig. 4).




Fig. 4



Fig. 5

Gërmimet në pikat B dhe C, që vazhduan edhe në vitin 1974 patën një rëndësi të vecantë. Ato përvëçse na dhanë një material të pasur arkeologjik, nxorën në dritë një pjesë të konsiderueshme të murit rrëthues të periudhës qytetare ilire dhe elementë që ndihmojnë në sqarimin e sistemit të fortifikimit mbrojtës të këtij qyteti.

Gërmimet e viteve 1975 e 1978 u kryen në pikat D,E,F dhe G si edhe në të djathhtë të portës kryesore, në anën e brendshme të saj<sup>19</sup> (Fig. 4).

19) Për vendosjen e pikave të ndryshme të gërmimit Shih: Rilevimin topografik të planimetrisë të kalasë së Beratit marrë nga originali që ruhet në fototekën e Institutit të Monumënteve të Kulturës në Tiranë. Korrigimet dhe plotësimet në të duke shënuar dhe pikat e ndryshme ku u kryen gërmimet janë bërë nga P. Naipi. Shënojmë me këtë rast që nuk është illogaritur për kullë, pasi nuk rezulton si e tillë, kullën nr. 15 (sipas A. Baçes), është fjala për kontrafortin midis mureve IJ dhe kullave nr. 9 e 10 në planimetrinë tonë.

Prej tyre pika D u vendos në anën lindore të fortifikimit të qytetit, në murin I midis kullave nr. 9 e 10, pika E në anën perëndimore të murit rrethues, jo shumë larg pikës A, në murin Q, midis kullave nr. 16 e 17, pika G u caktua në sheshin pranë xhamisë së kuqe, rrëzë murit rrethues të anës jugperëndimore, në murin L, midis kullave nr. 11 e 12 dhe së fundi pika F e shënuar pranë murit rrethues lindor të qytetit të sipërm.


Gjatë këtyre gërmimeve u piketuan 23 kuadrate  $5 \times 5$  m dhe u eksplorua një sipërfaqe e përgjithshme prej  $575 \text{ m}^2$ . Thellësia ndryshon sipas pikave të gërmimit. Kështu ajo nga 0.75 m (në pikën G dhe 1,60 m në pikën C) arriti në 2,50-4,60 m, në pikat B, D, E dhe F. Bën përjashtim këtu vetëm pika A, ku gërmimi arriti një thellësi prej 7,40 m, dhe që ishte krysisht vend me depozitime të shumta kulturore të përziera.

#### 4. STRATIGRAFIA

Gërmimet e bëra në kalanë e Beratit, siç do ta shohim më poshtë, jo në të gjitha pikat kanë dhënë një stratigrafi të diferencuar qartë. Në shtresat e sipërme vihet re një farë përzierje. Më mirë se kudo stratigrafia vertikale e gërmimit ka dalë e qartë në pikën B, ku u hapën gjithsej 10 kuadrate (I-X). Nga vrojtimet e bëra në profilet e kuadrateve IV, VIII dhe IX (Fig. 6) të hapura këtu dhe nga studimi i materialit arkeologjik jemi përpjekur të jadin një tablo pak a shumë të plotë të shtresave kulturore, që ju përkasin disa periudha të ndryshme kohore të kësaj kalaje. Stratigrafia e gërmimit, ku shtresat kulturore ndjekin njëra-tjetër, flet për një vazhdimësi të pandërprerë të banimit që nga periudha paraqytetare deri në mesjetën e vonë.

# PROFILI PERENDIMOR.

KUADRATI IV



### Legjenda

HUMUS

DHE I PERZIER

ÇAKELL I IMET

" I TRASHE

DHE ARGILOR ME MBETURINA DJEGJE

DHE ARGILOR OKER

" " I NGJESHUR NGJYRE KAFF

" " KAFE I ERRET

" " ME DJEGJE E THENGJ

DJEGJE E FUQISHME

DHE ARGILOR I KUQEREMTE

" " I KUD PA GJETJE

0

100 CM

Fig. 6

## a. Pika B

I. Shtresa e sipërme e gërmimit, kronologjikisht më e vona në pikën B dallon nga ngjyra e çelët e dheut, pak si në të përhimtë e përzier me copëra çakëlli dhe qeramikë mesjetare (Fig. 6).

Në këtë shtresë me trashësi 1,60 m kemi dalluar dy nënshtresa. E para me trashësi 0,75 m karakterizohet nga fragmente qeramike me smalt si tasa, pjata, çibukë tipike për periudhën e pushtimit turk (shek. XV). Nënshtresa tjeter 0,85 m, e trashë përbëhet nga fragmente të qeramikës pàraturke (shek. XII-XIV). Në këtë shtresë përveç qeramikës së përdorimit të përditshëm shtëpiak, u gjetën shumë fragmente tjegullash të harkuara dhe më pak tulla si edhe disa monedha bizantine.

Gjatë gërmimit të kësaj shtrese në pjesën e sipërme të saj në kuadrate II dhe III të pikës B u zbuluan disa varre të kohës mesjetare të vonë, ndoshta të periudhës së pushtimit turk me skeletet e ruajtura deri diku mirë.

II. Në shtresën e dytë dhei vazhdon të jetë i shkrifët, me ngjyrë pak më të errët, gri në kafe. Ai është i përzier me sasira të shumta gurësh me përmasa mesatare.

Në këtë shtresë me trashësi 0,80 m, që nga 1,60 m, shkon deri në 2,40 m thëllësi, mbizotërojnë fragmente tjegullash dhe enësh me parete të holla dhe të trasha (tip amforiskash dhe dinosash) të kohës antike të vonë (shek. IV-VI të e. sonë), të përziera me fragmente të pakta të qeramikës së shekujve të parë të erës sonë.

III. Dhei i shtresës së tretë është i shkrifët me ngjyrë gri të errët në të zezë, i përzier vende vende me copëra thëngjish. Në këtë shtresë me trashësi 0,70 m që shkon nga 2,40 m deri në 3,10 m dhei është i përzier me çakëll dhe fragmente enësh të kuzhinës (vorba, tasa, tava, këpake), dhe të tavolinës (pjata, tasa, amforiska etj.), fragmente enësh me përmasë të mëdha e mesatare (amfora dhe amforiska) si edhe material ndërtimi. Me interes janë në këtë shtresë sidomos fragmentet e qeramikës së piktuar me ngjyrë të kuqe dhe të enëve të tipit pseudoterra-sigillata dhe më pak terra sigillota, si dhe disa copa gotash dhe shishesh prej qelqi të shek. I-IV të e. sonë që u gjetën në një gjendje shumë të fragmentuar.

IV. Në shtresën e katërt dheu gjithashtu është i shkrifët subargjilor dhe dallon nga ai i shtresës së mëparshme nga ngjyra kafe në të murrme dhe vende-vende i kuqërremtë, i përzier aty-këtu me copëra thëngjijsh. Në këtë shtresë me trashësi 0,65 m. dhe thellësi që shkon nga 3.10 m — 3.75 m u gjetën një sasi e madhe fragmentesh të qeramikës masive kryesisht tjegulla të sheshta (solene) dhe më pak të harkuara (kaliptere) dhe disa fragmente tullash. Me shumicë ishin edhe fragmentet e enëve të përdorimit të përditshëm shtëpiak si vorba, tasa kupa, skifosa, pjata, amfora e amforiska etj., që i përkasin periudhës qytetare ilire (shek. III-II p.e. sonë). Në belat e sipërm kjo shtresë ishte e përzier me qeramikë të shekujve të parë të e. sonë.

V. Dheu i shtresës së pestë kulturore dhe të fundit asaj më të hershme të dokumentuar vetëm në kuadratin IV të kësaj pike të vendosur direkt mbi tabanin e tokës në përgjithësi ishte i shkrifët, ngjyrë kafe në të kuqërremtë, i përzier me shumë çakell të mbetur me sa duket nga ndërtimi i murit ilir. Kjo shtresë me një trashësi 0,85-0,90 m shkon nga 3.75 m deri në 4,60 m. Në të ndonëse në një sipërfaqe tepër të kufizuar u zbuluan disa fragmente të pakta qeramike që lidhen me periudhën e parë të banimit në këtë kala (shek. VII-V p.e.sonë). Së bashku me to u gjetën dy pjesë suvaje prej balte me gjurmët e thuprave të pareteve të kasolleve.

### Pika C

Gërmimet në pikën C në anën e jashtme të murit jugor të hyrjes kryesore nuk dhanë një stratigrafi të diferencuar mirë. Përveç materialit të shumtë qeramik të ndërtimit, kryesisht tjegulla, që i përkasin periudhave të ndryshme, në këtë pikë u gjetën shumë fragmente enësh me parete të trasha dhe përmasa të mëdha (dinosa), disa fragmente enësh të përdorimit shtëpiak të përditshëm, qeramikë e tipit pseudo-terra-sigillata, fragmente të qeramikës me smalt, një modello bizantine e shek. VI, gozhdë kovaçi, kocka kafshësh etj. Në shtresën e fundit të kësaj pike u zbulua një varr fëmije, ku u gjet një monedhë e shek. IV të e. sonë.

Në pikën A gërmimet, që kishin më tepër karakter kontrolli, nuk dhanë një stratigrafi të rregullt. Thellësia e përgjithshme e gërmimit në këtë pikë ishte 7,40 m. dhe shtresat

kulturore u gjetën të përziera. Qeramika e zbuluar i përket në pjesën më të madhe të saj periudhës së pushtimit turk dhe më pak asaj paraturke.

Për t'u shënuar në këtë pikë, në shtresën e fundit të gërmimit është zbulimi i një varri, të ndërtuar me rasa guri gëlqeror, fundi i të cilit mbështetej mbi një radhë kloqesh të mëdha gurësh gëlqerorë, kuadratikë, me sa duket mbeturina të murit ilir, i vendosur përmbi të, me sa duket gjatë periudhës së pushtimit romak, në një kohë kur muri nuk e luante më funksionin e tij mbrojtës të dikurshëm.

## Pika D

Në stratigrafinë vertikale të pikës D mundëm të vëçojmë tri shtresa të ndryshme kulturore. (Fig. 7).


I. Shtresa e parë me një trashësi 0,78 m paraqitet e përzier dhe karakterizohet në pjesën e saj të sipërm nga dhë i shkrifët hümusor ngjyrë kafe në të zezë, i përzier me fragmente të paktë të qeramikës së përdorimit të përditshëm, shtëpiak, fragmente tjegullash dhe më pak lillash mosjtarë si edhe qeramikë e përdorimit të përditshëm shtëpiak e periudhës turke dhe mesjetare paraturke si vorba, lasa, pjata dhe enë të tjera të zbuluar nga me smart.

II. Shtresa II e trashë 2,40 m (që shkon nga 0,78 m — 3,18 m) përbëhet nga dhë i shkrifët ngjyrë kafe që pakt ndryshon nga shtresa e mëparshme. Vlen të thëksobhet këtu zbulimi i një sasie të madhe gurësh të thyer (çekull), me sa duket teprica të gurëve të mbetur gjatë ndërtimit të murit rrethues. Duke filluar nga beli 7 i kësaj shtrese deri në kelin e 13 ngjyra e dheut ndryshon dhe anon më tepër nga ngjyra kafe në të kuqérremtë me gjurmë djegieje.

Nga materiali arkeologjik i kësaj shtrese janë për t'u shënuar, përvëç qeramikës masive, enët e kuzhinës dhe të tavolinës kryesisht me smart që i përkasin periudhës para pushtimit turk (shek. VII-XIV), Qeramika me smart e kësaj shtrese është e kufizuar në numër. Në këtë shtresë është gjetur një monedhë bizantine e Teodor XIII Duka Vatacit (shek. XIII).

III. Trashësia e shtresës së tretë nga 3,18 shkon deri në 3,50 m dhe është 0,32 m. Dheu i saj nuk ndryshon shumë nga ai i shtresës së mëparshme dhë i shkrifët ngjyrë kafe

**PROFILI VEROIOR  
SEKTORI D.**



Legjenda

- [Solid black diagonal lines] KAFE E HAPET
- [Solid black horizontal lines] KAFE ME NUANCA GRI
- [Solid black vertical lines] E VERDHE
- [Solid black diagonal lines] E ZEZE ME GURE TE VEGJEL
- [Solid black horizontal lines] KAFE ME PERZIERJE ÇAKULLI
- [Solid black vertical lines] KAFE NE TE VERDHE ME PERZIERJE GURESH

Fig. 7

i përzier me pak guraleca, që ndryshon në mënyrë të dukshme nga fundi i kësaj shtrese duke u bërë më i fortë, me ngjyrë kafe në të kuqërrëmtë dhe me përzierje çakelli.

Për t'u vënë në dukje në këtë shtresë është mbizotërimi i qeramikës me parete të holla si fragmente vorbash e dinosash, karakteristike për kohën antike të vonë.


Me shumë rëndësi për datimin e qeramikës së kësaj shtrese ishte gjetja e dy monedhave bizantine prej bronzi të Justinianit I (527-565).

### Pika F

Gërmimet në pikën F me gjithëse të kufizuara, na dhanë një stratigrafi deri diku të diferencuar mirë. (Fig. 8).

Me përashtim të belave 5 e 9 të kuadratit I të kësaj pike ku u vu re një farë përzierje e shtresave kulturore,

**PRERJA A-A  
SEKTORI 'F, KUADRATI I**



**Fig. 8**

gjatë gërmimit në kuadratet e tjera mundëm të veçojmë 3 shtresa kulturore, që ju përgjigjen tri periudhave kronologjike të njëpasnjëshme.

I. Shtresa e parë që shkon nga 0 m — 0,80 m i përket periudhës së pushtimit turk. Dheu ishte i shkrifët ngjyrë hiri i përzier me sasira të bollshme gurësh gëlqerorë mbeturina nga ndërtimi ose nga rindërtimi i mureve rrëthuese të qytetit të sipërm, që nga fundi i shtresës ai merr ngjyrë kafe të çelët me nuanca të verdha.

Lënda arkeologjike e kësaj shtrese përbëhet kryesisht nga qeramika masive e ndërtimit (fragmente tjegullash e më rrallë tullash) të periudhës së pushtimit turk si edhe enë të përdorimit shtëpiak të përditshëm si pjata, tasa, enë uji të thjeshta dhe me smallt, çibukë etj.

II. Shtresa e dytë me trashësi prej 1 m shkon nga 0,80–1,80 m. Dheu i shkrifët me ngjyrë të çelët pak si në të përhimtë është i përzier gjithashtu me sasira të bollshme çakëlli, fragmente qeramike masive, tjegulla mesjetare dhe më të hershme të ripërdorura. Fragmentet e tullave janë shumë të rralla. U gjetën gjithashtu fragmente enësh të kuzhinës dhe të tavolinës, si vorba, tasa, kana, kotruve dhe ojnohe të periudhës mesjetare paraturke.

III. Shtresa e tretë që nga 1,80 shkon deri në 3 m thellësi ka një trashësi prej 1,20 m, përbëhet nga dy nënshtresa: Nënshtresa I i takon shtresa me fragmente tjegullash e parate dinosash të zbukuruara me tufa vijash të valëzuara që u gjetën «insitu» në kuadratin e parë të këtij sektori, (Fig. 9, 10), si dhe fragmente enësh me përmasa të mëdha të lyera me serë, vorba e tasa karakteristike për kohën antike të vonë etj.

Nënshtresa tjetër i përket shekujve të parë të e. sonë dhe karakterizohet nga fragmente amforash, enësh të thjeshta, midis tyre edhe fragmente të qeramikës pseudo terra sigillata, disa fragmente enësh me pikturim me ngjyrë të kuqe dhe një monedhë e perandorit Komod (175–192 e. sonë).

Stratigrafia vertikale e pikës E jep pak a shumë të njëjtën tablo si në pikën A, megjithëse këtu shtresat kulturore duken më të qarta. Gërmimet në këtë pikë përcaktuan dy shtresa kryesore: e para me trashësi 2,80 m dhe e dyta 1,20 m, që nga 2,80 m shkon deri në 4 m thellësi. Shtresa e parë karakterizohet nga dhë i shkrifët ngjyrë kafe, i përzier me gëlqere e sasira të bollshme çakëlli dhe me qeramikë të periudhës së pushtimit turk. Tek e dyta ngjyra e dheut nuk

PLANIMETRI E SEKTORIT F.  
KUADRATI I




Fig. 9

ndryshon shumë, në të vihen re gurë e çakëll përzier, me fragmente të pakta qeramike të periudhës mesjetare paraturke dhe antiqe të vonë.




Fig. 10

Gërmimet në pikën G treguan se shtresa kulturore ishte shumë e cekët dhe thellësia e përgjithshme e gërmimit nënuk i kalonte 0,75 m. Pothuajse në krejt sipërfaqen e kuadrit, që u hap për qëllime kontrolli, doli shkëmbi natyror.

Qeramika e zbuluar në këtë pëkkë e shumë e pakët dhe tepër e fragmentuar. U gjetën fragmente tjegullash të shekujve të parë të e. sonë dhe antike të vona si fragmente vorbash, kapakësh dhe amforash të zbukuruara me hulli, karakteristike për enët e kohës antike të vonë.

\*  
\*      \*

Duke vrojtuar me kudjes stratigrafinë në pikat e ndryshme të gërmimit vumë re se intensiteti i jetës në qytet nuk ka qënë gjithkund njëlloj.

Për një jetë intensive aktive flet stratigrafia vertikale në pikën kryesore të gërmimit B e cila tregon se jeta aty ka vazhduar pa ndërprerje që nga periudha protourbane deri në mesjetën e vonë. Në pikën C pjesa më e madhe e gjet-

jeve i takojnë kryesisht kohës antike të vonë, çka tregon se në shek. IV-VI të e. sonë ka pasur një intensitet më të madh banimi. Më e zbehtë në këtë sektor del periudha qytetare ilire dhe ajo e shekuje të parë të e. sonë. Pak a shumë e njëjta tablo vihet re edhe në pikën D, ku shtresa kulturore périudhës antike të vonë dhe të mesjetës janë përfaqësuar relativisht mirë, qeramika që i takon shekuje të parë të e. sonë është mjaft e kufizuar, kurse ajo e periudhës qytetare ilire mungon krejtësisht.

Në pikat e tjera të gërmimit (A,G,E) të 'dhënat për shek. I të e. sonë dhe periudhën qytetare ilire ose janë shumë të zbehta ose mungojnë krejtësisht.

Për t'u shënuar është gjithashtu tabloja që na jep stratigrafia e gërmimit në pikën më të lartë të qytetit F, ku periudha e shekuje të parë të e. sonë dhe ajo e antikitetit të vonë janë përfaqësuar mjaft mirë nga materiali arkeologjik. Të dhënat stratigrafike në këtë pikë tregojnë se jeta aty duhet të ketë filluar në shek. II të e. sonë dhe se intensitetin më të madh të jetës duhet ta ketë pasur në kohën antike të vonë. Jeta aty ka vazduar edhe më vonë në periudhën e mesjetës së hershme dhe të vonë. Këtë e tregojnë në një farë mënyre edhe të dhënat e arkitekturës. Gjurmë të ndërtimeve dhe të fortifikimeve të periudhës qytetare ilire dhe të shtresës kulturore përkatëse këtu nuk u gjetën.

## KREU II

### PERIUDHA FROTOQYTETARE (FUND I SHEK. VII — SHEK. V P. E. SONË)

Periudha e parë e banimit në kodrën e qytetit të fortifikuar të Beratit, siç rezulton nga gërmimet arkologjike tani për tani dëshmohet nga disa fragmente enësh (Tab. I, 1-5; Tab. XLIX, 1-8; Tab. L, 1-5). Dhe dy copa suvaje prej balte, që ruajnë gjurmët e thuprave të pareteve të kasolleve (Tab. L, 6-7). Ato vijnë nga rrëthana stratigrafike shumë të qarta të gërmimeve të bëra në pikën B. Lënda arkeologjike që përcakton të vetmin horizont banimi të periudhës protoqytetare të zbuluar deri tani u gjet e veçuar qartë në kuadratin IV dhe pjesërisht në atë të V në thellësinë 4,30-4,60 m, që ishte shtresa e fundit kulturore e depozituar drejtpërdrejt përmbi tabanin steril të tokës.

Në qeramikën e kësaj shtrese, ndonëse të pakta në numër, dhe tepër të fragmentuara, dallohen dy grupe kryesore:

- 1) Enë të prodhimit vendas.
- 2) Enë të importuara.

#### 1. QERAMIKA E PRODHIMIT VENDAS

Në qeramikën e këtij grupi të prodhuar kryesisht pa çark murid të vëçohen enë të thjeshta dhe enë me pikturim. Në enët e thjeshta hyjnë ato më parete relativisht të hollë dhe përmasa mesatare dhe enë më parete, jo shumë të trasha

dhe përmasa të mëdha, pitosa. Enët e thjeshta e të zakonshme janë përgatitur nga një baltë jo shumë e pastër që ka në përzierje grimca gurësh gëlqerorë. Ngjyra e pjekjes është kafe në të kuqërrëmtë dhe ndonjëherë gri ose okër në rozë mat. Midis tyre për t'u përmendur janë:

1. Fragment buzë ene tip vorbe, punuar në mënyrë trashanike me dorë (Tab. I, 2). Një enë shumë të përafërt me këtë e ndeshim në qeramikën e shtresës kulturore që i takon etapës I të zhvillimit të jetës të vendbanimit protoqytetar të Dimalit në konteks gjetjesh që i takojnë periudhës I të hekurit e ndoshta edhe më përpara<sup>20</sup>.

2. Fragment buzë tasi me sipërfaqe të lëmuar (Tab. I, 4). Është e ngjashme me një ekzemplar nga Kuçi i Zi<sup>21</sup> dhe me një tjetër nga qeramika e shtresës protoqytetare të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme. forma e të cilit mendohet se është huazuar nga repertori helen<sup>22</sup>.

3. Për t'u shënuar në qeramikën e këtij grapi është edhe një vegjë ene e fragmentuar me seksion elipsoidal.

4. Qeramikës së këtij grapi i takon edhe një vegjë tjetër enë e fragmentuar me seksion katërkëndësh. (Tab. I, 5). Vegja të tillë janë të pranishme në qeramikën protoqytetare të Dimalit dhe në atë të gjetur në shtresën protourbane të qytetit ilir pranë Selcës së poshtme<sup>23</sup>.

Në qeramikën e prodhimit vendas vlen të përmenden fragmentet me pikturnim, që dallojnë jo vetëm për baltën e edhe për pikturnimin. Ngjyra e pjekjes është okër në rozë tuar nuk na lejon të gjykojmë për format që kanë pasur. Po përmendim midis tyre:

5. Paret ene e modeluar me dorë (Tab. XLIX, 1). Mbi katër via paralele nga 0,5 mm të trasha secila, që i vijnë

20) B. Dautaj, *Aspekte të jetës ekonomike në Dimal*, «Iliria» VI, 1976, f. 149, Tab. I, 6.

21) Zh. Andrea, *Kultura ilire e tumave në pellgun e Korçës*, Tiranë 1985, f. 158, Tab. XL, varri 10, nr. 1.

22) N. Ceka, *Kultura protoqytetare ilire*, «Iliria» 1, 1985, f. 122, Tab. VI, 21.

23) Po aty, Tab. I, 5; N. Ceka, *Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme*, Tiranë 1985, f. 25, Tab. VIII, 5, 9.

rreth e qark enës, poshtë të cilave duken gjurmët e një trikëndëshi të varur me kulmin poshtë, të mbushur me vija të holla paralele. Boja e përdorur për pikturimin është kafe gështenjë mat. Mënyra e pikturimit, teknika dhe motivet e përdorura e afrojnë këtë lloj qeramike me qeramikën e pikturuar para pjekjes të fazës Barç, V, (shek. VI-V p.e.sonë Rr. i Korçës)<sup>24</sup> me qeramikën e pikturuar të fazës II të vendbanimit të Liqenit (Rr. Skraparit)<sup>25</sup> dhe me qeramikën e pikturuar të tumës së Rehovës (Rr. Kolonjës), të gjetur në varret 221, 222 dhe 247 në konteks gjetjesh që i takojnë fundit të shek. VII p.e.sonë.<sup>26</sup>

6. Fragment i vogël ene me parete relativisht të holla, i zbukruar në sipërfaqe me pikturim të bërë para pjekjes, me friz trikëndëshash të mbushur me vija paralele që kufizohen me vija 0,18 mm, të trasha (Tab. XLIX, 5). Boja e pikturimit është kafe e errët në gështenjë mat. Ena është e lyer nga brenda me serë. Ngjashmërinë më të madhe copa jonë e ka me një enë të zbuluar në varrin nr. 10 të tumës II të Kucit të Zi (Rr. Korçës) dhe me disa fragmente enësh me pikturim që vijnë nga nënshtresa II e vendbanimit protourban të Belshit (Belsh II c),<sup>27</sup> të cilat janë datuar në shek. VII-VI p.e.sonë.

7. E përafërt pér nga balta, teknika e punimit dhe boja e pikturimit me copën e mësipërme është edhe një parete, që ndryshon nga e para vetëm nga motivi i zbukurimit, i cili përbëhet nga dy vija të trasha paralele. Ena është gjithashtu e lyer nga brenda me serë (Tab. XLIX, 4).

8. Vegjë ene cilindrike e fragmentuar e dekoruar në rreppjesën e sipërme me vija lineare paralele jo shumë të rregullta të bëra para pjekjes me bojë kafe gështenjë. Kjo lloj vegje dhe pikturimi i saj do të ndeshen më vonë, si elemente të traditës, në qeramikën e pikturuar të periudhës qytetare ilire të këtij qyteti (Tab. LIII, 11).

*Pitosa.* Në qeramikën e periudhës protourbane një grup

24) Zh. Andrea, vep. cit., Tab. XVI, varri 171.

25) L. Ylli, *Vështrim arkeologjik i kulturave prehistorike dhe antiike ilire në rrëthin e Skraparit* (Disertacion), Tiranë 1986.

26) S. Aliu, *Tuma e Rehovës* (Disertacion), Tiranë, 1987.

27) Zh. Andrea, vep. cit., f. 158, Tab. XL, varri 10 nr. 1; N. Ceka, *Vendbanimi paraqytetar në gradishtën e Belshit*, «Iliria» III, 1974, f. 498, Tab. I, 14.

më vete përbëjnë 50 barqe enësh me parete shumë të trasha, dhe me përmasa të mëdha, pitosa. Janë përgatitur prej një balte të ashpër që përmban në përzierje grimca gëlqerore, që ia rrisin enës rezistencën. Lyerja e disa copave prej tyre nga brenda me serë tregon se përvëç pilosave që shërbën për rezervimin e ushqimeve të thata (drithërave), ka pasur edhe të tjera ku depozitoheshin lëngjet.

9. Një brimë me diametër 8 mm e hapur në një paret pitosi pas pjekjes tregon për përdorimin e tij, edhe pas thyerjes për mbajtjen e drithërave. (Tab. L, 4).

## 2. QERAMIKA E IMPORTUAR

Në enët e mëdha të qeramikës së importuar hyjnë:

10. Buzë amfore pothuajse horizontale, me prerje të lehta të rrafshit të sipërm punuar njësh me grykën e zgjeruar. Balta e ashpër ngjyrë okër përmban kokrriza gurësh të bardhë, që dallohen nën cipën e fakturës (Tab. I, 1). Është fragment i një amfore tregtare me tipare karakteristike të amforave korintike të tipit A të gjysmës I të shek. VII p.e.sonë.<sup>28</sup> Amfora të ngjashme me copën tonë janë gjetur në qeramikën e shtresës protoqytetare të vendbanimit ilir të Triportit, që i përkasin shek. VII-VI p.e.sonë dhe në Butrint (amforat e tipit A).<sup>29</sup> Ato i ndeshim edhe midis qeramikës arkaide në Torre S. Sabina, të datuara gjithashtu në shek. VII. p.e.sonë.<sup>30</sup> Copa jonë duket se afrojn më tepër me amforat e Margëlliqit dhe si ato duhet t'i përkasi gjysmës II të shek. VII, kohës kur fillon eksporti i tyre.<sup>31</sup>

11. Buzë krateri me parete shumë të trasha, i përgatitur prej një balte të pastër. Pjekja e mirë në ngjyrë rozë të

28) C. Koehler, *Corinthian A and B amphoras*, Princeton, 1980, nr. 18, f. 13.

29) V. Bereti, *Vendbanimi ilir i Triportit* (Disertacion) Tiranë 1988, f. 61, Tab. nr. 29; A. Nanaj, *Butrinti protoqytetar* (Disertacion) Tiranë 1988, f. 63; nr. 31, Tab. XVII.

30) F. D'Andria, *Le ceramiche archaiche da Torre-S. Sabina (Brindisi) e gli apofiti adriatici della Messapia* «Ricerche e Studi» IX, 1976, f. 55, fig. 14-15; f. 57, fig. 16.

31) N. Ceka, *Amfora antike nga Margëlliçet*, «Iliria», 2/1986, f. 13; Tab. I, 5.

çelët në okë. Sipërfaqja e enës ëshë e lyer me vernik të zi me shkëlqim metalik. Diametri i grykës 36 cm. Fragmen- ti ynë është i përafërt me krashtat e gjetura në Torre-S. Sabina të Italisë të datuara në shek. VII p.e.sonë.<sup>32</sup> (Tab. I, 3. Tab. L, 1).

12. Vegjë masive e ndonjë krateri punuar prej një bal- te të pastër ngjyrë okër në rozë dhe e lyer me vernik të zi me shkëlqim argendi (Tab. L 3). Për nga balta dhe ngjyra e vernikut, të përdorur kjo copë është shumë e ngjashme me copën e mësipërme (nr. 11) dhe duken si pjesë të të njëjtë krater.

13. Edhe një copë tjetër, me sa duket pjesa e sipërme e buzës së një krateri, hyn gjithashtu në grupin e qerami- kës së importuar. Është përgatitur nga një argjilë e pastër ngjyrë okër, e piketur mirë, me sipërfaqe të lëmuar dhe e lyer nga brenda me serë.

Disa fragmentë të tjera enësh, kryesisht parete, bëjnë pjesë në grupin e enëve të luksit me përmasa të vogla dhe mesatare. Copat janë të fragmentuara dhe nuk lejojnë, veç- se së ndonjë rast të rrallë, të jepin gjykim mbi format e tyre. (Tab. XLIX, 7, 8).

Mënyra e pikturimit, të këtyre enëve prej të cilave di- sa janë të lyera nga brenda dhe të tjera në të dy anët, me vernik të zi me shkëlqim metalik ëshë karakteristikë pér qeramikën arkaike të fundit të shek. VII-V p.e.sonë. (Tab. LXIX).

14. Vlen të përmenden në mes tyre veçanërisht dy pa- rete enësh të përgatitura prej një argjile të pastër ngjyrë okër me fakturë të lëmuar. Nga brenda janë të lyera me brevernik kafe që anon nga e kuqja, ndërsa nga jashtë me breza të purpurt (Tab. XLIX, 3, 7) ngjyrë kafe në vishnje me shkëlqim argjendi, që i përkasin enëve të luksit, karakteristikë pér shek. VII-V p.e.sonë.

15. Paret kyliksi. Copa është tepër e fragmentuar, me gjithatë në pjesën e brendshme të tij vihet re një brez i ngushtë i kursyer, i lënë pa u lyer, që i vinte rreth e qark enës së lyer me vernik të zi.

16. Paret i ndonjë pseudolekiti, me pjesën e poshtme

---

32) F. D'Andria, rep. cit., f. 50.

të fryrë në formë vezake. Është lyer nga brenda me vernik të zi me shkëlqim argjendi.

17. Vegjë e vogël me prerje rrethore e ndonjë kupe apo skifosi, punuar prej balte të pastër, pjekja e mirë ngjyrë okër. Vegja është e lyer me vernik kafe ngjyrë ulliri me shkëlqim metalik. (Tab. L, 5).

18. Vegjë ene me pjesë pareti jo shumë të hollë dhe përmasa mesatare, punuar me çark, prej një balte të pastër ngjyrë okër, pjekja uniforme. Ena ka qenë lyer në të dy anët me vernik kafe me breza të purpurt e shkëlqin. argjendi.

19. Fragment ene grykëgjerë me buzë të shpërvjela nga jashtë që fryhen në skaje dhe e kalojnë trashësinë e parateve. Është punuar prej një balte të situr mirë, pjekja uniforme ngjyrëokër. Ena është e lyer nga brenda me vernik të kuq, që cifloset lehtë.

20. Fundit të kësaj shtrese kulturore i përket një gjil-përë flokësh prej bronzi ndoshta dykokëshe, e thyer (Tab. XLVI, 17). Ajo ka formën e një shufre metalike me sek-sion rrethor pak të fryrë në pjesën e mesit, që zbukurohet në të dy anët nga dy kokrriza të kufizuara lart e poshtë me nga tri rruaza të vogla. Në pjesën e sipërme të skajeve duhet të ketë pasur një mbaresë në trajtë oblike që nuk ruhet. Këto lloj gjilpérash janë njojur nga studiuesit si punim i pastër ilir, në territorin e të cilëve kanë arritur një zhvillim të plotë.<sup>33</sup> Janë gjetur në varrezën e Trebenishtit (Maqedoni-Jugosllavi)<sup>34</sup>, në Kalkidi, Bosnjë e gjetkë.<sup>35</sup> Studiuesit i kanë vendosur gjilpérat dykokëshe në një grup të veçantë<sup>36</sup> dhe i datojnë në çerekun e parë të shek. V p.e.sonë (v.425), kohë së cilës mendojmë se duhet t'i përkasë edhe gjilpëra jonë.

---

33) V. Lahtov, *Problem Trebeniske kulture*, Ohrid, 1965, f. 64.

34) B. Filow, *Die archaische Necropole von Trebeniste*, Leipzig-Berlin, 1927, f. 29, 4.

35) P. Amandry, *Collection Hélène Stathatos, Les bijoux antiques*, Strasbourg 1953, Tab. XXIV, 139, 140, 143-145; P. Jacobsthal, *Greek Pins and their connexions with Europe and Asia*. Oxford 1956, sl. 114-123.

36) P. Jacobsthal, vep. cit., sl. 118; sl. 343-347.

Zbulimi pér herë të parë në shtresën kulturore të fundit, kronologjikisht më e hershmja, të gjermimit në kalanë e Beratit, të qeramikës protoqytetare dhe i fragmenteve të suvasë prej balte hedhin një dritë të re mbi lashtësinë e këtij vendbanimi. Fragmentet e suvasë prej balte me gjurmët e thuprave të pareteve të kasolleve (Tab. L, 6, 7) janë, tanë pér tanë të vetmet dëshmi që flasin pér karakterin e banesave të këtij vendbanimi.

Vendbanimi protoqytetar i Beratit nuk është i vetmi në rrëthin e tij. Zbulimet e rastit dhe gjermimet arkeologjike sistematike kanë dhënë një material të pasur arkeologjik që vjen nga vendbanimet e hapura protoqytetare pranë Beratit.<sup>37</sup> Siç tregon materiali arkeologjik, ai qëndron në unitet me vendbanimet e periudhës protoqytetare të territorit tonë, që janë njojur si rezultat i një procesi të ri ekonomiko-shoqëror, që zhvillohet në Ilirinë e Jugut në shek. VI-IV p.e.sonë.<sup>38</sup>

Në klasifikimin e përgjithshëm të vendbanimeve protourbane të bërë mbi bazën e formës dhe intensitetit të jetës. Vendbanimi protoqytetar i Beratit është radhitur në grupin e dytë të vendbanimeve protourbane të mbrojtura, jeta e të cilave zhvillohet në një terren të mbrojtur natyror, të pafortifikuar.<sup>39</sup>

Në qeramikën e shtresës protoqytetare të tërheqin vëmendjen ndër të tjera, fragmentet e qeramikës së pikturuar të stilit devollit. Një qeramikë me tipare të tilla, siç kanë qenë në dukje studiuesit e ndryshëm, njihet edhe nga qendra të tjera.

Mund të përmendim këtu qeramikën e fazës II të vendbanimit të Liqethit (Rr. i Skraparit), qeramikën e vendbanimit shpellor të Katundasit (Qyteti Stalin — Rr. i Beratit), qeramikën që vjen nga shtresa protoqytetare e qytetit ilir

37) N. Ceka, Kultura..., f. 118; M. Korkuti, Gërmimet e viti 1986 në shpellën e Katundasit, «Iliria» 2/1986, f. 251-252.

38) N. Ceka, Vendbanime protourbane në Ilirinë e Jugut, «Iliria», 7-8, 1977-1978, f. 255.

39) Po aty, f. 255-256.

pranë Selcës së Poshtme, nga nënshtresa II e vendbanimit të Belshit (Belsh II c); nga Treporti etj.

Në pikturimin e kësaj qeramike kemi përsëritjen e elementeve të traditës, që vihen re në repertorin e motiveve të trashëgura kryesisht nga faza II e hekurit. Motivet e saj kanë karakter gjemotik dhe linear. Në kombinimin e tyre vërehet e njëjtë renditje ashtu si në qeramikën devollite, vëtëm pikturimi është bërë në mënyrë më pak të kujdesur. Këto tipare i dallojnë fragmentet tona nga qeramika e pikturuar devollite e fazave më të hershme dhe e përcaktojnë këtë grup qeramik si të fazës më të fundit të zhvillimit të qeramikës devollite, e cila nga qendra kryesore e prodhit të saj në pellgun e Korçës është përhapur edhe në krahina të tjera jugore të vendit tonë.

Qeramika me tipare të qarta arkaike, ndonëse e kufizuar në numër, na shtyn ta kërkojmë prejardhjen e saj në sendet e importit që vinin nga marrëdhëni me Korintin dhe viset e Italisë Jugore. Në zhvillimin e brendshëm ekonomik e shoqëror të këtij vendbanimi protoqytetar një rol të rëndësishëm ka luajtur, pa dyshim, pozita gjografike e tij. Periudha që përfshin fundin e shek. VII-V p.e.sonë përvendbanimin e lashtë të Beratit është koha e zhvillimit të brendshëm ekonomik e shoqëror, i cili do të çojë nga fundi i shek. IV-fillimi i shek. III në lindjen dhe lulëzimin e qytetit ilir të tipit skllavopronar, në këtë truall. Shtresa kulturore që pason atë protourbane në gërmimet e këtij qyteti, që kronologjikisht i takon shekujve V-IV p.e.sonë duhet thënë se tani për tani nuk është kapur dhe përbën një hiatus, arsyet e të cilët mendojmë se duhen kërkuar në gërmimet e pamjaftueshme. Për vështirësitë që paraqiste tregreni këto gërmime nuk dhanë mundësi të rrrokej në stratigrafi shtresa kulturore që paraprinte periudhën qytetare ilire të shek. III-II p.e.sonë, gjë që shpresojmë se do të plotësohet në të ardhmen.

### KREU III

#### PERIUDHA QYTETARE ILIRE (SHEK. III P.E. SONË — — SHEK. IV I E. SONË)

Antipatrean ilire e përmendur për herë të parë nga Polibii,<sup>40</sup> është identifikuar nga shumica e studiuesve me kalanë e Beratit. Nga një pasazh i këtij autori antik, ku përshkruan luftërat iliro-romake, mësojmë se komandanti ilir Skerdilaidi, në vitin 216 p.e.sonë menjëherë pas paqes me etolët, kishte pushtuar nga njëra anë Piseun, qytet i vogël në Pelagoni, nga ana tjetër kishte bërë për vete me premtimë, midis qyteteve të Dasaretisë, Krysondyon, Geruntin edhe Antipatrean, që ndodheshin në duar të maqedonëve.

Nga një mesazh tjetër, sapas dëshmisë së Tit Livit<sup>41</sup> mësojmë se Legati romak Luc Apusti, sulmoi në vitin 200 mësojmë se Legati romak Luc Apusti, sulmoi në vitin 200 Duke pasur besim tek madhësia e qytetit nuk pranoi ta lëshojë pa luftë atë. Legati romak e pushtoi qytetin me forcën e armëve dhe pasi vrau të gjithë banorët nga 16 vjeç e lart, lëshoi ushtrinë në plaçkë dhe i vuri zjarrin qytetit. Kjo e dhënë e Tit Livit, ndonëse në dukje e ekzagjetuar, tregon se popullsia nuk e lëshoi kalanë pa luftë, por i bëri një qëndresë heroike ushtrive romake.

---

40. Polibius, V, 108, 2 në I.I.A.A. f. 59.

41. Livi, XXXI, 27, 2, 3, 4, 5 në I.I.A.A. f. 107.

## 1. MURET RRETHUESE TË PERIUDHËS QYTETARE ILIRE

Kodra e qytetit të fortifikuar të Beratit ka formën e një trikëndëshi të çrregullt të rrethuar me mure që formojnë anët e gjata të lakuara, prej të cilave ajo lindorja arrin deri në 600 m gjatësi, ndërsa ana veriperëndimore dhe jug-perëndimore nga 400 m. secila. Kështu muret rrethuese të periudhës qytetare ilire duke iu përshtatur konfiguracionit të terrenit të kodrës arrijnë një gjatësi prej 1400 m. linearë.

Këto mure së bashku me sistemin e kullave dhe të galerive që lidhin këshjellën me lumin rrethojnë një sipërfaqe prej 16 ha, nga e cila 10 ha i takojnë territorit të breshtshëm të qytetit, ku sot shtrihet një lagje karakteristike me tipare arkitektonike të krijuara në shek. XVIII-XIX dhe disa monumente kulti (shek. XIII-XIV).

Në fushatën e parë të gërmimeve në pikën B u zbulua faqja e brendshme, e një pjese të murit rrethues perimetror të anës veriperëndimore të qytetit që i takon periudhës qytetare ilire.<sup>42</sup> Në pikën C u gërmuan më tej dy trakte të tjera muresh në anën e jashtme juglindore të korridorit të hyrjes, të zbuluara pjesërisht gjatë punimeve restauruese të vitit 1967.

Gërmimet në rrënojat e qytetit ilir të Antipatreas dhanë jo vetëm një tablo më të plotë të murit rrethues.<sup>43</sup> Por krijuan mundësi që të studioheshin karakteristikat e teknikës së ndërtimit në pjesë të ndryshme të tij.

Ky mur, ndonëse i dëmtuar nga rrebeshet e kohës, përbën tanë përfshirë tanë, traktin më të bukur dhe të ruajtur më mirë të mureve rrethuese të periudhës qytetare ilire. Përpërafte gërmimeve prej tij shihet vetëm një pjesë e vogël në faqen e jashtme pranë kullës 21 në murin V (Fig. 11, 12). Në këtë anë murin mundëm ta ndjekim deri në një gjatësi prej 27 m dhe u vu re se kishte drejtëm verilindje-jugpe-

42) Në emërtimin e mureve rrethuese dhe të kullave jemi nisur nga gërmimi ynë në pikën C. Përfshirë kuptimi muret janë shënuar me gërmat e mëdha të alfabetit, kurse kullat me shifra arabe.

43) H. Spahiu, *Rezultatet e gërmimeve të vitit 1974 në kalanë e Beratit*, «Buletin Arkeologjik» 5, 1975, f. 79, Tab. I (Më poshtë kjo revistë do të jepet shkurtimisht «B.A.»).




Fig. 11




Fig. 12

rëndim. Në këtë pikë ai ruhej nga 4 deri në 6 rrështë të plotë me një lartësi nga 1,50 m deri në 2,65 m (Fig. 13).

Në një trakt të këtij muri të zbuluar, ku gjermimi arriti thellësinë më të madhe prej 4,60 m, u pa se ai ngrihet përmbi një themel të ndërtuar prej gurësh gëlqerorë me forma të çrregullta. (Fig. 14). Ata janë vendosur për së gjati në mënyrë të tillë, që lejojnë të dalë jashtë një pjesë e vogël në formë xokolature, prej 14-19 cm. Gurët e themelit në pjesën e sipërme të tyre janë gdhendur joli a shumë rrafsh për të mbajtur ndërtimet e fuqishme që ngriheshin mbi ta. Ata kanë një gjatësi që shkon nga 0,54 m deri në 0,94 m me një lartësi që nuk i kalon 0,49 m.

Muri ka dy këmisha dhe mbushjen, e cila në këtë rast nuk duket, por që zakonisht përbëhet, si në shumë mure të qyteteve të tjera ilire, prej gurësh të thërrmuar, tepriçia të punimit të bloqeve gjatë ndërtimit të murit.

Faqja e brendshme e tij është ndërtuar prej bloqe gurësh me përmasa relativisht të mëdha, gjatësia e të cilave vende-vende arrin nga 2,84 deri në 3,40 m. Bloqet e gurëve




Fig. 13




Fig. 14

kanë forma katrore dhe katërkëndëshi kënddrojtë, me mbi-zotërimin e këtij të fundit. Ata janë vendosur njëri mbi tjetrin në tashë, pa kurfarë lidhjeje.

Në renditjen e bloqeve me radhë paralele në përgjithësi vihet re se ato nuk kanë ndonjë ndryshim të dukshëm të lartësive, gjë që përcakton edhe stilin kuadratik izodemik (Fig. 13, 14) që është nga më të përhapurit në fortifikimet ilire të vendit tonë dhe që i takon në përgjithësi shek. III p.e.sonë.<sup>44)</sup> Por duhet thënë se aty-këtu në teknikën e ndërtimit të këtyre mureve vihen re edhe ndikime të pseudoi zodomikut. Nga ana tjetër ka raste, ndonëse më rrallë, kur rreshtimi vijëdrejtë, nuk ruhet kudo njëlloj për shkak sistë përdorimit të bloqeve të dhëmbëzuara. (Fig. 15). Sistët përdorimit që ndeshet në muret e shumë qyteteve mi i shkallëzimit që ndeshet në muret e shumë qyteteve

44) Gj. Karaiskaj, *Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë, 1931, f. 85.

filire,<sup>45</sup> edhe këtu është zbatuar për të kursyer dhe përdo-rur sa më me nikoqirllëk materialin e gurtë. Gjatësitë e blloqeve janë: 0,43 m; 0,75 m; 0,90 m; 1,08 m; 1,32 m;




Fig. 15

1,40 m; 1,50 m; 1,72 m; 2,65 m; 2,85 m; 3,40 m me një mbizo-tërim të gjatësisë nga 0,90 m deri në 1,50 m, kurse lartësitë e tyre janë 0,32 m; 0,45 m; 0,47 m; 0,50 m; 0,60 m, ku më e zakonshme është lartësia 0,45 m.

Me qëllim që të sigurohej një mbështetje sa më e si-gurt dhe të mënjanoheshin boshllëqet, ndërtuesit i kanë ku-shtuar një kujdes të veçantë përpunimit të faqeve anësore të gurëve, kështu që në muraturën e fituar në këtë mënyrë është arritur një puthitje mjaft e mirë e blloqeve, si në drejtëtim horizontal edhe në atë vertikal.

Ajo që të bie menjëherë në sy në ndërtimin e kë-tij muri është se në pjesën më të madhe të blloqeve faqja e tyre e jashtme është lënë e gufuar me një mysëti që

45) S. Islami, *Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri*, «Ili-ria» II, 1972 f. 27.

shkon nga 10-15 cm. Ato dallojnë për një punim të trashë, që nuk është gjithkund i një trajtshëm (Fig. 14). Në të viven re gropëzime e të ngritura që i japin fasadës pamje të ashpër. Por në disa pjesë të këtij muri ndodh që së bashku me blloqet me sipërfaqe të gusuara janë përdorur aty këtu, dhe blloqe kuadratike me faqen e tyre ballore të punuar rrafsh, në të cilën dallojmë qartë gjurmët e çukatjes së daltave metalike majëmprehëta të muratorit. Nga pikë-pamja e teknikës së ndërtimit këto mure ngajnjë me muret e periudhës ilire të kalasë së Goricës dhe të Kalasë së Prishtës<sup>46</sup>. Nga vrojtimet e bëra në gjithë gjatësinë e murit të periudhës qytetare ilire të zbuluar në pikën B vumë re se blloqet me faqe të gusuara nuk formojnë trakte të shkëputura, por janë të shpërndara në të njëjtin mur së bashku me blloqet me faqen ballore të sheshtë.

Këmisha e jashtme dhe e brendshme e këtij muri kanë qenë lidhur tërthorazi me njëra-tjetrën me blloqe të vendosura transversalisht (diatonat) në distanca pothuajse të barabarta. Në radhën e poshime blloqet transversale janë vendosur pas dy blloqeve me brinjën e gjatë në ballë, në një largësi prej 2,93 m. Në rreshtin e tretë, ato përsëriten në largësi të barabartë prej afro 3 m. Këtu muri ka një trashësi që lëviz nga 3,12 m-3,35 m.

Përdorimi i blloqeve transversale, i këtij elementi ndërtimor mjaft të rëndësishëm, si edhe gdhendja me shirit anësor, janë elemente të përdorura edhe në ndërtimet e qyteteve të tjera të trevës iliro-jugore dhe cpirote si në Zgërdhesh, Lis, Antigone<sup>47</sup>. Irmajt<sup>48</sup> etj.

Gjatë gërmimit duke gjurmuar murin e periudhës qytetare ilire në drejtim të jugperëndimit vumë re se ai ndërpritej nga një portë me boshtin e korridorit të saj në drejtim veriperëndimor (Fig. 16). Kjo portë, sot e mbushur me dhe gurë, dikur të çonte në kullën 21. Është e lartë 1.37 m

46) L. Ylli; *Dy kështjella...*, f. 125; Sh. Mane, *Kalaja e Goricës*, «Monumentet» 2, 1987, f. 147-151.

47) DH. Budina, *Disa rezultate të gjurmimeve në vendbanimet e lashta të Kaonisë*, «Konferenca II e studimeve Albanologjike» Tiranë 1969, f. 324; Po ai, *Antigonea*, «Iliria», II, 1972, f. 156, fig. 6.

48) S. Islami, *Qyteti ilir në Zgërdhesh*, «Iliria» II, 1972, f. 201, 202, Tab. III, 5; F. Prendi — K. Zheku, *Qyteti ilir i Listit, Origjina dhe sistemi i fortifikimit të tij*, po aty, f. 220; F. Prendi — Dh. Budina, *Kalaja e Irmajt*, «Iliria» II, 1972, f. 25, 48. Tab. V, 6.

FASADA E BRENDSHME E MURIT ILIR




Fig. 16

dhe e gjerë 1,47 m. Dy blloqe me gjatësi 0,46 m dhe 0,63 m. të vendosura në pjesën e poshtme të saj, kanë qenë me sa duket, të pragut të portës. Në pjesën e sipërme të portës është vendosur një arkitra prej guri gëlqeror me gjatësi 2,55 m dhe lartësi 0,40 m.

Muri vazhdon më tej, në drejtim të jugperëndimit edhe gati 3 m të tjera, ku përsëri vërehet një boshillëk, po këtë radhë i shkaktuar nga kthesa që bën muri në drejtim pingul me murin e mëvonshëm mesjetar.

Kulla 21 ndodhet në anën veriperëndimore të murit rrëthues 48 m larg kullës 22 në anën jugperëndimore të saj (Fig. 4.) Ajo është e projektuar 7,16 m jashtë vijës së këtij muri dhe ka formë katërkëndëshi të rregullt, me brinjën verilindore 3,80 m, në pjesën e poshtme të së cilës ruhen dy deri në pesë rrështha blloqesh gëlqerorë, me një lartësi të përgjithshme prej 2,65 m. Ky mur i ndërtuar prej gurësh kuadratikë, dallonet për pënnasat shumë të mëdha të blloqueve dhe radhitjen e tyre në rrështha të rregullt horizontale. Në këtë muraturë janë përdorur blloqet me sipërfaqe të gufuar me gjatësi 0,80 m dhe lartësi jo të barabartë, që shkojnë nga 0,40 m deri në 0,80 m, me një zotërim të lartësisë mbi 0,70 m.

Nga muri i anës jugperëndimore të kullës 21 ruhen «in situ» nëntë blloqe gurësh të vënë njëri mbi tjetrin, që arrijnë lartësinë afro 5 m. Largësia midis fases së jashitme të këtij muri dhe atij verilindor është 7,5 m., që njëkohësisht është vetë gjerësia e kullës antike.

Në brinjën ballore të kullës nuk janë vënë re gjurmë të mureve të periudhës qytetare ilire. Por në pjesën e poshtme të saj duken disa radhë blloqesh të mëdha kuadratikë të vendosura në formë shkallësh, të përdorura me sa duket, për të rrëtih sipërfaqen e tabanit të themelit në varësi të sipërfaqes së dobët të terrenit për të mënjanuar rrëshqitjet e mundshme. Të dhinat e reja të gërmimeve dëshmojnë për një kullë të lashtë, element përbërës ky i sistemit të fortifikimit mbrojtës të periudhës qytetare ilire. Përmbi këtë kullë është ngritur më vonë kulla mesjetare që me disa përforsime dhe rindërtimë të mëvonshme ruhet në këmbë edhe sot e kësaj dite.

Trakti i murit rrëthues nis tek qoshja e kullës 21 dhe ka njerin bllok të vendosur me faqen e gjatë në ballë, kurse blloku tjetër me atë më të shkurtër në ballë dhe të gjatë

në drejtim të murit jugperëndimor të kullës, gjë që vihet re edhe në vendosjen e bloqeve të tjera. Edhe këtu bie në sy përpunimi i faqeve anësore të bloqeve që lejon puthitjen sa më të mirë të tyre.

Pas kthesës me kënd të drejtë të murit në këtë pikë u vu re një ndërprerje e murit, e cila për vështirësitë që paraqiste terreni nuk mundi të svarohej<sup>49)</sup>. Ndoshta kemi të bëjmë këtu me një hyrje tjetër të dorës së dytë ose me rrënimin e murit në këtë pjesë të qytetit.

Përpara hyrjes për në kullén nr. 21, pak më në veri të saj, vërehen dy radhë bloqe gurësh gëlqerorë të vendosura përpendikular me këtë mur me përmasa të mëdha dhe mesatare që shkojnë paralel me njëra tjetrën në një gjatësi prej 1,25 m. Ndoshta këto kanë shërbyer si prita për të më-njanuar rrëshqitjet e mundshme të dhet përpara murit rrethues. Raste të tillë të ngjashme janë të njoitura në qytetet antike, p.sh., në Apoloni, Antigone<sup>50)</sup> etj.

Trakti i murit rrethues të zbuluar në pikën C me drejtim juglindje-veriperëndim, është vazhdimi i murit të anës verilindore të qytetit (i murit A), që lidhet me faqen e jashtme të murit të hyrjes pranë portës kryesore të qytetit (Fig. 4). Bashkimi i këtyre mureve tek qoshja e kësaj kulle, është bërë në një kënd jo të gjërë, që arrin përafersisht deri në 116, (Fig. 17). Muri i periudhës qytetare ilire në këtë pikë u zbulua në një gjatësi të përgjithshme prej 9,45 m. Ai ruhet deri në 6 radhë të përbëra prej bloqesh guri gëlqerorë me një lartësi të përgjithshme që nuk i kalon të 3 m. Trashësia e tij është 3,28 m<sup>51)</sup>.

Faqja e brendshme e këtij muri, që pjesërisht ka qenë e zbuluar përpara gërmimeve, është ndërtuar prej bloqe gurësh gëlqerorë kuadratikë të vendosur mbi njëri tjetrin në të thatë. Faqet e tyre anësore janë të punuara rrafsh dhe

49) Shënojmë se për shkak të sipërfaqes së lirë tepër të kufizuar, të rrugës që të çon për në kishën e Shën Triadhës buzë së cilës ngrihen shtëpitë e sotme të banimit, gërmimi nuk vazhdoi më tej.

50) B. Dautaj, Një rrugë kryesore në Apoloni, «Monumentet» 7-8, 1974, f. 55 e vazhd.; Dh. Budina, *Antigonea...*, f. 291, Tab. XV.

51) Matja është bërë prej faqes së brendshme të këtij muri deri në faqen e jashtme të murit mesjetar që ngrihet mbi të, kjo është në fakt gjerësia e shkallëve që ndodhen përmbi murin mesjetar që të çojnë në kullën 2.




Fig. 17

të puthitura mirë. Faqet ballore të gurëve, të punuara trashë, janë lënë të gufuara me gropëzime dhe të dala, të ngjashme me ato të pikës B. Ajo që bie në sy në teknikën e këtij muri është rreshtimi vijëdrejtë i rregullt i blloqeve të vendosura horizontalisht, me gjatësi nga 0,42 deri 1,32 m, ku mbizotëron gjatësia 0,80 m. Lartësitë midis blloqeve janë të barabarta (0,55 m). Këto mure janë të ngjashme me muret e qytetit ilir në Klos,<sup>52</sup> me murin e brendshëm të Lisit (Lis III a)<sup>53</sup> si dhe me muret rrëthues të periudhës së dytë të Zgërdheshit.<sup>54</sup>

52) L. Papajani, *Raport mbi gjermimet arkeologjike të vitit 1973 në qytetin ilir të fsha'it Klos të Mallakastrës*, «B.A» 4, 1974, f. 106.

53) F. Prendi, K. Zheku, *Qyteti...*, f. 240.

54) S. Islami, *Qyteti...*, f. 200.

Në këtë pikë u zbulua deri në themel muri jugor (i jashëm) i portës kryesore të periudhës qytetare ilire, i cili nga pikpamja e teknikës nuk ndryshon shumë nga muri i mësipërm. (Fig. 18). Ai dallon prej këtij të fundit vetëm nga përmasat më të vogla të gurëve. Lartësitë e bloqeve, siç del nga matjet vertikale, edhe këtu nuk kanë ndonjë ndryshim të dukshëm, ndërsa përmasat gjatësore luhaten midis




Fig. 18

0,71-1,50 m. Prej këtij muri janë ruajtur në gjendje të mirë pesë radhë me biloqe gëlqerore. Bloqet kanë faqet e dukshme në formë paralelopipëdi të punuar trashë, vende vende me gropëzime dhe gufime.

Lidhja midis bloqeve eshtë mjaft e mirë dhe rrreshtat ruajnë pothuajse kudo vija të rregullta horizontale.

Fakti që si në pikën B ashtu dhe në pikën C, në të njëjtin trakt muri gjemë njëkohësisht të përdorur dy lloj bloqesh me faqe guroreje të gufuar dhe të sheshtë, mendojmë se nuk duhet lidhur me dy periudha të ndryshme ndërtimi.

## 2. PORTA KRYESORE E QYTETIT

Gjurmë të qarta të ndërtimeve të periudhës qytetare ilire janë vënë re qysh përpara gërmimeve, veçanërisht në portën kryesore të qytetit.<sup>55)</sup>

PRERJE A-A E KRYEKULLES DHE PLANIMETRIA E PORTES





Fig. 19

55) C. Praschmiker — A. Schober, *vep. cit.*, f. 63.

Porta me aksin e saj gati lindje-perëndim formohet nga ndërprerja e murit A, që lidh murin e jashtëm të korridorit të hyrjes të anës jugore me kullën nr. 2. Ky korridor është formuar nga përthyerja në një kënd të drejtë e mureve rrethuese në anën e brendshme të tyre në të dy anët e hyrjes.

Hyrja që përshkon murin A është një portë e tipit darë. (Fig. 19). Ka planimetri të rregullt katërkëndëshe dhe ndahet në dy pjesë kryesore; në një parakthninë, korridori i parë, që shërbente për kufizimin e numrit të sulmuesve dhe në korridorin e dytë të pajisur me dy porta. Korridori i hyrjes, që kufizohet në të dy anët me blloqe gurësh kuadratikë, ka një gjatësi prej 10 m dhe një gjerësi 3,70 m. Dy blloqe që kanë shërbyer si bazamente në fillim të korridorit të dytë dhe gdhendja e blloqueve mbi ta për vendosjen e kasës së portës vërtetojnë plotësisht se aty duhet të ketë qenë porta e parë.

Muret anësore të korridorit të hyrjes ruhen nga 3-5 radhë blloqesh në anën e djathë (Fig. 20) dhe nga 2-4 radhë gurësh kuadratikë në anën e majtë të saj, (Fig. 21) prej të cilave dy radhë kanë një lartësi prej 0,60 m është tri të tjera me nga 0,36 m të lartë secila. Gjatësia e disa gurëve arrin deri në 1,30 m. Fragmenti i anës së djathë i ruajtur deri në



9 m gjatësi formon një kënd prej  $20^\circ$  me pjesën ballore të hyrjes, ndërsa i majti, që arrin deri në 5 m gjatësi krijon një kënd prej  $40^\circ$ .

Në pjesën më të ngushtë të korridorit të hyrjes kanë mbetur «*in situ*» vetëm gurët e radhës së fundit. Ato përfshihen në planimetrinë e portës mesjetare dhe lënë një ka-



Fig. 21

lim me gjerësi prej 2,40 m. Duket qartë se muri më i vonshëm në korridorin e parë ai i anës së djathtë (Fig. 20) ndjek vijën e murit antik, ndërsa ai i anës së majtë (Fig. 21) kalon pak më jashtë tij në drejtim të pjesës së brendshme të kalasë, duke lënë të pambuluar gurët e murit të lashtë, që formojnë një farë sofaje.

Dy blloqe gurësh kuadratikë të vendosur njëri mbi tjetrin dhe të pajisur me vijë peshimi si gjurmë të pilastrës së djathtë në dalje dëshmojnë për qenien e portës së dytë.

Për portën e tretë në hyrje, që mbyllte korridorin e parë për të cilën Prashnikeri mendonte se është mesjetare,

jemi të një mendimi me A. Baçen, se ajo është një portë antike.

Si mbulesë e portës antike, me sa duket ka qenë përderur sistemi i harkuar, gjë që vërtetohet nga kurbëzimi i qosheve, mbi bazën e të cilave është bërë restaurimi i plotë i mbulesës në korridorin e hyrjes kryesore, që arrin një lartësi prej afro 8 m e që vende vende lëviz në varëzi me pjetrësinë e terrenit të shtruar me kalldrëm të korridorit të hyrjes.

Përmbi mbulesën e kurbëzuar në formë qemeri të portës është ngritur kryekulla me planimetri katërkëndëshe (Fig. 22). Kulla mbi portë, që ndoshta ka ekzistuar që në kohën antike, është në mungesë të kullave që mbrojnë portën në të dy anët e saj, një element arkitektonik mjaft i rëndësishëm që ka shërbyer si përforcim i fuqishëm i hyrjes kryesore të qytetit. Kjo kullë e rindërtuar dhe e pajisur me elemente të reja konstruktive të kohës ruhet deri në ditët tona. (Fig. 23).

Në faqen e jashtme të shtyllës (paturës) veriore të kësaj porte, u zbuluan 7 radhë blloqesh kuadratikë të ripërderur në kohën antike të vonë, që arrijnë një lartësi prej 1,50 m (Fig. 24). Gurët ishin të lidhur me llaç gëlqeror ngjyrë rozë të përzier me pluhur tulle dhe fugaturat midis tyre të zëna me copa tullash e tjegullash të ripërdorura. Për këtë shtyllë Prashnikeri, gjatë vizitës së tij nç këtë qytet, shënon-te se ishte një mur antik me lartësi prej afro 3, me blloqet e qosheve të pajisura me shirit anësor të gdhendur pastër.

Porta e qytetit, që sapo përshkruam e vendosur në pikën më të arritshme të qytetit me elemente të rëndësishme konstruktive, e pajisur në një kohë më të vonë (shek. XIII) me një oborr të fortifikuar (Fig. 25), është e vëtmja e ruajtur deri tanë në kalanë e Beratit dhe më kryesorja, që ka funksionuar për një kohë të gjatë pandërpërje deri në ditët tona. Ajo ka shërbyer për të lidhur qytetin e sipërm me atë të poshtmin dhe me qendra të tjera të zonës përreth tij.

Sistemin e fortifikimit mbrojtës të këtij qyteti në periudhën qytetare ilire e plotësonte mjaft mirë kalaja ilire e Goricës, në anën e përtëjme të Osumit, e cila krijon kështu një sistem mbrojtës të dyfisitë të paraplanizuar me rëndësi të madhe strategjike.




Fig. 22




Fig. 23




Fig. 24

### 3. KALAJA E GORICËS

Ajo shtrihet në pjesën e sipërme të kodrës së lagjes me të njëtin emër (Fig. 26) në një kuotë pak më të lartë se ajo e qytetit të fortifikuar të Beratit. Në njëren anë ajo mbyll plotësisht ngushticën e Osumit dhe në anën tjetër grykëderdhjen e Velabishkit. Kjo e fundit ka një rëndësi jo vogël për të depërtuar si në drejtim të Përmetit (Këltë ashtu edhe për tu hedhur përsëri në luginën e Osucyrës), ashtu edhe për veshtrimin nga kummit.<sup>56</sup> Në këtë mënyrë ajo vështirësonte rrëthimin nga kummit.

56) A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, *Historia e arkitekturës shqiptare* (Maket), Tiranë, 1979, f. 43.




Fig. 25




Fig. 26

dërshtari. Në një rast të tillë të dyja fortifikimet ndihmonin njëri-tjetrin me kundërsulme.

Vrojtimet arkeologjike të bëra në këtë kala kanë treguar se kemi të bëjmë me një vendbanim të fortifikuar ilir. Punimet e ndryshme të pastrimit të bëra kohët e fundit në kodrën e kalasë kanë bërë të mundur sqarimin e planime-risë së saj.<sup>57</sup> Muret rrëthuese me trashësi 3 m - 3.30 m që rrethojnë një sipërfaqe prej afro 3 ha mund të ndiqen në mënyrë të plotë në anët lindore e jugore të kështjellës. Ato ruhen deri në një gjatësi prej 167 m. Disa trakte muresh mund të ndiqen edhe në anën perëndimore të kalasë, prej të cilave një pjesë shkon paralele me vijat roshkulluese të terrenit dhe pjesa tjetër fërthoi me to.

57) Sh. Mane, *Kalaja...*, f. 48, fig. 1.

Kalaja e Goricës ka qenë pajisur me dy hyrje të tèrthorëta, njëra në anën lindore dhe tjetra në atë jugore të saj. Dy kulla katërkëndëshe të projektuara tèrësisht në anën e jashtme të murit rrethues e përforcojnë atë në anën lindore (Fig. 27).

Megjithëse është ende e parakohshme të japim një mendim të plotë mbi këtë kala, mbasi kërkimet janë në filimet e tyre, të dhënat e deritanishme siç është teknika e mureve rrethuese të kësaj kalaje dhe qeramika e afrojnë atë mjaft me kalanë e Beratit. Këto tregojnë se kemi të bëj-




Fig. 27

më me një qendër banimi me kushte të mira klimatike, ekonomike dhe strategjike për të qenë një qendër prodhimi dhe shkëmbimi në shek. IV-III p.e.sonë. Pra si e tillë ajo duhet të jetë afërsisht e njëkohëshme me kalanë e Beratit.

#### 4. QERAMIKA E PERIUDHËS QYTETARE ILIRE

Në bazë të stratigrafisë vertikale të diferençuar mirë të shtresave kulturore të gërmimeve të bëra në pikën B pranë murit rrethues të periudhës qytetare ilire<sup>58</sup> (kuadratet I-IX) doli qartë se periudhën protoqytetare e ndjek pa ndërprerje periudha qytetare ilire. Qeramika e kësaj periudhe në pjesën më të madhe të saj vjen nga gërmimet e bëra në këtë pikë dhe ve'ën një pjesë fare e vogël i përket gërmimeve të bëra në pikën C.

Në masën e madhe të kësaj qeramike, përveç materialit masiv të ndërtimit (tjegulla të tipit solen e kalipter), një vend të rëndësishëm zë qeramika me parete të holla e lyer me vernik të zi, karakteristike për qytetet e trevës ilire jugore dhe epirote si Dimali, Antigonea, Zgërdheshi, Selca e Poshtme etj. dhe për kolonitë helene Apoloni në dherët Dyrrahun. Kjo qeramikë paraqitet e bollshme dhe e larmishme, me një sasi të madhe formash e variantesh të njohura e të përdorura gjërisht në periudhën qytetare ilire, si kupa, tasa, pjata, skifosa, hidrie, broka, amfora e amforiske vorba, tava, tenxhere, pesha të peshkimit, fragmente kandilash etj.<sup>59</sup>

Duhet thënë qysh në fillim se kjo qeramikë ka dalë shumë e fragmentuar. Megjithatë, gjatë studimit të saj, me ndihmën e riprodhimit të pjesës së grafik dhe të qëllimit për të cilin kanë shërbyer, jemi përpjekur të veçojmë katër grupe kryesore enësh: A) enët e tavolinës, B) enët e kuzhinës, C) enët e qilarit dhe D) enët e transportit.

58) H. Spahiu, *Muret rrethuese të kështjellës së Beratit*, në «Iliria», 1, 1983, f. 119-135.

59) Në klasifikimin e kësaj qeramike tepër të fragmentuar herë pas here më ka ndihmuar kolegu im N. Ceka, të cilin me këtë rast e falënderoj.

## A. Enët e tavolinës

Enët e tavolinës që shërbejnë për ngrënien, pirje dhe për të servirur dallojnë për baltën shumë të pastër dhe për teknologjinë e lartë të prodhimit të tyre. Kanë në përgjithësi një pjekje të mirë të realizuar në temperaturë konstante. Në pjesën më të madhe të tyre ato janë lyer brenda dhe jashtë me vnik të zi të holuar e herë herë në ngjyrë kafe gështenjë me pak shkëlqim ose fare pa shkëlqim. Karakteristike për periudhën e vonë helenistike, të bërë zakonisht me zhytje. Në këtë kategori enësh kemi mundur të dallojmë disa tipa, kryesisht grykë-gjerë, format e të cilave janë karakteristike për këtë periudhë.

a) *Kupat* kanë në përgjithësi pare të holla dhe përmassa mesatare. Diametri i tyre lëviz nga 8-16 cm. Më me interes në kategorinë e kupave janë ato fragmente, që me ndihmën e restaurimit na jasin forma të plota. Mbizotërojnë ndër to kupat me trup kësulë gjysmësferike (të ashtuquajturat kripore) (Tab. VI, 1,2,3). Ndryshon prej tyre një kupë me trup në formë trapezi dhe fund të sheshtë (Tab. VI, 4) dhe një tjetër në trajtë kësule gjysmësferike me anët pak të lakuara. Të parat kanë një lartësi nga 3,5 cm — 4 cm. Lartësia tek dy copat e fundit nga 3,6 cm arrin deri në 5,50 cm.

a/1) Kupë e vogël (e fragmentuar) me trup në formë kësule gjysmësferike, me buzë të drejtë vertikale të rrumbullakuara në skajet. Kupa qëndron mbi një fund të sheshtë si vazhdimi i paretive të enës. Diametri i grykës 9 cm, i fundit 3,8 cm (Tab. VI, 1).

a/2) Kupë shumë e vogël (e fragmentuar) me trup në formë segmenti, rrrethor dhe buzët e rrumbullakuara në pjesën e sipërme kryesisht në paretin e jashtëm. Diametri i grykës 8 cm. Fundi i sheshtë me diametër 4 cm (Tab. b, VI, 2; Tab. LIII, 7).

a/3) Kupë e vogël (e fragmentuar) me trup në formë trapezi dhe buzë shumë të shpërvjela e të varura nga jashtë me skajet e rrumbullakuara. Fundi i sheshtë është vazhdimi i drçjtpërdrejtë i trupit të enës. Diametri i grykës 10 cm. Diametri i fundit 6 cm.

a/4) Kupë e vogël (e fragmentuar) me trupin në trajtë kësule gjysmësferike, me pjesën e sipërme të prerë. që qëndron përmbi një fund të sheshtë të ngritur me fron pseudo-

unazor dhe diametër 5-5 cm. (Tab. VI, 6; Tab. LII, 1). Diametri i grykës 9 cm.

a/5) Fragmente kupash me trup bikonik dhe buzë të kthyera lehtas nga brenda të harkuara në pjesën e sipërme ose të prera nga brenda (Tab. III, 3,5). Është lyer me vernik të zi të dobët ose kafe në gështenjë e vende-vende e kuqërremtë. Forma e saj është e një tipi mjaft të përhapur në qeramikën qytetare ilire. Ajo mund të krahasohet me copa të ngjashme, që i ndeshim në qeramikën e shekujve III-II p.e.sonë në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>60</sup>

a/6) Fragment kupe me pjesën e poshtme të trupit në trajtë gati gjysmësferike dhe të sipërme në formën e një trungu konik (Tab. III, 2). Buzët e drejta të pjerrura nga brenda janë pajisur me dy kanale paksa të shënuara në pjesën e jashtme të tyre.

a/7) Fragment kupe me trup gjysmësferik e buzë të sheshta të pjerrura nga brenda (Tab. III, 6). Është e lyer nga brenda dhe pak në pjesën e jashtme të saj me vernik të zi të dobët të dhënë në formë rëkesh, çka tregon se lyerja ka qenë bërë me zhytjen e enës në vernikun e holluar.

Një formë shumë të përafërt me copat tona e ndeshim në qeramikën e periudhës qytetare ilire të kalasë së Pogradecit.<sup>61</sup>

a/8 Fragment kupe me trup gati nikonik, me parete dhe buzë të trashura gjysmë të shpërvjela nga jashtë dhe të pajisura nga brenda me një kanal për vendosjen e kapakut (Tab. V, 6). Ka fakturë të lëmuar, me sa duket të lyer me një shtresë të hollë kajmaku në ngjyrën e baltës.

a/9) Fragment kupe me trup në formë hinke dhe buzë të drejta me prerje elipsoidale, të pajisura në pjesën e sipërme me dy kanale paksa të shënuara. Ena është e lyer me vernik të zi, (Tab. V, 17). Paralelet e përafërtë të kësaj kupe i gjejnë në qeramikën e periudhës qytetare ilire të zbuluar në gërmimet e bëra në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>62</sup>

a/10) Kupë e vogël (e fragmentuar) me trup të ulët në

60) N. Ceka, Qyteti..., tab. XL, 9.

61) S. Anamali, Kështjella e Pogradecit: «Iliria», IX-X, 1979-1980,

f. 216, Tab. XIII, 15.

62) N. Ceka, Qyteti..., f. 131, Tab. XXXVIII, 7.

formë kësule gjysmësferike dhe me buzë të kthyera nga brenda (Tab. VI, 3, Tab. L1,5). Kupa qëndron mbi një këmbëz të sheshtë, të diferencuar qartë nga trupi i enës. Diametri i grykës 9 cm dhe ai i fundit 3,80 cm.

a/11) Fragment kupe me trup gjysmësferik dhe me buzë të drejta pak të rrumbullakuara në skajet (Tab. III, 1). Është e lyer me vernik të zi të dobët, që anon në kafe-gështenjë.

Kupa është e ngjashme me një kupë të periudhës qytetare ilire të zbuluar në gërmimet në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>63</sup>

a/12) Fragmente kupash me trup bikonik, me buzët e pjerrura nga brenda. Enët kanë qenë të lyera pjesërisht nga brenda me vernik të zi të holluar me pak shkëlqim metalik. Njëra kupë është e ngjashme me një copë të gjetur në ambientin I të zbuluar në gërmimet në qytetin ilir në Klos me materiale të fundit të qytetit të shek. II dhe fillimit të shek. I p.e.sonë<sup>64</sup> (Tab. III, 7,8).

b) *Tasat*. Fragmetet e tasave (Tab. III, 9-16) riprodhojnë kryesisht tasa me trup në trajtë kësule gjysmësferike. Ato ndryshojnë në mes tyre vetëm nga profilimi i buzëve, të cilat në disa raste janë të rrumbullakuara, të sheshta ose të pjerrura nga brenda (Tab. V, 5,7). Kanë parete mesatarisht të trasha dhe diametër që lëviz nga 21 cm deri në 29 cm. Këtu bëjnë përjashtim dy tasa me diametër 30–36 cm (Tab. VII, 3,13), me buzët e tyre të kthyera nga brenda dhe të drejta në pjesën e sipërme.

b/1) Fragment tasi me trup gjysmësferik dhe me buzë të kthyera nga brenda (Tab. III, 10), formë kjo e njojur në qeramikën e periudhës ilire të zbuluar në kështjellën e Podgradecit dhe në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>65</sup>

b/2) Fragmente buzë tasash pothuajse vertikale që rrumbullakohen në skajet (Tab. III, 11,15).

b/3 Fragment tasi me trup trungkonik, buzë të shpërvjela nga jashtë. Paralelen më të përafërt të këtij tipi e gjej-

63) Po aty, Tab. XLI, 11 dhe Tab. XLVI, 4.

64) L. Papajani, *Gërmimet arkeologjike të vitti 1974 në qytetin ilir të Klosit*, «BA» 5, 1975, f. 41; Tab. III, 6.

65) S. Anamali, *Kështjella...*, Tab. XIII, 8; N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XXXVI, 8.

më midis qeramikës të periudhës qytetare ilire pranë Selcës së Poshtme.<sup>66</sup> (Tab. III, 6).

b/4) Fragmente tasash me trup trungkonik, anët e mble-  
dhura nga brenda dhe të pjerrura në paretin e brendshëm.  
(Tab. V, 8,13).

b/5) Fragment tasi i thellë me trup sferik, buzët pak të zgjeruara, të anuara dhe të pjerrura nga jashtë me një pro-  
filim dhe kanal në paretin e brendshëm për vendosjen e kapakut, (Tab. V, 18).

### c. Skifosat

c/1) Fragmente skifosash tip kantaroidi me parete relati-  
visht të holla, me trup vezak e buzë të drejta lehta të anuara  
nga jashtë. Janë lyer në pjesën e brendshme me vernik  
kafe të çelët e kafe në gështenjë. Tek njëri fragment gati  
1 cm nën buzë nga ana e jashtme shihet një kanal që i vjen  
rrreth e qark enës (Tab. IV, 2,3,13; Tab. LVI 10).

c/2) Fragmente skifosash me buzë të fryra të rruebubu-  
llakuara në skajet dhe të pajisura në paretin e jashtëm pë-  
rrreth qafës me vijaska të lehta qarkuese. Janë lyer në të  
dy anët me vernik të zi të dobët pa shkëlqim që vende vende  
ka marrë ngjyrë kafe në të kuqërrremtë (Tab. IV, 4,5).  
Ky tip ndeshet rëndom në qytetet tona ilire. Në një formë  
mjaft të përafërt atë e gjemjë në qeramikën e shek. III-I  
p.e.sonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>67</sup>

c/3) Fragmente skifosash me trup në formë dardhe, buzë  
të shpërvjela nga jashtë me seksion sinusoidal. Janë lyer me  
vernik të zi të dobët pa shkëlqim. Njëri prej tyre është i  
pajisur në shpatullat me një kanal qarkues. Skifosa të tillë  
janë të pranishëm në qeramikën e periudhës qytetare ilire  
të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme dhe në qeramikën e  
nekropolit ilir në Belsh.<sup>68</sup> (Tab IV, 1).

c/4) Fragment skifosi me buzë gjysmë të hapura nga  
jashtë që pjerren nga brenda. Është i lyer në të dy anët  
me vernik të zi me pak shkëlqim metalik (Tab. IV, 11).

c/5) Fragmente skifosash me trup gati sferik (Tab. IV,  
1,8,9, Tab. LVI,3. Tab. LX,6), me buzë vertikale ose paksa  
të hapura nga jashtë me seksion sinusoidal, të pajisura në

66) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XLIII, 10.

67) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XLII, 18.

68) Po aty., Tab. XLIV, 11; N. Ceka, *Nekropoli ilir në Belsh,*  
«B.A» 5/1975, f. 49 (i treti duke filluar nga lart poshtë).

paretin e jashtëm të tyre ose në pjesën e barkut me një ose më shumë kanale.

c/6) Tri funde konike skifosash, midis tyre njëri me përmasa të mëdha. Janë lyer nga brenda dhe në disa raste edhe nga jashtë me vernik të zi në kafe gështenjë ose të kuqërremetë (Tab. IV, 14,15,19).

c/7) Fragment gryke e një skifosi tip kontaroid. me trupgati në formë dardhe dhe buzë të hapura nga jashtë, pak të rrumbullakuara në skajet. Është i lyer në të dy anët me vernik të zi në kafe — gështenjë me pak shkëlqim metalik (Tab. IV, 12).

c/8) Skifos me trup në trajtë elipsi dhe buzë të veçuara qartë nga trupi e pak të kthyera nga brenda, me dy vegje unazore me prerje gati petullicë. Skifosi qëndron mbi një këmbë unazore jo shumë të lartë, me diametër 3,5 cm, që veçohet qartë nga trupi. Ena është e lyer me vernik kafe në të kuqe karakteristik për shek. I p.e.sonë dhe shek. I të e.sonë. Është e tipit kalimtar për në periudhën romake. Lartësia 5 cm. Diametri i grykës 8 cm. Diametri i fundit 3,5 cm. (Tab. VII, 18; Tab. LI,1).

c/9 Paret skifosi i lyer me vernik të zi me shkëlqim metalik, është i zbuluar me kanelyra të dendura vertikale, që duke gjykuar nga cilësia e vernikut duhet t'i takojë fundit të shek.IV-III p.e.sonë (Tab. IX, 1).

c/10) Fragment skifosi me parete shumë të holla. (Tab. IV, 2). Përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë rozë në të kuqërremetë. Pjekja e mirë. Paretet e saj janë të zbuluar në sipërfaqe me vija në formë brinjësh e pikë si themtha të bëra para pjekjes me baltën e vetë enës. Sipërfaqja është e lyer në të dy anët me vernik të zi në kafe ose kafe në të kuqërremetë. Është e ngjashme me një skifos të gjetur në shtresën kulturore të shek. II-I p.e.sonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>69)</sup>

d) *Pjatat*. Janë përgatitur në përgjithësi prej një balte të pastër, ngjyra e pjekjes është okër, okër në rozë ose kafe e çelët dhe herë-herë gri si pasojë e pjekjes në prani të gazit karbonik në furra të myllura. Kanë në përgjithësi një fakturë të lëmuar. Pjekja është e mirë, por jo gjithnjë uniforme.

---

69) N., Ceka. *Qyteti...*, Tab. VI, 7.

Në fragmentet e pjatave dallojmë: pjata të cekëta dhe pjata të thella.

d/1) Pjatë e madhe e plotë (e restauruar) e shtrirë, me buzët e trashuara dhe të zgjatura tej trupit pak të pjerura nga brenda me seksion katërkëndëshi (Tab. V, 15).

Në pjesën qendrore pjata është dekoruar më katër rrathë koncentrikë të bërë me rrotëz në formë thonjézash, të cilat tek rrethi i jashtëm janë më të mëdha e vijnë duke u zvogëluar drejt qendrës. Pjata qëndron mbi një këmbëz unazore jo shumë të lartë. Është e lyer në të dy anët me vernik të zi të dobët në ngjyrë gri. Duke u nisur nga cilësia e vernikut duket se kjo pjatë i takon shek. II p.e.sonë. Diometri i sipërm 37,6 cm; Diametri i fundit 9 cm. Trashësia e këmbëzës unazore 1,5 cm.

d 2 Fragment pjate e madhe e shtrirë me buzë të trashura, që hipën vertikalish mbi paretet e enës. Ena është e lyer në të dy anët me vernik të zi, si kohë duhet të jetë e fundit të shek. IV-III p.e.sonë (Tab. V; 12).

d/3 Fragment pjatash të cekëta me buzë të gjera, të hapura nga jashtë dhe ndonjëherë të pajisura me nga një kanal; si zgjatim i drejtpërdrejtë i trupit, ato janë gjysëm ose tërësisht të hapura. Janë të lyera me vernik të zi të dobët, herë herë në ngjyrë kafe (Tab. V, 10,11,14; Tab. VII, 15).

Forma të tilla pjatash janë ndeshur në qeramikën e së njëjtës periudhë të zbuluar në qytetin e Dyrrahut dhe në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>70</sup>

d/4 Fragment pjate me trup në formë kësule gjysmë-sferike e buzë të diferençuara qartë nga trupi i enës dhe të shtrira nga jashtë në formë strehe. Ena qëndron mbi një froni unazor jo shumë të lartë. Ajo është e lyer nga brenda me vernik të zi të zbetë ose në kafe gështenjë. (Tab. VII, 14). Nga forma është e përafërt me një pjatë të gjetur në qeramikën e shek. III-II p.e.sonë në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>71</sup>

a/5 Fragment pjate me trup kësulë gjysmësferik dhe buzë të drejta pak të anuara nga jashtë. Ena është lyer nga brenda dhe në pjesën e buzëve me vernik kafe pa shkëlqim. Është e ngjashme me një pjatë që vjen nga qeramika e shek.

70) H. Hidri, *Gjurmë të një punishteje qeramike në Dyrrah, «Iliria», VI, 1976, Tab. II, f. 12; N. Ceka, *Qyteti..., Tab. XXXVII, 23.**

71) N. Ceka, po aty., Tab. XXXVII, 21.

III-II p.e.sonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>72</sup> (Tab. V, 10).

d/6 Fragmenta pjatash me trup në formë kësule gjysmësferike dhe buzë të drejta vertikale që rrumbullakohen në skajet. Janë të lyera nga brenda dhe pak në pjesën e jashtme të buzëve (si rezultat i lyerjes me zhytje) me vernik të zi të dobët. Forma të tilla pjatash janë të shpeshta në gjetjet qeramike të periudhës qytetare ilire në qytetet e trevës ilire jugore.<sup>73</sup> (Tab. VII, 6,7).

d/7 Fragment pjate me parete relativisht të trasha. buzë të drejta. që ngrihen vertikalish, pak të rrumbullakuara në pjesën e brendshme. Ena është lyer me vernik të zi pa shkëlqim. (Tab. V, 1-5,9).

d/8 Fragment pjate të cekët me buzë të trashura që bien pothuajse vertikalish paksa të kthyera nga brenda dhe të holluara pranë skajeve. Ka fakturë të ashpër (Tab. VII, 2).

d/9 Fragment pjate të thellë me trup me seksion trapezoidal dhe buzë të kthyera nga brenda e të rrumbullakuara në skajet. Ena është e lyer me vernik të zi pa shkëlqim. (Tab. XI, 18).

d/10 Fragment pjate të thellë me trup në formë kësule gjysmësferike dhe buzë të kthyera nga brenda me seksion trekëndëshi të mprehta në skajet. Ena është e lyer nga brenda me vernik kafe të dobët (Tab. XI, 4)

d/11 Fragment pjate të thellë me buzë të drejta me seksion trikëndëshi të pjerrura nga jashtë me dalje këndore. Ena është lyer nga brenda dhe nga jashtë pak nën buzë me vernik të zi me pak shkëlqim. (Tab. XII, 10). Pjata të tilla të thella ose tasa janë të pranishëm në qeramikën e shtresës kulturore që i përket gjysmës së dytë të shek. III — shek. II p.e.sonë të zbuluar në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>73/1</sup>

d/12 Fragmente buzë pjatash prej balte ngjyrë gri të zbuluar në pjesën e sipërme me thellime ovale (Tab. IX, 7; Tab LIV, 3,4). Një fragment i ngjashëm me këtë është gjetur në qeramikën e shtresës të shek. III-II p.e.sonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme<sup>74</sup>.

72) Po aty., Tab. XLIII, 8.

73) Po aty., Tab. LI, 17-19. Shih literaturën e cituar prej tij.

73/1) N. Ceka, Qyteti..., f. 72, Tab. XLII, 9.

74) N. Ceka, Qyteti..., f. 75, Tab. XLIX, 2: Tab. LIII, 3.

d/13. Dy fragmente riprodrojnë pjata me trup në trajtë kësule gjysmësferike, me buzë të drejta dhe vertikale pak të anuara nga brenda. Janë të lyera në të dy anët ose vetëm nga brenda me vernik të zi të zbehtë.

d/14. Fund pjate të thellë, në trajtë konike, i ulët dhe i zbuluar në pjesën e sipërme me dy rrathë koncentrikë të bërë me penel të trashë me vnik të zi në kafe gështenjë pa shkëlgim.

d/15. Fund pjate të cekët, në formë unazore, zbuluar në pjesën e sipërme me dy lloj motivesh të bëra me ruletim (Tab. IV, 16). Është e lyer në pjesën e brendshme me vernik të zi me shkëlgim metalik.

d/16. Fragment fund pjate zrukuruar me gjethë palmete të bëra me stampë. Balta është e pastër ngjyrë rozë, vendë-vende në ngjyrë kafe, pjekja e mirë. Copa është e lyer me vernik të zi me shkëlqim metalik. Duke gjykuar nga mënyra e punimit dhe verniku i përdorur për lyerje duket e importuar nga një qendër tjeter prodhimi, ndoshta i përket importit apoloniat. Paralelen e kësaj pjate e gjejmë në një pjatë të shtrirë të zrukuruar në qendër me katër palmeta, të gjetur në qeramikën e qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme, që sipas studiuesit janë imitim i pjatave të tipit helenistik të prodhua të punishtet e qyteteve bregdetare dhe të përdorura gjorësisht në gjysmën e dytë të shek. IV dhe në shek. III p.e.sonë<sup>75</sup>. Në forma mjaft të përafërtë atë e ndeshim në qeramikën e së njëjtës periudhë të Antigones.<sup>76</sup>

d/17. Fund pjate, që ka si zburim gjithashtu një palmetë të bërë me stampë para pjekjes. Balta është e pastërgjyrë okër, e lyer nga jashtë me vernik të zi në kafe gështenjë. Fundi është i ngritur në formë themthi.

Në qeramikën e kësaj shtrese janë gjetur edhe disa fragmente lekitësh (Tab. VII, 8,10; Tab. LIV, 6,7) të tipit aribalistik me trup të fryrë. Tek njëra copë qafa është e shkurtër në formë hinke me buzët e drejta (Tab. VII, 10) me diametër të grykës 3 cm dhe 5 cm, forma të njoitura zakonisht përkohën e vonë e helenistike shek. II-I p.e.sonë. Janë lyer me vernik të zi të dobët në ngjyrë kafe. Një lekit mjaft i ngja-

75) Po atv f 66 Tab. XVI, 17; Shih dhe referimin e tij.

75) Po aty..., I. 66, Tab. XVI, IV, 7, 9.  
76) Dh. Budina *Antigonea*..., Tab. XXIV, 7, 9.

shëm për nga forma me copën tonë është gjetur në Mallkuç, i datuar në shek. IV-III p.e.sonë.<sup>77</sup>

### e) Hidrije

Në masën e mëdhe të qeramikës të kësaj shtrese të bien në sy enët me parete të holla me pikturim. të grumbulluara në pjesën më të madhe në pikën B (Tab. LXX, LXXI).

Në grupin e kësaj qeramike kemi mundur të përcaktojmë kryesisht enë të tipit hidrije (Tab. VI, 10). Ato dallojnë për një teknologji të përparuar prodhimi dha për elegancën e formave. Janë përgatitur prej balte të pastër ngjyrë okër në rozë. Veçori dalluese për këtë grup enësh është dekorimi i tyre i thjeshtë me pikturim njëngjyrësh. Si ngjyrë bazë e përdorur është kafja në gështenjë, e cila gjatë pjekjes nga oksidimi ka marrë ngjyrë që priret drejt portokalles. Ngjyra është vendosur në faqe drejt në sfondin natyror të enës. Me këtë lloj dekor i pikturoheshin zakonisht pjesët e dukshme të enës (buzët, qafa e supet e saj). Më rrallë lyheshin pjesët e padukshme të enës si ana e brendshme e buzëve ose fundi i saj. Zbukurime të bëra me pikturim mbanin edhe vegjet vertikale. Zbukurime të tjera ishin vijat e drejta lineare që vinin rrith e qark enës, vija prej pikash e njollash amorfë (Tab. VI, 8), që ndeshen zakonisht në vegjét horizontale të këtyre enëve dhe vija të trasha të kryqëzuara në formën e gërmës X. (Tab. LII, 5). Më pasurisht zbukurohej pjesa mbi supet dhe qafën e enës. Dekorimi i tyre bëhej me furçë. Për qafën e enës karakteristike ishin pikëzimet dhe vijat radiale (Tab. LXVI).

Krahasimi stilistiko tipologjik i këtyre enëve, veçanërisht dekorimi i tyre, me të tilla enë të qendrave të tjera antike ka treguar se kjo lloj qeramike ka pasur një përhapje të gjerë. Deri vonë ekzistonte mendimi se treva e përhapjes të kësaj qeramike ishte ajo Vjosë-Devoll-Shkumbin, por nuk është përjashtuar mundësia e gjetjes së saj edhe jashtë kësaj treve. Si origjinë e prodhimit të saj deri para disa vjetësh ka qenë konsideruar Apolonia. Por zbulimi në këta pesë-

---

77) N. Bodinaku, Mallkuç, «B.A.» nr. 4, 1971, f. 219, Tab. II; H. Spahiu, Rethi i Krujës, Po aty, Tab. IV, 7.

mbëdhjetë vjetët e fundit i kësaj qeramike dhe skarciteteve të saj në gjermimet e bëra në Dimal u ka dhënë mundësi studiuesve të kërkojnë qendrat e prodhimit të saj. Në stadin e sotëm të kërkimeve si një nga qendrat prodhuese kryesore për këtë lloj qeramike të datuar në shek. III-II p.e.sonë e të dokumentuar nga sasia e madhe e gjetjeve dhe e skarciteteve rezulton të jetë qyteti ilir i Dimalit.<sup>78</sup>

e 1. Fragment buzë hidrijesh, të sheshta dhe të shpërvjela nga jashtë në formë strehe. Ena është lyer në pjesën e sipërme të grykës me vernik të zi në kafe (Tab. LI, 2).

e/2. Disa fragmente të tjera hidrijesh me buzët e drejta dhe të shpërvjela nga jashtë ndryshojnë nga të parat nga profilimi në pjesën e brendshme ose të jashtme të tyre (Tab. VIII, 15).

e 3 Fragmente hidrijesh, me buzë gjysmë të shpërvjela nga jashtë në formë strehe dhe të rrumbullakuara e të pajisura me një kanal në pjesën e sipërme (Tab. II, 9). Një fragment të ngjashëm me këtë e gjejmë midis qeramikës të shek. III-II p.e.sonë të zbuluara në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>79</sup>

e 4 Pjesë gryke e një hidrije me vegjen e plotë petullicë të pajisur me dy kanelyra të thella (Tab. VIII, 17).

e 5 Fragment grykë hidrije me buzë të shpërvjela nga jashtë në formë strehe me prerje trekëndëshi (Tab. VIII, 16).

e 6 Vegjë hidrije me pjesë pareti e buzë të shpërvjela nga jashtë me një kanal paksa të shënuar në pjesën e sipërme. Vegja me prerje petullicë është e pajisur me dy kanelyra gjatësore dhe tri gungëza prej balte të përdorura si përforcim në vendin e bashkimit me buzët (Tab. VIII, 18).

f 7 Vegjë horizontale e një hidrije me pjesë pareti, ka prerje petullicë (Tab. VII, 8).

f 8 Fragment hidrije me buzë të anuara nga jashtë dhe të pajisura anash me kanal (Tab. VIII, 14; Tab. LI, 2).

Vegjë, buzë dhe parete hidrijesh të zbakuruara me shirita, vija të pikëzuara, njolla amorfë etj., të bëra me bojë të zezë, kafe ose të kuqërrëmtë janë zbuluar edhe në kalanë e Irmajt dhe në qytetin ilir të Dimalit.<sup>80</sup> Enë të tilla me pik-

78) B. Dautaj, *Aspekte të jetës ekonomike në Dimal*, «Iliria» VI, 1976, f. 152 (Tab. IV).

79) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XL, 14.

80) F. Prendi, Dh. Budina, *Kalaja...*, f. 35, Tab. XII, a; B. Dautaj *Aspekte...*, f. 152, Tab. IV.

turime të ngjashme me tonat janë gjetaur në Apoloni, vëçanërisht në një hedhurinë qeramike të shtresës së shek. II-I p.e.sonë në Dyrrah, në Amanti, në Cakran të Fierit, Belsh, Klos, Margëlliç, Kaninë etj.<sup>81</sup>

Qeramika e dekoruar me pikturim me vernik të zi dhe kafe në të kuqërrëmtë, e cila në qytetin e fortifikuar të Beratit datohet gjithashtu në shek. III-II p.e.sonë, duhet konsideruar, në mungesë të prodhimeve skarco e importuar nga qyteti më i afërt ilir i Dimalit<sup>82</sup>, ose nga një qendër e madhe prodhimi siç ishte Apolonia. Me këtë të fundit sikurse tregojnë edhe monedhat e Apolonisë me Apolon-Obelisk të gjetura gjatë gërmimeve, qyteti ilir në kalanë e Beratit duhet të ketë pasur marrëdhënie të dendura tregtare.

#### f) *Ojnohe*

f/1. Enë të tipit ojnohe ose kotruve të fragmentuara. Njëra prej tyre ka një vegjë petullicë të përshkuar për së gjati nga dy kanelyra të cekëta, që zenë vend fill nën buzë ose në qafën e enës për t'u mbështetur mbi shpatullat e saj. Ena është e lyer në pjesën e jashtme dhe pjesërisht nga brenda, në pjesën e buzëve, me vernik të zi pa shkëlim. (Tab. VII, 12).

Në qeramikën e kësaj shtrese të térheqin vëmendjen edhe disa vegja brinake dhe ato në formë bisht kungulli, (Tab. LI, 4, 6; Tab. LII, 2, 7) që ju përkasin enëve të tipit kanë dhe që zakonisht zënë vend pothuaj në një nivel me buzët e enës; janë të lyera me vernik të zi të dobët (Tab. LVI, 2). Këto lloj vegjesh janë të shpeshta në qeramikën e qyteteve tona iliro-jugore dhe epirote<sup>83</sup>.

81) S. Anamali, *Gërmime në anën verilindore të qytetit të Apolonisë* (Sektori C-1958) «Studime Historike» 1, 1964, f. 142; N. Ceka, Vendbanimi..., f. 438; B. Dautaj, Aspekte ..., f. 152-153; D. Komata, *Rezultatet e gërmimeve të vitit 1974 në Kalanë e Kaninës* «B.A», 5, 1975, f. 67.

82) B. Dautaj, *Zbulimi i qytetit ilir Dimal*, «Iliria» II, 1972, f. 139.

83) F. Prendi, Dh. Budina, *Kalaja* ..., f. 35, Tab. XI b; DH. Budina, *Antigonea* ..., f. 343, Tab XXIV, 12; B. Dautaj, Aspekte..., f. 152, Tab. III, 12, 13; H. Hidri, *Gjurmë* ..., f. 210.

g) *Flakoneë*

g/1 Fragment gryke flakoni me buzë të hapurë nga jashtë në formë strehe. Diametri i grykës 1,5 cm.  
g/2 Dy funde flakonesh. Diametri i njërit 2,5 cm. Tjetri i tjetër i thyer.

gj) *Piksidi*

gj/1 Pjesë e fundit të një piksidi të pajisur me këmbëz gjysmëunazore, pak të thyer në njerën anë. Është i lyer me vernik të zi pa shkëlqim. (Tab. IV, 20).

B. Enët e kuzhinës. Në krahasim me kategoritë e tjera të enëve enët e kuzhinës paraqiten në një numër më të kufizuar tipash dhe variantesh. Megjithëse ato nga gërmimi kanë dalë në një gjendje mjaft të fragmentuar, kemi mundur të dallojmë në mes tyre, enë të tipit vorbë, tasa, tava, qypa etj.

a) *Vorba*

Vorbat janë përgatitur prej një balte jo shumë të pastër që shpeshherë përmban grimca gurësh gëlqerorë. Kanë ngjyrë kafe të errët, në të zezë, gështenjë ose kafe në të kuqërrremtë. Kanë në përgjithësi trup gati sferik, qafë të shkurtër dhe buzë të drejta, herë herë të trashuara që hapen nga jashtë në formë strehe. Vegjët që zakonisht kanë poshtme.<sup>84</sup>

a/1 Fragmente vorbash me trup sferik e buzë të trashura, të pjerrura nga brenda (Tab. VII, 4, 5, Tab. LII, 4; Tab. LIII, 1, 2).

a/2 Fragment vorbe në trup të strëgjatur në formë

---

84) N. Ceka, *Qyteti...*, f. 83, Tab. LIV.

dardhe dhe buzë gjysmë të hapura nga jashtë me seksion katërkëndëshi dhe një pragëzim në pjesën e brendshme (Tab. II, 18).

b) *Tava*

b/1 Fragment tave me parete relativisht të trasha. Buzët e drejta vertikale janë të pjerruara nga jashtë paksa të pragëzuara (Tab. VII, 1). Balta e pastër ngjyrë kafe në gri përmban cikërrima mike, pjekja e mirë.

b/2 Fragment tave me parete jo shumë të trasha, fund të sheshtë dhe buzë të harkuara nga brenda me profilim të dyanshëm dhe të rrumbullakuar në formë gjysmërrethi në pjesën e sipërme të tyre. Balta e pastër që përmban cikërrima mike, ka ngjyrë kafe pak si në të kuqerremtë, pjekja e mirë.

b/3 Fragmente tavash me parete të trasha, buzë pak të kthyera nga brenda të harkuara dhe të profiluara nga jashtë. Balta e pastër ngjyrë kafe në gri, pjekja e mirë. Njëri fragment është i pajisur me një kanal të vogël në buzë.

c/ *Kapakë*

Midis fragmenteve të enëve të kuzhinës dhe të transportit në këtë shtresë janë mbledhur edhe disa fragmente kapakësh. (Tab. LI, 7, 8).

c/1 Kapak i fragmentuar, mjaft i shtrirë dhe me buzët të rrumbullakuara në skajet, me mbajtësen në formë cilindrike, jo shumë të lartë. Balta e pastër ngjyrë okër në rozë, pjekja e mirë. Diametri i mbajtëses 4,2 cm. Diametri i kapakut 6 cm.

c/2 Kapak i fragmentuar me mbajtësen e plotë në formë cilindrike 1,1 cm të lartë me një gropëz të thelluar në anën e brendshme. Balta e pastër ngjyrë rozë, pjekja e mirë.

c/3 Kapak i madh në trajtë kësule gjysmësferike me mbajtësen në formë unazore. Balta e ashpër ngjyrë kafe me gjurmë djegieje. Pjekja relativisht e mirë. Diametri i mbajtëses 5,5 cm. (Tab. LIV, 5).

c/4 Kapak i vogël i shtrirë me buzë të drejta pak të

trashura, që vijnë e hoilohen në skajët me një këmbëz të ulët dhe të sheshitë në formë disku. Balta jo shumë e pastër përmban grimca tulle me ngjyrë okër në kafe, faktura shumë e ashpër. Pjekja relativisht e mirë. Diametri i kapakut 7,7 cm, ai i mbajtëses 3,8 cm.

c 5 Kapak masiv i ndonjë amfore (Tab. LI, 7). Ka formë disku me trashësi 1,7 cm dhe mbajtëse në trajtë kubike. është përgatitur prej balte të pastër që gjatë pjekjes ka marrë ngjyrë gri. Diametri 9,2 cm.

Kapakë të tillë janë të zakonshëm në qytetet antike.

### C. Enë të qilarit

a/1 Fragment qypi me trup të stërgjatur në formë dardhë, me grykë të shkurtër cilindrike dhe buzë paksa të hapura dhe të pjerrura nga brenda me profilim për mbështetjen e kapakut. Balta e pastër, ngjyrë rozë e ndezur në kafe, pjekja e mirë. Ena ka një punim të ashpër, karakteristik për enët e kuzhinës dhe të qilarit. Është e ngjashme me një copë të gjetur në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme që si kohë i takon shek. III-II p.e.sonë<sup>85</sup>.

a/2 Fragment gryke qypi në formë cilindrike, me buzët të trashura e me prerje trekëndëshi, paksa të profiliuara nga jashtë. Balta jo shumë e pastër përmban grimca guri gëlqeror të shtypur, ngjyra e baltës e kuqërrëmtë, me sa duket i përket shek. III-II p.e.sonë. Ena ka një punim të trashë dhe fakturë të ashpër. Pjekja e mirë.

a/3 Fragment gryke pitosi me buzë të trashura e të sheshta shumë të shpërvjela nga jashtë. Balta ngjyrë okër në kafe përmban copa gurësh e tullash të shtypura, pjekja relativisht e mirë (Tab. VIII, 13).

Një grykë pitosi e ngjashme me këtë është gjetur në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme dhe në Kalanë e Irmajt.<sup>86</sup>

85) Po aty, f. 71, Tab. XL, 12.

86) N. Ceka, *Qyteti..*, Tab. XLIII, 11; F. Prendi—Dh. Budina, vep. cit., f. 32, Tab. IX b (e treta).

## D. Enët e transportit

Në ekominë e këtij qyteti dhe sidomos në marrëdhëni e tij tregtare me vendet e tjera një vend të rëndësishëm zinin enët e transportit, amforat. Ato kanë përete relativisht të trasha me përmasa të mëdha. Janë përgatitur prej një balte të pastër herë ngjyrë okër në rozë ose të verdhë dhe herë kafe në të kuqerremtë ose të çelët, që ndonjëherë përmban grimca tullash të situra mirë. Diadmetri i tyre lëviz nga 12-20 cm.

### a. Amforat.

a'1 Fragmente gryke amforash me buzë të trashura dhe të shtrira si strehë me prerje në formë trekëndëshi (Tab. II, 16) dhe ndonjëherë të pajisura anash me një vijë të thelluar. (Tab. II, 17; Tab. VIII, 11). Nga pikëpamja tipologjike këto amfora janë të ngjashme me amforat italike. Paralelen e tyre më të afërt e gjemjë në qeramikën e shtresës VII të Albintimiliumit (Itali), që datohet në shek. III p.e.sonë.<sup>87</sup>

a'2 Fragmente amfore me buzë të trashura të profiluar e të pjerrura nga jashtë me prerje trikëndëshi. (Tab. II, 15). Ky tip amfore është i ngjashëm me njërin nga variantet themelore të amforave Dressel 1, të ashtuquajturat «Amfora di Marsiglia» (Dressel 1A), të datuara në vitet 170-150 p.e.sonë.<sup>88</sup>

a'3 Fragmente amforash me grykë në trajtë hinke e buzë të shpërvjela si strehë me seksion sinusoidal. Njëra copë është e lyer në të dy anët me vernik të zi pa shkëlqim, ndërsa tjetra e lyer pak hollë në pjesën e brendshme dhe të jashtme të buzëve me një vernik kafe-gështenjë.

a'4 Fragmente grykë amforash me buzë të shtrira nga jashtë si strehë me seksion trekëndëshi dhe skaje të drejta ose me majë. Njëra copë ruan tepricat e një vegje. të thyer me seksion në formë elipsi që hapet nën buzët e enës (Tab. II, 19; Tab. VIII, 3, 9).

87) N. Lambolia, *Sulla oronologia della amfore romane di età Repubblicane (II-I secolo A.C)* botuar në «Revista di Studi Liguri» Anno XXI, N 3/4, 1935, f. 251, fig. 7.

88) Po aty., f. 247, fig. 3.

Paralelet më të përafërta të këtyre copave i gjejmë në qeramikën e shtresës së VI (B<sub>1</sub>, B<sub>2</sub>, B<sub>3</sub>) të Albintimiliumit të datuara rreth viteve 170-110 p.e.sonë.<sup>89)</sup> Njëra copë prej tyre ruan edhe vegjën petullicë që ze vend nën grykër e enës. Ky tip mund të krahasohet fare mirë me një amforë 1C të shtresës më të lashtë të Vada Sabinas (Itali) të datuar në fund të shek. II p.e.sonë.<sup>90)</sup>

a/5. Fragmente amforash me buzë të rrumbullakta në formë unazore në disa raste të veçuara qartë nga trupi dhe me seksion eliptik (Tab. VIII, 2, 7, 10). Janë të ngjashme me amforat e gjetura në shtresën VI A<sup>2</sup> të Albintimiliumit (Itali) të datuara rreth vitit 50 p.e.sonë.<sup>91)</sup>

a/6. Fragmente amforash me buzë të drejta me seksion gati në formë katërkëndëshi (Tab. VIII, 1, 4, 5, 9). Njëra nga këto copa është e ngjashme me një buzë amfore të formës 1C, që vjen nga shtresa më e lashtë e Vada Sabinas (Itali), e datuar rreth shek. II p.e.sonë.<sup>92)</sup>

a/7. Fragmente gryke amforash me buzët pak të veçuara nga trupi dhe me seksion gati në formë katërkëndëshi, pak të lakuara në paretin e jashtëm (Tab. VIII, 8, 15). Si formë këto lloj amforash afrohen me një copë të formës 1B -të amforave të Albenga-s (Itali), të datuara në vitet 170-150 p.e.sonë.<sup>93)</sup>

a/8. Fragment buzë amofre e veçuar paksia nga trupi dhe e pjerrur lehtas nga jashtë. Është mjaft e ngjashme me një amforë të gjetur në shtresën e VB të Albintimiliumit (Itali), të datuar rreth vitit 150 p.e.sonë.<sup>94)</sup> (Tab. VIII, 6).

a/9. Fragment gryke amfore cilindrike e ngushtë me buzët e prera pjerrëtas dhe e profiluar në paretin e jashtëm. Nën vijën qarkuese të profiluar shihen tepricat e një vegje petullice, që nuk ruhet (Tab. VIII, 14). Është e përafërt me formën 28 të amforave të anijes romake nga Albenga të datuar në shek. II p.e.sonë.<sup>95)</sup>

89) Po aty, f. 252, fig. 8 (e para në rreshtin e II).

90) Po aty, f. 249, fig. 6 (e dyta në rreshtin e I).

91) N. Lambolia, *Sulla Cronologia ...*, f. 259, fig. 15 (e dyta dhe e treta në rreshtin e fundit).

92) Po aty ..., f. 249, (e dyta në rreshtin e III).

93) Po aty ..., f. 247, fig. 4.

94) Po aty ..., f. 252 (e gjashta në rreshtin e parë).

95) Po aty ..., f. 266, fig. 22.

a/10 Fragment grykë amofre në formë hinke, me buzë të trashura dhe të lakuara nga jashtë me seksion në formë bajameje (Tab. XIII, 3). Është e përafërt me një fragment amfore të gjetur në shtresën kulturore të shek. III-II p.e. sonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>96</sup>

a/11 Fragment buzë amfore e profiluar nga jashtë në formë të shkallëzuar, me seksion gati në formë trekëndëshi.

a/12 Fragment gryke amfore me buzë të shpërvjela dhe të pjerrura nga jashtë. Ena është e lyer nga brenda dhe pjesërisht nën buzë me vernik të zi të holluar ngjyrë kafe në gështenjë.

Midis fragranteve të amforave janë gjetur edhe disa vegja, dy prej tyre me një pjesë buze, të cilat janë të drejta dhe të pajisura nga jashtë me tri brazda qarkuese. (Tab. LII, 5, 8), ndërsa në sipërfaqen e një vegje të tretë shihen zbukurime të stampuara në formë rozete e halëpishe (Tab. IX, 10, Tab. LI, 9).

Një vegjë tjetër e përbërë prej dy shiritash të lidhur në formë nyje (Tab. LIII, 6) duket se i përket gjithashtu një ene të tipit amforë.

Këto lloj vegjash janë karakteristike për qeramikën e qyteteve tona antike. Dy të tillë janë gjetur në punishten e qeramikës së Dyrrahut, të datuara në gjysmën e dytë të shek. III dhe në shek. II p.e.sonë.<sup>97</sup>

Në mbyllje të analizës të qeramikës të kësaj shtrese vlen të vihen në dukje edhe disa fragmente qeramike, midis tyre një paret skifosi me kanelyra me vernik të zi me shkëlqim metalik (Tab. IX, 1; Tab. LIII, 8), që si kohë duhet ti përkasë gjysmës së dytë të shek. IV p.e.sonë dhe disa parete enësh tip megare (Tab. IX, 7, 8; Tab. LIII, 3-5), të cilat në krahasim me gjetjet e tjera të qeramikës kanë dalë në një numër tepër të kufizuar.

#### D. Të ndryshme

Në qeramikën e kësaj shtrese janë gjetur edhe disa fragmente kandilash, pesha dhe rrotulla prej balte të pjekur, terrakota, tjegulla dhe tulla. Me interes të veçantë janë disa

96) N. Ceka, Qyteti ..., Tab. XL, 7.

97) H. Hidri, Gjurmë..., Tab. IV, 8, 9.

vula epigrafike dhe anepigrafike të bëra mbi fragmente tu-llash dhe mbi parete e vegjë enësh etj.

### a. *Kandilat*

Midis fragmenteve të qeramikës të kësaj shtrese janë gjetur edhe disa copa kandilash, që, megjithëse shumë të fragmentuara, janë me interes. Po japim më poshtë përshkrimin e tyre.

a'1 Fragment kandili me trup në formë disku dhe me pipthin të dalë, që zgjerohet në të dy anët si sqep zogu, e të pajisur me brimën rrethore, që duket pjesërisht prej nga dilte fitili i ndezur. Është përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë rozë në të kuqërrremtë dhe i lyer me vnik ngjyrë kafe, pjekja e mirë. (Tab. IV, 21). Te të njëjtë tip janë edhe tri copë të tjera shumë të fragmentuara (Tab. IV, 22, 24).

Kandila me formë shumë të përafërt me këtë janë gjetur në gërmimet e bëra në një punishte qeramike në Dyrrah,<sup>98</sup> të datuar në shek. II p.e.sonë dhe në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>99</sup>

a'2 Një tipi tjetër duket se i përket pjesa e një kandili me trup të rrumbullakët, gati në formë cilindrike me pipthin e stërgjatur. Balta është e pastër, ngjyrë rozë në kafe, pjekja e mirë. Kandili është i lyer në të dy anët me vnik të zi të dobët (Tab. IV; 23).

a'3 Pjesa e sipërme e një kandili të zbukuruar me tri vija të thelluara në pjesën e sipërme dhe me një rozetë, nga e cila ruhen vetëm katër petale jo të plota. Balta është e pastër, ngjyrë rozë në kafe, pjekja e mirë; është i lyer me vnik të kuq me pak shkëlqim. Duket si i tipit tranzistor dhe si kohë duhet t'i përkasë fazës së kalimit nga periuadha helenistike në atë të pushtimit romak, shek. I p.e. sonë (Tab. IX, 3; Tab. LII, 3).

---

98) Po aty..., f. 249; Tab. II, 15.

99) N. Ceka, Qyteti..., f. 123, Tab. LXXVII, 3

## b. Peshat

Në kompleksin e gjetjeve të qeramikës një grup të vëçantë formojnë edhe peshat prej balte të pjekur.

Sipas formës që ato kanë mund të veçohen në dy grupe: pjesa më e madhe e tyre kanë formë konike (Tab. IX, 15-17), të tjerat piramidale. Janë përgatitur prej një balte jo shumë të pastër që përmban grimca tullash ose gurësh të thërrmuar me ngjyrë okër në kafe, e kafe në gri ose kafe në rozë apo të kuqërrremtë. Brumi i baltës të këtyre peshave është i ngjashëm me brumin e qeramikës masive dhe të enëve të tjera të kësaj shtrese, çka tregon se ato janë prodhuar në vend në të njëjtat punishte të qytetit. Në përgjithësi janë masive me një lartësi që shkon nga 8,5 cm deri në 10,5 cm. Diametrat e peshave konike, duke llogaritur copat e plota luhaten midis 4,2-7,5 cm. Shumica e peshave tona janë të thjeshta dhe duhet të kenë shërbyer si pesha për rrjeta peshkimi. Por midis tyre ka edhe të tillë që mbajnë vula gërmash të paqarta me shenja të ndryshme dekorative, si edhe me vula të vogla figurative anepigrafike (Tab. LIV, 8, 9; Tab. LV, 4, 7).

Këto të fundit duhet të kenë shërbyer padyshim si pesha për të térhequr fijen në vegjët vertikale. Midis tyre dallohen shenja dhe ornamente të bëra me gjërvishje ose prej tri radhë vijash të pikëzuara të vendosura për së gjati në faqen anësore ose në formë kryqi mbi bazën e konit (Tab. IX, 11; Tab. LV, 4).

Nuk ka të dhëna të sigurta, së paku deri tani, për datimin e këtyre peshave.

Vulat në peshat janë konsideruar nga studiuesit si vula të punishteve të vëçanta ose janë bërë për efekte zbukurimi.<sup>100</sup>

Peshat e të dy illojeve që përmendëm janë gjetje të zakonshme në qytetet tona antike e ilire. Ato janë gjetur me shumicë në Apoloni, në Dyrrah, në Kalanë e Irmajt, në Dimal, në Zgërdhesh, në Antigone, në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme etj.<sup>101</sup>

100) F. Prendi, Dh. Budina, *Kalaja...*, f. 37.

101) Po aty, f. 36, 37, Tab. XVII, á; Dh. Budina, *Antigonea...*, f. 308, fig. 49, Tab. XIX, 3; N. Ceka, *Qyteti...*, f. 74, Tab. XLVII, 16-18.

### c. Terrakotat

Përveç qeramikës së përdorimit të përditshëm shtëpiak dhe asaj masive të ndërtimit nga gërmimet kanë dalë edhe prodhime të qeramikës artistike, kryesisht terrakota. Megjithëse të kufizuara në numër dhe mjaft të fragmentuara ato, duket se trajtojnë figura nga jeta e përditshme. Disa fragmente të mbledhura në gërmimet në pikën B paraqesin figurat njerëzish dhe kafshësh, që kanë shërbyer si atributë hyjnish ose mund të kenë qenë përdorur si lodra fëmijësh.

Terrakota të tilla janë të njohura në qytetet tona ilire si në Amanti, Dimal, Antigone, në Zgërdhesh etj.<sup>102</sup>

c 1. Fragment terrakote që paraqet një trup gruaje (e thyer) pa kokë dhe pa gjymtyrët e poshtme. Është e piktuar me dy breza verniku të zi që kryqëzojnë njëri tjetrin. Është përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë okër, me pjekje të mirë.

Përmasat e ruajtura janë lartësia 5 cm, gjerësia 3 cm.

c 2. Fragment terrakote, pjesa e poshtme e një figurine gruaje me veshje të gjatë. Është përgatitur prej një balte jo shumë të pastër që përban pak grimca gurësh gëlqerorë. Ngjyra e pjekjes okër, vende-vende sidomos në prerje gri. Pjekja e mirë. Gjatësia e pjesës së ruajtur 8,7 cm; gjerësia 4 cm (Tab. LXIV, 1).

c/3. Fragment, koka e një terrakote që përfytyron një kafshë shtëpiake ndoshta një qen. Përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë okër në gri. Pjekja e mirë (Tab. IX, 6; Tab. LXIV, 2).

Në masën e madhe të qeramikës së kësaj periudhe janë gjetur edhe disa rrotulla prej balte të pjekur (diferencatorë) që kanë shërbyer për vëçimin e enëve të stivosura në furra që të mos ngjiten gjatë procesit të pjekjes. Ato janë dy tipash: në formë çikriku (Tab. LV, 3) dhe rrotulle (Tab. LV, 5, 6).

d 1. Dy prej tyre të fragmentuara janë masive me parete të trasha në formë çikriku, të larta 4,4-4,5 cm me diametër 3,5 cm — 4 cm, dhe me trashësi që lëviz nga 1,2-1,6 cm. Njëra copë është përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë

102) S. Anamali, Amantia..., «Iliria» II, 1972, f. 85, Tab. XIII, 2,3; B. Dautaj, Zbulimi..., f. 140, Tab. V; S. Islami, Qyteti ilir..., f. 207, Tab. V, 1 e 5; Dh. Budina, Antigonea..., f. 307, fig. 48, 3.

okër në sipërfaqe dhe rozë në prerje, (Tab. VI, 7.9; Tab. LIII, 10) ndërsa tjetra ngjyrë gri me nuanca të errëta dhe e lyer në sipërfaqe me një lym balte ngjyrë bezhë, që vende vende është ciflosur (Tab. LIII, 9). Rrotulla të tilla janë gjetur në qeramikën e shek. III-II p.e.sonë të zbuluar në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>103</sup>

d/2. Dy rrotulla të tjera jo shumë të larta kanë sipërfaqe të sheshta e skaje të mprehta. Janë përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë okër në rozë dhe vetëm në anën e dukshme janë punuar. Kanë sipërfaqe të lëmuar, kurse nga brenda kanë një punim trashanik. Diametri i tyre i brendshëm është 2,7-4,5 cm lartësia 1 cm (Tab. VI, 14).

Edhe këto lloj rrotullash janë të njoitura nga qeramika e së njëjtës periudhë (shek. III-II p.e.sonë) të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>104</sup>

d/3 Një disk i vogël prej balte të pjekur në formë gjuhëze ka shërbyer, me sa duket, si diferencator. Është përgatitur prej një balte jo shumë të pastër ngjyrë rozë në kafe që përmban grimca tjegullash të shtypura. Diametri 3,7 cm.

#### e. Vulat

e/1 Fragment tjegulle me trashësi 2,7 cm. Balta e saj ngjyrë rozë në kafe përmban thërrmija tullash të shtypura. Në njerën anë të fragmentit brenda një fushe në formë katërkëndëshi të rregullt lexohen katër gërmat e para të një emri ΠΑΤΕ...: Katërkëndëshi dhe mbishkrimi i gdhendur brenda tij nuk janë të plotë mbasi tjegulla është e thyer (Tab. IX, 12).

Mbishkrimi jo i plotë i vulës është shkurtimi i emrit të pronarit të punishtes, emër që e kemi ndeshur edhe në një vulë përmbi një tjegull të zbuluar në Kalanë e Irmajt.<sup>105</sup>

e/2 Në buzën e një fragmenti ene me parete jo shumë të trasha lexohet vazhdimi i një mbishkrimi: ενοει... (e bëri), ku mungon emri i pronarit të punishtes që e bëri.

103) N. Ceka, *Qyteti...*, f. 74, Tab. XL, 21; Tab. XLVII, 14, 15.

104) Po aty., f. 174, Tab. XLVII, 14, 15.

105) F. Prendi, Dh. Budina, *Kalaja...*, f. 31, Tab. VIII, a.

e/3 Në një peshë që ka qenë përdorur për vëgja brenda një fushe katërkëndëshe lexojmë një vulë epigrafike: ATMA (Tab. IX, 13; Tab. LIV, 8). Vula të tilla nuk janë të zakonshme në peshore. Ato i gjejmë në përgjithësi në fragmente tjegullash dhe tregojnë emrin e pronarit të punishtes ku janë prodhuar.

e/4 Vegjë masive e ndonjë amfore transporti në formë cilindrike. Balta e pastër ngjyrë kafe e çelët, pjekja e mirë. Në pjesën e sipërme të vegjës, brenda një fushe në formë katërkëndëshi të rregullt  $4,3 \text{ cm} \times 1,6 \text{ cm}$  ka qenë stampuar një mbishkrim, prej të cilit sot lexohen vetëm tri germat e fundit .... AIO, ku ndoshta kemi një KAIO (Tab. IX, 14; Tab. LV, 2).

Mbi vegjën e një amfore është ngulitur një germë N, ndoshta shenja e mjeshtrit ose e punishtes, ku ka qenë prodhuar.

Një vulë me germa të ngjashme si kjo e shohim mbi vegjën e një amfore të prodhuar në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>106</sup>

e/5 Mbi buzën e një amfore të shek. II p.e.sonë, brenda një kornize në formë katërkëndëshi lexohet një vulë tjetër jo e plotë me shkronja të pabarabarta dhe të paniveluara mirë: EUKOΛ... (Tab. IX, 9; Tab. LVI, 6).

e/6 Në anën e sipërme të një vegje ene gati shpatuke shihen stampa vulash anepigrafike dy llojesh: në formë rozete të stilizuar dhe në formë bredhi. (Tab. IX, 10). Vula të tilla në formë rrethore me rozetë të skematizuar, janë të njoitura dhe nga qytete të tjera ilire jugore si në Dimal, Kalanë e Irmajt, në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme<sup>107</sup> etj.

e/7 Mbi buzën e një pitosi të zbuluar në pikën B shihet një vulë anepigrafike brenda një rrathi të vogël me 8 rrëze në formë rozete të skematizuar (Tab. LV, 1) Vula të tilla janë të shpeshta në gjetjet e vendbanimeve dhe qyteteve tonë ilire si në Kalanë e Irmajt<sup>108</sup>, në zonën e Çorovodës (Rr. i Skraparit) etj.

...Prania e vulave anepigrafike në qeramikën e këtij qyteti

106) N. Ceka, *Qyteti...*, f. 67, Tab. XVI, 21.

107) B. Dautaj, *Zbulimi...*, f. 139, Tab. II, 4; F. Prendi — Dh. Budina, Kalaja..., f. 33, Tab. X (e katërtë nga e majta në të djathtë); N. Ceka, *Qyteti...*, f. 74, Tab. XVII, 5.

108) F. Prendi — Dh. Budina, *Kalaja...*, f. 34; Tab. X, C.

lidhet, me sa duket, me një zakon të njojur edhe në qendra të tjera të trevës iliro-jugore dhe mjaft të përhapur në botën helene. Studiuesit i lidhin këto me zakonin e vulosjes së artikujve të geramikës me shenjën e pronarit të punishtes dhe janë konsideruar më tepër si marka, që shënojnë një punishte të caktuar, por mund të jenë bërë edhe për efekte zbulimi.<sup>109</sup>

Gërmimet në qytetin e fortifikuar të Beratit kanë dhënë midis të tjerash një sasi të madhe qeramike masive të ndërtimit, veçanërisht kjo bie në sy për periudhën qytetare ilire.

Ajo përfaqësohet kryesisht nga tjegullat e sheshta (solene) dhe të harkuara (kaliptere) (Tab. X, 1,5). Janë të pranishme solenet e tipit me pragje anësore të shkurtra, karakteristike për shek. III-II p.e.sonë (Tab. X, 1-4). Tjegullat e tipit solen dallojnë nga ato të tipit kalipter për brumin e pastër dhe pjekjen e mirë. Kalipteret kanë formën e një tubi gjysmëcilindrik, me faqe të larta e të përkulura. Përveç soleneve me profil të trashur janë gjetur me shumicë solene me profil katërkëndësh ose si sqep zogu.

Tjegullat e gjetura me shumicë tregojnë se ato kanë pasur një përdorim dhe ripërdorim të gjerë në ndërtimin e shtëpisive të baniimit ose të godinave me karakter shoqëror. Por ato kanë qenë përdorur edhe për ndërtimin e varreve siç është rasti i varrit të zbuluar në pikën C, i ndërtuar me tjegulla solene të plota me përmasa: 0,85 m x 0,42 m; 0,80 m x 0,41 m.

Në pikat e ndryshme të gërmimit janë gjetur edhe disa fragmente tullash me trashësi të ndryshme: 2,5 cm — 5 cm; 2 cm — 5,8 cm; 2,5 cm — 3,7 cm; 2,7 cm — 4,5 cm. Një copë tulle e fragmentuar ishte 3 cm x 2,8 cm. Është gjetur vetëm një tullë e plotë me përmasa 4 cm x 3,2; 2 cm x 3 cm. Janë gjetur, ndonëse më rrallë, tulla me gjurmë byku dhe trashësi 7,5 cm — 8 cm. Karakteristikë për periudhën helenistike. Në një rast të vetëm janë gjetur (në pikën A) disa fragmente tullash të rrumbullakta të përdorura, me sa duket, në ndonjë godinë me sistem ngrohjeje me hipokaust. Por duhet thënë se përdorimi i tullës është shumë i rrallë, gjë që tregon se guri zinte vendin kryesor në ndërtimet e ndryshme me karakter shoqëror ose privat të këtij qyteti.

---

109) Po aty, f. 37, Tab. XVI, 8.

## 5. OBJEKTE METALIKE DHE KOCKE.

Në këtë shtresë kulturore përvèç qeramikës së përdorimit të përditshëm shtëpiak dhë asaj masive janë mbledhur edhe disa objekte të pakta hekuri e kocke si majë shigjetash, grepa për peshkim, etj. dhe disa monëdha prej bronzi. (Tab. XLVI, 7,15; Tab. LXIII, 1,7).

1. *Daltë*. e madhe prej hekuri në formë shpatuke me fletën e zgjatur dhe të ngushtë katërkëndëshe. Megjithëse shumë e démtuar nga ndryshku objekti ruan një gjatësi prej 15,5 cm. Gjerësia e saj është 2,5 cm — 3 cm. (Tab. XLIV, 14; Tab. LXIII, 3). Kjo është një vegël e përdorur nga gurskali-tësit dhe paraqet ngjashmëri me vegla të tillë të së njëjtës periudhë të përdorura për të njëtin qëllim të zbuluara në qytetin ilir të Antigones.<sup>110</sup>

2. Majë hosteni prej hekuri në trajtë konike 7,3 cm e lartë me diametrin e buzës afro 4 cm. Maya është gollë përbrenda, ku ruhen ende tepricat e karbonizuara të bishtit të drunjtë. (Tab. XLVI, 15; Tab. LXIII, 2). Një majë hosteni e ngjashme me këtë është gjetur në gërmimet në Antigone.<sup>111</sup>

Në shtresën kulturore të periudhës qytetare ilire u gjeten edhe dy objekte kocke. Prej këtyre njëri ka formë të gjatë cilindrike gollë përbrenda i pajisur me dy vrima për fiksime, ndoshta doreza e ndonjë instrumenti metalik. Është i gjatë 7,5 cm dhe ka diametrin 1,2 cm. (Tab. XLVII, 8; Tab. LXIV, 4). Objekti tjetër, gjithashtu prej kocke është i thyer dhe si i tillë është vështirë të përcaktohet destinacioni i tij. Pjesa e sipërme ka formën e një rruaze të madhe gjysmësfrike të profiluar lart e poshtë. Lartësia e ruajtur e objektit është 2,1 cm. Diametri 1,8 cm (Tab. LXIV, 12).

## 6. MONEDHAT

### Apoloni

Tip Apolon-obelisk (shek. III-II p.e.sonë).

1. *Æ* ✓ F. Kryet e Apolonit me kurorë dafine mj. rrëthi i përbërë prej kokrrizash.

110) Dh. Budina, *Antigonea...*, f. 302, fig. 43, 1-3.

111) Po aty..., f. 298, fig. 38, 4.

Shp. Legjenda vertikale në të dy anët e obeliskut jo shumë e qartë. [Απολλωνίαταν], kurorë dafinash.

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1973 në pikën C gjatë pastrimit të kanalit kontrollues.

P=3,75 gr. D=15 mm.

H. Ceka, Probleme të Numizmatikës ilire, Tiranë, 1967, f. 118, 69, Tab. IV, 8.

2.  $\Delta E \downarrow$  F. Si nr. 1

Shp. Si nr. 1

Monedha është gjetur në fushatën e gjermimeve të vitit 1973 në pikën «C».

P=3,25 gr. D=16 cm.

3.  $\Delta E \downarrow$  F. Si nr. 1 (Tab. LXV, 2)

Shp. Si nr. 1.

Monedha është gjetur rastësisht në pikën E gjatë fushatës së gjermimeve të vitit 1975.

P=8 gr. D=20 mm.

4.  $\Delta E \uparrow$  F. Kryet e Apolonit në profil dj. (Tab. LXV, 1).

Shp. Obelisk mbi një bazament. Në të dy anët e tij legjenda (AM) BIP.

P=3,75 gr. D=18 mm.

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1974 në pikën B.

## 7. EMRI ANTIK I QYTETIT

Një ndër problemet, që prej kohësh ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm është ai i emrit antik të qytetit të Beratit. Që nga fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i këtij shekulli një varg studiuesish, midis të cilëve i pari Liku e pastaj Batifoli, Tomasheku, Prashnikeri etj.<sup>112</sup> të mbështetur tek autorët antikë, patën shfaqur mendimin se në rrënojat e kështjellës së Beratit duhet parë Antipatrea e përmendur në ngjarjet e vitit 216 p.e.sonë, nga Polibi dhe në ato të vitit 200 p.e.sonë nga Tit Livi.<sup>113</sup> Lidhur me identifikimin e këtij qytetit në literaturën arkeologjike ka mbizotë-

112) W.M. Leake, *vep. cit.*, f. 461; B. Batifoli, *vep. cit.*, f. 7; W. Tomaschek-Payly-Wissowa, *vep. cit.*, sv. Antipatrea; C. Prashniker A. Schober, *vep. cit.*, f. 61.

113) Polyb V, 108, 2; Tit Livi XXXI, 27, 1, 5.

ruar mendimi tradicional se në rrënojat e qytetit të fortifikuar të Beratit duhet parë qyteti ilir i Antipatreas.<sup>114</sup> Këtë mendim e ka shprehur kohët e fundit edhe P. Kaban.<sup>115</sup>

Në lidhje me identifikimin e rrënojave të qytetit antik në kalanë e Beratit me Antipatrean, duhet thënë se, ka pasur edhe mendime që e kundërshtojnë atë. Ndër studiuesit e huaj do të përmendim Pajakovskin i cili e kërkon Antipatrean ilire në stacionin rrugor Mutatio Patras (Itinerarum Burdigalense, Miller S. 520) 11 milje përtej Ohrit.<sup>116</sup> Nuk është pa interes, nga ana tjetër, mendimi i shfaqur kohët e fundit nga N. Ceka, sipas të cilët Antipatre a është përfshirë saj Gerunti, Kryesondyon, Koragu dhe Orgesi duhen kërkuar në luginën e sipërme të Devollit dhe ndoshta në fushën e Korçës. Sipas autorit përshkrimi fizik i Antipatreas përputhet me Symizën.<sup>117</sup>

Në rrënojat e kalasë së Beratit, nga ana tjetër N. Ceka mendon se ndoshta duhet parë qyteti Bargull<sup>118</sup> (Livi XXIX, 12, 137). Ky mendim është kundërshtuar nga Pajakovski dhe S. Islami, të cilët e kërkojnë qytetin ilir të Bargulit në fshatin Bargullas në afërsi të Beratit, ku toponimi shumë i ngjashëm (Bargul-Bargullas) lidhet edhe me ekzistencën e një kështjelle antike.<sup>119</sup> Këto dhe fakti që Barguli, ndryshe nga Antipatre, në burimet e shkruara, përmendet vetëm një herë, na duken bindëse.

Një tregues mjaft domethënës është edhe rishfaqja në

114) Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë, Tiranë, 1965, f. 524; H. Ceka, *Dega jugore e rrugës Egnatia «Monumentet»* 2, 1971, f. 31; A. Baçe, *Qyteti...*, f. 47; S. Islami, *Shteti ilir në luftat kundër Romës*, «Iliria» III, 1974, f. 23, citimi 97; F. Prendi, *Urbanizimi...*, f. 108; S. Anamali, *Nga ilirët tek Arbërit*, «Iliria», f. 1985; Gj. Karaiskaj, *Pesë mijë*, f. 55; H. Spahiu, *Muret...*, f. 134.

115) P. Cabanes, *Recherches archéologiques en Albanie 1945-1985*, «Rev. Arch.» 1, 1986, f. 140.

116) W. Pajakovski, «Starozytni Epir e jego mieszkanczy» Poznań 1970.

117) N. Ceka, *Qyteti ilir në Selcën e Poshtme*, «Iliria» II, 1972, f. 177 citimi 37; N. Ceka, *Qyteti....*, Tiranë, 1985, f. 146, Citimi 492. Lidhur me këtë problem edhe H. Ceka është përkrahës i pikëpamjes Shih: H. Ceka, *Shënimë nga gjeografia historike e Ilirisë së Jugut*, «Iliria» 1, 1984, f. 20.

118) Po aty..., f. 117, citimi 37.

119) S. Islami, *Shteti ilir...*, f. 23, citimi 97; W. Pajakovski, vep. cit., f. 92.

burimet e shkruara, të mëvonshme e emrit të qytetit në një formë pak të ndryshuar Antipagrai, siç e gjemë në shek. VI tek Prokopi i Qezaresë. Vazhdimësia e emrit të qytetit me ndonjë ndryshim të vogël, nga periudha qytetare ilire në kohën antike, të vonë (Antipatrea-Antipagrai) dhe në perudhat e mëvonshme (Pulheriopolis, Belagrita, Belagradon, Belgrad-Berat) përputhet edhe me vazhdimësinë e jetës sociale ekonomike të qytetit, të pasqyruar, sikurse e kemi përmendur edhe gjatë shtjellimit të lëndës, në arkitekturë dhe në kulturën materiale.

Dukuri tjetër që meriton të vihet në dukje dhe që flet në të mirë të mendimit se në rrënojat e qytetit antik të Beratit duhet parë Antipatrea ilire, është, sikurse tregojnë të dhënat stratigrafike të gërmimit të parashtuara më lart, djegia e konstatuar në kuadrin III e IV, gjurmët e së cilës lidhen me shtresën e vonë helenistike, që ka të bëjë me sa duket me ngjarjet e vitit 200 p.e.sonë, për të cilat flet Tit Livi. Tepricat e shumta të drithit të karbonizuar (Fig. 28) nga ana tjetër, të gjetura në brinjën jugperëndimore të kuadratit I (Pika B) dhe shtroja me një shumicë tjegullash helenistike të fragmentuara e gjetur në kuadratin VIII-IX (Pika B) (Fig. 29) janë gjithashtu pasoja të një djegieje të fuqishme që duhet të ketë ndodhur në këtë kohë. Këtyre të dhënavë mund t'u shtojmë edhe faktin sé jo shumë larg qytetit të sotëm të Beratit, në shpinë të tij, ndodhet kalaja ilire e Irmajt, të cilën autorët e gërmimit (F. Prendi e Dh. Budina) me shumë probabilitet e identifikojnë me një nga qytetet e përmendura nga Polybi dhe Livi, me Kodrionin,<sup>120</sup> të cilin Livi duke e quajtur «qytet në një pozitë të mirë dhe të fortifikuar» e përmend fill mbas Antipatreas, kur pëershkuaran pushtimin e qyteteve të Desaretisë (Koragun, Geruntin dhe Orgesin) nga legati romak Luc Apusti, që vintë me ushtrinë e tij nga Apsi (Semani). Vendosja e këtij qyteti në shpinë të Antipatreas antike si dhe pozicioni i përshtatshëm gjeografik e sistemi i tij fortifikues përkojnë plotësisht me të dhënat e historianit romak Tit Livot.

Të gjitha këto sa më sipër parashtuam, si edhe fakti se asnjë qytet tjetër i njojur, së paku deri tanë, nuk mund t'i përgjigjet Antipatreas ilire më mirë sesa Berati, e bëjnë

<sup>120)</sup> F. Prendi — Dh. Budina, *Kalaja...*, f. 44.




Fig. 28

shumë më të mundshëm identifikimin e rrënojave të qytetit antik në kalanë e Beratit me Antipatrean ilire.

#### 8. PERIUDHA QYTETARE ILIRE SHEK. I P.E.SONË — — SHEK. IV I E. SONË

Gërmimet arkeologjike të bëra në rrënojat e qytetit të fortifikuar të Beratit, veçanërisht ato të kryera në pikën B patën një rëndësi të madhe sidomos për ndriçimin e perëdhës qytetare ilire që përfshin shek. I p.e.sonë deri në shek. IV të e. sonë, për të cilën mungojnë të dhënrat e shkruara burimore dhe arkitektone.

Mungesa e materialit arkeologjik dhe e ndërtimeve të kësaj periudhe në qytetin e fortifikuar të Beratit si edhe njoftimi i Tit Lavit mbi ngjarjet e vitiit 200 p.e.sonë (luftërat ilire romake) i kanë dhënë shkas ndonjë studiuesi që të mendojë

• PLANIMETRIA E KUADRATIT IX




Fig. 29

se gjatë periudhës së pushtimit romak qyteti i Antipatreas pat rënë në heshtje,<sup>21</sup> megjithëse pranohet ekzistenza e jetës në bazë të qeramikës «pseudoterrasigillata». Fakti që në mu-

21) A. Baçe, Qyteti..., f. 47.

ret rrighthuese të kalasë së Beratit nuk janë vënë re ndërtimë të periudhës së pushtimit romak nuk duhet lidhur me ndërprerjen e jetës qytetare, pasi një dukuri e tillë, me ndonjë përjashtim, është e njohur edhe në një varg qytetesh e qytezash të trevës ilire jugore dhe të Epirit, si në kalanë e Irmajt, Antigone, Zgërdhesh<sup>122</sup> etj. Në kushtet e qetësisë relative gjatë pushtimit romak në këto qendra, midis tyre edhe në Antipatrea, nuk u ndie nevoja përfortifikime.<sup>123</sup>

Muret rrighthuese të qytetit, që asnjëherë nuk kanë qenë rënuar rrafsh me tokën,<sup>124</sup> në këtë kohë si edhe gjetkë e kishin humbur funksionin e tyre të dikurshëm.

Shtresa kulturore që i përket kësaj periudhe është përfaqësuar nga një sasi e konsiderueshme qeramike e përdorimit të përditshëm shtëpiak, asaj masive të ndërtimit, kjo e fundit në shumicën e rasteve e ripërdorur nga periudha pararendëse, dhe e disa monedhave. Megjithëse kjo qeramikë ka arritur deri tek ne në një gjendje të fragmentuar jemi përpjekur të veçojmë në të dy grupet kryesore: qeramikën e shekuar I p.e.sonë — I të e.sonë dhe grupin tjetër që i takon shek. II-IV të e.sonë, të cilat do t'i analizojmë sipas destinacionit të tyre.

## 9. QERAMIKA E SHEK. I P.E.SONË — SHEK. I TË E.SONË

### A. Enët e tavolinës

Në serinë e enëve të tavolinës janë grupuar ato fragmente që riprodhojnë enë me parete relativisht të holla si kupa, tasa, pjata e pjatanca dhe enë uji si amforiska, broka, këtruve, etj. Këtu janë përfshirë edhe enët e tipit pseudo-terra-sigillata dhe pak terra-sigillata të lyera me vernik të kuq me pak shkëlqim ose pa shkëlqim, të përfaqësuara kryesisht nga buzë enë me pjesë paretë dhe më rrallë funde enësh.

122) F. Prendi, — Dh. Budina, *Kalaja...*, f. 29; S. Anamali, *Amantia...*, f. 61; S. Islami, *Qyteti...*, f. 208; Dh. Budina, *Antigonea...*, f. 318.

123) S. Anamali, *Proçese shndërrimi në trevën Jugore ilire* në shek. I-IV, «Iliria» 1, 1986, f. 13, 22.

124) J. P. Adam, *L'architecture militaire grecque*, Paris, 1982, f. 36.

a) *Kupat*. Në fragmentet është enëve me përmasa të vogla mbizoterojnë kupat më paretë të holla, që dallojnë për larminë e formave të tyre. Janë përgatitur prej një deltine të pastër ngjyrë rozë në të kuqërrëmtë që përmban shumë silicium, gjurmët e të cilit duken në sipërfaqe. Një grup më vete formojnë kupat e vogla të lyera me vernik të kuq ose kafe me shkëlqim argjendi dhe shkëlqim metalik, që dallojnë për pjekjen e mirë dhe finesën e punimit të tyre.

a/1 Më e zakonshme ndër to është kupa në formë kësule gjysmësferike me paretë harkuara dhe buzët e shpërvjela horizontalisht nga jashtë (Tab. XVI, 1-5,12) ose të varura poshtë nganjëherë me seksion rrrethor që shkëputet qartë nga trupi i enës (Tab. XVI, 11).

a/2. Disa fragmente të tjera kupash kanë formë jo të zakonshme të trupit në trajtë hinke me buzët e drejta pak të holluara ose të trashura në skajet dhe të hapura nga jashtë në formë strehe. Shpeshherë ato janë të pajisura në të dy anët me 1-3 vijaska horizontale (Tab. XVI, 14).

a/3 Më vete qëndrojnë disa fragmente kupash me trup në formë trapezi dhe me buzët me seksion sinusoidal të rrumbullakuara nga brenda (Tab. XVI, 7).

a/4 Disa fragmente të tjera kupash kanë pjesën e sipërme të trupit në formë cilindrike dhe të poshtmen në formë segmenti rrrethor (Tab. XI, 2).

a/5 Tipa të veçantë kupash formojnë disa fragmente të tjera me trup në formë këmbane, dardhe apo vezak të fryrë (Tab. XVI, 6, 11,13,14). Kanë buzë të trashura të hapura nga jashtë, me seksion rrrethor që ndonjëherë zgjerohen së tepsëri në skajet ose varen poshtë. Njëra nga kupat tonë me trup në formë trapezi (Tab. XVI, 13) është e ngjashme me një copë të gjetur në shtresën e sipërme të gërmimit të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme, që datohet në shek. I p.e.sonë — shek. I i e.sonë.<sup>125</sup>

a/6 Fragment kupe me trup të vogël bikonik e buzë të sheshta dhe të pjerrura pak nga brenda, me dalje këndore (Tab. XII, 2). Ajo aftron me një kupë të gjetur në shtresën e dytë kulturore të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>126</sup>

Këto lloj kupash kanë qenë lyer në të dy anët me vernik

125) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XLVI, 10.

126) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. L: 9:

të kuq të dobët pa shkëlqim. Më rrallë ato janë lyer vetëm nga jashtë me vernik të kuq me shkëlqim metalik.

b) *Skifosat*. Në qeramikën e kësaj shtrese janë grumbulluar edhe disa fragmente skifosash.

b/1 Disa prej tyre kanë trup vezak, me buzë të drejtë, që ngushtohen në pjesën e sipërme (Tab. XVI, 10). Janë të lyer në përgjithësi me vernik të kuq të holluar me shkëlqim të zbetë dhe më rrallë me shkëlqim metalik.

b/2 Fragmente të tjera skifosash kanë trup gati gjysmë-sferik, buzë të drejtë dhe të kthyera nga brenda, herë-hërë me një profilim të lehtë që del tej paretit. Janë të lyer me vernik kafe në të kuq ose kafe në ngjyrë argjendë me shkëlqim metalik (Tab. XVI, 9).

Si formë është e njojur dhe e trashëguar nga format e qeramikës të periudhës qytetare ilire të shek. III-II p.e.sonë.

a/3 Një tip më vete formojnë skifosat me trup të stërgjatur cilindrik e buzë të veçuara qartë nga trupi i enës me diametrin e grykës 7 cm. Janë të lyer nga brenda ose në të dy anët me vernik të kuq pa shkëlqim (Tab. IV, 6.10; Tab. XVI, 5). Këto lloj skifosash që si formë janë karakteristike për shek. I p.e.sonë janë të ngjashme me një ekzemplar të gjetur në shtresën kulturore që i përket shek. I p.e.sonë — shek. I të e.sonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>127)</sup>

b/4 Skifosat tip kantaroidi me trup vezak dhe paretë relativisht të holla. Buzët e drejtë pak të anuara nga brenda janë të mprehta në skajet. Është i lyer në të dy anët me vernik të kuq pa shkëlqim (Tab. XVII, 3). Për nga trajtimi tipologjik është i ngjashëm me skifosat e shtresës së dytë ulturore të banimit (shekujt III-II p.e.sonë). në këtë qytet.

b/5 Midis fragmenteve të kupave dhe skifozave u gjet dhe fundi i sheshtë i një vazoje në formë cilindrike, që qëndron mbi një fron jo shumë të lartë pseudounazor. Është i përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë okër në rozë, i lyer në të dy anët me vernik të kuq me pak shkëlqim (Tab. XVI, 8). Është e ngjashme me një vazo aretine nga Halterni.<sup>128)</sup>

Këto fragmente paraqesin forma karakteristike për periudhën kalimtare nga antikiteti ilir në periudhën e pushtimit romak dhe si kohë ato datohen në shek. I të e.sonë.

127) Po aty, Tab. L.I, 10.

128) Howard Comfort, Corpus Vaso Arretinorum, Bonn, 1968, Plate I, 16.

c. Tasat, sikurse enët e tjera të këtij lloji dallojnë përbaltën e pastër ngjyrë okër e kafe në të kuqërrremtë ose në ngjyrë kanellë dhe bien në sy përfinesën e punimit dhe pjetkjen e mirë të tyre. Ndër to mbizoterojnë fragmentet e tashave të qeramikës pseudoterra-sigillata dhe më pak ato terra-sigillata, të lyera me vernik të kuq në më të shumtën e rasteve pa shkëlqim dhe më rrallë gjenden ato me sipërfaqe të lustruar mirë me shkëlqim; tek disa nga këto verniku nuk e mbulon të gjithë sipërfaqen e enës. Lyerja është bërë me sa duket me zhytje çka e tregojnë gjurmët e vernikut në formë rëkesh në pjesën e jashtme të buzëve.

Tasat dallojnë jo vetëm nga përmasat e ndryshme, por edhe nga forma e trupit, sipas të cilës kemi mundur të vëçojmë disa tipa:

c/1 Fragmente tasash të vegjël që e kanë trupin në formë trapezi dhe anët të rrumbullakuara në skajet, paksa të anuara nga jashtë me seksion sinusoidal (Tab. XII, 3).

Për nga forma këto tasa janë shymë të përafërt me një ekzemplar të grupit G sipas klasifikimit të H.S.Robinsonit të gjetur në shtresën e dytë kulturore të depozitës D, në Agoranë e Athinës lënda arkeologjike e të cilës i përket gjysmës së parë të shek. I p.e.sonë.<sup>129</sup>

c/2. Fragmente tasash me pjesën e sipërmë të trupit në formë trapezi dhe të poshtmen në formë kësule gjysmësférique, me paretet anësore të drejta të mbledhura nga brenda (Tab. XII, 1) dhe me seksion të ndryshëm trekëndëshi, katër-këndëshi elipsoidal ose paksa të hapura nga jashtë, buzët e të cilave në disa raste trashohen në drejtim të skajeve dhe dalin tej paretit të enëve në formë këmbëze (Tab. XII, 2,5, 7,8,11); në raste të tjera kanë pjesën e brendshme me seksion gjithashu në formë këmbëze (Tab. XII, 8). Ndonjëherë me profilime në pjesën e jashtme të buzëve me prerje këndore që përfundojnë si sqep zogu (Tab. XII, 9).

c/3 Formë jo të zakonshme duket se paraqet një fragment tasi ose pjate e thellë me buzët me seksion trekëndëshi të prera vertikalish nga jashtë. Është përgatitur prej qeramike fine terra-sigillata në ngjyrë të kuqe kanellë të lyer me vernik të kuq të shkëlqyeshëm, që vende vende është cilosur (Tab. XI, 4).

---

129) H. S. Robinson, Pottery of the Roman period «The Athenian Agora», vol. V, Princeton, 1959, f. 24, Pl. 60, G. 9.

c/4 Një fragment tjetër riprodhon një tas të thellë me paretet anësore të rrumbullakuara dhe buzët që hapen nga jashtë në formë strehe (Tab. XII, 7). Balta e pastër ngjyrë okër, pjekja jo e mirë. Ena është e lyer nga brenda me vernik kafe të dobët.

Dy fragmente tasash (Tab. XII, 5,8) janë të ngjashme me një tas që vjen nga shtresa e sipërme e gjermimit në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme (shek. I p.e.sonë — shek. I i.e.sonë)<sup>130</sup> dhe me tasat pergamase të shek. I p.e.sonë të gjatura në Agoranë e Athinës.<sup>131</sup>

c/5 Fragmente tasash (Tab. XII, 6) me trup të vogël e mesatar gati konik ose kësulë gjysmësferike. Kanë buzë të kthyera nga brenda me seksion elipsoidal, katërkëndëshi ose me profilim të brendshëm. Janë përgatitur prej një balte ngjyrë kafe të lyer në më të shumtën e rasteve me vernik ngjyrë kafe pa shkëlqim dhe anës buzëve në pjesën e jashtë kuq kafe pa shkëlqim dhe anës buzëve në pjesën e jashtë me shirita verniku ngjyrë kafe gështenjë në të zezë. (Tab. XII, 6).

Tasa të tillë të përafërt me tanët janë të njojur nga shtresa e sipërme e gjermimit në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme (shek. I p.e.sonë — shek. I i.e.sonë) të konsideruar me të drejtë si formë tasash të trashëguar nga periudha e mëparshme (shek. III-II p.e.sonë).<sup>132</sup> Forma të tillë të përafërt me tonat janë gjetur edhe në gjermimet në Agoranë e Athinës.<sup>133</sup>

d) *Pjatanca*. Një pakicë fragmente enësh duket se riprodhojnë enë të tipit pjatancë me përmasa relativisht të mëdha. Disa prej tyre kanë trup me prerje në formë trapezi me parate anësore dhe buzë paksa të kthyera nga brenda.

Të tjera kanë paretet anësore të pjerrëta me buzët e trashura, që dalin në formë fletëze tej paretit të enës (Tab. XI, 17). Në rastet e tjera, ato si vazhdim i drejtpërdrejtë (Tab. i trupit të enës, shtrihen nga jashtë në formë strehe (Tab. XI, 5). Janë përgatitur nga e njëjta argjilë ngjyrë rozë në të pakuqërremtë, të lyer nga brenda dhe paksa nga jashtë në pje-

130) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. LI, 16.

131) H.S. Robinson, *Pottery...*, Pl. 70, Grupi. L. 61; Pl. 72 g, grupi KE.

132) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XLIX, 15.

133) H.S. Robinson, *Pottery...*, Pl. 68, H. 32, K. 17.

sën e sipërme me vernik të kuq pa shkëlqim. Dallojnë për një pjekje të mirë dhe kanë një tingëllim metalik.

Veçanërisht interesante për nga forma dhe përmasat e mëdha është një pjatancë me trup me prerje me seksion katërkëndëshi kënddrejtë me paretet anësore që bien vertikalish mbi fundin e sheshtë të enës. Diametri i saj 44 cm (Tab. XVII, 7).

Disa nga këto pjatanca paraqesin ngjashmëri, sidomos nga profilimi i buzëve me një tas të gjetur në shtresën e sipërme kulturore të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme të datuar në shek. I p.e.sonë — shek. I i e. sonë.<sup>134</sup>

e. Pjatat. Numri i fragmenteve të pjatave të mbledhura në gjermime është relativisht i madh. Janë gjetur kryesisht buzë me pjesë paretesh, parete dhe funde të veçuara me zbulurime të bëra me ngulitje. Ato janë përgatitur nga e njëjtë argjilë e pastër dhe dallojnë për finesën e punimit të tyre. I përkasin qeramikës të tipit pseudoterra-sigillata dhet më pak asaj terra-sigillata, të lyera në shumicën e rasteve me një vernik të kuq pa shkëlqim. Rrallëherë vihen re copa të lyera me vërnik të kuq në ngjyrë kanelle me shkëlqim.

e/1 Pjata të shtrira më trup gati cilindrik dhe buzë të larta, të ngritura pothuajse vertikalish, me seksion rrëthor ose katërkëndëshi, janë lyer me vernik të kuq pa shkëlqim ose me shkëlqim argjendi, që vende-vende është ciflosur (Tab. XI, 8,11,12,13).

Këto pjata janë të ngjashme me pjatat e formës 4 të qeramikës së shtresës së sipërme të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme (shek. I p.e.sonë — shek. I i e.sonë), që sipas autorit përsërisin një formë të kohës së vonë helenistike.<sup>135</sup> Ato janë të ngjashme edhe me format tipike të qeramikës pergamese Agorasë së Athinës të datuara në tre çerekët e fundit të shek. I p.e.sonë.<sup>136</sup>

e/2 Disa fragmente qeramike riprodhojnë pjata të shtrira me trup në formë trapezi, dhe anët e pjerrëta të ngritura në një kënd të gjerë ose pak të lakuara që përfundojnë me buzë me seksion sinusoidal. Kanë në përgjithësi fund të gjerë dhe të sheshtë. Balta e tyre rozë në të kuqërrëmtë është e tipit pseudoterra-sigillata.

134) N. Ceka, *Qyteti...*, Tab. XL, 23.

135) Po aty..., f. 79; Tab. XLIX, 19; Tab. L, 17; 18.

136) H.S. Robinson, *Pottery...*, Plate 60, F. 1-2.

Janë të lyera me vernik të kuq të dobët, që është ciflosur.  
(Tab. XX, 4,9,13).

e/3. Në këtë tip hyn edhe një pjatë, mjaft e përafërt për nga forma e trupit me pjatat e mësipërme, por që dallon prej tyre nga mënyra e formimit të buzëve, që hapen horizontalisht në formë strehe, me seksion këndor ose rrëthor (Tab. XX, 6; Tab. XI, 14). Kjo pjatë është shumë e ngjashme me një copë nga nekropoli i dystë i Apolonisë.<sup>137</sup>

e/4. Fragmente pjatash në formë kësule gjysmësferike, me buzë të trashura me seksion në formë këmbëze ose trekëndëshi. Janë përgatitur nga një baltë e pastër e kuqërrëmtë në ngjyrë kanellë dhe lyer në të dy anët me vernik të kuq me shkëlqim të një cilësie mjaft të mirë (Tab. XI, 6,9). Është e ngjashme me një pjatë samiane të gjetur në shtresën II të gërmimit të Agorasë së Athinës, që datohet në gjysmën e parë të shek. I të e. sonë.<sup>138</sup>

*Fundet.* Së bashku me fragmentet e pjatave dhe pjatancave në gërmim janë mbledhur edhe disa funde të tyre. Në to dallohen dy lloje: funde të sheshta dhe të harkuara. Këto të fundit ngrihen mbi një këmbëz unazore ose pseudo-unazore. Pjesa më e madhe e tyre janë dekoruar nga brenda, zakonisht në pjesën qëndrore të enës, me motive të ndryshme si rrathë bashkëqendrorë të bërë me ngulitje ose ruletim. Një pjesë tjetër mbajnë si dekoracion vula anepigrafike, kryqe të zbukuruara, rrathë të mbushur me motive në formë rrjete, motive në formë trikëndëshi, rozete, zambaku e më rrallë ndonjë figurë njeriu.

Janë përdorur, ndonëse rrallë, edhe funde të zbukuruar me vula epigrafike, siç është rasti i pjatës prej qeramike pseudo-terrasigillata, në pjesën qëndrore të së cilës lexohet: Λογκία, ndoshta emri i mjeshtrit poçar që e punoi (Tab. LXI; 1, 9).

Motive zbukurimi të ngjashme me këto janë të zakonshme në pjatat e qeramikës të shek. I të e. sonë dhe janë të njohura edhe nga qendra të tjera të territorit tonë. Motivet e pjatave të bëra me ruletim janë të ngjashme me motivet e disa pjatave që vijnë nga shtresa e sipërme kulturo-

137) A. Mano, *Nekropoli i Apolonisë*, Tuma I (Gërmime të viteve 1958-59), «Iliria» I, 1971, Tab. VI, 4.

138) H.S. Robinson, *Pottery...*, Tab. 62, Grupi G. 33.

re e qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>139</sup> Disa nga këto motive, siç janë ato në formë thonjëzash dhe teknika e përdorur për realizimin e tyre përsëriten nga periudha më e hershme.

f. *Amforiskat*. Në qeramikën e tavolinës të kësaj shtrese mbizotërojnë fragmentet e amforiskave, që dallojnë si për numrin e madh, ashtu edhe për variantet e shumta të buzëve të tyre. Janë përgatitur nga një baltë e pastër ngjyrë rozë në okër. Pjekja e tyre është e mirë. Herë-herë gjenden fragmente të lyera nga brenda me serë, ndërsa në sipërfaqen e tyre shihen zbulurime në formë rrëkesh të bëra me bojë të kuqe në kafe (Tab. LXXII).

f/1 Fragmente amforiskash me qafë cilindrike, grykë që hapet në formë hinke dhe buzë të zgjatura si sqep zogu (Tab. XVII, 1) me seksion trekëndëshi, (Tab. XXII, 2; Tab. XXI, 2, 17; Tab. XIII, 19; Tab. XXII, 14, 16; Tab. XIX, 9). Janë të ngjashme me një amforiskë të gjetur në nekropolin e dystë të Apolonisë dhe me një tjetër, që vjen nga qeramika e shtresës së sipërme të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme të datuara në shek. I p.e.sonë — shek. I i e.sonë.<sup>140</sup>

f/2 Fragmente amforiskash me qafë të ngushtë cilindrike dhe buzë të trashura me seksion elipsoidal (Tab. XIII, 6, 10; Tab. XXI, 1).

f/3 Fragment amforiske me qafë të lartë cilindrike, buzë të zgjatura anash në formë këmbëze dhe të profiluara nga brenda. Është e lyer nga jashtë me vernik ngjyrë kafe në të kuqërrremtë. (Tab. XIII, 20). Paraqet ngjashmëri me një amforiskë nga qyteti ilir, pranë Selcës së Poshtme, të datuar në shek. I. p.e.sonë - shek. I i e.sonë.<sup>141</sup>

f/4 Fragment amforiske me qafë cilindrike, që duke u zgjeruar pak përfundon në buzët gjysmë të shpërvjela nga jashtë të pajisura me një kanal në pjesën e sipërme (Tab. XXII, 10).

f/5 Fragment amforiske me qafë të lartë, që ngushtohet në pjesën e sipërme dhe përfundon në buzët e trashura, të prera vertikalish nga jashtë (Tab. XXII, 7).

---

139) N. Ceka, *Qyteti* ..., Tab. LI, 27.

140) Poraty., Tab. LIV; 13; A. Mano, *Nekropoli* ..., f. 203, Tab. V, 9, 10

141) N. Ceka, *Qyteti* ..., Tab. L, 3.

f 6 Fragment amforiske me qafë pak të fryrë cilindrike dhe buzë të profiluara nga jashtë (Tab. XIII, 2).

f 7 Fragmente amforiskash me qafë të ngushtë cilindrike dhe buzë të shtrira horizontalisht nga jashtë. Janë të ngjashme me një amforiskë që vjen nga qeramika e shtresës së sipërm kulturore të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>142</sup> (Tab. XXII, 3, 22).

f 8 Fragment amforiske me buzë të shtrira dhe të pregra gati vertikalisht nga jashtë me një kanal në pjesën e sipërm. (Tab. XXI, 4).

f 9 Fragmente amforiskash me qafë të lartë cilindrike, pak të fryrë anash në vendin ku kapeshin vegjat. Buzët e drejta vertikale janë të rrumbullakuara në skajet. Njëra prej tyre është e lyer nga jashtë me vernik të kuq pa shkëlqim (Tab. XXI, 11).

f 10 Fragment amforiske me qafë të ngushtë cilindrike, buzë të trashura që hapen nga jashtë me seksion elipsoidal (Tab. XIII, 3). Është e ngjashme me një amforiskë të gjetur në shtresën VI A<sup>2</sup> të Albintimiliumit (Itali), të datuar rreth v. 50 p.e.sonë.<sup>143</sup> Së bashku me fragmentet e amforiskave dhe të amforave të kësaj shtrese u gjet edhe një pjesë buze e ndonjë ene të madhe grykëgjerë, me një profilim në anën e jashtme të buzëve, që ngjet me një amforiskë të gjetur në qeramikën e shtresës së sipërm të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme e datuar në shek. I p.e.sonë - shek. I i e.sonë.<sup>144</sup>

f 11 Tri fragmente enësh me vernik të kuq paraqesin forma pak të veçanta dhe ju përkasin me sa duket gjithash tu grupit të amforiskave. Njëra prej tyre me parete shumë të holla ka grykën në formë këmbane dhe buzët e drejta me një profilim të theksuar në paretin e jashtëm të saj. Është e lyer me vernik të kuq pa shkëlqim (Tab. XVII, 2).

f 12 Një trajtë të veçantë amforiske paraqet edhe një fragment ene me buzët pak të shpërvjela nga jashtë dhe të rrumbullakuara në skajet. Është e lyer me vernik të kuq pa shkëlqim (Tab. XXII, 11).

---

142) Po aty, Tab. XLV, 2.

143) N. Lambolia, *Sulla cronologia...*, f. 259, fig. 15: f. 268. Fig. 25 (e dyta në rreshtin e II-të).

144) N. Ceka, Qyteti..., f. 80, Tab. LI, 8.

Në fragmentet e amforiskave është gjetur edhe një kapak amforiske grykëngushtë, e përgatitur prej një balte të pastër ngjyrë okër në rozë, i fragmentuar në gjysmën e tij. Ka formën e një disku me një dorezë cilindrike pak të ngri-tur në pjesën e mesit me diametër 3,2 cm. Diametri i vetë kapakut është 7,4 cm (Tab. XIII, 8).

## B. Enët e transportit

*Amforat.* Në shtresën kulturore që i përket shekujve të parë të e.sonë janë mbledhur edhe disa fragmente amforash transporti. Janë përgatitur nga një baltë e verdhë në okër që herë herë anon nga ngjyra kafe e çelët.

a/1 Fragment amfore me qafë cilindrike me buzë të drejta vertikale të rrumbullakuara nga jashtë (Tab. XV, 5). Është e ngjashme me amforat verëmbajtëse të tipit Alben-ga (Itali), të datuara rrith v. 90-70 p.e.sonë.<sup>145</sup>, por që kanë vazhduar edhe në shek. I të e.sonë. Me sa duket i përket importit italik.

a/2 Fragment amfore me grykë të ngushtë që hapet në formë hinke dhe buzët e trashura në pjesën e sipërme me profilim në paretin e jashtëm (Tab. XXII, 6).

a/3 Fragment amfore me grykë të lartë në formë hinke, buzë të trashura me profilim si sqep zogu, me një lugëzim në paretin e brendshëm (Tab. XV, 10). Fragmente amforash të ngjashme me këto janë gjetur në qeramikën e shtresës së sipërme (shek. I p.e.sonë - shek. I i e.sonë) të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme dhe në vendbanimin e fortifi-kuar të Kratulit (Rrethi i Shkodrës), ku gjithashtu janë të datuara në shek. I të e.sonë.<sup>146</sup>

a/4 Fragment amfore grykëngushtë që zgjerohet në formë hinke me buzët e shpërvjela dhe të rrumbullakuara në skajet. (Tab. XIII, 9). Nga mënyra e profilimit të buzëve ajo është e ngjashme me një amforë romake nga Albintimiliu-mi dhe me një tjetër të anijes romake nga Albenga. Evolu-

145) N. Lambolia, *Sulla Cronologia...*, f. 247, f. 4.

146) N. Ceka, *Qyteti...*, f. 97, Tab. L, 5; F. Fistani, *Vendbanimi i fortifikuar i Kratulit*, «Iliria» 1/1983, f. 119. Tab. I, 13.

cioni i formave të këtyre amforave shtrihej nga shek. II p.e.sonë deri në shek I të e.sonë.<sup>147</sup>

a/5 Fragment amfore me grykë të lartë cilindrike dhe buzë të rrumbullakuara në formë unazore (Tab. XIV, 9, 11). Është e ngjashme me një copë që vjen nga qeramika e shtresës së sipërme të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme e datuar me materiale të shek. I p.e.sonë - shek. I të e.sonë, si tip është i ngjashëm edhe me një amforë të shtresës VI A<sup>3</sup> të Albintimiliumit të datuar rrith viti 70 p.e.sonë.<sup>148</sup>

a/6 Disa fragmente amforash kanë grykë të gjerë cilindrike që hapen në formë hinke me buzët e profiluara në paratin e jashtëm me dalje këndore (Tab. XVIII, 22; Tab. XXII, 21), të prera pjerrëtas apo vertikalish nga jashtë dhe që ndonjëherë zgjaten tej paretit të enës (Tab. XXI, 6).

a/7 Fragment amfore me grykë të gjerë cilindrike dhe buzë të prera vertikalish nga jashtë të profiluara në paratin e brendshëm. Është shumë e përafërt me një amforë që vjen nga shtresa e sipërme e gërmimit në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>149</sup> (Tab. XXI, 18).

## 10. QERAMIKA E SHEK. II-IV E.SONË

### A) Enët e tavolinës

a/1 Fragmente pjatash të thella ose tasa me trup në formë kësule gjysmësférique, me paretet anësore jo shumë të larta, të kurbëzuara dhe me buzët e rrumbullakta me sekcion në trajtë këmbëze. Jänë përgatitur nga e njëjtë argjilë ngjyrë rozë, janë të lyera në të dy anët me vernik të kuq pa shkëlqim dhe anës buzëve me shirita verniku ngjyrë kapë gështenjë (Tab. XI, 1-3, 6-10; Tab. XVIII 10, 15; Tab. XX, 3).

Një pjatë e përafërt me pjatat tonë, sidomos për nga profilimi i buzëve është gjetur në nekropolin romak të But-

147) L. Lambolia, *Sulla Cronologia...*, fig. 22, f. 266.

148) N. Ceka, *Qyteti...*, f. 79, Tab. L, 2; N. Lambolia, *Sulla Cronologia...*, f. 257, fig. 13 (e fundit në rreshtin e parë).

149) N. Ceka, *Po aty*, Tab. L, 1.

rintit gjatë gërmimeve të vitit 1980 e datuar në shek. II-III të e.sonë.<sup>150</sup>

a/2 Fragmente pjatash në trajtë kësule gjysmësferike me buzët të shpërvjela nga jashtë në formë strehe të lugëzuara ose të prera pjerrëtas nga brenda (Tab. XI, 16). Janë të lyera në të dy anët me vnik të kuq pa shkëlqim.

Njera prej tyre (Tab. XII, 4) është mjaft e përafërt nga mënyra e profilimit të buzëve me një tas nga shtresa kulturore e depozituar mbi dyshemenë e Apodyterit (Ad Quintum) e datuar në shek. IV të e.sonë.<sup>151</sup>

Një pjatë të ngjashme me këtë e ndeshim në qeramikën e Agorasë së Athinës të datuar aty nga mesi i shek. III e.sonë.<sup>152</sup>

a/3 Fragmente pjatash të shtrira ose të thella me trup në formë segmenti rrrethor. Kanë buzët e drejta dhe gjysëm të hapura nga jashtë me seksion oval, trekëndëshi ose në formë ashiku (Tab. XI, 4, 10, 11, 17). Ndërjëherë buzët me seksion rrrethor zgjerohen në skajet tej paretit të enës (Tab. XI, 14). Njëra prej tyre (Tab. XX, 12) është mjaft e përafërt me një pjatë të grupit G.82 të qeramikës së Agorasë së Athinës, sipas klasifikimit të H.S.Robinsonit, të datuar në shek. I, fillimin e shek. II të e.sonë.<sup>153</sup>

a/4 Fragment pjate e vogël me parete anësore të harkuara dhe buzët paksa të anuara nga jashtë dhe të rrumbullakuara në skajet me një profilim të lehtë nga jashtë (Tab. XX, 12) është e ngjashme me një pjatë aretine nga Halterni.<sup>154</sup>

a/5 Një fragment buze me pjesë pareti riprodhon një pjatë me trup në formë segmenti rrrethor dhe me buzë të shpërvjela horizontalisht nga jashtë që rrumbullakohen në skajet e varura pak poshtë (Tab. XI, 5).

Në enët e ujit të tavolinës janë gjetur, ndonëse rrallë,

150) Dh. Budina, Rezultatet e gërmimeve të vitit 1980 në nekropolin romak të Butrintit, varri 13. (Materialet janë të pabotuara. Falënderoj me këtë rast autorin e gërmimeve që m'i vuri në dispozicion këto materiale.

151) N. Ceka, Ad Quintum, «Iliria», VI, 1976, f. 297, Tab. VIII, 2.

152) H.S.Robinson, Pottery..., Plate 72, K. 89.

153) H.S.Robinson, Pottery..., Pl. 67, G. 82.

154) Haward Comfort, Corpvs..., Plate I, 48.

155) A. Mano, Nekropoli i dystë i Apolonisë, «Iliria» III, 1974, f. 208, Tab. 11.

edhe disa fragmente kanash e brokash. Prej tyre njëra ripro-dhon një kanë qafë shkurtër (Tab. XVII, 10), që hapet në formë hinke me buzët e shpërvjela nga jashtë. Nga profilimi i buzëve ajo është shumë e përafërt me një enë tip kanë mjaft të përhapur në qeramikën e Apolonisë e datuar në shek. III të e.sonë.<sup>155</sup>

a,6 Një fragment buze me pjesë vegje riprodhon një enë të një tipi të veçantë ose ndoshta brokë me një vegjë që del përmbi grykë si verigë (Tab. XV, 1.) (Tab. LIX, 7). Enë të këtij tipi janë të njoitura nga qeramika e zbuluar në qytetin iliro-arbëror të Kaninës.<sup>156</sup> Si tip enë është i përhapur në qeramikën e kohës romake të vonë të zbuluar në Agorën e Athinës e datuar në shek. I-III të e.sonë.<sup>157</sup> Si formë ajo ka vazhduar të përdoret edhe në ditët tona, njihet në popull me emrat veglore, vegjore etj.<sup>158</sup>

B. Enët e kuzhinës, megjithëse janë gjetur shumë të fragmentuara kemi mundur të dallojmë në to enë të tipit vorbë, tenxhere, tasa dhe kapakë.

*Vorbat.* Në enët e kuzhinës vendin kryesor e zenë vorbat. që dallojnë për tipat dhe variantet e tyre. Në përgjithësi, si të gjitha enët e kuzhinës, ato kanë një fakturë të ash-për. Janë përgatitur prej një argjile jo shumë të pastër, që përmban në përzierjen e saj përveç cikrimave të mikës dhe rrëres dhe copa gurësh gëlqerorë të shtypur. Ngjyra e pjekjes ndryshon nga kafe në rozë e të kuqërremetë, e cila në prerje shpesh paraqitet me breza të kuqërremetë dhe gri si rezultati i pjekjes në furra të myllura.

Midis fragmenteve të shumta të vorbave nga forma e trupit kemi mundur të veçojmë katër tipa kryesorë me variante të ndryshme.

*Tipi 1.* Në tipin e parë janë radhitur vorbat me parete jo shumë të trasha dhe trup shumë të fryrë sferik. me qafë paksa të shënuar ose fare pa qafë dhe grykë të gjerë. Fuzët e trashura dhe të veçuara qartë nga trupi i enës janë gjy-

156) D. Komata, Qyteti iliro-shqiptar i Kaninës (Disertacion) 1983.

157) H.S.Robinson, Pottery..., Tab. 6, G. 106; Tab. 9, J. 2, 3.

158) A. Onuzi, Vazhdimësia e qeramikës mesjetare në qeramikën populllore shqiptare, «Kultura Popullore» nr. 2, Tiranë, 1932, f. 96.

smë të anuara ose paksa të anuara nga brenda me seksion trekëndëshi. Në përgjithësi ato janë të rrumbullakuara në anën e jashtme të tyre dhe herë-herë me 1-2 vija qarkuese të bëra gjatë rrrotullimit të enës në çarkun e poçarit. (Tab. XVIII, 1, 4, 23). Si formë është e trashëguar nga qeramika e periudhës pararendëse e shek. III-II p.e.sonë.

Një vorbë e ngjashme me vorbat tonë të këtij tipi është gjetur në varrin nr. 9 të nekropolit të Butrintit gjatë gërmimeve të vitit 1980 me materiale të shek. II-III t, e.sonë.<sup>159</sup>

*Tipi 2.* Në tipin e dytë hyjnë fragmente që riprohjojnë vorba me parete relativisht të trasha. Kanë trup cilindrik dhe rrallëherë paksa të fryrë në pjesën e mesit. Karakteristikë për këto vorba janë buzët e trashura me seksion në formë këmbëze, të shtrira nga jashtë dhe të diferencuara qartë nga trupi i enës. (Tab. XVIII, 6, 9, 16, 18, 19).

Në ndonjë rast buzët e trashura dhe të rrumbullakuara në skajet janë gjysmë të shpërvjela nga jashtë dhe të pajisura nga brenda me një kanal për mbështetjen e kapakut. Pjesa nën buzë herë-herë ka 2-3 kanelyra të cekëta horizontale (Tab. XVIII, 21).

Vorba të ngjashme me vorbat e këtij tipi i ndeshim në qeramikën e horizontit të dytë të banimit të Bradasheshit, të datuara në shek. IV të e.sonë.<sup>160</sup>

Të veçanta për nga mënyra e trajtimit të buzëve janë dy fragmente vorbash të këtij tipi me parete të trasha, qafë të shkurtër cilindrike dhe buzë të gufuara tej paretit të jashtëm, me seksion sinusoidal dhe të lugëzuara në të dy anët me profilime në paretin e jashtëm (Tab. XIV, 4, 5).

Një vorbë tjetër e vogël me trup gati cilindrik ka qafë të shkurtër dhe grykë të gjerë, me buzët që hapen pak nga jashtë në formë hinke, me profil të theksuar në formë S-je (Tab. XXII, 5). Ngjashmëria e formës të kësaj vorbe me një enë të gjetur në shtresën e sipërme të gërmimeve në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme të datuar në shek. I p.e.sonë - shek. I i e.sonë,<sup>161</sup> tregon se ajo ruan tradita më të hershme.

*Tipi 3.* Disa fragmente enësh me parete të holla riprohjojnë vorba me trup jo shumë të fryrë vezak dhe grykë të

159) DH. Budina, Rezultatet...,

160) N. Ceka, Aq Quintum..., f. 237, Tab. VII, 8.

161) N. Ceka, Qyteti..., f. 78, Tab. XLVI, 3.

gjerë që ndryshojnë midis tyre nga profilimi i buzëve (Tab. XIV, 1, 4, 5, 6). Buzët e disave janë të hapura në formë hinke, pak të përkulura nga jashtë me skaje të rrumbullakuara. Njëra prej tyre (Tab. XVIII, 2), është mjaft e ngjashme për nga forma dhe profilimi i buzëve me një vorbë të gjetur në horizontin e dytë të banimit të Bradasheshit, që datohet në shek. IV të e.sonë<sup>12</sup>.

Tek një fragment (Tab. XIV, 1) buzët paksa të hapura nga jashtë janë të profiluara anash dhe të rrumbullakuara në skajet. Një formë mjaft të ngjashme me këtë na ofron ena e gjetur në horizontin e dytë të banimit të Bradasheshit e datuar gjithashtu me materiale të shek IV të e.sonë.<sup>163</sup>

Vorbat e këtij tipi kanë pasur me sa duket permisa me tê vogla se tê parat. Diametri i tyre lëviz nga 13 cm deri në 15.6 cm.

Tipi 4. Fragmente vorbash me trup pak a shumë në formë dardhe, grykë të gjërë dhe buzë gjysmë të shtrira nga jashtë me seksion në formë këmbëze, janë të ngjashme për trajtimi i buzëve me vorbat e tipit të parë (Tab. XIV, 8; Tab XVIII, 3, 5, 12, 17). Profilin e buzëve dy fragmen-

Dallojnë midis tyre për profilin e buzëve dy fragmente vorbash dyvegjake (Tab. XVIII, 3; Tab. XXI. 5). me trup në formë dardhe dhe buzë të harkuara, të shtrira nga jashtë përmbi vegjët me seksion sinusoidal. Kanë në pjesën e sipërme 1-2 vijëza qarkuese të bëra gjatë rrrotullimit të enës në carkun e poçarit.

Një formë të përafërt me këtë vorbë e gjëjme në qera-  
mikën e horizontit të dytë të banimit të Bradasheshit, të  
datuar në shek. IV të e.sonë.<sup>161</sup>

Në qeramikën e kësaj strese janë gjetur dhe një fragment qypti, një pitos, disa rrötulla prej balte të pjekur dhe ndonjë fragment kandili.

ndonjë fragment kandili.  
1. Fragment pitosi me qafë jo shumë të gjerë cilindrike  
dhe buzët e shpërvjela nga jashtë në formë strehe. Ka nën  
buzë një zbukurim në formë spirali si bisht qeni që me sa  
duket vinte rrëth e rrötull faqes së enës (Tab. XIV, 14).  
Kjo është magjil tip vazoje, me trup gati ci-

2. Fragment qyptih i vogël, tip vazoje, me trup gati rrumbullakuara në skajet. Eshtë i lyer nga brenda me serë.

162) N. Ceka Ad Quintum..., f. 297, Tab. VII, 8.

162) N. Ceka, Ad Quintum...; 163) Bo aty. f. 297. Tab. VI, 9.

163) Po aty., f. 297, Tab. VIII, 5.  
164) Po aty., f. 297, Tab. VIII, 6.

Zbukurohet nga jashtë me vija qarkuese të thelluara (Tab. XIV, 2).

3. Rrotull baltë e fragmentuar me anësore shumë të trasha, ka pjesën e sipërme më të shkurtër se të poshtmen me seksion sinusoidal. Diametri i sipërm 8 cm, i poshtmi 8,3 cm.

4. Rrotull balte në formë çikriku me anësore të trasha. Diametri 5 cm (Tab. XIII, 15).

5. Rrotull balte e një forme jo të zakonshme. Pjesa e sipërme më e shkurtër se e poshtmja (Tab. VI, 12). Diametri i sipërm 15 cm. Diametri i poshtém 17 cm. Rrotulla të tilla prej balte të pjekur janë të njoitura edhe nga qeramika e periudhës paraardhëse të këtij qyteti. Ato kanë qenë përdorur edhe në këtë rast në furrat e pjekjes së enëve si ndarëse pér të mos lejuar ngjitjen e tyre gjatë pjekjes.

6. Pjesa e sipërme e një kandili me parete shumë të holla e lyer me vernik të kuq në kafe karakteristike pér shek. I-II të e.sonë. Në të duken në relief tepricat e gjymtyrëve të një kafshe fantastike, që zbukuronte pjesën e sipërme të kandilit. (Tab. IX, 4).

7. Në gërmimet e vitit 1978 të bëra në pikën F, midis fragmenteve të qeramikës, u gjet edhe një objekt prej kocke në trajtën e një pipete. Objekti përbëhet nga një tub i ngushtë i tejshpuar, përmes të cilët kalon një disk rrëthor, që kurorëzohet në pjesën e sipërme nga një kokë cilindrike e brazduar në sipërfaqe. Gjatësia e objektit është 4,6 cm dhe diametri i paftës 1,2 cm. Objekti duhet të ketë qenë mbylliësja e ndonjë shisheje të vogël medicinale (Tab. LXIV, 11). Gjetja e tij në rrëthana stratigrafike jo shumë të qarta e vështirëson datimin e saktë të tij. Ka shumë mundësi që ai të lidhet me materialet e shtresës së fundit të zbuluara në këtë sektor, që i përket shek. II të e.sonë.

## 11. MONEDHA PERANDORAKE ROMAKE

Komodi 176-192 (Tab. LXV, 3)

1. AE ↑ F... M.COMMODVS.ANT.AVG.... Kryet e lauruar të perandorit komod me mjekér në profil dj.

Shp. Nike e ulur mbi trofe, mban një mburojë në dorën e majtë dhe një ushtë në dorën tjeter. Legjenda rrëthore jo shumë e qartë. Në segundat: VICT. DRIT.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1975 në pikën F në shiresën me qeramikë të shekujve të parë të e.sonë. P.22 gr. D=30mm.

Diokleciani (284-305) (Tab. LXV, 4)

2. AE ↓ F. IMP.CC.VAL.DIOCLETIANVS P.PAVG. Busti i perandorit me përkrenare me rrëze, me veshje dhe parzmore në profil djathtas.

Shp. CONCORDIA. MILITVM. Jupiteri lakuq qëndron në këmbë djathtas i mbështetur në skeptrin, duke i paragjitur një glob me nikel Dioklejianit, që qëndron në këmbë në të djathtë të tij dhe mban një skeptër të shkurtër. Në fushe M.E.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=2,79 gr. D=21 mm.

Krahaso: Henry Cohen, Description Historique des monnaies Leipzig, 1930, vëll. VI, f. 418, nr. 23.

Galer Maksimiani (292-311) (Tab. LXV, 5)

3. AE ↓ F. [C] GAL.VAL.MAXIMINVS.NOB CAES. Busti i perandorit me kurorë dhe mburojë në profil djathtas.

Shp. [Genio AVG. ET CAESARVM MN]. Geni i krengur sipas modës, gjysmë i zhveshur në këmbë djathtas duke mbajtur në dorën e dj. një enë nga e cila rrjedh liker, në dorën tjeter mban një bri bollëku.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

Ajo është e brimuar, me sa duket, e përdorur më vonë si medaljon në kohën kur e ka humbur vlerën e saj monetare.

P=4,75 gr. D=26 mm.

Krahaso: H. Cohen, Description.... vëll. VIII, f. 106, nr. 39.

\* \* \*

Në procesin e lindjes dhe të zhvillimit të jetës qytetare në Ilirinë e Jugut, qyteti ilir në kalanë e Beratit hyn në etapën e dytë, që përfshin periudhën midis viteve 335-230 p.e.sonë. Themi në etapën e dytë mbasi shkalla e zhvillimit të ilirëve nuk ka qenë e njëjtë në të gjitha krahinat e trevës së banuar prej tyre. Kjo është koha, kur qytetet ilire jetuan periudhën më të lulëzuar, e cila në bazë të të dhënave arkeologjike paraqitet si kohë e një begatje të vërtetë.<sup>165</sup> Një zhvillim të dukshëm mori jeta qytetare veçanërisht në krahinat e Ultësirës Bregdetare, që shtriheshin në shpinë të Dyrrahut dhe të Apolonisë, ku përfshihej edhe Berati.

Në ecurinë e pandërprerë të zhvillimit social-ekonomik e kulturor, qyteti ilir i Antipatreas lindi jo mbi një truall të ri, siç ka qenë menduar më parë.<sup>166</sup> por mbi bazën e vendbanimit më të hershëm protourban, në gjirin e të cilit ishin përgatitur kushtet për lindjen e tij.

Pozita e favorshme gjeografike, kushtet e mira natyrore e klimatike dhe lidhjet ekonomike e kulturore që kishte qyteti me zonat e Ultësirës Bregdetare dhe me krahinat e brendshme të vendit të realizuara përmes rrugës natyrore të luginës së Osumit, ishin faktorë të rëndësishëm, që çuan aty nga fundi i shek. IV-shek. III p.e.sonë në krijimin dheJulëzimin e qytetit ilir të Antipatreas.

Zbulimi në gjërmimet sistematike (Pika B e C) i trakteve të mureve rrethuese të periudhës qytetare ilire, porta kryesore e qytetit e ruajtur pothuajse e pandryshuar deri në ditët tona, teknika e përsosur e ndërtimit që vihet re në të gjithë sistemin e fortifikimit mbrojtës të këtij qyteti dhe qeramika e gjetur në gjërmimet në sasira të mëdha, flasin për nivelin ekonomik e kulturor që kishte arritur qyteti në këtë kohë.

Në treguesit më karakteristikë të qyteteve ilire siç janë pozicioni gjeografik, koncepti në ndërtimin e sistemit fortifikues, forma e jetës ekonomike e deri tek kultura materiale vihet re një ngjashmëri e madhe e qytetit ilir në kalanë të Beratit me qytetet e tjera iliro jugore dhe epirote.

---

165) S. Islami, Lindja..., f. 11.

166) Po aty, f. 12.

Porta kryesore e qytetit me korridorin e thellë të mbrojtur nga një kryekullë, vendosja në të thatë e blloqeve kuadratike me lartësi jo të barabartë (sistemi izodomik), përdorimi i blloqeve transversale në lidhjet midis dy faqeve dhe i atyre të shkallëzuara, punimi i faqeve ballore ose lënia shpeshherë e gufuar deri tek pajisja në ndonjë rast e tyre me shirit anësor janë elemente karakteristike konstruktive që ndeshen kudo në qytetet ilire të Ilirisë së Jugut dhe Epirit, si Prishtë, Dimal, Kala e Irmajt, Zgërdhesh, Lish, Butrint, Antigone etj.

Qeramika e përdorimit të përditshëm shtëpiak dhe ajc masive e ndërtimit në këtë shtresë kulturore ndjek në përgjithësi atë evolucion që vihet re në qeramikën e zbuluar në një varg qendrash të tjera të trevës ilire jugore. Veçori karakteristike e qeramikës të kësaj periudhe në qytetin ilir në kalanë e Beratit është, si kudo në Ilirinë e Jugut, zëvëndësimi gradual i teknikës tradicionale paraqytetare të prodhimit me dorë të qeramikës dhe përdorimi gjërësisht i çarkut të poçarit.

Në repertorin mjaf të pasur të formave të saj, (kupa, skifosa, tasa, pjata, pjatanca amfora etj) vihet re përvetësimi nga poçarët vendas e formave dhe e zbulurimeve helenistike. Pa u ndalur në veçoritë stilistike e morfologjike të kësaj qeramike ajo që duhet vënë në dukje këtu është bollëku i saj dhe larmia e formave, veçanërisht në enët e tavolinës.

Nga pikëpamja e teknologjisë së prodhimit, e formave dhe e dekoracioneve, është po ajo qeramikë që mbizotëron në këtë kohë në qytetet e tjera ilire dhe që lidhen me përmirësimin dhe zhvillimin e teknologjisë së prodhimit në përgjithësi, me naënyrën e prodhimit zejtar dhe me kërkessat e tregut, tipar ky karakteristik i kulturës qytetare ilire.

Sic e vumë në dukje edhe gjatë analizës së materialit në qeramikën e tavolinës të kësaj periudhe për t'u përmendur qeramikën e vernik të zi e kafe në të kuqërrëmtë, kryejanë enët me vernik të tipit hidrije, që dallojnë për cilësinë e lartë të prodhimit të tyre, të cilat për mungesë të prodhimeve skarco përfundim është ngjashmëria e madhe e kësaj qeramike me qeramikën e së njëjtës periudhë dimalite, por ka të ngjarë që ajo të ketë ardhur edhe nga ndonjë qendër tjetër e madhe prodhimi sic ishte Apolonia, me të cilën qyteti ilir i Anti-

patreas kishte marrëdhëniet tregtare, gjë që e provojnë monedhat e Apolonisë me Apolon-Obelisk të gjeturia në gërmime.

Si kjo qeramikë ashtu edhe pjesa më e madhe e qeramikës të prodhimit vendas të këtij qyteti e krahasuar me atë të qendrave të tjera ilire datohet në kufijtë kohorë të fillimit të shek. III p.e.sonë deri në shek. II të e.sonë. Fragmentet e qeramikës me vernik të zi karakteristike për shek. IV p.e.sonë tanë për tanë janë shumë të pakta. Gjetja në gërmime e skorjeve të baltës dhe e disa skarciteteve të enëve të përdorimit të përditshëm shtëpiak, e rrotullave prej balte të pjekur, tjegullave etj., tregojnë për prodhimin e tyre në vend. Për zhvillimin e poçerisë në këtë qytet flasin gjithash tu edhe prania e disa vulave epigrafike të shkruara në gjuhën greke (ΠΑΤΕ, Λουτσ, ενε- etj.); dhe e atyre anepigrafike me emrat ose shenjat e pronarëve të punishteve lokale të bëra në disa objekte qeramike (tjegulla, amfora, në ndonjë enë tavoline, në peshat etj.)

Sasia relativisht e madhe e qeramikës shtëpiake dhe e asaj masive të ndërtimit, kryesisht tjegulla të sheshta (solene) dhe të harkuara (kaliptere) janë tregues i mirë i nevojave në rritje të popullsisë dhe i prodhimit lokal të tyre.

Teknika e përsosur e mureve rrethuese e përdorur në fortifikimet e fuqishme mbrojtëse të këtij qyteti ilir dhe bollëku i qeramikës lokale flasin për një veprimitari ekonomike shoqërore, ndërtimore dhe prodhuese të dukshme të qytetit, çka presupozon se ai kishte arritur në këtë kohë, një nivel të mirë ekonomiko-shoqëror e kulturor.

Numri tepër i kufizuar i qeramikës së importuar nga qendra të botës helene jashtë territorit të Ilirisë Jugore, trengon se qyteti i përballonte vetëm me prodhimet e tij nevojat kryesore të popullsisë dhe me importin (kryesisht enët e luksit, siç ishin enët e piktuvara) nga qendra të tjera të trevës ilire jugore dhe nga kolonitë helene të bregdetit tonë të Adriatikut, Dyrrahu dhe Apolonia. Në këtë mënyrë ajo e kufizonte thuajse në maksimum importin e largët helen. Ky fakt është një tregues tjetër i nivelit të mirë ekonomiko-shoqëror që kishte arritur qyteti ilir në kalanë e Beratit, nivel që përkon me atë periudhë lulëzimi të përgjithshëm, që vihet re në këtë kohë në një varg qendrash të trevës ilire jugore.

Në periudhë që përfshin fundin e shek. II p.e.sonë deri

në shek. IV të e.sonë në muret rrethuese të qytetit ilir të Antipatreas nuk u bënë rindërtime, karakteristike kjo edhe për një varg qendërbanimesh ilire dikur të fortifikuara. Si rezultat i politikës ekonomike që ndiqte Roma popullsia e këtij qyteti, sikurse edhe e shumë qyteteve të tjera erdhë duke u zvogëluar. Me rëndësinë që merr bujqësia në këtë kohë, një pjesë e mirë e banorëve të qytetit ka të ngjarë që të kenë zbritur në fushë dhe të merren me bujqësi. Kemi edhe këtu, ndoshta si në shumë qendërbanime të tjera, fenomenin e ruralizimit të ekonomisë qytetare.

Megjithatë të dhënat e gjermi me arkeologjike, qeramika dhe numri i kufizuar i monedhave që qëndrojnë në raport 1 me 3 me monedhat mesjetare të zbuluara në gjermime, tregojnë se edhe pas ngjarjeve të vitit 200 në luftrat me Romën, me gjithë démet që i solli atij pushtimi romak, edhe pse në fortifikimet mbrojtëse në kuadrin e qytetit relative të Romës nuk u bënë rindërtime, jeta në qytet ka vazhduar pa ndërprerje. Por duhet thënë se, qyteti ilir i Antipatreas në këtë kohë, në kuadrin e organizimit të sistemit të provincave perandorake, si shumë qytete të tjera ilire që nuk u shndërruan në koloninë romake, nuk gjëzonte më pozitën e mëparshme dhe nuk ka pasur atë gjallërinë e dikurshme.

Kjo rënie që vihet re në këtë kohë në qytetin ilir të Antipatreas është një dukuri e konstatuar edhe në qendra të tjera ilire si në Dimal, Kalanë e Irmajt, Selcën e Poshtme, Pogradec etj.

Gjetjet arkeologjike të shekujve të parë të e.sonë, sikurse e pamë edhe gjatë analizës së materialit, përbëhen kryesisht nga qeramika e përdorimit të përditshëm shtëpiak dhe ajo e ndërtimit, e përdorur kryesisht si material për mbulimin e çative të godinave me karakter shoqëror e privat dhe në ndërtimin e varreve. Numri i konsiderueshëm i fragmenteve të zbuluara në gjermim tregon se edhe në shek. I p.e.sonë — IV të e.sonë punishtet zejtare të qeramikës vazhduan të prodhojnë për nevojat e popullsisë së qytetit. Kështu dalëngadalë vendin e enëve prej balte të periudhës pararendëse ilire e zunë tanë enët karakteristike për shek. I të erës sonë, në trajtimin e të cilave vihet re një përpjekje për t'i përshtatur tipareve të qeramikës terra-sigillata.

Në elementet shprehëse të kësaj qeramike, në format dhe dekoracionet e enëve, në teknologjinë e prodhimit e deri në

pikturimin me ngjyrë të kuqe vihen re tipare të përbashkëta me qeramikën e qendrave të tjera të trevës ilire jugore. Në krahasim me periudhën pararendëse, prodhimet e qeramikës së kësaj kohe nuk kanë më atë finesën e mëparshme si përsë i përket trajtimit të formave, ashtu edhe zbukurimit të tyre. Kjo gjë bie në sy, veçanërisht në qeramikën me dekorim të bërë dosido në dhëni e pikturimit pa ndonjë kriter të caktuar dhe në përdorimin e një verniku të dobët. Megjithatë duhet vënë në dukje se shumë forma enësh siç janë kupat, pjatat etj. ruajnjë elemente karakteristike nga periudha e poçterisë antike ilire të shek. III-II p.e.sonë.

## KREU IV

### PERIUDHA E KOHËS ANTIKE TË VONË SHEK. IV-VI të E.SONE

Pas njoftimit të fundit të historianit romak Tit Livit (në v. 200 p.e.sonë) në shek. I të e.sonë burimet e shkruara për qytetin ilir të Antipatreas heshtin. Emri i qytetit në një trajtë pak të ndryshuar (Antipagrai) do të rishfaqet në shek. VI. Atë e gjejmë tek Prokopi i Qezaresë në listën e fortifikimeve të Epirit të Ri të rindërtuara nga Justiniani I.<sup>167</sup> Në guidën «Synecdemus» të Hieroklit (shek. VI i e.sonë) atë e ndeshim me një emër krejtësisht të ndryshuar, Polyheriopolis.<sup>168</sup>

Lënda arkeologjike e kohës antike të vonë u zbulua në shtresën e katërt kulturore gjatë gërmimeve të viteve 1973-1974 në pikat B e C si dhe më pak në pikat e tjera të gërmimeve (D,E,F dhe G).

Pjesën më të madhe të gjetjeve e përbën qeramika e përdorimit të përditshëm shtëpiak. Duhet thënë se objektet metalike janë gjetur në një numër disi të kufizuar, ndërsa monedhat në krahasim me periudhën e mëparshme janë më të shumta.

Qeramika e kësaj shtrese, po të krahasohet me atë të

167) Procopii Caesariensis,, De Aedificis, IV, 4 në «I.I.A.A.» f. 440, 4; 3.

168) Hierocli, «Hieroclis Synecdemus», 8, XIII, 653, 6, në: «I.I.A.A.» f. 455.

dy periudhave të mëparshme, është më e kufizuar jo vetëm pér sa i përket sasisë së fragmenteve të grumbulluara në pikat e ndryshme të gërmimit, por edhe repertorit të formave të enëve. Një dukuri e tillë është vënë re edhe në qendra të tjera bashkëkohore të vendit tonë.<sup>169</sup>

Për vazhdimësinë e jetës së qytetit në këtë periudhë, përveç qeramikës, të cilën do ta analizojmë pak më poshtë, flasin edhe të dhënat e pakta të arkitekturës që mundëm të kapim në gërmim.

## 1. GJURMË NDËRTESASH TË KOHËS ANTIKE TË VONË.<sup>170</sup>

Në gërmimet arkeologjike të vitit 1973, të bëra pranë portës kryesore të qytetit, pér tu vënë në dukje është zbulimi i fasadës së jashtme të paturës së djathtë në hyrje të korridorit të portës kryesore të qytetit.

Në gërmimet e bëra në kuadratin V të pikës B u vunë re se pér mbi ndërtimet e fuqishme të mureve të periudhës ilire është ngritur muri i kohës së vonë antike. Ky mur është më brenda fasadës së murit të periudhës ilire 0,18-0,40 m, duke lënë në këtë mënyrë të pambuluar një pjesë të tij (Fig. 13). Muri është ndërtuar prej gurësh gëlqerorë me trajta të çrrëgullta, që herë herë kanë formën e rrasave me përmasa të vogla dhe mesatare. Vendosja e tyre njeri mbi tjetrin nuk është bërë sipas ndonjë rregulli të caktuar. Lidhja midis gurëve është bërë pjesërisht me llaç balte dhe pjesërisht me llaç të bardhë gëlqeror të një cilësie jo shumë të mirë. Këtë mur, që ruan një lartësi fare të paktë, prej afro 0,32 m mundëm ta ndjekim deri në një gjatësi prej 2,23 m. Ai ruan trashësinë e murit të periudhës ilire, është i trashë vetëm 1,95 m.

Në anën lindore të kështjellës në pikën D, që në kazmat e para, ngjitur me murin e vonë mesjetar në pjesën e brendshme të tij, u zbuluan faqja e brendshme e një muri më të hershëm mesjetar me drejtim veri-jug (Fig. 30). Muri është i gjatë 5 m, ruhej deri në lartësinë 3,40 m.

169) S. Anamali, Kështjella..., f. 228; N. Ceka, Qyteti..., f. 157.

170) Shënojmë se nga muret e ndërtësave të kohës antike të vonë do të përshkruajmë ato trakte që na kanë dalë në gërmim.

PIKA D

PLANIMETRIA E GERMIMIT TE KUADRATIT I




Fig. 30

Muri ngrihet mbi një themel të ndërtuar prej gurësh gëlqerorë, me madhësi të vogël dhe mesatare, të përzier me cakell, përmbi të cilin është derdhur në formë vetulloreje një shtresë llaçi gëlqeror i përzier me guralecë lumi. (Fig. 31).





Fig. 31

Shtresa e llaçit, me trashësi 0,30-0,40 m, del në pjesën e jashtme të murit në formë xokolature 0,05-0,10 m. Materiali arkeologjik i zbuluar në këtë shtresë, kryesisht qeramika, i shoqëruar edhe me monedha të Justinianit I e vendosin shtresën e llaçit dhe murin në përgjithësi në kohën e vonë antike (shek. VI).

Në ndërtimin e murit LL (pika E), siç vihet re në faqen e jashtme të tij, së bashku me gurët gëlqerorë me përmasa të mëdha dhe mesatare janë ripërdorur si material ndërtimi dhe bilojet katërkëndëshe (Fig. 32), fugaturat midis e cilave janë

PLANIMETRIA E MUREVE



PAMJE BALLORE E MURIT IT JASHIEM

100 CM




Fig. 32

mbushur me copa tjegullash dhe çakëll (Fig. 33). Si material lidhës edhe këtu në tre rreshtat e fundit është përdorur balta. Materiali i ndërtimit të këtij muri dhe fakti se pranë tij ndodhet kulla 18, e ndërtuar me një muraturë me gurë të vegjël, që përshkohet prej një brezi me katër rreshta tullash na shtyjnë të shohim këtu një pjesë të murit rrethues të rindërtuar, me sa duket, në shek. VI të e.sonë.




Fig. 33

Në gërmimet e bëra në pikën «F», në kuadratet I, II dhe III u zbuluan disa trakte muresh që dikur mbyllnin mjediset e ndonjë godine me karakter shoqëror ose privat. (Fig. 34).

Pranë brinjës lindore të kuadratit II, në një thelli të prej 1,25 m nga sipërfaqja e tokës, mbi një shtresë llaci gëlqeror 4 cm-10 cm të trashë u gjet një shtrojë prej gurësh gëlqerorë formash të çrregullta të vendosur pa ndonjë kriter të caktuar (Fig. 34, nr. 1). Midis gurëve të lidhur me një llaç gëlqeror të një cilësie jo shumë të mirë ndeshen aty-këtu fragmente tullash 3,5 cm-4 cm të trasha. Shtroja është e gjatë 4,5 cm me një gjerësi, që lëviz nga 0,84 m-1,35 m. Në skajin

PL ANIME TR' E QUADRAT'E // E III

SFERK 7 ORR.




Fig. 34

më jugor të saj u gjetën gjurmët e një hyrjeje (Fig. 34, nr. 7), jetër 0,70 m. e gjerë, që me sa duket shërbente për komunikimin me mjediset e krahut lindor të korridorit. (Fig. 35).




Fig. 35

Po në këtë kuadrat, në gjysmën lindore të tij, në thellësinë 1,65 m u zbulua një shtrojë me pllaka guri shtuf (Fig. 34, nr. 2) me gjerësi 0,85 m.-1.85 m, e cila prej veriut në jug të ndoq deri në një gjatësi prej 10 m. Kjo nuk është gjatësia e plotë, mbasi gërmimi nuk ka përfunduar. Plakat kanë formë të çrregullta dhe përmasa të ndryshme 0,60 m x 0,40 m x x 0,6 m; 0,32 m x 0,22 m). Shtroja nuk ruhet në gjithë gjatësinë e saj. Ajo është e dëmtuar veçanërisht në pjesën jug-lindore të kuadratit, ku ato pothuajse mungojnë krejtësisht. Aty ka dalë shkëmbi natyror (Fig. 34, nr. 5).

*Muri 3a-b.* Në anën perëndimore të kësaj shtroje 1,80 m larg brinjës perëndimore të kuadratit II muri (3a) me drejtim veri-jug u gjurmua më tej dhe u pa se ishte ndërtuar prej gurësh të thyer gëlqerorë, formash të çrregullta që herë herë kanë trajtën e rasave me përmasa të vogla dhe mesatare (Fig. 34, 3a-b). Janë punuar deri diku vetëm faqet e tyre të jashtme dhe janë lidhur me një llaç që ka në përzierje shumë gëlqere, rërë dhe guraleca. Gurët në mur nuk formojnë rrështa të rregullt dhe e gjithë muratura nuk dallon për ndonjë teknikë të përparuar ndërtimi. Muri ka një gjatësi të përgjitheshme prej 7.25 m dhe është i trashë 0,70 m. Lartësia e tij e ruajtur lëviz nga 0,18 m-0,63 m-0,70 m.

Në vendin e takimit të kuadratit II dhe III, ky mur ndërrpritet nga një hyrje (Fig. 34, nr. 6). 0,85 m e gjerë, gurët e qosheve të së cilës janë të punuar mirë. Kjo hyrje ka shërbuaj me sa duket, për komunikimin me mjediset që zhvillohen në anën perëndimore të murit. Ai vazhdon me të njëjtin drejtim gjatë gjithë pjesës të gërmuar të kuadratit të III deri sa takohet me brinjën jugore të tij.

*Harku 4 a.* Në kuadratin II 0,42 m larg faqes lindore të murit (3a) u gjet «in situ» një hark me konveksitet drejt perëndimit (Fig. 34, 4a; Fig. 36, 4a). Harku është ndërtuar me tulla dhe gurë shmërci të bëra në formë pyke. Tullat me përmasa 0,30 m x 0,80 m x 0,35 m, karakteristike për shek. IV-V të e.sonë, anëve të harkut, janë vendosur alternativisht pas çdo bloku shmërci 2,5 m - 3,5 cm, të trashë, ndërsa në pjesën qëndrore të tij pas çdo tulle është vendosur një guri i tillë. Gurët dhe tullat janë lidhur në mes tyre me llaç gëlqeror. Gurët dëmtuar janë lidhur në mes tyre me llaç gëlqeror.

*Harku 4 b.* Një hark i dytë pothuajse i njëjtë me të parin

u zbulua «in situ» në kuadratin III. (Fig. 34, 4b). Ai u gjet  
në të njëjtin pozicion me të parin, në krahun tjetër të hyrjes,  
gjithashtu përmbi shtrojen me pllaka. Është i ndërtuar me

KTORI F

MJE E PLOTE E HARKUT  
KUADRATIN E II

A




Fig. 36

tulla dhe me gurë shmörc me të njëjtën teknikë si harku 4a. Pranë këtij harku 1,65 m thellë në qoshen verilindore të kuadratit III, së bashku me fragmente të shumta enësh me parete të trasha, u gjet një follis bronzi e Anastasit I (491-518).

Gjatë brinjës jugore të kuadratit I, në thellësinë 1,60 m përmbi shtrojën me copa tjegullash e dinosash u zbulua një mur tjetër me orientim L-P. Muri ruhej në gjendje jo të mirë. Atij i mungonte farada e brendshme dhe dukej më tepër si mbushje muri. Ishte ndërtuar prej gurësh të madhësive të vogla dhe mesatare trajtash të çrregullta, që herë-herë merrnin formën e plakave. Mure të tillë të ndërtuar me plaka janë vënë re në murin e brendshëm ndarës të kalasë së Çorovodës dhe në muraturën e kalasë së Qafës.<sup>171</sup> Pjesa e brendshme e murit midis dy këmishave ka qenë mbushur me çakell, copa tjegullash e tullash dhe tek-tuk me fragmente enësh me parete të trasha (dinoa) të zbukuruara me tufa vijash të valëzuara, karakteristike për kohën antike të vonë. Lidhja midis gurëve është bërë me baltë në ngjyrë të verdhë (vapem). Muri u gjurmua në një gjatësi prej 4,34 m. Në thellësinë 1 m, gjatë brinjës perëndimore të këtij kuadrati u zbulua një mur tjetër, i cili ka drejtim veri-jug me një shmangie të lehtë drejt lindjes. Muri është i ndërtuar prej gurësh përmashash të vogla e mesatare të vendosura pa ndonjë kriter të caktuar, fugatura midis të cilave kanë qenë zenë me baltë në ngjyrë të verdhë.

Gjendja tepër e rënuar e këtyre mureve dhe kufizimi i gërmimit nuk na dha mundësi të përcaktojmë saktë shtrirjen e këtyre mjediseve. Por lënda arkeologjike e gjetur aty ndihmon pak a shumë në përcaktimin e tyre si teprica muresh të mjediseve që shtrihen në anën lindore të korridorit me pllaka, të cilat së bashku me mjediset e anës perëndimore, duket se bënин pjesë në kompleksin e të njëjtës godinë.

Duke gjykuar nga pozicioni «*in situ*» në të cilin u gjetën harqet 4a-b dhe nga prania në gërmim e shumë fragmenteve të enëve me parete të trasha dhe përmasa të mëdha (tip dinosash) jemi të prirur të shohim këtu harqet e rrëzuara të dy drithareve të sipërme të murit perëndimor të korridorit të një godine ndoshta të tipit bazilikal (hipostil) me mjedise njëka-

171) H. Spahiu, Ekspeditë të..., f. 349; Y. Cerova, Kështjella e Qafës në krahinën e Sulovës, 2, 1987, f. 157, fig. 5.

KTC  
M.  
3 K

tëshe, të vendosura në të dy anët e korridorit dhe të përdomrura si magazina.

Teknika e ndërtimit të mureve, përmasat e tullave, materiali arkeologjik dhe monedha e Anastasit të I i lidhin rrënojat e kësaj godine dhe mijediset rrëth saj me kohën antike të vonë (shek. V-VI të e.sonë).

## 2. VARRET

Gjatë gjermimeve të viteve 1973-1974 pranë mureve të periudhës qytetare ilire në pjesën e brendshme të tyre u zbuluan dy varre.

*Varri 1* (Varr fëmije). U zbulua në pikën C, pranë murit ilir në thellësinë 1,75 m nga sipërfaqja e tokës. Ishte 2,15 m larg brinjës juglindore të kuadratit II të kësaj pike, pothuajse në qoshen juglindore të tij. Varri ishte i ndërtuar me dy tjegulla solene të plota 0,85 m x 0,43 m; 0,75 x 0,41 m me buzët e profiluara si sqep zogu 3 cm të trasha të vendosura në formë çatje dyujëshe, që si kohë i takojnë shek. III-IV të e.sonë. Varri kishte drejtim VL-JP (Fig. 37).

Skeleti u gjet shumë i shpërbërë. Me përjashtim të disa fragmenteve të kafkës eshtra të tjera nuk u gjetën në varr. Brenda në varr u gjet vetëm një monedhë bronzi e perandorit Arkad (395-408) dhe asnje objekt tjeter.

*Varri 2*. U zbulua në pikën A në thellësinë 7,15 m nga sipërfaqja e tokës, përmbi rrënojat e murit ilir. (Fig. 38).

Varri kishte formën e një arke katërkëndëshe të kufizuar prej pllakash guri gëlqeror të çrrëgullta, prej të cilave përbëhet edhe mbulesa e tij. Skeleti në varr nuk u gjet në pozicion të rregullt. Kafka e fragmentuar ishte vendosur përmbi klavikul. Mungonte femuri i majtë dhe gjymtyrët e sipërme së bashku me brinjët. Varri ka qënë i dhunuar. Përveç një tokëze prej hekuri në formë katërkëndëshi të fragmentuar në varr nuk u gjet asnje objekt tjeter.

Varri ishte 2 m i gjatë, 0,52-0,53 m i gjerë tek kryet dhe tek krahët, 0,60 m i gjerë në mesin e tij dhe 0,43 m i thellë.

Gjatësia e skeletit në varr nuk ishte e mundur të përcaktohej. Materiali arkeologjik i gjetur në këtë shtresë nuk na ndihmon në përcaktimin e kohës të këtij varri, pasi siç u tha më lart shtresat kulturore ishin të përziera. Ky varr duhet t'i




Fig. 37

përkasi me shumë probabilitet, kohës antiike të vonë ose mesjetës së hershme.

Varre fëmijësh të vendosura pranë mureve rrighthuese janë gjetur edhe në qendërbanime të tjera të vendit tonë si në kështjellën e Pogradecit, në atë të Paleokastrës, Krujës etj.<sup>172)</sup>

Varrimet e bëra pranë mureve rrighthuese të qytetit të lashtë të Beratit duhen lidhur, sikurse është vënë në dukje edhe më parë, me ritin pagan, sipas të cilit shpirtrat e fëmijëve të varrosur do të mbronin, bashkë me luftëtarët, kështjellat.<sup>173)</sup>

172) S. Anamali, *Kështjella...*, f. 227, fig. 7,8; A. Baçe, *Gërmime në Kështjellën e Paleokastrës (Rr. i Gjirokastrës)* «B.A» 5. 1975, f. 107; Gj. Frashëri, *Kalaja e Krujës, Gjurmime dhe Konservime (Dissertacion)* Tirane, 1997.

173) S. Anamali, *Kështjella...*, f. 227.




Fig. 33

### 3. QERAMIKA E SHEK.IV-VI E.SONË.

#### A. Enët e tavolinës.

Në enët e tavolinës janë përfshirë fragmentet e enëve me parete të holla, që riprodhojnë enë të përdorimit shtëpiak të përditshëm si pjata të thella ose tasa, kupa ose filxhana, kana, kotruve, ojnohe etj.

Enët e tavolinës janë përgatitur me çark prej një balte të pastër dhe dallojnë për një pjekje të mirë dhe uniforme. Ngjyra e baltës si në sipërfaqe ashtu edhe në thyerje është e njëjtë okër në rozë pak si e kuqërremptë. Kanë zakonisht vegja petullicë ndonjëherë mjaft të gjera dhe të trashura me prerje elipsoidale dhe cilindrike. Fundet zakonisht janë të sheshta. Si kohë ato i takojnë kohës së vonë antike dhe ndoshta periudhës tranzitore për në mesjetën e hershme.

a. *Tasat.* Në serinë e enëve të tavolinës vëndin kryesor e zënë tasat ose pjatat e thella me përmasa mesatare. Diametri i tyre shkon nga 17,5-30 cm.

Megjithëse ato kanë arritur deri tek ne të fragmentuara, po paraqesim më kryesoret prej tyre, që dallojnë si për formën dhe teknologjinë e prodhimit, ashtu që për zbukurimet.

a 1 Fragment tasi me trup gati gjysmësierik dhe buzë paksa të dala nga jashë me seksion si sqep zogu (Tab. XXVII, 1). Tasi ka pasur fund të sheshtë dhe të profiluar nga jashtë. Është dekoruar në pjesën e brendshme të buzëve me një vijë qarkuese ngjyrë të kuqe të përbëre nga një varg sektorësh dhe nga vija radiale që dalin nga qendra e tasit në drejtim të buzëve të enës. Me sa duket këto vija alternoheshin nga një rozeti 8 petalëshe e piktuar gjithashtu me ngjyrë të kuqe.

a 2 Fragment tasi me pjesën e poshme në formë konike dhc të sipërmen me prerje në trajtë trapezi, me buzë të drejta e të rrumbullakuara në skajet. Në pjesën e brendshme ka qenë zbukuruar me disa harqe të bëra para pjekjes me penel të trashë me ngjyrë kafe gështenjë (Tab. XXVII, 2).

a 3 Fragment tasi ose pjate të thellë në formë kësule gjysmësierike me buzët e gjera të shpërvjela nga jashtë në formë strehe. Në pjesën e sipërme të buzëve janë piktuar me ngjyrë të kuqe para pjekjes me penel të hollë një varg harqesh që ndërpresin njëri-tjetrin (Tab. XXVII, 5).

a 4 Fund tasi me një bazë unazore jo shumë të lartë. Në pjesën e sipërme të enës ka qenë piktuar para pjekjes me ngjyrë i të kuqëremtë një rozetë 8 petalëshe shumë e ngjashme me atë të tasit nr. 1 (Tab. XXIX, 1).

Në enët e tavolinës kemi mundur të veçojmë disa fragmente enësh kryesisht, pjesë buzësh, parete e funde enësh, që duhet të kenë shërbyer për ujë.

Gjendja e tyre tëpër e fragmentuar e përjashton mundësinë e rindërtimit të formave të tyre. Ato mesa duket ripro-dhojnë enë të tipit kupë, kotruve, broke (ojnohe) (tab. XXVIII 1-8; Tab. XXIX, 4). Ajo që bie në sy rë këtë kategori enësh është piktuimi i bërë me ngjyrë të kuqe kafe gështenjë i aplikuar kryesisht në pjesën e jashtme të grvkës, në shpatullat e enës dhe në pjesën e barkut (Tab. XXVIII e XXIX).

Janë përgatitur prej një balte që përban në përzierje grimca gurësh gëlqerorë të thërrmuar. Ngjyra e baltës okër, rozë dhe më rrallë kafe në gri. Kanë pasur në përgjithësi qafë jo shumë të lartë cilindrike ose në formë hinke dhe buzë të drejta paksa të shpërvjela ose shumë të shpërvjela nga jashtë me seksion katërkëndëshi ose të rrumbullakuara në skajet (Tab.

XXVIII, 1-3; Tab. XXIX, 2-9). Vegjat, megjithëse prej tyre janë ruajtur shumë pak, duket se kanë pasur prerje elipsoide, po janë ndeshur edhe vegja të gjera me seksion petullicë.

Analogjitë më të përaferta të tyre i ndeshim në qeramikën e shekujve IV-VI të e.sonë të zbuluar në kalanë e Elbasanit, në kështjellën e Kaninës, në atë të Paleokastrës, në gradishtën e Symizës në Durrës, Onhezëm etj.<sup>174</sup>

### Kupa

b'1 Fragment kupe me trup në trajtë kësule gjysmë-sferike, buzë të anuara në të dy anët dhe të pajisura nga brenda me një kanal për mbështetjen e kapakut (Tab. XXVI, 2). Sipërfaqja e enës zbulurohet me disa kanelyra të den dura horizontale.

b'2 Fragment fund kotruveje më gropën të theksuar që ngrihet në anën e brendshme të enës me një themth qendror. (Tab. XXVI, 4). Copa është e ngjashme me enët me fund të gropëzuar nga jashtë dhe të gufuar nga brenda, të pajisura me një themth të vogël në mes, të njoitura në rrëthin e Korçës, por edhe gjetkë, e deri në Lushnjë. Këto lloj fundesh janë të ngjashme me fundet e vorbave të gjetura në gërmimet në Kalanë e Pogradecit, të shoqëruara me materiale të shek. IV të e.sonë.<sup>175</sup>

b'3 Fragment ene tavoline me trup të fyrë cilindrik dhe qafë të shkurtër që përfundon në një grykë të gjerë. Buzët me seksion elipsoidal përkulen lehtas nga jashtë. (Aab. XXIII, 11). Sipërfaqja e enës është e lyer me një shtresë të hollë lymi, në ngjyrën e baltës së vet, që i jep asaj një shkëlqim të lehtë.

Rrëzë grykës dhe në pjesën e shpatullave e zbulurohet me tufa vijash të valëzuara të bëra para pjekjes me pikturim me ngjyrë kafe. Një enë të ngjashme me këtë e ndë-

174) Gj. Karaiskaj, *Disa të dhëna të reja për datimin e kalasë Elbasanit*, «B.A.», Tiranë 1971, f. 164, Tab. IV, 6-9; A. Baçe, *Kështjella...*, f. 199, Tab. XII, 5-12, shih edhe literaturën e cituar prej tij; Gj. Karaiskaj, *Gradishta e Symizës në kohën antike të vonë dhe në mesjetë*, «Iliria» IX-X, 1979-1980 f. 177, 178, Tab. XVII, 4, tab. III, 3; K. Lako *Kështjella e Onhezmit*, «Iliria» 2, 1934, f. 173, Tab. II, 4, 8.

175) S. Anamali, *Kështjella...*, f. 228.

shim në qeramikën e së njëjtës periudhë të zbuluar në kështjellën e Pogradecit, motivi i zbukurimit me vija të valëzuara i së cilës i ndeshur edhe në enë të tjera, me të drejtë është konsideruar si një element vendas.<sup>176</sup> Si forma, ashtu edhe pikturimi i kësaj ene gjithashtu do të vazhdojë të përdoret edhe në mesjetë.<sup>177</sup>

## B. Enët e kuzhinës

Në enët e kuzhinës hyjnë enët e përdorimit të përditështëm shtëpiak, si vorba, tasa, kapakë etj. Ato kanë në përgjithësi një fakturë të ashpër me parete relativisht të holla dhe janë përgatitur prej një deltine jo shumë të pastër, që në disa raste ka në përbërje jo vetëm cikërrima mike, por edhe thërrmija gurësh gëlqerorë e copa tullash të shtypura që herë-herë dalin në sipërfaqe. Në pjesën më të madhe janë punuar me çark, por ndeshen, ndonëse rrallë, copa enësh të punuara me dorë. Në përgjithësi janë të pjekura mirë, por ka midis tyre, edhe fragmente me një pjekje të dobët ose prodhime skarco, gjë që tregon se janë prodhuar në punishtet lokale të këtij qyteti. Ngjyra e pjekjes nuk është gjithkund uniforme. Ajo ndryshon jo vetëm nga një enë tek tjetra, por edhe në të njëjtën enë. Mbizoteron në përgjithësi ngjyra kafe e kafe në rozë, në të kuqërrëmtë ose në gri.

Vorbat. Në enët e kuzhinës vendin kryesor e zenë fragmentet e vorbave. Nga numri relativisht i madh i fragmenteve të tyre të zbuluara në gërmimet e vitit 1973-1974 në Kështjellën e Beratit (parete enësh, buzë e vegjë të thyera e më rrallë funde enësh) del se vorbat kanë qenë tipi më i përhapur i enëve të kuzhinës që kishin gjelur një përdorim të gjerë në jetën e përditshme të banorëve vendas. Nga mund të gjykohet nga riprodhimi grafik i tyre ato kanë pasur përmasa të vogla e mesatare (Tab. XXIII, XXIV, XXV, XXVI).

Në mungesë të enëve të plota riprodhimi grafik i fragmenteve të këtyre vorbave, ashtu si për përmasat, na ofron një ide të përafërt edhe për format e tyre, sipas të cilave mund të veçojmë dy tipa kryesorë:

176) Po aty, f. 228, Tab. XIX, 1.

177). Gj. Karaiskaj, *Gradishta...*, f. 180, Tab. X, 11.

*Tipi 1.* Në tipin e parë janë përfshirë vorba grykë-gjerë me trup të fryrë sferik, pa qafë ose me një qafë të shkurtër pa kalim të dukshëm nga trupi i enës. Ato kanë buzët gjysmë të shpërvjela nga jashtë dhe shpeshherë të lugëzuara nga brenda me një kanal për mbështetjen e kapakut (Tab. XXIII, 4.5,10,12; Tab. XXIV, 6,7,9,10; Tab XXV, 7,9,11,12,13).

Vorbat e këtij tipi ndryshojnë midis tyre nga përmasat dhe profilimi i buzëve, sipas të cilave mund të dallohen disa variante:

1. Vorbë me buzë të sheshëri horizontale, pak të anuara nga jashtë me seksion në formë ashiku ose fasuleje, sinusoidal në formë trekëndëshi, katërkëndëshi etj. të drejta ose të fryra në skajet (Tab. XXIII, 10).

Këto lloj vorbash kanë zakonisht vegja të vogla me seksion petullicë ose në formë fasuleje, të zbulkuarara shpesh me 2-4 kanelyra gjatësore të bëra para pjekjes (Tab. LVII, 1,2,4). Vegjet si vazhdim i buzëve të enës nuk e kalojnë nivelin e tyre, por duke u harkuar ato kapen mbi shpatullat e erës (Tab. XXV, 16). Ngandonjëherë ato zenë vend paksa nën buzët. në vendin e lidhjes të vegjës me paretin duket një gropëz e bërë para pjekjes me mollëzën e gishtit për përforcim (Tab. XXIII, 9; Tab. XXVI. 11).

2. Vorbë me trup të fryrë sferik, qafë të shkurtër cilindrike dhe buzë të gufuara e të rrumbullakuara pak të mbledhura nga brenda dhe të lugëzuara në paretin e brendshëm (Tab. XXXII, 9).

Një vorbë shumë e ngjashme me këtë është gjetur në keramikën e periudhës të katërt të banimit (shek. IV-VIII e.s.) të kështjellës së Pogradecit.<sup>178</sup>

3. Vorbë me trup sferik, buzët pak të anuara nga jashtë me seksion gjysmësferik dhe profilime në paretin e jashtëm dhe të brendshëm (Tab. XXXII, 10).

4. Vorbë me trup sferik, me buzë gjysmë të hapura nga jashtë, të fryra dhe të rrumbullakuara në skajet (Tab. XXXII, 7,10).

5. Vorbë me trup të fryrë sferik dhe buzë që zgjerohen në skajet. të sheshta ose të prera pjerrëtas nga jashtë (Tab. XXXII, 14,16).

6. Vorbë me trup të fryrë sferik, qafë të shkurtër dhe buzë jo të zakonta me seksion sinusoidal në paretin e brend-

<sup>178)</sup> S. Anamali, Kështjella..., f. 228, Tab. XIX, 1.

shëm dhe në formë ashiku nga jashtë, të lugëzuara (Tab. XXXII, 12).

Vorbat e këtij tipi afrohen shumë me ato të kohës antike të vonë të gjetura në kështjellën e Paleokastrës.<sup>179</sup>

Tipi 2. Vorbat e tipit të dytë kanë parete relativishë të holla dhe dallohen nga forma e trupit në trajtë voze jo shumë të fryrë. Janë pa qafë ose me një qafë shumë të shkurtër, grykë të gjërë me buzë gjysmë të shpërvjela nga jashtë dhe të profiluara ngandonjëherë në të dy anët. Herë-herë ato janë të pajisura me një kanal paksa të lugëzuar për vendosjen e kapakut.

1. Vorbë me trup jo shumë të fryrë, buzë të sheshta të prera gati vertikalishë nga jashtë me prerje në formë ashiku, me një lugëzim të lehtë në pjesën e brendshme (Tab. XXXII, 17).

2. Vorbë me trup jo shumë të fryrë, me buzë shumë të trashura, të pjerrura nga jashtë me dalje këndore dhe seksion në formë këmbëze, me një kanal në pjesën e brendshme për mbështetjen e kapakut (Tab. XXXII, 8).

3. Vorbë me trup jo shumë të fryrë dhe buzë gjysmë të hapura dhe të prera pjerrëtas nga jashtë të lugëzuara në paratin e brendshëm (Tab. XXXII, 6).

Vegjét e tyre me seksion gati rrëthor, e gjysmë rrëthor më të shumtën petullicë janë në përgjithësi, sikurse ato të tipit të parë, vazhdim i drejtpërdrejtë i buzëve (Tab. XXIII, 1-3, 6-8; Tab. XXIV, 5, 7, 11; XXVI, 3).

4. Një fragment tjetër vorbe ka trup të stërgjatur në formë vezake, grykë të gjërë me buzët të shpërvjela nga jashtë dhe vegjë të vogël petullicë (Tab. XXIII, 8).

5. Disa fragmente vorbash kanë grykë të gjërë të trajtë hinke dhe buzët me seksion katërkëndëshi (Tab. XXVI, 5; Tab. XXIV, 1, 8; Tab. XXV, 15). Në vegjën e njëjës prej tyre në pikën ku ajo lidhet me buzët ë enës si përforsim eshtë mbivënë para pjekjes një topth balte. (Tab. XXIV, 8).

Këto lloj vorbash janë karakteristike për shek. III-IV duke anuar më tepër nga shek. IV. Vorba të ngjashme me këto janë gjetur në qeramikën e kohës antike të vonë të Kainës, Ballshit eti.<sup>180</sup>

179) A. Baçe, Kështjella..., f. 200. Tab. XIII, 1-14. Shih dhe literaturën e cituar aty.

180) D. Komata, Kështjella..., f. 77, 78.

6. Një fragment vorbe (Tab. XIV, 8) dallon nga të tjerat nga buzët e shtrira nga jashtë në formë strehe dhe të profiluara në paretin e jashtëm. Ky tip vorbe për nga forma përaqet ngjashmëri me dy enët prej balte të ashpër të gjetura njëra në varrin 20 dhe tjetra jashtë varreve në nekropolin e dyshë të Apoloni, të datuara në fillim të shek. III të e.sonë.<sup>181</sup> Për nga forma ato përsërisin enë të periudhës qytetarë ilire.

Vorbat e këtij lloj kanë vegjë me seksion petullicë, rrethoh gjysmërrëthor dhe elipsoidal me dy thellime në formë kanelyrash, që shkojnë paralel me buzët e enës dhe nuk e kalojnë nivelin e tyre. Vegja horizontale në barkun e enës ndeshët rrallë. (Tab. XVIII, 3; Tab. XXI, 11).

7. Si variante të këtyre vorbave janë disa fragmente me paretë të trasha dhe me buzët me seksion katërkëndëshi të shtrira nga jashtë horizontalisht dhe të profiluara në skajet (Tab. XII, 12,13). Midis fragmenteve të vorbave të bien në sy disa copa që riprohijnë vorbë me përmasa të mëdha. (Tab. LX, 1). Nga forma dhe trajtimi i buzëve ato afrojnë me vorbat e gjetura në horizontin II të banimit të Bradashësit, të datuara në shek. IV të e.sonë.<sup>182</sup>

8: Për t'u shënuar është një fragment vorbe me trup gati sferik dhe buzë me seksion trekëndëshi të fryra në anën e jashtme. (Tab. XXIV, 2). Paksa nien buzët e enës shihet një zbulurim i përbërë nga dy vija rrethore paralele të bëra gjatë rrotullimit të enës, motive të ngjashme që i ndeshim edhe në vorbat e së njëjtës periudhë të zbuluara në kështjellën e Pogradecit.<sup>183</sup>

9. Në enët e kuzhinës do të vendosej edhe fragmenti i një kupe prej balte të ashpër me trup gjysmësferik, buzë paksa të shpërvjela nga jashtë dhe të pajisura me kanal për vendosjen e kapakut (Tab. XXVI, 2).

10. Duke gjykuar nga balta dhe teknologjia e prodhimit në enët e kuzhinës kemi radhitur dhe një fragment të vogël ene të pajisur me brima, të përdorur me sa duket si kulluesë (Tab. XXIV, 4).

Fundet e këtyre vorbave, me gjithë numrin e tyre jo

181) A. Mano, *Nekropoli*..., f. 203, Tab. V, 9, 10.

182) N. Ceka, *Ad Quintum*..., f. 297, Tab. VI, 5; Tab. VII, 9, 10.

183) S. Anamali, *Kështjella*..., Tab. XIX, 6.

184) N. Ceka, *Ad Quintum*..., f. 298, Tab. X, 12.

shumë të madh duket se kanë qenë dy llojeshi; të sheshtë si vazhdim i drejtpërdrejtë i trupit të enës dhe të gufuara nga brenda. (Tab. XXVI, 4,8,10). Këto të fundit kanë në pjesën e tyre të mesit një gropëz jo shumë të thellë, të pajisur me një themth të vogël qëndror në parëtin e jashtëm. (Tab. XXVI, 6; Tab. LVII, 7).

Funde të tilla vörbash janë gjetur në qeramikën e zbuluar gjatë gërmimeve në fshatin Bradashesh,<sup>184</sup> në qeramikën e periudhës së katërt të banimit në kështjellën e Pogradecit, në qeramikën e grumbulluar gjatë zbulimit të Bazilikës paleokristiane të Mesaplikut në kështjellën e Onhezmit (Sarandë), në kalanë e Zharrës etj., të datuara në shek. IV-VI të e.sonë.<sup>185</sup>

Duke gjykuar nga copat që mbajnë dekoracione mendohet se ato kanë qenë dekoruar nga disa hulli të ngushta dhe të gjera të bëra para pjekjes në zonën midis buzëve dhe shpatullave të enës. të cilat ngandonjëherë ndërpriten nga gropëza në formën e farës së mollës. (Tab. XXV, 5,6,9,11; Tab. XXVI; Tab. LXII, 3,5,6; Tab. LVIII, 3). Një pjesë tjeter fragmen-tesh mbajnë zbulurime në formë tufa vijash qarkuese të çrregullta të bëra me incizim para pjekjes (Tab. XXV, 5). Si zbulurime të vegjës janë disa vija paralele të vendosura në pjesën e sipërme të saj.

Janë gjetur shpesh fragmente vorbash të këtilla të lyerë nga brenda me serë dke herë-herë edhe në pjesën e jashtme dhe në vegjët e tyre (Tab. XXVI, 7).

Të ngjashme me këto janë ndeshur në gërmimet e bëra në kështjellën e Pogradecit, në qeramikën e kohës antike të vonë të kështjellës së Kaninës, në kështjellën e Paleokastrës, në qeramikën sinkrone të gradishtës të Symizës dhe në një varg qendrash të tjera të kohës antike të vonë të vendit tonë të datuara në përgjithësi në shek. IV-VI të e.sonë.<sup>186</sup>

Enëve të tipit tenxhere i përket një fragment ene kuzhine, me trup gati cilindrik, pak të fryrë, me buzët e shpërvjela

185) S. Anamali, *Kështjella...*, f. 228, D. Komata, *Bazilitika paleokristiane e Mesaplikut*, «Iliria» I, 1984, f. 194, Tab. I, 24, 25; K. Lakó, *Kështjella...*, f. 181, Tab. VI, 13-16; D. Komata, *Kështjella e Zharrës — Fortesa e periudhës antike të vonë*, «Iliria» VI, 1976, f. 317, Tab. IV, 8.

186) S. Anamali, *Kështjella...*, f. 228, Tab. XIV, 166; D. Komata, *Kështjella...*, f. 76-78; A. Baçe, *Kështjella...*, f. 200, Tab. XIII, 1-14; G.I. Karaiskaj, *Gradishta...*, f. 175, Tab. II, 1, 4, 8 shih edhe literaturën krahasuese që jepet aty për visët e tjera të Ballkanit

te rrumbullakuara në skajet, të pajisura në pjesën e sipërme pranë vijës perimetrale me një vijaskë qarkuese. Ka gjurmë të një vegje horizontale nën buzë (Tab. XVIII, 8). Ena ri-prodhon një formë të trashëguar nga periudha pararendëse.

Në qeramikën e kuzhinës kemi mundur të veçojmë edhe disa fragmente (kryesisht buzë enësh) që riprodrojnë pjata të thella dhe tasa me fakturë të ashpér të përgatitur nga e njëjtë argjilë.

*Pjatat.* Më të zakonshme janë pjatat e thella me përmasa relativisht të mëdha, me trup me prerje në formë trapezi, buzë të drejta, të rrumbullakuara, të shtrira ose të kthyera nga brenda (Tab. XVIII, 11; Tab. XX, 7).

Forma të ngjashme me këto janë të pranishme në qeramikën e periudhës së dytë të banimit në këtë qytet, të datuara në shek. III-II p.e.sonë, çka flet për rruajtjen e traditave të lashta nga qeramika e periudhës qytetare ilire. Janë të përafërt me pjatat e gjetura në shtresën e depozituar mbi dyshemenë e apodyteriumit të Bradasheshit<sup>187</sup> etj.

*Tasat.* Fragmentet e tasave të kuzhinës në krahasim me vorbat kanë dalë në një numër mjaft të kufizuar, midis tyre dallojmë dy tipa kryesorë:

*Tipi 1.* Tasat e tipit të parë kanë trup gjysmësferik (Tab. XII, 9; Tab. XIX, 12); paraqesin tipa të njojur nga qeramika e kohës së vonë romake edhe në qendra të tjera të vendit tonë. Kanë buzët e trashura dhe të shpërvjela nga jashtë me seksion si sqep zogu. Në raste të tjera ato janë të shtrira nga jashtë me seksion elipsoidal, të pajisura nën to ngandonjëherë me via qarkuese (Tab. XXV, 1'2).

Një copë të përafërt me këtë tip e njohten nga qeramika e apodyterit të Bradasheshit.<sup>188</sup>

*Tipi 2.* Një tip tjetër përfaqëson fragmenti i një tasi me trup në formë segmenti sferik, me faqet e pjerrëta dhe buzët e shtrira e të rrumbullakuara në skajet (Tab. XII, 10). Për nga forma ai afron me një tas të zbuluar në horizontin e dytë të banimit të Bradasheshit, të datuar në shek. IV p.e.sonë.<sup>189</sup>

Një formë disi të veçantë paraqet tasi me trup gjysmësferik, (Tab. XII, 15) me buzët e drejta paksa të anuara nga

<sup>187) N. Ceka, Ad Quintum..., Tab. II, 5.</sup>

<sup>188) Po. aty., f. 297, Tab. IX, 4.</sup>

<sup>189) Po. aty., f. 296, Tab. IV, 5.</sup>

jashtë, që përshkohet në pjesën e mesit nga një kreshtë në formë strehe.

Për nga forma ai afrohet me një tas me faqe të pjerrëta të gjetur në horizontin e dytë të banimit të Bradasheshit, të datuar me materiale të gjysmës së dytë të shek. IV të e.sonë.<sup>190</sup>

Këto lloj tasash janë prodhime lokale dhe përsërisin forma tipike të shek. IV e.sonë që vijnë edhe nga qendërbanimë të tjera të vendit tonë. Ato janë të njoitura nga qeramika e së njëjtës periudhë e kalasë së Zharrës, nga ajo e mbledhur në gërmimet e bëra në gradishtën e Symizës etj.<sup>191</sup>

Tipi 3. Një tip të tretë formojnë tri fragmente tasash me trup në formë sektori rrrethor, buzë të rrumbullakuara dhe parete jo shumë të trasha. Balta dhe teknika e prodhimit të tyre janë shumë të ngjashme me ato të tipit të parë, ndryshojnë prej tyre vetëm nga përmasat, që tek këta të fundit janë më të mëdha (Tab. XXV, 1,4; XXVII, 7).

Forma tasash si këto janë gjetur në qeramikën e së njëjtës periudhë që vjen nga qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme, nga kështjella e Zharrës, gradishta e Symizës etj.<sup>192</sup>

Në qeramikën e kuzhinës të kësaj shtrese janë gjetur edhe disa fragmente enësh me fakturë të ashpër të tipit ojnohe dhe amforiska të përgatitura prej një argjile, që përbën në përzierje grimca gurësh gëlqerorë të shtypur. Për nga teknologjia e prodhimit këto lloj enësh duhet të jenë përdorur si enë pér nevojat e kuzhinës.

1. Fragment grykë ene triullukëshe tip ojnohe. Ngjyra e baltës kafe në të kuqërrëmtë me nuanca të zeba (Tab. XIII, 1). Enë të këtij tipi janë forma të njoitura dhe të zakonshme në qeramikën e shekujve të parë të e.sonë. Një grykë ene triullukëshe tip ojnohe është gjetur në nekropolin e dystë të Apolonisë, e datuar me materiale të shekullit I-III të e.sonë.<sup>193</sup>

2. Amforiskë me qafë jo shumë të lartë cilindrike e buzë të hapura nga jashtë në formë strehe me një pragëzim

190) Po aty, f. 296, Tab. V, 2.

191) D. Komata, Kalaja e Zharrës, qendër e periudhës së vonë antike (Gërmime pér vitin 1970), «B.A.», 1971, f. 139, Tab. II, 7, 8 Gj. Karaiskaj Gradishta..., f. 171, Tab. IV, 1 dhe Tab. V, 8.

192) N. Ceka, Qyteti..., Tab. LXXXVI, 14; D. Komata, Kështjella e Zharrës..., f. 818, Tab. III, 17; Gj. Karaiskaj, Gradishta..., tab. V, 8.

193) A. Mano, Nekropoli..., f. 205, Tab. VI, 10.

paksa tē shënuar nē pjesën e sipérme (Tab. XIII, 4). Si kohë ajo i takon shek. II-III tē e.sonë .

3. Amforiskë me parete tē holla, grykë tē ngushtë cilindrike, buzë tē trashura e tē hapura nga jashtë gati horizontalisht (Tab. XIII, 5; Tab. XXI, 2). Për nga forma nuk ndryshon nga amforiskat e tavolinës.

4. Amforiskë me qafë jo shumë tē lartë cilindrike me buzë tē valëzuara me seksion sinusoidal tē dyfishtë (Tab. XVII, 8).

5. Amforiskë me qafë jo shumë tē lartë cilindrike, grykë tē gjerë dhe buzë tē profiluara nga jashtë me seksion nē formë ashiku (Tab. XIII, 12).

Së bashku me fragmentet e amforiskave tē kuzhinës janë mbledhur edhe disa vegjë tē fragmentuara. që për nga karakteristikat e baltës dhe teknologjisë së prodhimit duket se i përkasin amforiskave tē mësipérme. Mbizotërojnë nē mes tyre vegjët me seksion katërkëndëshi. Ka nga ato me seksion rrëthor tē pajisura herë-herë me hulli tē cekëta ose me kreshta tē dala nē relief, që shpesh mbajnë gjurmën e bulzës së gishtit. Midis tyre janë gjetur edhe dy vegjë horizontale me seksion katërkëndëshi ose nē formë fasolje tē bëra prej balte tē ashpër, tē ndonjë ene tip tenxhereje ose tave. (Tab. XV, 11,12,13; Tab. XVI, 15-18).

Në fragmentet e enëve tē kuzhinës janë mbledhur edhe disa fragmente kapakësh me përmasa tē vogla dhe mesatare. Janë përgatitur nga e njëjtë argjilë dhe kanë sipërfaqe tē ashpër, ngjyrë rozë ose kafe nē tē kuqërremtë dhe gri me nuanca të zeza, që dëshmojnë për përdorimin e tyre nē enët e zjarrit.

Kanë formë kësule gjysmësférique me skaje tē kthyera nga brenda. Doreza e kapjes është e sheshtë ose e borduruar anash nē formë unazore. Diametri i dorezës ku kapeshin shkon nga 3,5 cm -4,8 cm. Tek një fragment i plotë diametri i dorezës është 5,4 cm. (Tab. VII, 9; Tab. XV, 2,3,4,6):

Disa fragmente tē tjera enësh, kryesisht parete duket se riprodhojnë kapakë enësh, që afërsisht nē pjesën e mesit tē trupit vizohen prej një brezi nē formë kreshte tē theksuar nē relief, i cili e ndan enën nē dy pjesë. Pjesa e sipérme e tyre ka formë hinke dhe pjerrësi më tē madhe se e poshtmjë. (Tab. XXVII, 9,11; Tab. LVII, 5). Janë përgatitur prej një balte jo shumë tē pastër ngjyrë gri nē tē zezë. Kapakë tē tillë tē ngjashëm tē cilësuar nē disa raste nga sudiuesit, gërmisht si tasa për shkak tē gjendjes tepër tē fragmentuar tē

tyre, janë gjetur në kalanë e Kaninës, Pogradecit, Bradashestit, në Butrint, Onhezni<sup>194</sup>, etj., ku datohen zë me materiale të kohës antike të vonë (shek. IV-VI).

Në qeramikën e kësaj shtrese janë mbledhur edhe disa fragmente të tjera kapakësh të thjeshtë që riprodrojnë format e ndryshme: në trajtë sektori sferik, në trajtë koni të cunguar apo kësule gjysmësferike. Kanë skaje me seksion drejt-këndëshi të rrumbullakuara dhe paksa të anuara nga jashtë. Ngjyra e baltës dhe teknologji e prodhimit të këtyre kapakëve është shumë e ngjashme me atë të tasave të mësipërm. (Tab. XXVII, 3,4,6,7,10).

Kapakë konikë të vorbave janë të pranishëm në qeramikën e kuzhinës të Bradasheshit të datuara në shek. IV dhe në kështjellën e Paleokastrës në konteks gjetjesh të shek. V-VI.<sup>195</sup>

### C. Enët e transportit dhe të qilarit.

Në shtresën e kohës antike të vonë janë gjetur edhe disa amfora transporti dhe një sasi e konsiderueshme fragmente enësh me përmasa të mëdha dhe parete relativisht të trasha që kanë shërbyer si enë qilari, për ruajtjen e rezervave ushqimore, të drithërave dhe të lëngjeve.

Janë gjetur në sektorët B,C,D dhe F gjatë gërmimit buzë mureve rrethuese, në një gjendje të fragmentuar. Prej tyre janë mbledhur kryesisht buzë dinosash e amforash me pjesë pareti, copa barqesh dinosash e amforash dhe shumë rrallë funde të tyre. Midis fragmenteve të qeramikës së kësaj shtrese janë gjetur një sasi e konsiderueshme fragmente enësh kryesisht parete e rrallëherë ndonjë vëgjë, të zbukuruara me hulleti të gjera dhe të ngushta, që iu përkisnin amforave karakteristike për kohën e vonë antike. (Tab. XXV, 5,6,17; Tab. XXVI, 1; Tab. LVIII, 4).

194) O. Komata, *Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në kalanë e Kaninës* (në vitet 1971-1973), «Iliria» III, 1974, f. 478; S. Anamali, Kështjella..., f. 228; A. Baçe, Kështjella..., f. 203, Tab. XVIII, 1-3; N. Ceka, *Fortifikime të vona antike pranë rrugës Egnatia*, «Monumenti» 7-8, 1974, fig. 20; K. Lako, *Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Butrint* (në vitet 1975-1976), «Iliria» I, 1981, f. 114-115; Po ai, Kështjella..., f. 185, Tab. IX, 6, 8.

195) N. Ceka, *Ad Quintum...*, f. 297, Tab. VII, 7; A. Baçe, Kështjella..., f. 201, Tab. XIV, 4.

Enët e tipit amforë janë gjetur në një gjendje tepër të fragmentuar, gjë që vështirëson riprodhimin e formave të tyre. qoftë edhe më ndihmën e rindërtimit grafik. Enë të këtij tipi janë të njoitura nga qeramika e kohës antike të vonë të zbuluar në gradiştinë e Syrnizës, në atë të Kaninës, Paleokastrës etj.<sup>196</sup> Me gjithë vështirësitë që paraqet gjetja e tyre tepër e fragmentuar edhe në këto qendra kjo lloj qeramike është datuar në shek. IV-VI të e.soni.

Fragmentet e dinosave u gjetën në pjesën më të madhe të tyre në pikën C dhe F. Janë përgatitur prej brumi të ashpër që përmban në përzierje copa gurësh gëlqerorë të thërrmuar dhe copa tullash. Pjekja është e mirë. ngjyrë kafe në të kuqërremtë.

Megjithëse ato janë shumë të fragmentuara dhe nuk na japin mundësi për një restaurim të plotë duket se kanë pasur trup barkosh pa qafë dhe rrallëherë formë të stërgjatur. Kanë grykë të gjerë me buzët e sheshta shumë të trashura me seksion trikëndësh. Fundet e tyre janë dy llojesh: të sheshta dhe në formë koke qepe. Diametri i grykës lëviz nga 14 cm - 33 cm.

Pitosa të tillë me përmasa të vogla (dinoa) janë gjetur në shtresën antike të vonë të qytetit ilir pranë Selcës së Poshtme në kështjellën e Paleokastrës, në kalanë e Zharrës etj.<sup>197</sup>

Midis fragmenteve të dinosave u gjet edhe një copë enë ndoshta gypi, me qafë të lartë cilindrike e grykë të gjerë me buzë gjysmë të shpërvjela nga jashtë me seksion të rrumbullakët. Është përgatitur prej një argjile jo shumë të pastër me përzierje gurësh gëlqerorë të shtypur dhe thërrmija siliciumi. Pjekja nuk është uniforme, ngjyra e baltës pas pjekjes është në sipërfaqë kafe në të kuqërremtë dhe në prerje rrëthor. Ena zbukurohet në pjesën e grykës nga vija të valëzuara, që ndahen njëra nga tjetra nga 1-3 vija paralele qarkuese të bëra nga rrotullimi i enës (Tab. XXXI, 7).

Të gjitha copat e dinosave të gjetura në gërmimet mbajnë në përgjithësi mbi sipërfaqen e tyre zbukurime të bëra me

<sup>196)</sup> Gj. Karaïskaj, *Gradishta*..., f. 177, Tab. IV, 5, shih. edhe literaturën e cituar aty për këtë problem.

<sup>197)</sup> N. Çeka, *Qyteti*..., f. 136, 137; Tab. LXXXV, 9-11; A. Baçë, Kështjella..., f. 201, Tab. XV, 7-11; D. Komata, *Kështjella*..., f. 317, Tab. IV, 8.

ngulitje në formë vijash të valëzuara (nga 3-5 të tillë), kryqë prej pikash të ngulitura, rrathë e pikës të vendosura në pjesën e sipërme të buzëve dhë mbi shpatulla. Këto motive të bëra me incizim dhe me ngulitje shpeshherë ndeshen të kombinuara me njëri tjetrin. (Tab. LVIII, 1, 2). Mbi buzën e një dinosi vihen re një radhë pikash të ngulitura dhe germa N, me sa duket shenja e poçarit të punishtes që e prodhoi (Tab. XXX, 8). Në të shumtën e rasteve fragmentet e këtyre dinosave janë gjetur të lyera nga brenda me serë, gjurmët e së cilës shihen ngandonjëherë në formë rëkesh në pjesën e sipërme të buzëve ose në shpatullat e enës (Tab. XX, 3-5; Tab. XXXI, 1-6, 8).

Me rëndësi është të vihet në dukje se së bashku me fragmentet e dinosave në pikën C u gjet një monedhë e Justinit I (518-527), në pikën D dy copë monedha të Justinit I me Justinianin (527) dhe të Justinit II me Sofinë (565-578), ndërsa në pikën F u gjet një monedhë e Anastasit I (491-518). Gjetja e këtyre fragmenteve me monedhat e mësipërmë na jep një datë të saktë të prodhimit dhe përdorimit të këtyre dinosave dhe pikërisht shek. V-VI të e.sonë. Këtë datë tregojnë dhe dinosat e zbuluara në kështjellën e Pogradecit, Symizës, Paleokastrës, të Zharrës dhe të Kaninës, ato të gjetura në këtë të fundit me të cilat janë shumë të ngjashme dinosat tonë janë datuar me ndihmën e tjequllave tipike për V-VI të e.sonë.<sup>198</sup>

#### 4. OBJEKTE METALIKE.

Objektet metalike të zbuluara në gërmimet në kalanë e Beratit, në krahasim me qeramikën janë në një numër të kufizuar. Janë përgatitur prej bronzi dhe prej hekuri. Ato prej bronzi janë fare të pakta.

1. *Fibulë bronzi* që paraqet figurën e stilizuar të një zogu, ndoshta të një palloj, ku dallojmë qartë kokën, sqepin dhe sytë e dhënë me dy rrathë të vegjël të thelluar me nga një pikë në mes. Trupi në trajtë pllakë eliptike përfundon me një bisht të zgjeruar në formë fshese, që të kujton bish-

<sup>198)</sup> S. Anamali, Kështjelli..., f. 229; Tab. XIV, 11; Gj. Kargëskaj, Gradishta..., f. 178, Tab. V, 1; D. Kernata, Kështjella..., f. 318, Tab. V, 3, 4.

tin e palloit. Faqja e sipérme e trupit éshëtë zrukuruar anëve më një vijë qarkuese të thelluar, që ndërpritet nga katër rrathë të vegjël me nga një pikë në mes, të lyer me ar, të vendosur në formë rombi, dy prej të cilëve, ata të skajeve më të largëta të elipsit lidhen me një vijë të drejtë të thelluar. Një vijë qarkuese e thelluar gjithashtu e lyer me ar, kufizon pjesën e poshtme të bishtit, ndërsa pesë brazda horizontale zrukurojnë pjesën e sipérme të tij. Faqja e mbrapme e fibulës éshëtë e sheshtë dhe e pajisur me brimën ku fiksohej gjilpëra, prej hekuri dhe pjesën ku ajo mbështetet, kjo e fundit u gjet pjesërisht e thyer. Gjatësia e fibulës éshëtë 5,3 cm; gjerësia e trupit 1,3 cm (Tab. XLVI, 1). Kjo fibul éshëtë e ngjashme me një fibul të gjetur në Amanti dhe të datuar në kohën e vonë antike.<sup>199</sup>

Një fibul në trajtë zogu, shumë të ngjashme me këtë, e gjejmë midis formave kryesore të fibulave të kohës perandorakë romake, të gjetura në Panoni, që ruhet në muzeun e Zagrebit, dhe një tjetër nga Sisaku (Hungari) të datuara në shek. IV të e.sonë<sup>200</sup>, kohë së cilës mendojmë se i takon edhe copa jonë.

Në grupin e objekteve prej hekuri hyjnë disa vegla pune dhe armë midis të cilave po përmendim një vegël bujqësore dhe disa pajisje të kuzhinës si thikat, një lugë, një thikë-ksistër dhe ndonjë majë shigjete 6,7 cm e gjatë (Tab. XLVI, 7).

2. *Celikan*, vegël e vogël bujqësore që përdorej për hapjen e tokave të reja. Ka formën e një «kmese» me një zgjatim në formë katérkëndëshi në pjesën e mbrapme, e cila shërbente, me sa duket për prerjen e rrënjjëve ose të ferrave dhe të bimëve të këqija. (Tab. XLVII, 12 (Tab. LXI, 2).

Pjesa e saj e poshtme përfundon me një bisht të zgjatur që futej në dorezën prej druri. Vegla éshëtë e thyer në pjesën e majës dhe në zgjatimin e pjesës së mbrapme. Gjatësia e ruajtur éshëtë 15,3 cm, kurse gjerësia e tehet éshëtë 2,6 cm.

Prototipat e kësaj vegle i gjejmë në materialin e periuudhës qytetare ilire dhe në atë të shekujve të parë të e.sonë, siç tregon një e tillë e gjetur në gërmimet e vitit 1973 të bëra në qytetin ilir të Antigonesë<sup>201</sup> dhe një kosore-sëpatë

199) S. Anamali, *Amantia..*, f. 91, Tab. III.

200) K. Ilona, *A. Császárkori fibulák fölformai Pannoniában*, Budapest, 1937, f. 97, Tab. XXXIV, 8.

201) Dh. Budina, *Antigonea...*, f. 294, Fig. 40, 3.

e gjetur në gërmimet e viti 1973 për zbulimin e teatrit antik të Apolonisë,<sup>202</sup> e datuar në shek. I të e.sonë. Shumë e përafërt është copa jonë edhe me dy veglat bujqësore të zbuluara në gërmimet e viti 1973 në gradishtën e Symizës,<sup>203</sup> që datohen në kohën antike të vonë (shek. IV-VI të e.sonë).

Duke marrë parasysh shtresën kulturorë dhe materialin arkeologjik me të cilin ajo është gjetur në gërmimin tonë, me qeramikë dhe monedha të kohës së vonë antike; jemi të prirur të shohim si kohë të prodhimit dhe përdorimit të saj, gjithashtu kohën antike të vonë. Në një formë të ngjashme kjo vegël ka vazhduar të përdoret dhe më vonë, madje deri në ditët tona në disa krahina të Shqipërisë Juglindore ku në gjuhën e popullit njihet me emrin «çelikan».<sup>204</sup>

Në pajisjet e kuzhinës bëjnë pjesë mbi 20 thika që ruanjë një gjatësi prej 10,5 cm -17 cm ose bicakë prej hekuri 8,5 cm -10,5 cm të gjatë, një thikë ksistër dhe një lugë hekuri e fragmentuar (Tab. XLVI, 2, 5, 6, 9, 10; Tab. XLVII, 7, 11, 13-16; Tab. LXI, 1, 3, 5, 7; Tab. LXII, 1-8).

3. *Thikë-ksistër*, me një dorezë që formohet nga një bosht me prerje katërkëndëshi. Në njerin skaj të dorezës është thika me fletën jo shumë të gjatë, afersisht 2,85 cm, pak e thyer në pjesën e majës dhe në anën tjetër ajo zgjerohet në formë elipsi të sheshtë me njëren anë të drejtë në pjesën e prefses. Gjatësia e përgjithshme e objektit është 20,5 cm, gjerësia e tehut të thikës 1,7 cm, gjerësia e ksistrës 5,8 cm, ndërsa gjatësia e saj 6,6 cm. Gjatësia e dorezës 9 cm (Tab. XLVI, 11); Tab. LXI, 4).

Kjo lloj vegle ka qenë përdorur me sa duket për të kthyer dhe për të prerë bukën në furrë ose për të kruar magjen ku ajo gatuhej. Vegla të tillë kanë qenë në përdorim deri vonë nëpër fshatra për të njëtin qëllim dhe njihen në gjuhën e popullit me emrin ksistër.

Analogjinë më të përafërt të këtij objekti e gjemjë në një objekt prej hekuri të zbuluar në sterën nr. 1 të gradishtës të Symizës dhe të datuar në fund të periudhës të vonë antike (shek. VI)<sup>205</sup>, kohë së cilës mendojmë se duhet t'i takojë edhe

202) A. Mano, *Rezultatet e kërkimeve për zbulimin e theatrit antik të Apolonisë*, Tiranë, 1971, f. 97, Tab. III.

203) Gj. Karaiskaj, *Gradishta...*, f. 183, Tab. XIV, 6, 7.

204) Po aty; f. 183.

205) Po aty, f. 184, Tab. XV, 1.

copa jonë sipas materialit arkeologjik me të cilin ajo shqerohet.

4. *Lugë hekuri* jo shumë e madhe, me sa duket e përdorur në guzhinë pér të trazuar ushqimin gjatë përgatitjes. Është pothuajse e sheshtë pa konveksitet. Ruhet në një gjendje mjaft të oksiduar. Gjatësia e ruajtur është 8,5 cm (Tab. XLVI, 3; Tab. LXI, 6).

5. Thikë hekuri me dorezë të gjatë dhe të drejtë të kthyer në formë laku në pjesën e sipërme pér tu varur. Ka pjesën e prefshes 2,5 cm të gjerë dhe të thyer në majë. Me sa duket edhe kjo vegël bën pjesë në pajisjet e guzhinës dhe si kohë duhet t'i takojë sëbashku me objektet e mësipërme, antikitetit të vonë. Është e gjatë 19 cm. (Tab. XLVII, 17; Tab. LXI, 8).

6. Në objektet prej hekuri mund të radhisim edhe një objekt tjeter me një bosht me prerje rrethore në njérën anë të brimuar dhe me një pllakëz katërkëndëshe të hapur në anën tjetër. (Tab. XLVII, 18; Tab. LXIV, 3) që mund të ketë shërbyer si mençeshë dyersh apo dritaresh. *Copa* jonë është shumë e ngjashme me një të tillë të zbuluar në *Gradishtë* e Symizës<sup>206</sup>, dhe të datuar me materiale të shek. IV-VI të e.sonë. Shtresës kulturore të kohës antike të vonë në pikën B i përkasin edhe 15 copë rruaza prej balte të pjekur. Kanë forma të ndryshme cilindrike, bikonike dhe sferike me mbizo-tërimin e këtyre të fundit (Tab. XLVI, 4, 12, 13, 16; Tab. XLVI, 4-6, 10; Tab. XLVIII, 1-8; Tab. LV, 8-14). Zakonisht janë të thjeshta dhe rrallëherë të lyera me serë. Kanë përmasa të ndryshme. Diametri i shumicës së tyre lëviz nga 2,1 cm -2.7 cm, me diametrin e brimës që shkon nga 0.5 cm -1 cm. Lartësitë e tyre nuk i kalojnë 2,1 cm. Rruaza të tillë, veçanërisht ato me përmasa më të mëdha mund të janë përdorur edhe si rrotulla boshti. Si të tillë ato janë të njoitura edhe nga qendërbanime të tjera të kohës antike të vonë si Kanina. Pogra-deci<sup>207</sup> etj.

Gjatë gjermimeve të vitit 1973 në pikën A, midis qeramikës së kohës antike të vonë janë gjetur edhe disa rrotulla boshti formash të çrrëgullta të përgatitura nga funde e pa-

206) Gj. Karaiskaj, *Gradishta...*, f. 184, Tab. XV, 9, 10.

207) S. Anamali, *Kështjella...*, f. 230, Tab. IV, 1, 2, H. Spahiu,

D. Komata, *Shurdhahu-Sarda*, *Qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar, «Iliria» III, 1974, f. 276, Tab. V.*

rete enësh të rixjerra jashtë përdorimit dhe copa tjegullash. Janë gjetur midis tyre edhe copa të papërfunduara, ku duken qartë gjurmët e goditjes në pjesët e mesit për hapjen e vrimës të rrotullës (Tab. VI, 16-17).

Rrotulla boshti të përgatitura nga funde ose parete enësh të dala jashtë përdorimit janë gjetur edhe në gërmimet e bëra në kalanë e Shurdhahut<sup>208</sup>.

## 5. MONEDHA TË KOHËS ANTIKE TË VONË (SHEK. IV-VI)

Bizantine

Arkadi (395-408) (Tab. LXVIII, 1)

1. AE ↓ F.DN. ARCADIVS. PF. AVG. Busti me diademë i Arkadit në profil djathtas.

Shp. Legjenda mj. pothuajse e palexueshme. Perandori në të mj. me kokën e kthyer dj., mbështet një palmë përbimë shpatullën e dj. dhe me dorën tjetër tërheq prej flokësh një rob lufte. Në fushë mj. Monogrami i Krishtit, në segment nuk shihet gjë.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1973 në pikën C.

P=1,08 gr. D=15 mm.

Konstanti III (tirani -407 -411) (?)

2. AE. — F. Legjenda rrethore e palexueshme. Busti me diademë i Konstantit në profil djathtas.

Shp. Legjenda rrethore e palexueshme. Konstanti me robe ushtarake qëndron në këmbë dj. mban një glob me nikelë në dorën e di. dhe një labarum në dorën tjetër.

Monedha është gjetur në pikën B.

P=1,24 gr D=14 mm.

3. AE. — Monedhë bronzi shumë e fshirë duket si nr. 2 (?)  
Eshtë gjetur në pikën B

P=1,04 gr. D=13 mm.

208) Po aty, f. 295, f. 296. Tab. V.

*Valentiniani III (425-455)* (Tab. LXVIII, 2)

4. AE F. Legjenda nga e majta në pjesën më të madhe e palexueshme. .... NIVS. P.F. AVG. Busti i tij me diademë në profil djathtas.

Shp. Kryq brenda një kurore të lauruar, në segment; CONOB ..... Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=0,81 gr D=13 mm.

*Anastasi (491-518)* (Tab. LXV, 6)

Follis

5. AE ↓ F.DN. ANASTASIUS AVG. Busti me diademë i Anastasit I në profil djathtas.

Shp. Shenja M nën një kryq mbështetet në të dy anët në dy yje: poshtë gërrma greke B dhe në segment; CON.

Monedha ëchëtë gjetur në gërmimet e vitit 1978 në pikën F, pranë harkut të rrëzuar, e shqëruar me fragmente të shumta enësh të kohës antike të vonë.

P=15,45 gr; D=33 mm.

*Justini I (518-527)* (Tab. LXV, 7)

Follis

6. AE ↓ F. Legjenda rrethore shumë e fshirë. Busti me diademë i Justinit në profil dj.

Shp. Shenja M nën një kryq rrethohet majtas nga një yll dhe djathtas nga një kryq poshtë gërrma greke Δ dhe në segment; CON. .... Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1973 në pikën C.

P=1,666 gr; D=28 mm

7. AE ↓ F. Legjenda rrethore pjesërisht e lexueshme... DN:[IVSTIN] VS.PP. AVG. Büsti me diademë i Justinit I në profil djathtas.

Shp. Shenja M nën një kryq rrethohet në të dy anët nga dy yje, poshtë një gërmë greke Γ, në segment më sa duket [CO]N.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1978 në pikën C.

P=14,37 gr. D=29 mm.

Justiniani I (527-465). (Tab. LXVI, 1).

Follis

8. AE ↓ F.DN. IVSTINIANVS. PP. AVG. Busti me përkrenarë i Justinianit I përballë, me mburojë, mban globin e kryqëzuar në dorën e dj. përmbi supin e majtë. Në fushë një kryq.

Shp. Shenja M nën një kryq majtas ANNO në katër rreshta vertikalë, djathtas në dy rreshta nën shenjën e vlefteks B dhe në segment: CON.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1975 në pikën D.

P=21,63 gr. D=40 mm.

Pentanumia

9. AE ... Në faqe dhe në shpinë monedha është shumë e fshirë, me sa duket një pentanunimia e Justinianit.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1978 në sektorin e Portës, së bashku me shumë fragmente qeramike të kohës antike të vonë.

P=0,41 gr. D=0,80 mm.

Justini dhe Justiniani, I (527)? (Tab. LXVI, 2)

Follis

10. AE ↓ F. Legjenda rrethore në pjesën më të madhe e palexueshme: DN. IV [STIN ET IVSTINIANVS. AV.] Busti me diademë i Justinianit I, në profil djathtas.

Shp. Shenja M nën një kryq, majtas një yll, djathtas një kryq, poshtë, me sa duket gëрма greke B e prerë nga një brimë e hapur më vonë, në qendër të monedhës, kur me sa duket ka shërbyer si medaljon. Në segment: CON që mezi dallon.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1975 në pikën D.

P=14,85 gr D=30 mm.

Justini II dhe Sofia (565-527) (Tab. LXVI, 3)

Gjysmëfollis

11. AE ↓ F. Legjenda rrethore e palexueshme. Dy perandorët me brerore qëndrojnë ulur përballë, midis kokave të tyre një kryq.

Shp. Shenja K nën një kryq dj. dhe mj. nuk shihet gjë, monedha është e prishur.

Monedha është gjetur rastësisht gjatë pastrimit të dheut në gërmimet e vitit 1975 në pikën D.

P=5.58 gr. D=18 mm.

\* \* \*

Qyteti i fortifikuar i Beratit hyn në grupin e atyre qyteteve e kështjellave iliro-arbërore, që sikurse Skodra, Lisi, Aulona, Hadrianopoli, Onhezmi etj., duke kapërcyer dhe përbaluar krizën e rendit skllavopronar të shek. IV të e.sonë, falë pozitës së tyre gjeografike pranë rrugëve të rëndësishme tokësore e detare, mbetën qytete të rëndësishme zejtare-tregtare edhe në kohën antike të vonë.

Kriza e rendit skllavopronar, dyndjet e popuje të shek. V-VII të e.sonë me pasojat e tyre e bënë të domosdoshëm. si në shumë qytete e kështjella të provincave bizantine, edhe në qytetin e fortifikuar të Beratit rindërtimin e mureve rrethuese ekzistuese. Këtë domosdoshmëri e tregojnë, sikurse e vemë në dukje mësipër, edhe burimet e shkruara të periudhës së hershme bizantine, në të cilat qytetin e fortifikuar të Beratit e ndeshim me emrin Antipagrai p.sh. tek. Prokopi i Qezaresë (shek. VI), në listën e fortifikimeve të Epirit të Rilë rindërtuara nga Justiniani I.<sup>209</sup> Në guidën «Synecdemua» (shoqërues udhëtimi) të Hieroklit (shek. VI) ai përmendet me emrin Polyheriopolis.<sup>210</sup>

Ngjashmëria e emrit, me ndonjë ndryshim të vogël, Antipagrai-Antipatreja, të dhënat e gërmimeve arkeologjike dhe pohimi i Prokopit lidhur me rindërtimet e bëra në këtë qytet na bindin të shohim në Antipagrain qytetin ilir të Antipatreas.

Shtresa kulturore e kohës antike të vonë duhet thënë, se lidhet në mënyrë organike me shtresën më të hershme.

Muret rrethuese të qytetit, gjurmët e rindërtuara të të cilave mundëm t'i kapim në disa pika të gërmimeve tona (ve-

---

<sup>209)</sup> Proc. Da Aedificis, IV, 4.

<sup>210)</sup> Hierocl. 8. XIII, 653, 6. Nga autorët e mëvonshëm Shufrait (M. Shufrait Stadt... f. 24), është i pari që duke u mbështetur tek prokopi e identifikon Antipagrain me Antipatrean, tezë, që merr të drejtë përkrahët nga A. Baçe (A. Baçe, Qyteti..., f. 47).

çanërisht të qarta ishin ato në pilastrin verior të portës kryesore) u vu re se ndjekin linjën e mureve rrethuese të periudhës qytetare ilire.

Për karakterin e banesave në kohën antike të vonë të dhënët e gërmimeve, megjithëse të kufizuara, tregojnë për ndërtimë të thjeshta. Ato kanë pasur planimetri katërkëndëshe të rrëthuar me mure gurësh të vegjël e mesatarë të lidhur me baltë. Materiali arkeologjik i gjetur në këto banesa (vorba, qypa drithi me shumicë dhe disa vegla bujqësore etj.) flet për karakterin më tepër bujqësor të ekonomisë së qytetit në këtë kohë.

Ajo që duhet vënë në dukje për qeramikën e kohës antike të vonë është reduktimi i formave dhe uniformiteti i saj.

Repertori i formave, në krahasim me periudhën pararendësë është më i kufizuar. Mbizotëruese janë vorbat, tasat, brokat e ndonjë kotruve a ojnohe. Megjithatë në trajtat e këtyre enëve, në veglat e punës (çelikanët, thikat, ksistrat) e deri në qarkullimin monetar të zhvilluar mbi bazën antike vihen re tradita të trashëguara nga periudhat e mëparëshme. Shfaqja në disa tipa enësh të tavolinës e teknikës së piktorimit me ngjyrë të kuqe tregon gjithashtu vijimësinë e elementeve të traditës nga qeramika e shekujve të parë të e.sonë.

Rindërtimet e bëra në sistemin e fortifikimit mbrojtës, lënda arkeologjike, e përbërë kryesisht nga qeramika, veglat e punës, ndonjë objekt stolie dhe monedhat bizantine të shek. IV-VI të gjetura në gërmim, në një numër jo të vogël (14 copë) dëshmojnë për një rigjallërim të jetës ekonomike e kulturore në qytet në këtë kohë.



Me emrin Belgrad ai përmendet për herë të parë në tetën që Papa Mihali VIII i dërgon mbretit Boris (16 Prill 878) dhe del si seli peshkopale (Episcopatum Belgradi Albanensis).<sup>214</sup>

Në dokumentet e shkruarë të mesjetës së hershme dhe të mesme (shek. VIII-XV) qyteti përmendet me formë të ndryshme të të njëjtit emër. Belgradum (Belogradum, Bellogradum, Belligradum, Бељградъ, Бељграда)<sup>212</sup>, që sipas studiuesve i përgjigjen Beratit të sotëm. Në dokumentet e kësaj kohe ai njihet si qytet kështjellë, seli peshkopale dhe më vonë qendër vilajeti.<sup>213</sup>

Në bazë të burimeve historike qyteti përvjetor emrit Belgrad

211) Acta et diplomata Res Albâniae Mediae Aetatis, vol. II. Vindobonae, 1913, doc. 55, viti 878, 16 prillu Mës pohstë kjëoadë të jepet vëtëm shkurtimisht At Albjanës sëmundjeve sociale. — Inscritur in acta.

213) Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. Veli, 11, shek. VIII-XV, Tiranë, 1962. f. 384.

në shek. IX njihet dhe me emrin Pulheriopolis, që sipas studiuesve është Berati i sotëm, i cili në këtë kohë hynte midis nëntë qyteteve që bënin pjesë në konsiliarinë e Dyrrahionit.<sup>214</sup>

Që nga gjysma e dytë e shek. IX deri në v. 1018 kur thyhet rezistenza e fundit e bullgarëve në Shqipëri,<sup>215</sup> qyteti ka qenë nën sundimin e bullgarëve, por ai si shumë qytete të tjera të vendit bije përsëri në duar të Bizantit.

Diploma e viti 1019 e Vasilit II, kryepeshkopit të Ohrit, ku thuhet se Belgradit, që në këtë kohë ishte qendër peshkopale, i jepen në vartësi Gradeci, Omca, Glaventina dhe numri më i madh i bujqve parikë (40 parikë e 40 klerikë) dëshmon për rëndësinë e qytetit në këtë kohë si qendër peshkopale.<sup>216</sup> Kjo dhe diploma e viti 1020,<sup>217</sup> menjëherë pas shembjes së perandorisë bullgare, dëshmojnë për zhvillimin e marrëdhënieve feudale në shek. XI-XII në Shqipëri.

Në vitin 1258, midis disa kështjellave dhe vendeve të tjera në Arbëri, Belgradi i dorëzohet Manfred Hohenstaufenit, prindit të Tarentit nga despoti i Epirit Mihali II Engjëlli (1204-1216) si prikë për martesën e tij me bijën e këtij të fundit, Helenën.<sup>218</sup>

Sipas përshkrimit të Pahymerit (G. Pahymeres VI, 32 Origjinali greqisht) në vitet 1272-1281 në Belgrad (Berat) zhvillohet lufta midis anzhuinëve dhe bizantinëve, shkak i së cilës ka qenë një kryengritje e shqiptarëve kundër Perandorisë Bizantine, e cila u dha mundësi anzhuinëve të pushtojnë në vitin 1272 qytetin.<sup>219</sup>

Arbëreshët që banonin në afërsi të Belagritës, të identifikuar nga studiuesit me Beratin e sotëm, dhe Kaninës, sipas përshkrimit të Kantakuzenit (I Kantakuzenos II, origjinali greqisht 32,34) në vitin 1336 kishin shkelur qytetet e atje-shme<sup>220</sup>. Është fjala për inkursionet e shqiptarëve kundër qyteteve të pushtuara në këtë kohë nga Bizanti.

214) Burime të zgjedhura..., f. 27.

215) Burime të zgjedhura..., f. 20-30; Historia e Shqipërisë, vell. I, Tiranë, 1959, f. 162-164.

216) A. Alb. ..., f. 15 (Doc. 58) v. 1019.

217) Burime të zgjedhura..., f. 66.

218) A. Alb. ..., f. 71, nr. 246.

219) K. Bozbori — F. Lico, *Burime tregimtare bizantine, për Historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, Tiranë 1975, f. 200-203; Burime të zgjedhura, f. 105-107.

220) Burime tregimtare..., f. 223.

**Në vitin 1345** dy vjet pas pushtimit të Krujës, qyteti i Belgradit (Berati) pushtohet nga Stefan Dushani.<sup>221</sup>

Pas marrjes së Krujës (v. 1415), Vlorës dhe Kaninës në vitin 1417, po atë vit duke përfituar nga përcarja e thellë feudale turqit pushtuan Beratin.<sup>222</sup> Nga përshkrimi i betejës së vitit 1455 të Beratit dhe përparësia që i jepnin atij pushtesit kuptojmë se Berati ishte në këtë kohë një nga qytetet më të rëndësishme të fortifikuara të sanxhakut të Shqipërisë.<sup>223</sup>

## 2. MURET RRETHUESE MESJETARE

Gjurmë të murit rrighthes të periudhës mesjetare paraturke në pikën B nuk mundëm të kapim. Me sa duket në këtë pjesë të qytetit ai ka qenë rënuar dhe muret rrighthuese, të mëvonshme, të periudhës së pushtimit turk, duket se janë ngritur përmbi gjurmët e murit të kohës së vonë antike e vende-vende drejtpërdrejt mbi blloqet e murit të periudhës qytetare ilire. (Fig. 39). Muri mesjetar në pikën C është ndërtuar prej gurësh me përmasa të vogla dhe mesatare të vendosura pa ndonjë kriter të caktuar. Gurët kanë faqet e tyre ballore deri-diku të punuara (Fig. 40). Si lidhës është përdo-rur një llaç i bollshëm gëlqeror me shumë mbushës (rërë dhe guralecë lumi) me ngjyrë të përhimtë. Muri mesjetar në këtë pikë në përgjithësi ruan trashësinë e murit të periudhës qytetare ilire, gjë që vihet re edhe në korridorin e brendshëm të hyrjes kryesore, në atë të anës së majtë, i cili është térhequr pak më brenda. **duke lënë** të pambuluar disa nga blloqet e murit të lashtë, të cilat këtu formojnë një farë shkallëzimi, një vend të përshtatshëm për truprojat që mbronin hyrjen e kështjellës.

Muri që ngrihet përmbi vetulloren në pikën D është i ndërtuar prej gurësh gëlqerorë me trajta të çrrëgullta me përmasa të vogla dhe mesatare. Fugaturat midis gurëve janë zënë me copa tullash e gurësh gëlqerorë të thyer. Lidhja e gurëve është bërë me llaç të një cilësie jo shumë të mirë. (Fig. 31). Ky mur i kohës antike të vonë, si tregon materiali arkeologjik,

221) Historia e Shqipërisë..., f. 209.

222) Burime të zgjedhura... f. 199.

223) Po aty., f. 315-316.




Fig. 39.

ka vazhduar të përdoret edhe në mesjetën e hershme, Për sa i përket materialit ndërtimor dhe teknikës së ndërtimit ai është shumë i ngjashëm me murin e rindërtuar në mesjetën e hershme të kullës nr. 1.<sup>224</sup>

Gjatësia e përgjithshme e zbuluar e tij është 4,60 m. Muri është i lartë 3,40 m dhe i trashë 0,83 m, që së bashku me gjerësinë e murit të vonë mesjetar arrin në 1,80 m trashësi. Në qoshen juglindore të kuadratit, në një lartësi prej 0,70 m nga shtroja e llaçit, u gjet një kamare jo shumë e rregullt, me përmasa  $0,42 \text{ m} \times 0,28 \text{ m}$ , e cila në brendësi të saj vjen duke u ngushtuar dhe të lë përshtypjen e ndonjë frengje, sot të zënë me dhe.

Për nga mënyra e punimit dhe materiali i ndërtimit mu-

---

224) A. Baçe, Qyteti..., 49, Tab. III, 3. (sipas emërtimit të A. Baçes).




Fig. 40

ret mesjetare të kalasë së Beratit afrojnë me muret rrrethuese  
të kalasë së Shurdhahut, sidomos me ato të pikës A.<sup>225</sup>

Në anën perëndimore të murit perimetral në pikën E,  
(Fig. 41) ngjitur me faqen e brendshme të murit të vogël me-  
sjetar, (Fig. 42 a-b, nr. 1) 0,43 m nën sipërfaqen e tokës, u  
zbulua një mur i dytë me drejtim veri-jug, me gjatësi 4,66 m,  
lartësi të ruajtur 1,96 m dhe trashësi 2,50 m (Fig. 42 a),  
të ndërtuar me gurë madhësish të ndryshme  
nr. 2). Muri është i ndërtuar me gurë madhësish të ndryshme  
0,9 m x 0,25 m x 0,32 m; 0,25 m x 0,15 m. (Fig. 43, 44).  
Ata kanë trajta të ndryshme dhe janë të lidhur midis tyre  
me llaç gëlqeror të një cilësie të mirë që përmban sasira të  
bollshme mbushësi (rërë e përzier me zaje lumi).

225) H. Spahiu, — D. Komata, *Shurdhahu...*, f. 263; 312-313.

PLANIMETRI E SEKTORIT 'E.






Fig. 41

SEKTORI E

PREDJA B-B



FRAGMENT FASADE (façade e fragment)



0 100 CM

Fig. 42




Fig. 43

### 3. NDÉRTIME TË TJERA

Në qoshen jugperëndimore të këtij kuadrati 0,92 cm nën murin nr. 2 u zbulua një kanal i ndërtuar me pllaka me gjatësi 3,15 m dhe i gjerë 0,70 m që mesa duket shërbente për shkarkimin e ujërave. (Fig. 44, 45).

Nën këtë mur, në thellësinë 2,40 m, dolën gjurmët e një muri të tretë (Fig. 42 a nr. 3) 3,40 m të gjatë, 1,09 m të lartë dhe rrëth 1 m të trashë që, me sa duket, ka shërbyer si mur mbështetës. Ai është ndërtuar me gurë trajtash të çrrëgullta me përmasa të vogla e mesatare, të lidhur midis tyre me baltë të verdhë (vapem) dhe ka shumë mundësi që t'i përkasë mesjetës së hershme. Duke llogaritur këtu edhe trashësinë e dy mureve të mëparshme del se trashësia e përgjithshme e murit të periudhës mesjetare ka qenë 2,35 m.

Sic shihet, në kohën antike të vonë dhe në mesjetë, në të dy këto pika (D dhe E) vihet re se muret e ndërtuara rish-



Fig. 44. - A view of the hillside where the remains of the ancient city of Bet She'an were found.




Fig. 45

tas apo të rindërtuara ndjekin kudo po atë vijë që kanë pasur muret rrethuese të periudhës qytetare ilire.

Gjatë gërmimeve të vitiit 1974 pranë murit rrethues në pikën B u zbuluan dy puseta ose siç janë quajtur ndryshe «vrima drithi» (Fig. 46, 47).

1. E para u gjet në thellësinë 1,20 m në kuadratin e IV të pikës B (Fig. 48). Ka pjesën e poshtme në formë cilindrike dhe të sipërmen në trajtën e një kubeje të cunguar. Është e ndërtuar me gurë të papunuar përmasash mesatare, të lidhura midis tyre me llaç balte në ngjyrë të verdhë (vapem), midis të cilëve janë futur copa tjegullash mesjetare. Faqet e brendshme të pusëtës janë suvatuar me një llaç të dobët hidroizolues, që përmban sasira të bollshme rëre me copa gëlqereje të pashuar. Faqja e brendshme e pusëtës dhe tabani i saj janë sheshuar mirë me mistri. Në lartësinë 0,60 m nga tabani i tokës nis ngushtimi i pjesës së sipërme të pusëtës, që përfundon me një grykë në formë katërkëndëshi të kufizuar anash nga katër pllaka guri shtuf, të cilat shër-




Fig. 46

SESTRIERI 6  
PREFIA A.A.

Fig. 48





Fig. 47



benin përmbylljen e saj. Brenda në pushtetë nuk u gjet asnjë objekt që të mund të ndihmonë sados pak si përcaktimin e saktë të kohës së ngritjes ashtu edhe përfunksionin e tij. Megjithatë teknika është ndërtimit dhe fakti që ajo duke prekur shtresat kulturore të periudhës së pushtimit romak dhe antik të vonë arrin deri në shtresën kulturore të mesjetës, së hershme tregon se i përket kësaj të fundit.

Puseta është 1,65 m e lartë, me një diametër e bazës 0,40 m × 0,60 m dhe atë të grykës 0,40 m.

2. Pranë murit rrighthues të periudhës qytetare ilire, në kuadratin III, në një distancë prej 13,30 m nga puseta, është gjithashtu 1,46 m në të njëjtën shtresë me puseten e parë u gjet një pusete tjeter shumë e ngjashme me të (fig. 49). Ajo




Fig. 49

ështe e ndërtuar me gurë të vëgjël të lidhur gjithashtu me adhuraç baltë në ngjyrë të verdhë dhe me pak përzierje gëllqereje.

Ndryshe nga puseta e parë në pjesën e sipërme të saj janë përdorur dy rreshita tullash me trashësi 0,06 m, që dalojnë për një pjekje të dobët. Në pjesën e poshtme të tabanit vihen re gjurmët e një shtroje nga e njëjta baltë me të cilën janë lidhur gurët. Gryka e rrumbullakët e pusëtës

mbyllej, sikurse në rastin e pusetës nr. I, nga disa pllaka guri shtuf, me përmasa të vogla dhe mesatare formash të çrrregullta.

Lartësia e pusetës është 1,90 m, diametri i bazës 0,90 m dhe i grykës 0,40 m x 0,34 m.

Duke u nisur nga mënyra e ndërtimit të kësaj pusete, mungesa e suvatimit dhe prania në afërsi të saj e disa mbeturinave të drithit të karbonizuar (Fig. 28) jemi të prirur të shohim këtu një «vrimë drithi» ose «grëpë drithi», të cilat në popull njihen me emrin havanë ose puse të thata dhe shërbenin për ruajtjen e drithit. Ndoshta e tillë duhet të ketë qenë edhe puseta nr. I. Puse të tilla janë njojur edhe në vende të tjera si në Serbi, Maqedoni e Mal të Zi<sup>226</sup>.

#### 4. QERAMIKA MESJETARE (SHEK. VII-XV)

Periudhës së parafundit në këtë qytet, asaj mesjetare paraturke i takon shtresa e pestë kulturore, që kronologjikisht i përket shekujve VII-XV të e.sënë. Karakteristikë kryesore për këtë shtresë është mbizotërimi i qeramikës mesjetare, i materialit ndërtimor shumë të fragmentuar (kryesisht tje-gulla), i fragmenteve të enëve prej qelqi i pajisjeve të disa orendive shtëpiake dhe i një sasie të konsiderueshme monedhash bizantine të shek. XI-XIV.

Në fillim të kësaj shtrese kemi veçuar disa fragmente enësh që kronologjikisht duket se lidhen me periudhën e mesjetës së hershme, shek. VII-IX madje disa prej tyre mund të shkojnë edhe në shek. X.

Pjesa më e madhe e tyre riprodhojnë enë të kuzhinës; kryesisht vörba, vetëm një pakicë u përkasin enëve të ujit, të tavolinës, si broke, kotruve, ibrikë, amforiska ose shtamba.

A. Enët e tavolinës. Janë përgatitur nga një argjilë relativisht e pastër ngjyrë okër në rozë. Pjekja e mirë dhe uniforme.

226) A. Deroko, *Stednëvjejkovni Gradovi u Stbirii Çrnio Gora i Makedonii*, Prosveta 1950, f. 87, fig. 75.

## 1. Kupë.

Në qeramikën e kësaj nënshtrese të tërheq vëmendjen e vetmja enë e plotë e zbuluar në gërmimet e bëra në rënijat e këtij qyteti (Tab. LIX, 2). Është një kupë e vogël e punuar prej një argjile ngjyrë okër në rozë që përmban në përzierje grimca siliciumi. Ka trup të fryrë sferik me buzë që hapen në formë strehe dhe me një vegjë petullicë, që del nga nën buzët dhe mbështetet në mesin e barkut. Ena qëndron mbi një fund të sheshtë që veçohet qartë nga trupi i saj. Është e lartë 10 cm me diametrin e grykës 8 cm, të barkut 9,5 cm dhe të fundit 5,5 cm. Kjo kupë është e ngjashme me një kupë të gjetur në varrezat arbërore të Krujës që i takon shek. VI-VIII të e.sonë,<sup>226/1</sup> kohë së cilës duhet t'i takojë dhe kupa jonë.

2. Kotruve. Nga disa fragmente kotruveje ku ruhet fundi i plotë me një pjesë pareti ose pjesë gryke shohim se enët e këtij lloji kanë pasur trup sferik më të fryrë në pjesën e barkut dhe fund të sheshtë, qafë të lartë, grykë të gjërë në trajtë hinke dhe buzë të sheshta paksa të shpërvjela nga jashtë (Tab. XXVI, Tab. XXIX, 8).

Mbi sipërfaqen e tyre shihen zbukurime spiralesh që ndjekin njëra tjetër duke ardhur rreth e përqark enës të bëra me pikturnim para pjekjes me ngjyrë kafe gështhenjë që nuk është gjithkund njëlloj. Prania e këtyre motiveve edhe në disa fragmente të tjera tregon se ato në disa raste zbukuronin krejt sipërfaqen e enës gati deri afér fundit (Tab. XXIX, 7, 8, 9).

3. Një pjesë pareti me gjurmët e lëfytit i përket me saduket një éne të tipit ibrik. Sipërfaqja e enës pak e shkël-qyeshme, është e lyer me një shtresë të hollë lymi balte.

4. Broka. Nga brokat janë mbledhur më të shumtën fragmente paretesh. Ato janë shumë të copëtuara dhe prej tyre nuk mund të riprodhohet forma e përafert. Paretet janë relativisht të holla. Disa kanë qafë të gjatë e grykë të gjërë në formë hinke, me buzë të trashura dhe të rrumbullakuara në skajet pak të anuara nga brenda ose të shpërvjela nga jashtë në formë strehe.

<sup>226/1/</sup> S. Anamali — H. Spahiu, Varreza e hershme mesjetare e Krujës, B.U.SH.T. Seria shkencat shqërore Nr. 12, 1963, fq. 25, Tab. VI, 11.

a/1 Dallohen në mes tyre një fragment brokë më grykë të gjerë, që vjen duke u ngushtuar nga poshtë, me buzë të sheshta më seksion drejtkëndor dhe me një vegjë petullicë që zhë vend nën buzën e enës. (Tab. XXVIII, 3). Në pjesën e sipërme të vegjës, gati në mesin e saj është pikturuar me bojë të kuqe hë kafe një vijë gjatësore jo shumë e trashë.

a/2 Brökë më grykë në trajtë hinke më disa profilime të lehta nën buzë, me paretin e jashtëm. Buzët janë të drejtë me seksion si sqep zogu (Tab. XXVIII, 2).

Ajo që bie në sy në këto enë janë zbulurimet mbi si-përfaqen e tyre, të realizuara me pikturim me bojë të kuqe ose kafe gështhenjë.

Motivi më i shpeshtë janë spiralet që ndjekin njëra tjetrën të vendosura në shpatullat e enës dhe rrëth e qark barkut të saj. (Tab. XXIX, 7-9). Motive shumë të ngjashmë të bëra me pikturim me ngjyrë të kuqe janë të njoitura në qeramikën me pikturim me vnik të kuq të periudhës qytetare ilire të këtij qyteti (gjysmës së I të shek. III p.e.sonë) dhe në qytete të tjera ilire, çka tregon për përsëritjen e traditës së pikturimit nga periudhat e mëparshme.

Motive të tjera të bëra me pikturim para pjekjes janë rozeta ose vijat rrezore e spirale (Tab. XXIX, 1) rrathët ose gjysmërrathët që ndjekin apo ndërpresin njëri tjetrin (Tab. XXIX, 4-8).

Zbulurime prej vijash spirale të stërgjatura, në formë rrjete apo rrëkesh e njollash amorfë të bëra me ngjyrë të kuqe në kafe mbajnë edhe disa parete enësh (Tab. XXIX, 2-5).

Në këtë qeramikë, në realizimin e këtyre motiveve vihet rë vazhdimi i truditave të lashta të pocërisë vendëse të shekujve të parë të e.sonë. Trajtëni dhe mënyrën e pikturimit të këtyre enëve me ngjyrë të kuqe e ndeshim në enët prej balte të varrezës arbërore (shek. VI-VIII) të Krujës, të Bukturit dhe të Lezhës etj.<sup>227</sup>

Qeramika e piktuar me ngjyrë të kuqe ka ngjashmëri edhe me qeramikën prej argjile të verdhë të piktuar të zbuluar në bazilikën e Linit dhe në kështjellën e Pogradecit, të datuara në shek. VII-VIII të e.sonë.<sup>228</sup>

<sup>227)</sup> S. Anamali-H. Spahiu, Vatreza arbërore e Krujës, «Iliria», IX-X, 1979-1980, f. 57; E. Prendi, Një varrezë e kulturës arbërore në Lezhë, Po aty, f. 139.

<sup>228)</sup> S. Anamali, Kështjella..., f. 228-229, Tab. XVI, 10-20.

Një dukuri e tillë nuk është e rastit, por vihet re edhe gjetkë, jashtë territorit tonë, në vise të tjera të Ballkanit. Duke folur për qeramikën me zbulurime me ngjyrë të kuqe të epokës së hershme feudale të zbuluar në vendbanimin e Kapidavas (Rumani) R. Floresku, vë në dukje se procesi i zbulimit me ngjyrë të kuqe duket gjatë periudhës së fundit të epokës romake (shek. IV) dhe përhapet pastaj tek popullsia mesjetare.<sup>229</sup>

### B. Enët e kuzhinës

Vorbat janë përgatitur nga një argjilë jo shumë e pastër që përmban në përzierje grimca gurësh gëlqerorë të shtypur, që dalin në sipërfaqe. Ngjyra e pjekjes është kafe në të zezë ose pak si në të kuqërrremtë me gjurmë zjarri. Disa prej tyre zbulurohen në sipërfaqe, kryesisht në shpatullat e enës me tufa vijash të drejta paralele ose via të valëzuara qarkuese që altenohen, të bëra me incizim para pjekjes gjatë rrrotullimit të enës në çarkun e poçarit. Diametri i grykës shkron nga 11 cm-16,8 cm.

Disa fragmente enësh, sipas rindërtimit grafik të formës së tyre riprodhojnë: vorba me trup vezak, me trup të fryrë sferik dhe vorba me trup gati cilindrik, ku në secilin grup vërehet një numër i madh variantesh (Tab. XXXII).

#### Tipi I

a/1 Vorbë me trup vezak me buzë gjysmë të hapura dhë të prera pjerrëtas nga jashtë më daljen këndore. Zbulohet në shpatulla me kanelyra të cekëta horizontale.

#### Tipi II

b/1 Vorbë me trup të fryrë sferik me qafë jo shumë të lartë cilindrike dhe buzet e drejta me seksion katërkëndëshi (Tab. XXXII, 5).

b/2 Vorbë me qafë të lartë, që hapet në formë hinke, më buzët e drejta; që hapen nga jashtë (Tab. XXXII, 18; Tab. LIX, 4).

<sup>229)</sup> K. Florescu, *Unele observații în privire la ceramica decorata cu culuare rosie din acezarea tirzie de la Capidava* në S.C.I.V., 1, 1958.

b/3 Vorbë me buzë të hapura nga jashtë me seksion elipsoidal (Tab. XXXII, 19).

b/4 Vorbë me qafë të lartë gati cilindrike dhe buzë pak-sa të anuara nga jashtë, që hollohen në drejtim të skajeve. (Tab. XXXII, 15).

b/5 Vorbë me buzë shumë të shpërvjela në formë hirke dhe të prera vertikalish nga jashtë (Tab. XXXII, 2).

### Tipi III

Vorbat me trup pothuajse cilindrike janë shumë të rra-lla. Kanë buzët e shtrira horizontalisht nga jashtë me sek-sion katërkëndëshi (Tab. XXXII, 13). Këto lloj vorbash si nga teknologjia e prodhimit, format dhe dekuracionet afrojnë shumë me qeramikën e mesjetës së hershme të zbuluar në kalanë e Shurdhahut, në atë të Durrësit e rrëthinës së tij etj.<sup>230</sup>

Ato i ndeshim edhe në varrezën tumulare të Rehovës (rrëthi i Kolonjës) ku gjenden të shoqëruara më materiale të datuara në shek. VII-IX të e.sonë.<sup>231</sup> Jashtë territorit tonë ato janë gjetur edhe në gërmimet në vendbanimin mesjetar të Veresegjhazit-Hungari<sup>232</sup> ku është datuar në shek. IX-X.

Në enët e ujit të kuzhinës që i përkasin kësaj periudhe janë gjetur edhe fragmente enësh (broka) me grykën triullukëshe në formën e gjethit të têrfillit (Tab. XXXII, 1, 3). Janë përgatitur nga një argjilë jo shumë e pastër, që përmban në përzierje grimca siliciumi dhe thërmija tullash e gurësh gëlqerorë të bardhë që dalin në sipërsaqe. Ngjyra e pjekjes kafe e kafe në të kuqërrëmitë me gjurmë zjarri. Ky tip ene ka një origjinë mjaft të lashtë. Enë mjaft të ngjashme me këto janë gjetur në varrezat arbërore të Krujës, Bukturit dhe të Lezhës, të datuara me materiale të shek. VI-VIII të e.sonë.

230) H. Spahiu, D. Komata, Shurdhahu..., f. 294-295, Tab. I-X; A. Hoti, *Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrëthit të Durrësit, «Iliria», 1/1987, f. 256, Tab. VII, 3, 5.*

231) S. Aliu, *Varreza mesjetare në tumën e Rehovës, «Iliria» 2/1986, f. 230-231, Tab. III, V, 47, 52, 53.*

232) K. Mesterhazy, *Településasatas Veresegyház-Ivácsón* në «Comunicaciones Archaeologica Hungarica» 1983, f. 153.

## A. Enët e zbuluarar të tavolinës. (Shek. XII-XIV)

Në qeramikën e kësaj shtresë një vend të rëndësishëm zenë enët e dekoruara të tavolinës, enët me smart, fragmëntet e të cilave ndëshen rëndom të shqëruara gjithmonë me qeramikën trashanike të kuzhinës. Kjo qeramikë ka dalë pa përashtim në të katër fushat e gërmimeve të bëra në këtë qytet, por në pjesën më të madhe të saj ajo është zbuluar në gërmimet e vitiit 1974-1975 në pikat B dhe D.

Pa hyrë në hollësitë e teknologjisë së prodhimit të kësaj qeramike, do të japim më poshtë karakteristikat e përgjithshme dhe klasifikimin e saj sipas grupeve apo nëngrupeve të veçantë që vihen re në serinë e këtyre enëve.

Qeramika e tavolinës është përgatitur prej një argjile të pâstër që përimbani grimca siliciumi. Pjekja është e mirë. Ngjyra e baltës pas pjekjes në pjesën më të madhe të saj është e bardhë në ngjyrë okër dhe rozë. Kanë në përgjithësi një fakturë të lëmuar dhe dallojnë për një punim të mirë. Ato janë të lyera pa përashtim me smart. (Tab. LXXXIII-LXXXV). Megjithëse kjo qeramikë ka arritur dëri tek ne shumë e copëtuar, jemi përpjekur të veçojmë në të disa kategoritë njerëz të hapura si kupa, tasa, pjata, pjataanca dhe enë të myllura si broke, kotruve dhe ibrikë.

Kupat kanë në përgjithësi përmasa të vogla e mesatare dhe diametri i tyre nuk i kalon të 16 cm. Prej tyre janë mbledhur kryesisht buzë, ndonjë paret dhe shumë rrallë pjesë fundesh.

Sipas përmasave të tyre kupat i kemi ndarë në dy grupë:

1. Në grupin e parë kemi përfshirë kupat me përmasa të vogla. Një pjesë e tyre kanë trup në trajtë kësule gjysmësferike dhe buzë paksa të mbledhura nga brenda, më seksion faszileje, kupat me krejt trupin në formë hinke (Tab. XXXVII, 13) ose vëtem pjesën e poshtme (Tab. XXXVII, 7, 9) e më buzë pak të hapura nga jashtë me skaje të rrumbullakuara dhe ngandonjëhërë të pajisura me një vijë të thelluar qarkuese të bërë gjatë rrrotullimit të enës në çarkun e poçarit. (Tab. XXXVII, 11).

2. Disa kupa të tjera dallojnë nga të parat nga forma e trupit, gjysma e poshtme e të cilat ka trajtën e një këstulle gjysmësferike dhe e sipërmja cilindrike me buzët e drejta (Tab. XXXIX. 3. 12) ose pak të mbledhura nga brenda me seksion sinusoidal ose katërkëndëshi, kjo e fundit dallon përpikturimin e saj me ngjyrë të kuqe (Tab. XXXVII, 6).

Midis kupave me trup në trajtë kësule gjysmësferike dalojnë disa fragmente që váriojnë në mes tyre nga profilimi i buzëve, të cilat në përgjithësi janë të sheshta në pjesën e sipërme, të rrumbullakuara ose me profilim sinusoidal në paratin e jashtëm (Tab. XXXIX, 1, 7, 9, 11).

Këto lloj kupash kanë fundin e sheshtë ose pak të gufuar nga jashtë dhe qëndrojnë mbi një këmbëz unazore jo shumë të lartë. Duke gjykuar nga dy fragmente kupash tek të cilat përvèç pjesës së buzës e paretit ruhet edhe një pjesë fundi, kemi mundur të kapim edhe lartësitë e tyre që nga 6 cm. shkojnë deri në 8,8 cm.

Ato janë zbukuruar anës buzëve me motive të ndryshme si vargje gjysmëharqesh e vijash qarkuese (Tab. XLIII, 14) motive në formë hale pishe (Tab. LVII, 10; Tab. XLIII, 14) ose gërsheti prej 3-4 fijesh (Tab. XLIV, 11), vargje trekëndëshash të mbushur me motive në formë rrjete etj., të bëra me smalt ngjyrë kafe të errët në të zezë, të kuqe, të gjelbërt e blu mbi sfondin ngjyrë kremi të enës (Tab. XLIII, 15, 18). Motive të tjera që zbukurojnë buzët e këtyre kupave janë edhe vargjet prej s-sh të shtrira që ndjekin njëra tjetrën e që shpeshherë i gjejmë të kombinuara me njëra tjetrën (Tab. XXXVII, 10; Tab. XL, 10). Midis fragmenteve të kupave të tërheq vëmëndjen një kapak i fragmentuar, i zbukuruar në pjesën e sipërme me dekoracione plastike në formë këmbe kafshe. Kapaku është i lyer me smalt monokrom të gjelbër. (Tab. XLIII, 9).

Kupat me pikturim me smalt ngjyrë kafe gështenjë ose blu të bëra mbi biskotin e bardhë ose ngjyrë kremi të enës, janë më të hershme se enët prej argjile të kuqe.

Nga pikëpamja e brumit dhe e teknikës së aplikimit të zbukurimeve kjo lloj qeramike është shumë e ngjashme me enët protomajolike të zbuluara në qytetin e Durrësit<sup>233</sup> dhe rrëthet e tij<sup>234</sup> dhe që në përgjithësi është e njojur në disa qytete të Mesdheut<sup>235</sup>.

Janë gjetur gjithashtu në shtresën e mesjetës së mesme të

(233) Qeramika me glauzurën e gjetur në Amfiteatrin e Durrësit është e pabotuar. Ruhet në fondet e Muzeut Arkeologjik të Durrësit.

(234) A. Hoti, Ndihmës..., f. 251.

(235) A. Hoti, Pol. aty, f. 251, Shih dhe literaturën e cituar aty, përkohë problemi.

kështjellës së Kaninës, në geramikën sinkrone, të zbuluar në bazilikën e Ballshit, në atë të Arapajt<sup>236</sup> etj.

Tasat janë përgatitur nga njëja argjile dhe kanë po ato karakteristika që u thonë më sipër. Në kategorinë e tasave mbizoterojnë ato me trup në trajtë kësule gjysmësferike, që sikurë kupat e këtij lloji, paraqesin variante të ndryshme, sipas profilimit të buzëve në paretin e jashtëm të tyre (Tab. XXXVIII, 13; Tab. XXXIX, 8, 10, 13; Tab. XL, 1, 2; Tab. XXXVIII, 12, 13, 14).

a/1 Disa fragmente të tjera riprodhojnë tasa me trup në trajtë kësule gjysmësferike me buzë të rrumbullakuara, në të dy anët (Tab. XXXVIII 5, 9, 16; Tab. XXXIX 2, 5, 6, 12).

a/2 Tek ndonjë fragment tasi pjesa e poshtme e trupit afersisht ka formë kësule gjysmësferike dhe e sipërmja në trajtë cilindrike me buzët e rrumbullakuara në të dy anët. (Tab. XLIV. 1, 7, 8, 9).

a/3 Në tasat me trup në trajtë kësule gjysmësferike bie në sy një copë me dekoracione plastike në formë dhëmbëzash në paretin e saj të jashtëm dhe me një dalje në formë fletëze. (1866) Tab. XL, 2.

Janë zbuluar me smalt dy ngjyrash, me motive florale e gjeometrike si rrathë, harqe e vija të bëra me teknikën «sgrafito». Ngjyrat e përdorura për dekoracion janë kafja, e gjelbërtë të dhëna shpesh në formë njollash apo rrëkesh të bëra mbi sfondin krem në bizele të enës. Ngandonjëherë sipërfaqja e enës ka reflekse ngjyrë argjendi. Tek një fragment tasi të bie në sy sipërfaqja e enës e lyer me smalt me shkëlqim ari dhe me ngjyrë të kuqe.

B. Pjatat. Në qeramikën e kësaj shtrese janë gjetur dhe disa fragmente pjatash të thella dhe të cekëta me përmasa të vogla dhe mesatare. Mbizoterojnë midis tyre pjatat me parate dhe buzë të trasha. Ato janë përgatitur në pjesën më të madhe të tyre prej një argjile të pastër ngjyrë rozë të ndezur në të kuqe dhe vetëm në raste të rralla janë gjetur copa të përgatitura prej argjilës të bardhë ose të verdhë në krem.

236) D. Komata, Kështjella..., f. 89, Tab. XXXII, 1-6; S. Anamali, Raport mbi rezultatet e gërmimeve të vitit 1983 në bazilikën e Ballshit (Ruhet në Arkivin e QKA); S. Hidri, Raport mbi rezultatet e gërmimeve të vitit 1980 në bazilikën e Arapajt (Ruhet në Arkivin e QKA).

Shumica e ketyre fragmenteve riprodrojnë pjata me trup në trajtë kësule gjysmësferike. Sipas modelimit të buzëve, ato paraqesin disa variante.

b/1 Pjatë e thellë (pothuajse e plotë, e restauruar) me trup në trajtë kësule gjysmësferike dhe buzë të shpërvjela nga jashtë. Pjata ka përfond një shtresë smalti ngjyrë bizele në ment (Tab. XL, 10; Tab. LXXV). Në pjesën e thellurës së pjata është e dekoruar nga brenda me 8 fusha në formë sektorësh, katër prej të cilave janë zbukuruar me vija rrezore që dalin nga qendra paksa e gropëzuar e pjatës të bëra me smalt ngjyrë kafe në gështenjë dhe katër të tjera janë lënë bosh përfunduar me rrathë me një pikë në mës të bëre me smalt të gjelbër që alternojnë njëri-tjetrin. I gjithë ky zhukurim i brendashkruhet një vije qarkuese të formuar prej hargesh që ndjekin njëri-tjetrin të bëre me smalt ngjyrë kafe gështenjë. Pjata zbukurohet në pjesën e sipërm të buzëve prej një vargu s-gjysmë të shtrira, që ndjekin njëra tjetren të vendosurë brenda një fushe të kufizuar në të dy anët nga vija treshe paralele të bëra me smalt ngjyrë kafe gështenjë. Diametri i sipërm i pjatës 23 cm, kurse i fundit 6,8 cm.

Kjo pjatë nga mënyrë e pikturimit dhe smalti i përdorur përfunduar hyn në grupin e enëve me pikturim polikrom dhe datohet në shek. XII të e.soni.

b/2. Tek disa pjata të tjera buzët janë pak të shpërvjela ose gjysmë të shpërvjela nga jashtë në formë strehe, (Tab. XXXVIII, 3, 4, 5; Tab. XLIV, 2, 3), më rrallë janë shumë të shpërvleja horizontalisht nga jashtë (Tab. XXXVII, 3; Tab. XLIV, 4). Ka raste kur buzët gjysmë të shpërvleja të pjatës janë profiluar jashtë e brenda me nga 2-3 valëzime (Tab. XXXVII, 1, 2) ose vetëm në pjesën e sipërm të tyre (Tab. XLIV, 6). Forma e riprodhuar e një fragmenti jep një pjatë të thellë në trajtën e një segmenti rrëthor me anët e trashura pak të hapura nga jashtë me seksion të dyfishtë sinusoidal (Tab. XXXVIII, 8).

b/3. Tek të tjerat ato si vazhdim i drejtpërdrejtë i trupit të enës veçohen prej tij nga një pragëzim i lehtë. (Tab. XLIV, 4, 5). Në një rast tjetër buzët duke dalë tej paretit të jashtëm ngrihen përfmbi enë në formë rezhgash ose valëzimesh në relief. (Tab. XXXIX, 14). Në këtë rast në vendin ku buzët veçohen nga trupi i enës, në paretin e jashtëm të tyre vijnë re zbukurime në formë dhëmbë sharre.

b/4. Disa fragmente pjataši riprodhojnë një formë disi jo të zakonitë me prerje gati në trajtë trapezi me parëtë të trasha, enët me seksion sinusoidal të dyfishtë dhe pjesën e sipërme si sqep zogu. (Tab. XXXVII, 1, 2).

### C. Pjatancat.

Në grumbullin e fragmenteve të enëve të tavolinës janë veçuar edhe disa copa, që riprodhojnë pjatanca të tipave të ndryshëm.

c/1 Disa prej tyre kanë pjesën e poshtme të trupit në trajtë kësule gjysmësferike me buzët e sheshta me seksion trekëndëshi (Tab. XXXIV, 4).

Janë përgatitur në përgjithësi prej një argjile të pastër me ngjyrë të bardhë në sipërfaqe dhe rozë në të kuqërrremtë në brendësi. Njëra copë është e lyer nga brenda dhe në pjesën e sipërme të buzëve me smalt të gjelbërt, përmbi të cilin duket një shtresë e hollë smalti të tejdukshëm vende-vende me lustër floriri (Tab. XXXVII, 8).

c/2 Një tipi tjetër i takon fragmenti i pjatancës me trup me seksion në formë trapezi, buzë të shpërvjela në formë strehe profiliuara në skajet dhe fund të sheshtë. Ena zbukurohet në pjesën e sipërme të buzëve me vija të drejta dhe të valëzuar që vijnë rrëth e qark enës me zbukurime në formë njoillash prej smalti të gjelbër. (Tab. XLIV, 4).

c/3 Në tipin e tretë hyn fragmenti i një pjatance me trup shumë të shtrirë në trajtë segmenti rrëthor. Ka buzët e sheshta në pjesën e sipërme të shtrira në formë strehe nga jashtë, dhe të rrumbullakuara në skajet. Brenda dy vijave rrëthore të hapura pranë skajëve të buzëve është piktuuar me smalt në ngjyrë kafe mat një zbukurim në formë gërshtetë prej katër fijesh, që i vjen rrëth e qark periferisë së enës. Motive në formë degëzimësh të bëra me të njëjtën ngjyrë shihen edhe në pjesën e brendshme të pjatës të kombinuara edhe më motive të tjera si rrathë ose harqe të mbushur me vija të pjerrëta paralele të bëra me smalt në ngjyrë kafe mat në vëndin ku veçohën buzët nga trupi i enës (Tab. XLIV, 11).

c/4. Një formë krejtësisht tjetër riprodhojnë dy fragmente enësh me trup gati cilindrik. Tek njëra copë buzët janë të drejta me seksion katërkëndëshi, ndërsa tek tjetra të anuara

nga jashtë që zgjerohen në skajet. (Tab. XXXVII, 8, 14). Ena  
është e lyer me smalt në ngjyrë bizele me reflekse argjendi.

### Fundet.

Në masën e kësaj qeramike janë gjetur edhe mjafit fun-  
de të plota e të fragmentuara tasash, pjatash ose pjatancash.  
Ato janë të sheshta dhe ngandonjëherë të gufuara nga jashtë  
me një majucë të vogël e rrallëherë me një gropëz nga bren-  
da. Që të gjitha qëndrojnë mbi një këmbëz të lartë unazore  
ose pseudounazore (Tab. XL, 8-10).

Këto funde në pjesën më të madhe të tyre iu përkasin  
enëve prej argjile të pastër të bardhë në krem dhe vetëm në  
raste të rralla janë ndeshur prej argjile të kuqe.

### Dekoracionet.

Enët e tavolinës të kësaj periudhe, të qeramikës proto-  
majolike, të tërheqin vëmendjen për repertorin e gjerë të mo-  
tiveve dhe të koloritit që zbukurojnë si faqet e brendshme  
(në enët e hapura), ashtu edhe ato të jashtme (në enët e  
mbyllura) (Tab. XL-XLIV).

Në fragmentet e kupave, tasave, pjatave e pjatancave si  
edhe në fragmentet e enëve të ujit (pjesë buzësh, paretash,  
funde e vegjë) vërehen zbukurime të ndryshme. Por në gjend-  
jen e tyre tepër të copëtuar, nuk mund të riprodhohen figura  
të plota përvçse fragmente të tyre sa pér të fituar një ide  
të përafërt mbi llojin e dekoracioneve.

Në përgjithësi motivet e ndryshme gjeometrike si vijat e  
drejta ose të valëzuara, rrathët e thjeshtë apo bashkë-qën-  
drorë, vijat paralele, harqet, rombet, katrorët e trekëndëshat  
e mbushur në formë rrjete janë karakteristike për qeramikën  
me smalt të shek. XII-XIII. I shpeshtë është edhe motivi në  
formë gërshtetë ose halë pishe (Tab. XLIII, 1; Tab. XLIV, 11).  
Në shumë fragmente kemi ndeshur motive floreale si fije e  
tufa bari, lule të ndryshme me gjethë e vija të thurura në  
formë arabeske, (Tab. XLII, 18), zbukurime në formë gjysmë  
palmete, rozeta etj. (Tab. XL, 3, 4; XLI, 7, 9). Janë gjetur  
edhe fragmente me përfytyrime nga bota e gjallë si peshq  
dhë më rrallë ndeshen edhe figura qeniesh fantastike. (Tab.  
XL, 9; XLI, 5).

Në një rast të vetëm në dy fragmentet e një pjate prej argjile, të bërdhë, është përfytyruar figura e një njëriu, nga trupi i të cilit në njërin fragment ruhet pjesërisht vëtëm koka me flokët e zez, të ngritur me 2-3 radhë kaçurelash, dhe me fytyrën ovale të zgjatur, ndërsa në fragmentin tjeter njëra dorë që mban një shpatë, e ngritur lart gati për goditje. (Tab. XLIII, 18).

Për nga mënyra e vizatimit pjata janë me figurën e njëriut është e përafërt me pjatat e Korintit, të datuara në shek. XII.

Zbukurimet në enët me smalt janë realizuar në mënyra të ndryshme, me mënyrën «sgrafito» (ose me incizim), me dekor të piktuar dhe me smalt pa zbukurime (Tab. XLI, 1-5, 10, 11; Tab. XL, 3, 7).

Në një grumbull fragmentesh (buzë pjatash, parete e funde tasash ose pjatancash vihen re dekorë të bëra me mënyrën «sgrafito» (Tab. XL, 2, 7; XLI, 7, 9). Këto motive janë vija të pjerrëta paralele të holla ose të trasha rrathë e harqe, spirale, që shpesh herë marrin pamjen e shkrimit. Në përgjithësi, mjeshtrit piktorë në zbukurimin e këtyre enëve kanë ndërthurur disa mënyra zbukurimi. Në disa raste enët e dekoruara më parë me mënyrën «sgrafito» lyheshin e zbukuroheshin me dekorë të ndryshme të pikturim me smalt shumëngjyrësh (polikrom) ose vetëm njëngjyrësh (monokrom); në këtë rastin e fundit me sa duket më e parapëlqyer duhet të ketë qenë e gjelbëra në ngjyrë bari ose bizelja. Qeramika e zbukuruar me mënyrën «sgrafito» tregon ndikime të tipave të ardhur nga Konstantinopoli, të datuara në shek. XIII-XIV.

Në disa fragmente kupash, pjatash e pjatancash (buzë funde e pjesë paretesh) spikasin zbukurime të bëra me bojë të kuqe, dë nërsërisin elemente të traditës së qeramikës së shkujve të parë të e sonë antikitetit të vonë dhe të mesjetës së hershme. (Tab. XXXVII, 16).

Në qeramikën me pikurim polikrom është përdorur për zbukurim një larmi e tërë, ngjyrash në kombinime nga më të ndryshmet. Ngjyrat me të zakonshme janë e bardha me nuancat e saj, ngjyrë krema ose qumështi, që zakonisht shërbente për dhënen e sfondit të enës, e verdha, e gjelbra me tonet e saj, kafja e çelët ose e errët, kafja e murme në gështenjë e kuqja dhe e zeza, vishnja e purpurt, bluja etj.

Midis fragmenteve të shumta të enëve të tavolinës të zbukuruara me pikurim polikrom e monokrom të bien në

sy një fragment tashi, një buzë kupe me pjesë pareti, një fragment buzë pjatë dhe një fragment ene uji (broke ose kanë), (Tab. XLII, 2, 4), që ruajnë në sipërfaqe gjurmë lustëri floriri. Më qartë duken ato tek një paret i zbuluar me motive në formë gjysmëpalmetash (Tab. XLIII, 4), të rrrethuara atash me smalt kafe-gështenjë në të zi dhe të mbushur me smalt në ngjyrë të bardhë. Këto lloj enësh me reflekse floriri janë karakteristike për prodhimet e Spanjës, të importuara në shhek. XIII. Në Itali kjo lloj qeramike shkon deri në shhek. XV. Këto fragmente në krahasim me qeramikën tjetër janë të rralla dhe kanë arritur tek ne me sa duket si sende luksi të porositura nga shtresat e pasura qytetare të shoqërisë feudale nëpërmjet importit italik. Disa fragmente pjatash (pjesë buzësh e parete tesash, kupash e enësh uji, kotruvesh e brokash janë lyer vetëm me smalt njëngjyrësh pa dekor.

Zakonisht në copat e mbledhura në gërmimet tonë, mbi-zoteron ngjyra e gjelbër me tonet e saj më të errëta ose të çelëta dhe bichelja.

Këto fragmente enësh riprodhojnë, zakonisht kupa, pjata dhe enë uji, katruve me grykë triullukëshe tip ojnohe dhe ndonjë kapak. I vërtmi dekor i këtyre enëve është smalti monokrom me përjashtim të ndonjë cope që ka si zbulimin edhe disa kanelyra horizontale (Tab. XLIII, 9).

Shumë forma enësh të kësaj qeramike dhe motivet, që zbulurojnë ato të ngjashme me tonat i gjejmë në qeramikën me smalt të së njëjtës periudhë të zbuluar në kështjellën e Kaninës, të datuara gjithashtu në shhek. XII-XIV. në qeramikën sinkrome të grumbulluara gjatë gërmimeve të bëra në rrënojat e Durrësit mesjetar dhe në amfiteatrin e tij, në bazilikën paleokristiane të Ballshit dhe në atë të Arapajt, në kështjellën e Krujës, në Butrint, Lezhë etj.

Enët me smalt monokrom pa zbulurime në përgjithësi përsërisin forma të enëve të njoitura me zbulurime të të gjitha tipave e grupeve, gjë që tregon se ato janë prodhuar në të njëjtën periudhë. Jashtë territorit tonë enë të tillë janë gjetur në Nessebre (Bulgari)<sup>237</sup> Konstantinopol, në Korinth dhe Hersones dhe janë datuar në shhek. IX-XI. Ato të tipit të Konstandinopolit shkojnë deri në shhek. XII.

237) J. Cimbuleva, *Vases a glaçure en argile blanche de Nessebre (IX-XII)* «Nessebre», Sofia, 1980, f. 203-252 shih edhe literaturën e cituar prej tij aty.

Në qeramikën me smalt vlen të përmendet një enë që për nga trajta afron shumë më vorbat mesjetare (Tab. LIX, 1). Ka trup të fryrë sferik qafë jo shumë të lartë cilindrike me buzët e drejta që bien vertikalish. Ena është e pajisur më dy vegja petullicë, që dalin nga buzët e enës dhe mbështetin mbi shpatullat e saj. Ena është e lyer nga jashtë më një cipë të holle smalti të tejdukshëm ngjyrë ulliri, përmes së cilis dallojnë kokrrizat e rërës në sipërfaqen e enës. Analogë më të përafërt të kësaj ene e gjejmë në qeramikën që lidhet me fazën e IIIa (shek. X-XII) të ndërtimit të mureve rrëthuese në kështjellën e Kaninës.<sup>238</sup>

Në gjermimet në pikën B e D janë mbledhur midis të tjerash dhe disa fragmente grykash e parete, që u përkasin enëve të tipit broke, kotruve (Tab. XXXVIII, 2, 6, 8, 10) dhe ibrik. Janë përgatitur nga argjilë e verdhë, ngjyrë okër dhe nga argjilë e kuqe. Janë shumë të fragmentuara dhe nuk mund të thuhet asgjë për format e tyre. Në pjesën më të madhe kanë grykë të lartë cilindrike, që hapet në formë hinke me buzë të shpërvjela nga jashtë ose të mbledhura nga brenda, që herë-herë rrumbullakohen në pjesën e sipërme.

Këto lloj enësh janë të dekoruara në mënyra të ndryshme: me smalt monokrom të gjelbër-ngjyrë bari ose bizele me zbukurime në formë kanelyrash horizontale në pjesën e jashtme të buzëve ose me smalt polikrom (të gjelbër, të verdhë, ngjyrë kafe dhe në ngjyrë të kuqe).

Një grup më vete formojnë disa fragmente (parete) enësh të tipit kotruve, që dallojnë për pikturimin monokrom me smalt të gjelbër-ngjyrë bari, karakteristike për shek. XII. Tek disa nga këto copa gjejmë të ndërthurura disa mënyra dekorimi me incizim (vijat e drejta qarkuesh dhe vijat e valëzuara), me ngulitje (radhë prej pikash të ngulitura), të aplikuara mbi sfondin e lyer me smalt të gjelbërt të enës etj. (Tab. XLII, 1, 6; Tab. XLIII, 19).

Këtu duhet radhitur edhe një paret e tip kotruveje që dallon për zbukurimet në anën e jashtme në formë vijash të drejta dhe të valëzuara vertikale që alternojnë njëra-tjetren, të bëra me smalt të gjelbër-ngjyrë bari dhe kafe magrezi përmbi sfondin ngjyrë qumështi të enës. (Tab. XLII, 17).

<sup>238) D. Komata, Sistemi fortifikues i Kështjelles së Kaninës. «Iliria» IX-X, 1979-1980, f. 266, Tab. IX, 4.</sup>

Ena është e lyer edhe nga brenda me smalt ngjyrë kremi, Një fragment ene e ngjashme me këtë është gjetur në Valentano (Itali) e datuar në fund të shek. të XIV.<sup>239</sup>

Midis fragmenteve të enëve të ujit është gjetur edhe një pjesë pareti ene tip ibrikû me teprica lëfyti të dekoruar me smalt, të hollë të tejdukshëm ngjyrë kremi në të verdhë, të gjelbër-rgjyrë bari dhe ngjyrë ulliri nëpërmjet së cilës dallojmë kokrrizat e rërës që përmban argjila. Në pjesën e sipërme të lëfytit ena është zbuluar me një vijë të harkuar zigzage të bërë me mënyrën «sgrafito». (Tab. XLIII, 17).

Enëve të ujit, të tipit broke e kotruve iu përkasin edhe disa vëgjë me prerje petullicë të lyera në të dy anët me smalt. Në pjesën e sipërme ato janë dekoruar me vija të perrëta paralele, me vargje prej s-sh të vendosura së prapthi përgjatë vegjës së enës dhe me vija të harkuara të bëra me smalt ngjyrë kafë në të zezë, që herë-herë alternohen nga të tilla të gjelbra. (Tab. XLII, 13, 14, 155). Kjo e fundit është shumë e ngjashme me ato të gjetura në qeramikën me smalt dhe argjilë të bardhë të Nessebres, e datuar në shek. IX-XII<sup>240</sup>.

Në enët e tavolinës janë veçuar disa fragmente (pjesë paretesh, funde dhe ndonjë grykë ene), që përsërisin enë, të tipit kotruve ose broka triullukëshe (ojnohe), që dallojnë për smalitin e tyre ngjyrë blu me të cilin janë dekoruar dhe që i yërkasin qeramikës majolike.

Në përgjithësi ato kanë një formë jo të zakonshme të trupit (Tab. XL, 5, 10), me qafë të shkurtër dhe grykë të gjerë cilindrike nganjëherë në formë gjethi tèrfili (Tab. XLIII, 5). Fundet i kanë zakonisht të sheshta që paksa të vëçuara nga trupi i enës.

Sipërfaqja e jashtme e këtyre enëve është dekoruar pothuajse e gjitha me motive të ndryshme floreale dhe gjeometrike: dritareza në formë bedenash, fije bari e lule zambaku etj. (Tab. XL, 5; Tab. XLIII, 5, 12).

Nga brenda ato janë të lyera me një lloj smalti të verdhë ngjyrë kremi pa shkëlqim.

239) R. Luzi — M. Romagnoli, *Antiche maioliche di scava dalla Rocca Farnese in Valentano e altre sparse dal duca di Castro*, sek. XIII-XVII. Valentano 26 sett. 25 ott. 1981, f. 23, A. 11.

240) J. Cimbuleva, *Vases*..., f. 230, Pl. XVII, 84-84a, 86.

Fragmentet e kësaj qeramike tregojnë lidhje me qeramiken me smalt blu të prodhimit të Fajencëz (Itali), të datuarë në çerekun e fundit të shek. XIV,<sup>241</sup> të ardhur me sa duket tek ne nëpërmjet importit që bënte Venediku me qytetin e rëndësishëm të Durrësit.

Midis tyre të tjerëq vëmendjen një fragment paret është me pikturim me smalt blu përmbi sfondin e bardhë.

Brenda një rrëthi me smalt blu, që i brendashkruhet një rrëthi tjetër lexohen inicialet me gërma latine të formulës së Krishtit: ISSUS HRISTUS (Tab. XLIII, 3).

Në dy fragmente të tjera (pjesë barqesh) vërehen zbuturime prej brezash vertikalë të përbërë nga motive në formë X që ndërpresin njëri — tjetrin (Tab. XLII, 4,5). Motive të ngjashme me këto shihen në brezin e mesit të kafshës që zbuturon pjesën ballore të një kotruveje që ndodhet në gjetjet e qeramikës së muzeut të Romës e datuar në shek. XIV — XV.<sup>242</sup>

Ajo që duhet nënvisuar pas analizës të qeramikës me smalt të periudhës bizantine është shumëllojshmëria e trajtave dhe e dekoracioneve të saj çka tregon për një rritje të repertorit të enëve të kësaj periudhe; Bollëku i kësaj qeramike tregon se qyteti i fortifikuar i Beratit në mesjetë ishte një qendër e rëndësishme ekonomike administrative. Ajo është gjithashtu trënges i qartë i nevojave në rritje të popullsisë të qytetit dhe i parapëlqimit të enëve dekorative të tavolinës. Këto të fundit lidheshin me shtresat e pasura feudale të qytetit.

Mungesa e skarciteteve të kësaj qramike dhe e skorjeve të baltës, duke përjashtur këtu disa copa të veçanta, që i përkasin sikurse u vu në dukje drejtërsëdrejtë importit-bizantin dhe atij italic, na shtyn të kërkojmë një qendër tjetër prodhimi të afërt, siç është Durrësi. Gërmimet e reja arkeologjike të bëra në këtë qytet dëshironë e tij kanë sjellë një material të bollshëm të kësaj qeramike, në bazë të së cilës, studiuvesit kanë shfaqur mendimin se ajo duhet të jetë prodhim durrssak.

Zbulimi i qeramikës me smalt të tipit protomajolik në qytetin e Beratit dëshironë e tijerë arbërore si në Durrës.

241) O. Mazzuhati, *La racolta ceramica del Museo di Roma*. Roma 1966, Fig. 16-19; fig. 25-28. Sipas këtyj autorit prodhimi i kësaj qeramike ka vazduhar deri në shek. XVI në prodhimin e porcelanit, si një mbiqjetim ose imitim i formave dhe prodhimeve të Fajencës.

242) Polaty., fig. 16.

Kaninë, Ballsh, Arapaj, Shkodër etj. e cila deri vonë tek ne ka munguar, tregon gjithashfu pér përhapjen e saj, përvac dekorative e afrojnë atë përmes Durrësit, me ekzemplarët kohedhe në territorin e Shqipërisë.

Teknika e prodhimit të saj, veçanërisht elementet e saj dekorative e afrojnë atë përmes Durrësit, me elzemplarët kointinas dhe të Italisë.

Analiza e hollësishme e qeramikës së kësaj shtresë dhe krahasimi stilistiko tipologjik i copave tona me të tilla të ngjashme nga e njëjta periudhë të zbuluara në qendra të tjera brenda dhe jashtë vendit na jepin mundësi të vendosim saktë kohën e prodhimit dhe përdorimit të saj. Gjetja në këtë shtresë e monedhave të Aleksit I Komnen (1081-1118), Janit II Komnen Porfynogeneti, (1118-1143) Isakut II Engjellit (115-1195)d he Teodosit III Vatac Duka Laskarit (1255-1259) na shtyn të përcaktojmë si kohë të mundshme të prodhimit dhe përdorimit të kësaj qeramike shek. XII-shek. XIII të e.sonë.

B. Enët e kuzhinës, (shek. XII-XIV), janë përgatitur prej një argjile jo shumë të pastër, që në më të shumtën e rasteve përban në përzierje grimca kuarcia, rëre të situr trashë dhe thërmija gurësh gëlqerorë të shtypur që duken në sipërfaqe. Kjo qeramikë dallon pér një punim trashanik dhe ka fakturë të ashpër. Tek të gjitha fragmentet dallojnë qartë gjurmët e çarkut të poçarit. Kanë në përgjithësi pjekje të mirë, ngjyra e baltës, eshtë kafe e kafe në të kuqërremetë, gri në të murreme e shpesh të zezë më gjurmë të theksuara zjarri. Ngjyrat apo nuancat e tyre që vihen re mbi sipërfaqen e këtyre enëve dhe në prerjet e pareteve të tyre janë rezultat i intensitetit të ndryshëm të pjekjes.

Në fragmentet e qeramikës së kuzhinës enët më të zakonshme janë edhe këtu ato të tipit vorbë, tasat, enët me grykë të gjerë, tavat, tenxheret, kapakët dhe saçet.

Vorbat e periudhës mesjetare dallojnë jo vetëm nga mënyra e modelimit të tyre, por edhe nga përmasat e mëdha. Nga forma e trupit të tyre dallojmë katër tipa kryesorë.

I. Në tipin e parë janë grupuar vorba me trup të fryrë sferik gati cilindrik dhe buzë të drejta, të prera pjerrëtas nga jashtë ose nga brenda dhe të rrumbullakuara në skajet. (Tab. XXXIII, 8,10 Tab. XXXIV Tab. LX, 3, 6).

II. Disa fragmente të tjera vorbash kanë trup vezak, me grykë jo shumë të lartë cilindrike dhe buzët e drejta të prera

pjerrëtas nga jashtë ose niga brenda me seksion gati rrëthor, drejtkëndor ose elipsoidal (Tab. XXXIII, 2,4,5,6,9; Tab. XXXIV, 6, 9; Tab. LX, 2; Tab. XXXV, II; Tab. LIX, 3; Tab. LX, 4).

III. Një tip më vete formojnë disa fragmente buzësh vorbe me grykë jo shumë të lartë që hapet në formë hinke. Buzët janë në përgjithësi të rrumbullakuara në skajet dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë kanë dalje këndore. Këto vorba janë zbuluar shpesh në anën e jashtme të grykës me vija të drejta dhe të valëzuara që alternohen, të bëra me incizim para pjekjes. (Tab. XXXIII, 1,3,7; Tab. XXXV, 4,5; Tab. LIX, 5,6).

IV. Një fragment vorbe qëndron i veçuar nga copat e tjera dhe duket se riprodhon një vorbë me trup të stërgjatur në formë dardhe dhe grykë të gjërë cilindrike, që përfundon me buzë të harkuara dhe të prera gati vertikalish nga jashtë me dalje këndore me profilime të lehta në paretin e jashtëm. Zbukurohet në shpatullat nga një tufë vijash treshe të valëzuara, të bëra me incizim para pjekjes (Tab. XXXV, 7).

Në asnjëren nga fragmentet e këtyre vorbave nuk janë gjetur vegjë. Por vegjët e gjetura veçmas në gërmimet e kësaj shtrese, si nga balta ashtu edhe nga teknologjia e prodhimit duket se i përkasin enëve të tipit vorbë dhe, meqenëse janë gjetur të shkëputura po i trajtojmë veças. Kanë në prerje forma katërkëndëshe, petullicë ose rrethore. Këto lloj vegjësh, siç tregojnë mbetjet e tyre kanë qenë vendosur paksa nën bûzëni e enës dhe vetëm në raste të rralla janë vazhdim i drejtpërdrejtë i tyre. Vegjët kanë qenë zbuluar në pjesën e sipërme me vijëza paralele ose gropëza të thelluara, të bëra me ndonjë mjet majëmprehtë ose të rrumbullakuar dhe me krehër prej 3-5 dhëmbëzash. Më rrallë ndeshet motivi halë pishe (Tab. XXXV, 15-20). Kanë në përgjithësi një punim trashnik dhe janë përgatitur nga e njëjta argjilë.

Forma të tilla vorbash janë të shpeshta në qendërbani- met dhe kështjellat tonë mesjetare, si në kalanë e Shurdhahut, në Gradishtën e Symizës, hë kështjellën e Kaminës.<sup>243</sup> etj., ku janë gjetur me material të datuar në shek. XI-XII dhe XII-XIV. Vorba të tilla të ngjashme me këto janë zbuluar edhe në gërmimet në bazilikën paleokristiane të Ballshit dhe në atë

243) H. Spahi — D. Komata, vep. cit., f. 295, 311; Tab. II, 1-6; Gj. Karaiskaj, Gradishta... f. 179; Tab. VIII, 1-10; D. Komata. Kështjella..., f. 86.

të Arapajt të shqëruara me qeramikë dhe monedha të shek. XII-XIV.<sup>244</sup>

Tasut. Pas vorbave në enët e kuzhinës vijnë tasat. Në krahësim më vorbat ata janë më të paktë dhe në përgjithësi kanë parëtë të trasha dhe përmasa të mëdha. Ngjyra ë baltës është kafe e çelët nga brenda dhe në pjesën e buzëve me nuancë gri ose të murmë nga jashtë.

Pjesa më e madhe ë tyre kanë trup gjysmësferik më buzë të sheshta pak të pjerrura nga brenda, të imprehta ose të rrumbullakuara në skajet.

Tek njëra copë anët vertikale të buzëve zgjaten tej paritetit të enës duke formuar një zbulurim në formë rezhgash në relief (Tab. XXXV, 12). Një tas të ngjashëm me këtë si për nga forma, ashtu edhe nga zbulurimet e ndeshim në qeramikën e kalasë së Bicit-Vaqar (Rr. i Tiranës).<sup>245</sup> Forma të tillë tasash janë të pranishme në qeramikën e zbuluar në kalanë e Shurdhahut, të datuara në shek. VII-XII.<sup>246</sup>

Një tip tjetër formon copa që riprodhon një tas me trup gati konik me buzët e drejta pothuajse vertikale dhe të rrumbullakuara në skajet e pak të mbledhura nga brenda (Tab. LIX, 8). Është i ngjashëm për nga forma me një tas të zbuluar në kalanë e Shurdhahut.<sup>247</sup> Anët vertikale të fryra të buzëve në profilimin e tyre të kujtojnë buzët me themtha të enëve të shtresës II (gjysma e II e shek. I) të Agorasë së Athinës.<sup>248</sup>

Një pjesë e këtyre tasave përsërisin forma tipike të qeramikës ilire të kohës antike të vonë të zbuluar në qytetin ilir pranë Selcës së Poshtme.<sup>249</sup>

Në qeramikën e kësaj shtrese janë gjetur dhe disa fragmente qypash shumë të copëtuara të përgatitura nga e njëjtë argjilë (Tab. XXXV, 9).

Tavat. Disa fragmente të tjera enësh me parete shumë të trasha riprohoinjë enë me përmasa të mëdha të tipit tava.

Tavat kanë paretet anësore të harkuara me trup në trajtë kësule gjysmësferike, grykë shumë të gjerë dhe buzë të sheshta, pak të anuara nga brenda që hapen nga jashtë në

244) S. Anamali, Résultatet..., S. Hidri, Bazilika...,

245) D. Komata, Disa tipare..., Tab. VI, 9.

246) Po aty., f. 228, Tab. VI, 18.

247) D. Komata, Disa tipare..., Tab. VI, 11.

248) H.S. Robinson, Pottery..., Tab. 79, G. 33.

249) N. Ceka, Qyteti..., Tab. LXXXVI, 17, 18.

formë strehe me dalje të rrumbullakuara ose me buzë të drejtë pak të anuara nga jashtë me prerje katërkëndëshe (Tab. XXXIV, 1, 2, 8).

Këto tava zbukurohen në anën e jashtme të tyre me tufa vijash të valëzuara, gropëza të stërgjatura paralele dhe shirita prej rezhgash.

Midis enëve të kuzhinës me parete të trasha të bie në sy një fragment tave e madhe me buzë të pjerrëta dhe të rrumbullakuara në skajet, e dekoruar para pjekjes nën buzë me një brez çallatash të bëra me një vegël të vogël me katër dhëmbëza.

Në qeramikën e këtij grupi është përfshirë edhe një fragment ene ndoshta e tipit tenxhere (buzë me pjesë pareti dhe vegjë) me përmasa të mëdha dhe parete shumë të trasha (Tab. XXXIV, 7; Tab. LX, 5). Ka ngjyrë kafe në të kuqërrremtë me gjurmë zjarri në sipërfaqe dhe ngjyrë rozë në prerje. Në buzë duken gjurmët e vegjëve petullice.

Është gjetur gjithashtu edhe fundi i një ene tip tenxhere, me parete shumë të trasha. Është përgatitur prej një argjile që përmban shumë grimca gurësh gëlqerorë të shtypur dhe cikërima mike. Ngjyra e pjekjes kafe. Ena është zbukuruar në pjesën e poshtme me dy breza rezhgash dhe çallatashi (Tab. XXXV, 10).

*Kapakët.* Në qeramikën e kësaj shtrese janë mbledhur edhe disa fragmente kapakësh. Ata kanë formë kësule gjysmë-sferike me buzë të drejta, pak të profiluara në skajet (Tab. XXXVI, 1, 3). Janë të përgatitura nga e njëjta argjilë. Ngjyra e pjekjes gri në të murrme me gjurmë të theksuara zjarri në pjesën e poshtme. Veçohen për nga forma, midis tyre dy fragmente kapakësh në trajtë disku me zbukurime plastike në relief në formë rezhgash, çallatash ose halë pishe. (Tab. XXXV, 6).

Në enët e kuzhinës kemi përfshirë edhe një fragment saçi dhe dy copë çërepësh shumë të trashë të përgatitur prej një balte jo shumë të pastër që përmban pluhur kashte (byk). Ngjyra e pjekjes është kafe në të murrme. Fragmenti është zbukuruar, në sipërfaqe me disa rezhga të vendosura horizontalisht dhe vertikalisht. Këto motive dekorative plastike kanë pasur, me sa duket edhe funksion praktik për të mbajtur prurshin që të mos binte gjatë pjekjes së bukës (Tab. LX, 7, 8).

Pas dhënies së formës përkatëse të enës një proces paq i rëndësishëm për mjeshtrit poçarë ka qenë ekzekutimi

dekoracionevé të ndryshmë që zbukuronin, këto enë. Zbukurimi mbanin pothuajse të gjitha kategoritë e enëve; vorbat, tasat, tenxheret etj. dhe vetëm një pakicë fare e vogël janë të thjeshta.

Ato janë realizuar në tri mënyra: me gërvishtje, me ngulitje dhe me relief.

Zbukurimet e ndryshme pavarësisht nga mënyra sesi ekzekutoheshin në më të shumtën e rasteve kanë qenë aplikuar në shpatullat e enës, poshtë buzëve, mbi barkun e enës në pjesën e sipërmë të vegjës dhe pranë fundit të saj. (Tab. XXXIII-XXXVI).

Zbukurimet e bëra me gërvishtje (ose incizim) janë zakonisht vija të drejta qarkuese që shkojnë paralel me buzët e enës në formë v'jaskash të cekëta dhe tufa vijash të valëzuara (Tab. XXXIII, 3). Zbukurimet në formë çallataš janë bërë me ngulitje mbi sipërfaqen e enës me ndihmën e ndonjë mjeti të thjeshtë majëmprehtë ose të rrumbullakët, (Tab. XXXIII, 2,3), kurse ato të bëra në relief në formë rezhgash përsërisht motive të njëtrajtshme plastike në formë shiritash prej gropëzash të bëra me mollëzën e gishtit. Motive të tjera në formë litari ngandonjëherë ndeshen të ndërthurura me të parat (Tab. XXXIII, 4; Tab. XXXV, 8).

Më rrallë shihen motive të bëra me krehër (me 2-5 dhëmbëza), motivi në formë rrjeti, halë pishe etj.

Të gjitha këto motive, që zbukurojnë enët prej balte të kuzhinës të gjetura në kështjellën e Beratit, të veçaura ose në kombinime të ndryshme të gjejmë në përgjithësi në qeramikën e të njëjtës periudhë të zbuluar në qytetet dhe kështjellat mesjetare si brenda dhe jashtë territorit tonë.<sup>250</sup>

## 5. ENËT PREJ QELQI.

Në gjermimet e bëra në pikën B, midis fragmenteve të shumta të qeramikës janë zbuluar edhe mjaft copa enësh prej qelqi. Ato kanë dalë pothuajse në të gjithë sipërfaqen e gërmuar por më shumë janë gjetur në kuadratet I, III, VIII dhë IX.

Megjithëse këto qelqe kanë arritur deri tek ne në një

<sup>250)</sup> D. Komata, Disa tipare..., f. 237, Tab. VII, f. 239, Tab. VIII, f. 241, Tab. IX (Shih, edhe literaturën e cituar prej tij).

gjendje shumë të fragmentuar, mbi bazën e krahasimeve me copa të përaferta jemi përpjekur të bëjmë klasifikimin e tyre.

Fragmentet e qelqeve tona mund të veçohen në 3 grupe kryesore:

A) Fragmente gotash me parete të holla të lëmuara dhe të dekoruara me zburime plastike.

B) Fragmente gotash me zburime në formë brinjësh në reliëf të bëra me fileto qelqi.

C) Shishe të thjeshta me grykë të gjatë e të ngushtë.

A) Pjesa më e madhe e fragmenteve të qelqeve (buze, parete e funde), sipas riprodhimit grafik të tyre na jasin gota me trup vezak dhe me funde të dhëmbëzuara (Tab. XLV, 1,3,9,11,14). Prej tyre janë mbledhur rreth 75 copë. Midis fundeve, pareteve dhe buzëve janë gjetur edhe hapje (pastilje) të veçuara, që dikur zburonin sipërfaqen e këtyre gotave.

Këto gota përsërisin trajta të prejardhura nga kupat e periudhave më të hershme.

Kanë trup cilindrik, përafërsisht 7 cm — 7,5 cm të lartë me një diametër të grykës që nuk i kalon 5,8 cm dhe të fundit 3,8 cm me pjesën e sipërme të fryrë nga jashtë.

Buzët e tyre, të gufuara në pjesën e mesit nga jashtë, tentojnë pak nga brenda dhe janë të rrumbullakuara në skajet. Herë-herë ato janë përforcuar në pjesën e qafës me një shirit të ngushtë prej brumi qelqi me prerje cilindrike (Tab. XLV, 1,3).

Fundet në pjesën më të madhe të tyre janë të futura nga brenda në formë koni me majë të mprehtë e rrallëherë janë të sheshta (Tab. XLV, 11-13). Ato janë borduruar në anën e jashtme me një ose dy fileto prej qelqi në formë kordoni të përdredhur; të valëzuar ose të dhëmbëzar (Tab. XLV, 13-14; Tab. LXIV, 10).

Këto gota janë zburuar në sipërfaqe me disa hapje të vogla e të mëdha (Tab. XLV, 5,12; Tab. LXI, 5,6,6,7). Të voglat kanë formë gjysmësferike ose themthore, kurse të më-dhatë janë në trajtë bajame. Ato janë përgatitur prej brumi qelqi të tejdukshëm.

Fragmente gotash me themtha gjysmësferikë dhe funde të dhëmbëzuara të përgatitura me të njëjtën teknikë janë gjetur kohët e fundit në varrezën e Kishës së Shën Ndout në kepin e Rodonit të datuara në shek. XII-XIII.<sup>251</sup>

251) A. Hoti. Ndiqimesë... f. 211, Tab. XI, 1,2,4,5.

**Copat tona kanë shumë ngjashmëri me fragmentet e qelqave të zbuluarar në Bohovac dhe me gotat e Sarajevës e të Gackos (Bosnie Hercegovinë-Jugosllavi), që i përkasin tipit të njojur në literaturën shkencore «Kraustrunk» (Koçan lakte).<sup>252</sup> Ato kanë shumë afërsi edhe me copat e gjeturar në Laguna (Itali) të datuara pas vitit 1330 dhe Cividale (Friuli) (shek. XIII-XIV); të Venedikut dhe me ato të Korintit.<sup>253</sup>**

Në këtë grup hyjnë edhe dy fragmente kupash me buzë unazore të dhëmbëzuara, prej të cilave një pjesë fundi e pareti është zbuluarar në sipërfaqe me dekoracione plastike në formë pikash të vogla gati konike. Këto fragmente kanë ngjashmëri me copat e zbuluarar në Korint, Venedik, Hungari, Jugosllavi etj.<sup>254</sup>

B) Një kategori tjeter formojnë dy fragmentet e zbuluarar me motive plastike në formë brinjesh, të vendosura zakonisht në pjesën e fundit të enës dhe në vegje. (Tab. LXIV, 8,9). Nga riprodhimi grafik i njërisë copë duket se ajo i përket një ene qelqi tip jo i zakonshëm ndoshta një vazo apo kavano (Tab. XLV, 8,16).

Ka formë gati cilindrike, me fundin pak të futur brenda dhe me zbulime plastike në formë brinjesh të kryqëzuara me njëra-tjetren. Për nga forma ajo paraqet afërsi me fragmentin nga Blagoj (Bosnie Herzegovinë-Jugosllavi),<sup>255</sup>

C) Disa gryka shishesh mund të radhiten në grupin e shishevë të thjeshta me parete relativisht të holla.

Njëra prej tyre ka buzë shumë të trashura unazore deri në 1,5 cm të larta dhe pak të fryra anash me një diametër prej 2,7 cm (Tab. XLV, 2). Megjithëse copa ka arritur deri tek ne në një gjendje mjaft të fragmentuar, sipas riprodhimit grafik të saj duket se afrohet mjaft me shishet me «gushë» të zbuluara në Korint (shek. XI-XII), me ato të Pallatit mbret-

252) P. Andelic, *Un aperçu de la typologie du verre médiéval en Bosnie et en Herzegovine*, «Srednovjekovno steklo na Balkanu (V-XV vek.)» Beograd, 1975, f. 171 Tab. IV, 13,14.

253) A. Gasparetto, *La Verrerie Vénitienne et ses relations avec le Levant balkanique au Moyen age*, po aty, f. 148, Tab. V, 16 a,b; Tab. VI, 19; R.J. Charleston, *Some english finds of medieval glaze with Balkan analogues*, po aty., f. 103, Tab. III a, b; f. 105, Tab. II, 2.

254) A. Gasparetto, vep. cit., f. 147, Tab. I, 1a, eb; 2a, b; c; P. Andelic, vep. cit., f. 172, Tab. I, 1.

255) P. Andelic, vep. cit., f. 172, Tab. V, 21a.

tëror në Buda (Hungari), që datohen në shek. XIII dhe me shishet e zbuluara në Cividale I (Itali) të shek. XIII-XIV.<sup>256</sup>

Ato janë gjetur në një shtresë kulturore së bashku me monedha bizantine të Isakut II Engjëllit (1185-1195), Manuelit I, Engjëllit (1230-1232) dhe me një monedhë të Teoder Vatac Duka Laskarit (1255-1259), kështu datohen pa mëdyshje në shek. XII-XIII.

Qelqet e zbuluara në gërmimet e bëra në qytetin iliro arbëror të Beratit kanë ngjashmëri të dukshme si nga pikëpamja tipologjike, e materialit dhe e teknikës së punimit me qelqet e prodhua e Venedik (Murano).<sup>257</sup> Kjo ngjashmëri na shtyn t'i konsiderojmë ato si artikuj importi të tregtisë me Venedikun.

Si përfundim qelqet tona mund tëjenë ose prodhime të industrisë së lartë qelqore venedikase të shek. XIII, që mund të kenë ardhur si rezultat i tregtisë me Venedikun<sup>258</sup>, ose prodhime të ndonjë punishteje lokale të qelqit me qendër në Durrës, që punonte, me sa duket, nën ndikimin e Venedikut.

## 6. OBJEKTE METALIKE.

1. Gishtëz bronzi e hapur në pjesën e sipërme, që kufizohet lart e poshtë me dy shirita të profiluar qarkues. Sipërfaqja e saj zbulurohet me tri radhë katrorësh të gdhendur në relief. Diametri i poshtëm 1,8 cm dhe ai i sipërm 1,5 cm. Gjerësia e saj 1,1 cm (Tab. XVIII, 15).

256) A. Gasparetto, vep. cit., f. 148, Tab. VI, 20.

257) Po aty, vep. cit., f. 147. Këto qelqe janë të njoitura si vazhduese të trashëgimisë morfollogjike dhe dekorative të qelqeve të Korintit, traditë kjo e përvetësuar në radhë të parë nga Venediku dhe e përhapur pastaj jo vetëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe ato të pellgut danubian dhe të Europës Qendrore e Veriperëndimore, me të cilat Venediku kishte marrëdhënie.

258) Në vendimin e Senatit të Venedikut Berati përmendet midis qyteteve të tjera si Vlora, Spinarica dhe Këlcyrë, për tregtinë që zhvillonte me Venedikun. Shih: A. Alb. (Acta et Diplomata) vol. I..., f. 796.

2. *Gjilpërë* prej bronzi e thyer, e përdorur me sa duket për qepje lëkure. Gjatësia 10 cm. trashësia 2 mm (Tab. XLVII, 2).

3. *Medaljon* në trajtë elipsoidale i punuar me derdhje prej paste qelqi të bardhë. (Tab. XLVIII, 14; Tab. LXIV, 13).

Në faqe duket busti i trajtuar në relief të lartë i sh. Kollit<sup>259</sup> me brorore rrëth kokës dhe me veshjen e hierarkut. Në dorën e tij të majtë ai mban ungjillin e mbyllur, ndërsa dorën tjetër e ka paksa të ngritur sipër tij si për bekim. Në të dy anët e bustit në rreshta vertikalë lexohet shënim i greqisht: O. ΝΙΚΟΛΑΟC. Faqja e mbrapme është e sheshtë. Forma e objektit të sugjeron mendimin se medaljoni duhet të ketë qenë fiksuar në ndonjë këllëf apo kornizë metalike dhe ka shërbyer për t'u varur.

Gjendja e përgjithshme e objektit paraqitet e mirë. Figurat e medaljonit ruhen të plota, por objekti ka pësuar ndryshime nga ndryshku dhe duket si i lyer me varak. Duke marrë parasysh shtresën kulturore dhe materialin tjetër arkeologjik me të cilin është gjetur veçanërisht një monedhë bizantine e Isakut II Engjëllit (1185-1195) e gjetur pothuajse në të njëjtën shtresë, copa jonë mund të dotohet mirë në shek. XII.

Pajisjeve të kalit duket se i përkasin një shpor hekuri dhe disa patkonj formash të ndryshme dhe përmasash mesatare (Tab. XLVIII, 9-13). Midis tyre ka disa objekte prej hekuri të fragmentuara. Gjendja e tyre e ruajtjes shumë e keqe nuk na lejon të përcaktojmë përdorimin e tyre.

6. Një objekt tjetër hekuri është i thyer në të dy anët. Nuk dihet se përfundon mund të jetë përdorur.

7. Rrëth me prerje katërkëndëshe, me diametër 2,5 cm.

8. Objekt hekuri në formë unaze me një shtojcë në njëren anë, përdorimi i të cilës është i paqartë. (Tab. LXII, 7).

---

259) Kulti i këtij shenjtori ka qenë mjaft i përhapur në kalanë e Beratit, ku përvëç ikonave ka dy kisha që i janë përkushtuar atij.

## 7. MONEDHA MESJETARE<sup>260</sup>

Bizantine.

Aleksi I Komnen (1081-1118)

1. AE ↓ F. Legjenda pjesërisht e lexueshme: [ΑΛΕΞΙΩ] Δ EC. Perandori qëndron në këmbë përballë, mban në dorën e dj. një kryq të gjatë dhë globin e kryqëzuar në dorën tjetër.

Shp. MP-ÖV. Virgjëresha me brorore qëndron ulur përballë dhe mban në prehër një medaljon me birin e saj hyjnor.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1973 në pikën B.

P=1,99 gr D=26 mm.

Është përfshirë në katalogun e H. Spahiut. Monedha. . . , f. 399, nr. 393, Tab. VII, 7.

Aleksi I Komnen dhe Konstandin Porfyrogjeneti  
(Tab. LXVI, 4) (1081-1118)

2. AE F. Legjenda rrethore pothuajse e palexueshme: ΑΛΕ... Dy Shtatnat e perandorëve që mbajnë së bashku globin e kryqëzuar. Secili prej tyre mban nga një labarum.

Shp. Shumë e fshirë

Monedha është gjetur në gërmimet e v. 1978 në pikën F gjatë pastrimit të dheut në anën lindore të kuadratit IV.

P=1,94 gr. D=21 mm.

Jani II Komnen Porfyrogjeneti (Tab. LXVI. 6)  
(1118-1143)

3. AE ↓ F. Pa legjendë. Perandori qëndron në këmbë përballë, mban labarumin në dorën e dj. dhë volumen në dorën tjetër.

260 Shënojmë se në fushatat e gërmimeve të bëra në këtë qytet janë zbuluar afro 40 copë monedha mesjetare, përvèç gjetjeve të rastit me origjinë nga kalaia e Beratit. që ruhen në muzeun e qytetit prej të cilave mundëm të lexojmë 27 copë. Për monedhat e rastit me origjinë nga kjo kala shih: H. Spahi, *Monedha bizantine të shekujve V-XIII të zbuluara në territorin e Shqipërisë* në: «Iliria» IX-X, 1979-1980.

Shp. MP-ΘV. Virgjëresha me brerore ulur përballë mban në prehër një medalion me Krishtin foshnjë.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1973 në pikën C.

P=1,44 gr D=20 mm.

4.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda rrethore e palexueshme. Shën Gjergji dhe Jani II mbajnë së bashku një kryq të gjatë grek. Shën Gjergji mbështet dorën e tij të djathtë mbi një shpatë në këllëf.

Shp. MP-ΘV. Virgjëresha me brerore qëndron ulur përballë dhe mban mbi prehër një medaljon me Krishtin foshnjë.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=2,11 gr. D=26 mm( Tab. LXVI, 5)

5.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Si nr. 3

Shp. si nr. 3

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1973.

P=1,41 gr. D=20 mm.

Jani II dhe Aleksi (?) (LXVI, 7)  
(1118-1143)

6.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Pa legjendë. Dy perandorët të veshur me robe me kuadrate qëndrojnë përballë në këmbë dhe mbajnë nga një kryq të gjatë.

Shp. Monedha është shumë e fshirë. Mezi dallon koka e Krishtit me brerore.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=1,68 gr D=20 mm.

Manuel Komnen  
(1143-1180)

7.  $\text{Æ} \uparrow F$ . Legjenda e palexueshme. Virgjëresha që mezi dallon me brerore përballë në këmbë kurorëzon perandorin që qëndron në këmbë përballë në të djathtë të saj. Perandori mban labarumin në dorën e dj. dhe globin e kryqëzuar në dorën tjetër.

Shp. Shumë e fshirë, mezi dallon koka e Krishtit me  
brerore.

Monedha është gjetur rastësisht në gërmimet e vitit 1974  
në pikën B.

P=1,98 gr. D=26 mm.

8.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda vertikale pjesërisht e lexueshme: M [A]  
N [OVHA Δεκρο]; në të djathtë të legjendës nuk shihet gjë.  
Perandori i ulur përballë mban në dorën e djathtë një glob  
me një kryq grek përsipër dhe në dorën tjetër ndoshta la-  
barumin.

Shp. Brenda një rrathi me kokrriza: A [Δεκρο], Busti  
me brerore përballë i Shën Evgjénisë (?) mban një shtizë në  
dorën e dj.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1975 në pikën  
D.

P=1,63 gr. D=23 mm (Tab. LXVII, 1)

Isak II Engjëlli (Tab. LXVII,2)  
(1185-1195)

9.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda e palexueshme. Perandori qëndron në  
këmbë përballë i kurorëzuar nga një dorë hyjnore; mban në  
dorën e dj. një kryq dhe volumen në dorën tjetër.

Shp. MP-ΘV. Virgjëresha me brerore mban në prehrin e  
saj një medaljon me Krishtin foshnjë.  
Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1978 në pikën F.

P=2,65 gr. D=25 mm.

10.  $\text{Æ} \downarrow F$ . [ICACIOC] ΔεκΠ Arkangjeli Shën Mihail dhe pe-  
randori mbajnë së bashku labariumin midis tyre, në të djathtë  
të Mihailit gërmat: A.M.X.

Shp. E ngjashme si shpina e nr. 9.

Monedha është gjetur rastësisht në vitin 1973 (Tab.  
LXVII, 4).

P=2,97 gr. D=27 mm.

11.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Si nr. 10.

Shp. si nr. 10

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1978 në pikën E. (Tab. LXVII, 3)

12.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda vertikale: IxA. Shën Mihaili me brerore përballe mban globin e kryqëzuar në dorën e mj. dhe një shpatë të zhveshur në dorën tjetër.

Shp. Legjenda nga e dj. e palexueshme. Busti përballe i Krishtit me brerore përmbi kryq.

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1973 në pikën B. (Tab. LXVII, 5)

$P=2,69$  gr.  $D=27$  mm.

13.  $\text{Æ} \downarrow F$ . si nr. 9

Shp. Shumë e fshirë.

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1973 në pikën A. (Tab. LXVII, 6).

$P=1,82$  gr.  $D=20$  mm.

*Monedha anonyme e perandorëve latinë (1204-1261)*

14.  $\text{Æ}$  — Monedha në faqe shumë e fshirë dhe e konsumuar gati në — e saj.

1

Shp. Kryqi latin, që mezi duket me këmbën e lulëzuar ndahet lart në dy zona ku janë vendosur dy drapërinj hëne; në qendër të kryqit takohen 4 rreze, tri skajet e tij zbulu-rohen secili me nga tri rruzuj.

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1978 në pikën F.

$P=1,51$  gr.  $D=27$  mm.

*Mihali VIII Paleologu*

(1261-1282)

15.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Bustet përballe të virgjëreshës me brerore dhe perandorit, mbajnë së bashku një lloj labarumi, në skajin e sipërm të të cilët shihet një kryq që i brendashkruhet një rrathi. Përmbi kokën e Virgjëreshës [OV].

Shp. XM. Arkangjeli Mihail me brerore qëndron në këmbë përballe.

Monedha është gjetur në gjermimet e vitit 1973 në pikën C.

$P=2,45$  gr.  $D=25$  mm.

16.  $\text{Æ} \downarrow F$ . XMAHA... ε. ΠΟΤ.... ΠΑΛ. Perandori përballë i ulur mbi fron mban një kryq në dorën e dj. dhe volumen në dorën tjetër.

Shp. [ΟΙΑΓΙ[OS-MIXAHΛ]. Arkangjeli Mihail me brerore qëndron në këmbë përballë.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=1,92 gr. D=25 mm (Tab. LXVII, 8)

*Manuel Engjelli* (Tab. LXVII, 7)  
(1230-1232)

17.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda rrethore e palexueshme. Nanueli dhe një shenjtor me brerore (Shën Dhimitri) qëndrojnë në këmbë përballë dhe mbështeten të dy tek një shpatë e zhveshur duke mbajtur sëbashku një lloj labarumi.

Shp. IC-XC. Busti përballë me brerore i Krishtit përmbi kryq.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=1,20 gr. D=22 mm.

*Teodori III Vatac, Duke Laskari (?)* (Tab. LXVIII, 3)  
(1255-1259)

18.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda rrethore e palexueshme. Shën Dhimitri me brerore dhe Teodori III mbajnë së bashku një labarum të zbuluar.

Shp. Shpina është shumë e fshirë.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1975 në pikën E.

P=0,99 gr. D=25 mm.

*Androniku II Paleologu* (Tab. LXVIII, 4)  
(1282-1328)

19.  $\text{Æ} \downarrow F$ . Legjenda e palexueshme: Androniku lutës përkulet për bekim përpara Krishtit me brerore përmbi kryq, që qëndron në këmbë. Lart përmbi kokën e Andronikut një kryq i brendashkruar një rrathi.

Shp. Busti përballë me brerore i Shën Dhimitrit me kostum ushtarak i armatosur me shtizë dhe mburojë.

Monedha është e konsumuar gati në 1/4 e saj. Është gjetur në gërmimet e v. 1974 në pikën B.

P=1,25 gr. D=22 mm.

20.  $\text{Æ} \uparrow$  F. Shumë e fshirë. Mezi dallon busti i Andronikut përballë.

Shp. Brenda një rrethi me kokrriza busti i Shën Gjergjit me brerore, mban një shtizë në dorën e djathtë dhe mburojën në dorën tjetër, lart, dj. Monogrami: [ΓΕΩΡΓΙΟΣ].

P=0,86 gr. D=13 mm.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B. (Tab. LXVIII, 5).

21.  $\text{Æ} \uparrow$  F. Legjenda vertikale: ANΔP.NHC... Perandori qëndron në këmbë përballë dhe mban një kryq të gjatë që i brendashkruhet një rrethi.

Shp. Legjenda vertikale nuk është e qartë.

Figura shumë e fshirë dhe e padukshme.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=1,60 gr. D=25 mm. (Tab. LXVIII, 6)

Monedha e Principatës së Ahesë (Filipi i Savojës — v. 1303) (Tab. LXVIII, 7).

22.  $\text{Æ} \downarrow$  F. Kryqi brenda një rrethi të dhëmbëzuar, përreth një krýq i vogël ndërmjet dy pikash dhe legjenda; Phs. D.SAB. P. Actte.

Shp. Kështjellë e stilizuar në mes e rrethuar nga legjenda, DE CLARENCIA.

Monedha është gjetur në gërmimet e vitit 1974 në pikën B.

P=0,51 gr D=18 mm.

Krahaso: G. Schlumberger, Numismatique de l'Orient, Paris MDCCLXX. VIII, f. 376; PL. XII, 20.

Monedha venecjane (Giovanni Saranzo (Tab. LXVIII, 8) (1312-1328).

23.  $\text{Æ} \downarrow$  F. Shën Marku i jep flamurin dozhit, në të mjaq, legjenda jo shumë e qartë: IC SVPANTIO në të dj. BM. VENETI. Vertikalishë midis dy kokave: DVX.

Shp. Krishti me brerore i ulur përballë përmbi fron. mjeti  
dhe dj. kokës IC-XC. Dj. Krahut të Krishtit është shenja se  
krete e njërit prej mjeshtërve të punishtes monetare.

Monedha është gjetur rastësisht në territorin e kalasë në  
v. 1978.

P=1,59 gr. D=20 mm.

Krahaso: N. Papadopuli, Le monete di Venezia, I, Venezia  
1883, f. 152, 2, Tab. IX, 6.

24. AE ↓F. dhe shp. si nr. 23

Monedha është e thyer i mungon  $\frac{1}{4}$  e saj.

\* \* \*

Pas shek. VI, në mesjetën e hershme dhe më pas, qyteti  
i fortifikuar i Beratit jetoi me ngjarjet historike që prekën  
krahinat shqiptare të jugut, të cilat në një farë mase kanë  
ndikuar në jetën e tij.

Në burimet historike të mesjetës së hershme, pas Hieroklitit,  
në shek. IX, qyteti do të zihet në gojë nga Porfirogeneti,  
i cili është i vetmi, që duke u bazuar në të dhëna burimore  
më të hershme (tek Hierokli), e përmend atë me emrin Pulheriopolis.<sup>261</sup>

Disa vjet pas pushtimit të Shqipërisë Jugore nga bullgarët  
(v. 851) mbreti Boris (852-889) pushtoi qytetin, i cili u  
quajt në atë kohë prej tyre Belgrad (qytet i bardhë), prej  
nga ka rrjedhur emri i sotëm Berat.<sup>262</sup>

Ndër autorët e mëvonshëm Farlati është i pari tek i cili  
gjejmë të ripërtërirë tezën e identifikimit të qytetit të Beratit  
me Pulheriopolisin e përmendur nga Porfirogeneti.<sup>263</sup> Sipas  
Farlatit qyteti mund të jetë ndërtuar nga Pulheria, motra e

---

261) Porfyrogeneti, De themat. Ox. Temai. IX

262) Historia e Shqipërisë..., f. 162.


263) D. Farlati, Illiricum sacrum-Jacopo Coleti, Venetiae, 1817,  
vol. VII, f. 436. Për emrin Pulheriopolis Shuflai (Städte..., f. 32) the-  
të se vjen nga deformimi i Bulgaropolisit, mendim që me të drejtë  
është kundërshtuar nga A. Baçe (Qyteti..., f. 48).

Teodosit II, hipotezë që edhe pse mund të duket me interes nuk është bindëse dhe me të drejtë është kundërshtuar nga A. Bace.<sup>264</sup>

Nga stratigrafia e gërmimit del, se edhe kjo shtresë është e lidhur organikisht me shtresën e mëparshme dhe tregon një vazhdimësi të pandërprerë nga antikiteti i vonë në mesjetë.

Në muret rrëthuese ekzistuese dhe në kullat vihen rrengërtime, të cilat dallojnë për një teknikë të çrrëgullt me gurë gëlqerorë të papunuar, që për nivelim përshkohen nga breza tullash. karakteristike për periudhën pas shek. IX<sup>265</sup>

Dëshminë më të bukur të këtyre rindërtimave e gjejmë tek monogrami i Mihal Komnenit (1204-1214), i bërë me tulla bizantine (Fig. 50) mbi portën e oborrit të fortifikuar në hyrje



të kalasë (Fig. 51), i cili lidhet jo vetëm me rindërtimin e kësaj porte, por me gjithë sistemin fortifikues, i cili iu nënshtrua në këtë kohë një rndërtimi të përgjithshëm.<sup>266</sup>



Fig. 51

Me gjithë vështirësitë që paraqet përcaktimi i riparimeve të kryera në mesjetën e hershme, del qartë ajo që pati vënë në dukje më parë Prashnikeri në formën e një hipoteze, se muret mejetare ndjekin vijën që kishte pasur muri rrëthues perimetral i periudhës ilire të qytetit.

Në sistemin mbrojtës të këtij qyteti ajo që meriton të vihet në dukje është ruajtja e elementeve antike. Vetë hyrjet në rrugët e një korridori të ngushtë është një element karakteristik i fortifikimeve ilire, që është ruajtur e plotë edhe në mesjetë, madje deri në ditët tona.

Në materialin arkeologjik të zbuluar në këtë shtresë, siç

266) Po aty, f. 49.

e pamë edhe gjatë analizës, vendin kryesor e zë qeramika mesjetare e përdorimit të përditshëm shtëpiak dhe ajo ndërtimore, disa vegla pune dhe monedhat.

Në enët e kuzhinës, ku mbizotërojnë vorbat, vihet re një ngjashmëri e madhe me enët e gjetura në qendërbanime e kështjella të tjera mesjetare të vendit tonë si me ato të Shurdhahut, Symizës, Kaninës, Durrësit etj., ku janë gjetur me materiale të datuara në shek. XII-XV.

Kjo qeramikë në trajtat, motivet e zbukurimit dhe në teknologjinë e prodhimit të saj trashëgon nga qeramika më e hershme e kohës antike të vonë (shek. V-VI) elemente të rëndësishme të traditës, çka flet për vazhdimësinë e poçerisë si një element i jetës qytetare.

Krahas qeramikës së kuzhinës në këtë shtresë u gjetën një sasi e madhe fragmente enësh të tavolinës me smalt që nga pikëpamja stilistike dhe e teknologjisë së prodhimit lidhen me qeramikën me smalt të periudhës bizantine. Shumë forma enësh dhe dekoracionet e tyre i ndeshim në qeramikën me smalt të tavolinës të zbuluar në qytete e kështjella mesjetare të territorit tonë dhe jashtë tij.

Ndërtimet e mëdha që kufizohen midis ndërtimeve të vona bizantine dhe të hershme turke,<sup>267</sup> qeramika, duke përfshirë këtu edhe qeramikën e ndërtimit, objektet prej hekuri (rrathë, thika, rreze etj.) e ndonjë stoli tregojnë se në shekujt e mesjetës së hershme e të mesme (shek. VII-XV), qyteti i Beratit ishte një qendër e rëndësishme qytetare me një nivel të mirë ekonomik. Monedhat bizantine të gjetura në gërmime në një numër jo të vogël, (rreth 40 copë, pa llogaritur këtu gjetjet e rastit) që nisin me monedhat e prera nga Aleksi I Komnen (1081-1118) dhe vazhdojnë, me ndonjë përjashtim të vogël, deri tek Androniku II Paleologu (1282-1328) janë një tregues tjetër i këtij niveli dhe i lidhjeve ekonomike që ka pasur qyteti i Beratit në këtë kohë me qytete të rëndësishme të Ultësirës sonë Bregdetare, siç ishte Durrësi.

Për rëndësinë që kishte qyteti i fortifikuar i Beratit dhe hovin që morën ndërtimet në fillim të shek. XIII dëshmojnë edhe ndërtimi i monumenteve të kultit, i një vargu kishash

---

267) Po aty, f. 50.

brenda dhe jashtë kalasë, midis të cilave më të rëndësishmet janë tri: ajo e Shën-Mërisë së Vllahernës, e Shën-Triadhës dhe e Shën-Mëhillit (kjo e fundit buzë lumit Osum në Shkëmbin e thepisur në anën jugore të kodrës), të ndërtuara sipas stilit bizantin.

Studuesit duke vërejtur arkitekturën e këtyre kishave, që i përket tipit me kryq të brendashkruar kanë vënë në dukje veçori të përbashkëta, që kanë shërbyer për vendosjen e tyre në njëren apo tjetrën shkollë të arkitekturës bizantine.

Të përcaktuara mirë në kohë kisha jepin një kuadër të plotë të zhvillimit të arkitekturës bizantine gjatë shek. XIII-XIV në qytetin e fortifikuar të Beratit dhe janë në të njëjtën kohë tregues të zhvillimit që pati qyteti i kushtëzuar nga pozita gjeografiko-strategjike dhe roli që ka luajtur ai në historinë mesjetare të Shqipërisë.<sup>268)</sup>

Këto kisha kanë rëndësi të veçantë jo vetëm për trajtimin arkitektonik, por edhe për interioret e tyre të zbukuruar me afreske, midis të cilave vlen të përmenden ato të kishës së Shën Triadhës, që përbëjnë monumentet më të rëndësishme të vendit në artin e periudhës parapushimit turk. Sipas mendimit të studiuesve ato sjellin një varg tiparesh, përmes të cilave dokumentohet evolucioni i piktureve monumentale në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIII.<sup>269)</sup> E rëndësishme dhe që duhet nën vizuar është se përmesat e vogla të kishës së Shën Triadhës dhe mungesa e ballkoneve i ka shtyrë studiuesit të lidhin atë dhe rindërtimet e bëra në të më vonë më tepër me emrin e ndonjë feudali vendas sesa me emrin e një perandori bizantin. Piktura në naos e kësaj kisha mendohet të jetë realizuar në cerekun e fundit të shek. XIII, ndërsa ajo e hajatit e kapërcen kufirin e mesit të shek. XIV.<sup>270)</sup>

Pas shek. VI, në mesjetën e hershme dhe më pas, qyteti i Beratit do të lidhet me popullsinë vendëse tanimë arbërore, pasardhëse e drejtpërdrejtë e popullsisë ilire.

268) A. Meksi, *Tri kisha bizantine në Berat «Monumentet»*, Tiranë, 1972, 4, f. 82-83. Për arkitekturën e ndërtimeve të kultit në këtë qytet shih edhe A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Berati..., f. 49-57.

269) Dh. Dhamo, *Tradita e Onufrit dhe pasuesit e tij*. (Gjurmime në pikturen shqiptare të mesjetës) -Disertacion i shkallës II, Tiranë, 1987, f. 87.

270) Po aty., f. 92.

Duke filluar nga shek. IX dhe veçanërisht në shek. XI-XIII, siç tregojnë të dhënrat arkeologjike dhe që në një farë mase na i thonë edhe të dhënrat burimore, me zhvillimin e marrëdhënieve feudale Berati është bërë një qytet feudal shqiptar. Në shek. XIV, siç na dëshmojnë edhe burimet e shkruara, ai ishte pronë e familjes feudale të Muzakajve.<sup>271</sup>

---

271) C. Hopf, *Croniques Greco-Romanes, inédites ou peu connues* Berlin, 1873 (gjenealogjia e familjes Muzakej) f. 275.

## PËRMBYLLJE

Në përfundim të studimit tonë po parashtrojmë përmbledhtazi arritjet më kryesore që dalin pas analizës së sistemit të fortifikimit dhe materialit arkeologjik të zbuluar në këtë qytet.

1. Gërmimet arkeologjike katërvjeçare në qytetin iliro-arbëror të Beratit kanë një rëndësi të veçantë se prej tyre u fituan të dhëna të reja të panjohura më parë mbi fazën protoqytetare që kishte paraprirë lindjen e qytetit ilir. Ato krijuan mundësi për të formuar një konceptim të ri, të ndryshëm nga ai i mëparshmi mbi lindjen e qytetit ilir Antipatrea mbi një truall të banuar më parë nga fisi ilir i dasaretëve dhe jo mbi një truall të ri siç ka qenë menduar deri përpara këtyre gërmimeve.

Vendbanimi protourban i Beratit, që hyn në grupin e atyre vëndbanimeve protourbane të mbrojtura nga natyra, siç tregon materiali arkeologjik, qëndron në unitet të plotë kulturor dhe etnik me vendbanimet e tjera protourbane të Ilirisë së Jugut.

Në qeramikën e prodhimit vendas të këtij vendbanimi, veçanërisht në qeramikën e piktuar të stilit devollit dalojen qartë elemente të traditës të trashëguara kryesisht nga faza II e periudhës së hekurit.

Me gjithë përkimet që vihen re në motivet e zbulurimit, që kanë gjithashtu karakter gjometrik e linear dhe në renditjen pothuajse të njëjtë të tyre me qeramikën devollite, duhet thënë se qeramika e piktuar paraqytetare e Beratit dallon nga qeramika e piktuar e fazave më të hershme nga mënyra më pak e kujdeshshme e ekzekutimit të motiveve të pikturuara. Mbi bazën e këtyre veçantive lokale e kemi

përcaktuar këtë grup qeramike si të fazës së fundit të zhvillimit të qeramikës devollite. Për marrëdhëniet me Korintin dhe viset e Italisë Jugore flet qeramika e importuar me tipare të qarta arkaike.

Pozita e favorshme gjeografike, veçanërisht rruga natyrore, që shkonte përgjatë luginës së Osumit e që lidhte krahinat e brendshme të vendit me zonat e Ultësirës Bregdetare, ishin faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik e shoqëror të këtij vendbanimi dhe që çuan në fund të shek. IV dhe në fillim të shek. III p.e. sonë në lindjen e qytetit ilir në kalanë e Beratit.

2. Në ecurinë e pandërprerë të zhvillimit social-ekonomik e kulturor, qyteti i fortifikuar në kalanë e Beratit, i takon etapës II të lindjes dhe zhvillimit të jetës qytetare në Ilirinë e Jugut, gjë që përputhet edhe me klasifikimin që i është bërë asaj dhe zhvillimit të jetës qytetare në Ilirinë e Jugut nga studiuesit tanë.

Si i tillë ai na del në këtë periudhë si një themelim i krijuar mbi bazën e zhvillimit të brendshëm të vendbanimit protourban, në gjirin e të cilit ishin përgatitur tanimë kushtet për lindjen e tij.

Në treguesit më karakteristikë të qytetit, siç janë konceptet në ndërtimin e sistemit fortifikues, kultura materiale etj., vihet re një ngjashmëri e madhe me qytetet e tjera të trevës iliro-jugore dhe epirote. Ngjashmëria tipologjike e teknikës së ndërtimit të mureve rrethuese ilire të fundit të shek. IV p.e.sonë dhe elementet konstruktive të qytetit ilir të Antipatreas e lidhin atë me një varg fortifikimesh të trevës së Ilirisë së Jugut çka tregon për zbatimin në të nga ana e mjeshtërve ndërtues të të njëjtave koncepte konstruktive arkitektonike.

Vendosja në të thatë e blloqeve kuadratike me lartësi, deri diku të barabartë (sistemi izodomik), përdorimi i blloqeve transversale (diatoneve) në lidhjet midis dy faqeve dhe i atyre të shkallëzuara, punimi ose jo i faqeve ballore deri tek pajisja në ndonjë rast i tyre me vijë peshimi dhe porta kryesore e qytetit me korridorin e thellë e të mbrojtur, janë elemente karakteristike konstruktivë, që ndeshen kudo në qytetet e Ilirisë së Jugut dhe të Epirit si në Lisi, Zgërdhesh, Butrint, Antigone, Dimal, Prishtë etj.

3. Në prodhimet e qeramikës të shek. III-II p.e.sonë ajo që duhet vënë në dukje është bollëku i saj dhe larmia e

formave. Zëvendësimi gradual i teknikës tradicionale protoqytetare të prodhimit me dorë të qeramikës dhe përdorimi gjërësish i çarkut të poçarit përbëjnë një veçori karakteristike dalluese për qeramikën e kësaj periudhe.

Teknologjia e prodhimit, format dhe dekoracionet e kësaj qeramike tregojnë se kemi të bëjmë me po atë qeramikë, që mbizotëron në këtë kohë në të gjitha qytetet e tjera ilire dhe që lidhet me përmirësimin dhe zhvillimin e teknologjisë së prodhimit në përgjithësi, me mënyrën e prodhimit zejtar dhe me një tipar karakteristik të kulturës qytetare ilire, me kërkosat e tregut.

Prania e skorjeve të baltës, e disa skarciteteve të enëve të përdorimit të përditshëm shtëpiak sasia e madhe e qeramikës masive të ndërtimit si edhe e disa vulave epigrafike dhe anepigrafike flasin jo vetëm për prodhimin e tyre në punishtet e qytetit, por edhe për nevojat në rritje të popullsisë së këtij qyteti.

Që qyteti i fortifikuar i Beratit i përballonte nevojat e popullsisë me prodhimet e veta dhe me importet (kryesisht enët e luksit, p.sh., enët e piktuara) nga qendra të tjera trevës ilire jugore e tregon numri tepër i kufizuar i qeramikës së importuar nga qendra të tjera të botës helene janë territorit të Ilirisë së Jugut.

Rritja e veprimtarisë ekonomike (ndërtimore e prodhue se), që më mirë se kudo shprehet në sistemin e fortifikimit mbrojtës, në prodhimet e ndryshme zetjare (qeramikë, objekte, metalike, e monedha), dëshmojnë se qyteti i fortifikuar ilir i Beratit po kalonte aty nga fundi i shek. IV fillimi shek. III p.e.sonë, sikurse një varg qytetesh ilire jugore dhe epërrote të tipit skllavopronar, periudhën e lulëzimit të tij.

Në sistemin e fortifikimit mbrojtës në arkitekturë dhe në lëndën arkeologjike, veçanërisht në prodhimet e qeramikës në repertorin mjart të pasur të formave të saj, siç e kemi vënë në dukje edhe gjatë analizës së materialit, vihet re imitim i elementeve helenistike, por kjo nuk e zbeh karakteristikët e bartësve të kulturës së këtij qyteti. Origjina ilire e tij bëhet edhe më e quartë po të kemi parasysh se ai u zhvillua në një truall të pastër ilir, në lidhje të ngushtë me qendrat e tjera ilire të afërtë dhe të largëta.

Në stratigrafinë e gërmimit duhet thënë se nuk është vënë re ndonjë ndërprerje e veprimtarisë njerëzore. Shtresat kulturore janë të lidhura në mënyrë organike me njëra-tjetrën dhe ndjekin pa ndërprerje ato.

4. Emri antik i qytetit përbën një problem të rëndësi-shëm që prej kohësh ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm. Lidhur me këtë çështje në literaturën arkeologjike shqiptare mbetet mbizotërues mendimi tradicional, sipas të cilës në rrënojat e qytetit të fortifikuar të Beratit duhet parë qyteti ilir i Antipatreas i përmendur nga autorët antikë Polib e Tit Livi, tek të cilët u mbështetën më vonë një varg studiuesish të fundit të shekullit të kaluar dhe të fillimit të këtij shekulli (Liku, Batifoli, Tomashku, Prashnikeri etj.), përkrahës të kësaj teze.

Në muret rrëthuese të qytetit ilir të Antipatreas, në periudhën që përfshin fundin e shek. II deri në shek. VI të e. sonë nuk janë bërë rindërtimë. Kjo është një dukuri që është vënë re edhe në qendërbanimë të tjera ilire dikur të fortifikuara.

Qeramika e zbuluar në gërmime dhe numri disi i kufizuar i monedhave tregojnë se edhe pas ngjarjeve të vitit 200 në luftërat me Romën, me gjithë démet që i solli qytetit pushtimi romak, edhe pse në fortifikimet mbrojtëse të tij nuk pati rindërtimë, jeta aty ka vazhduar.

Por duhet thënë se në kuadrin e organizimit administrativ të sistemit romak, si në shumë qytete të tjera ilire, që nuk u shndërruan në koloni romake, jeta në qytet nuk ka pasur më atë gjallérinë e dikurshme. Megjithatë numri i konsiderueshëm i fragmenteve të qeramikës së shekujve të parë të e.sonë të zbuluar në gërmime tregon se edhe në shek. I-IV të e.sonë punishtet zejtare lokale të qeramikës vazhduan të prodhojnë për nevojat e popullsisë së qytetit.

Elementet më shprehëse do t'i gjejmë edhe tanë kryesisht në qeramikë. Në format dhe dekoracionet e enëve, në teknologjinë e prodhimit e deri në pikturimin me bojë të kuqe vihen re tipare të përbashkëta me qeramikën e qendrave të tjera bashkëkohore të banuara nga ilirët.

Shumë forma enësh, siç janë kupat, pjatat, tasat etj., ruajnë elemente karakteristike të poçarisë antike të shek. III-II p.e.sonë. Kështu edhe për shekujt I të e.sonë të dhënat ar-

keologjike negojnë për vazhdimësinë e banimit nga e njëjtë popullsi.

6. Të dhënët e arkeologjisë tregojnë se qyteti ilir në Kalanë e Beratit në kohën antike të vonë, duke kapërcyer e përballuar krizën e rendit skllavopronar të shek. III-IV të e. sonë edhe pse ndoshta me një potencial ekonomik më të kufizuar vazhdoi jetën e tij.

Muret rrethuese të qytetit, në këtë kohë, sikurse tregojnë gjurmët e tyre të zbuluara në disa pika të gërmimit, ndjekin në përgjithësi linjën e mureve rrethuese të periudhës qytetare ilire.

Për qeramikën e kohës antike të vonë, ajo që duhet vë nënë në dukje, është reduktimi i formave dhe uniformizimi i tyre. Në krahasin me periudhat pararendëse repertori i formave të kësaj qeramike është më i kufizuar. Trajtat mbizo-tëruese janë vorbat, tasat, brokat e ndonjë, kotruve e ojnohe. Vazhdimësia e disa formave dekoracionet në trajtë spiralesh të varura, rrjetat e rombet, që vumë në dukje gjatë analizës të materialit deri tek pikturimi me ngjyrë të kuqe janë elemente karakteristike, që tregojnë për vijimësinë e traditës në këtë qytet.

Rindërtimet e bëra në sistemin e fortifikimit mbrojtës të qytetit nga perandori Justinian I, që na i dëshmojnë edhe burimet historike (Prokopi i Qezaresë, barazimi Antipatrea-Antipagrai) dhe ienda arkeologjike tregojnë jo vetëm për vijimësinë e jetës në qytetin e fortifikuar të Beratit, por edhe për një rigjallërim të saj në këtë kohë.

7. Në burimet dokumentare dhe tregimtare të mesjetës së hershme dhe më pas qyteti i fortifikuar i Beratit do të zihet në gojë me të njëjtin emër, por me forma të ndryshme, Belgradum, Belogradum, Bellogradum, Belligradum) nga kro-nistët bizantinë sa herë, që ai lidhet me ngjarjet historike që kanë prekur tokat shqiptare të jugut. Në këto dokumente ai njihet si qytet kështjellë, si seli peshkopale (v. 878) dhe më pas si qendër vilajeti.

Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. IX deri në v. 1018 qyteti ka qenë nën sundimin e bullgarëve. Për rëndësinë që kishte ai si qendër peshkopale në çerekun I të shek. XI flet diploma e v. 1019 e Vasilit II, kryepeshkopit të Ohrit.

Në burimet dokumentare qyteti do të përmendet më vonë lidhur me ngjarjet e ndryshme siç ishin luftat midis anzhuinëve e bizantinëve (v. 1272-1281), inkursionet e shqiptarëve kundër qyteteve të pushtuara në këtë kohë nga Bizanti (v. 1336) etj. Në vitin 1417, pas marrjes së Krujës, Vlorës dhe Kaninës, Berati bie në duar të pushtuesve turq.


Këto burime, ndonëse të kufizuara, vetë fakti që në to qyteti përmendet në lidhje me ngjarjet që kanë prekur trevat tona, tregon se qyteti i Beratit në mesjetë ka qenë një qendër e rëndësishme peshkopale dhe administrativo-ushtarake.

Stratigrafia e gërmimit edhe për shtresën që i takon kësaj periudhe duhet thënë se tregon një vazhdimësi të pandërrerë nga periudha antike e vonë. Në ndërtimet e kësaj periudhe ajo që vihet re dhe që duhet theksuar është se muret mesjetare ndjekin në përgjithësi vijën që kishte pasur muri rrethues i periudhës qytetare ilire. Një dukuri që duhet vënë në dukje në sistemin mbrojtës të këtij qyteti është ruajtja e elementeve antike. Si shembull tipik na shërben këtu vetë hyrja në trajtën e një korridori të ngushtë të mbrojtur, që si element karakteristik i fortifikimeve ilire është ruajtur e plotë deri në ditët e sotme.

Materiali arkeologjik i zbuluar në gërmime përvetëngjashmërisë me materialin e gjetur në qendërbanime të tjera mesjetare të vendit tonë (Shurdhah, Symizë, Kaninë, Durrës etj.) trashëgon nga periudha pararendëse, veçanërisht kjo mund të thuhet për qeramikën, tiparet karakteristike që flasin për vazhdimësinë e poçarisë si element i jetës qytetare.

Për tu vënë në dukje këtu është sidomos qeramika me smalt e tavolinës, e cila si nga pikëpamja stilistiko-dekorative dhe e teknologjisë së prodhimit lidhet më qeramikën me smalt të periudhës bizantine, prodhimi i së cilës në kuadrin e përgjithshëm të sundimit bizantin të vendit ka qenë kushtezuar nga zhvillimi i forcave prodhuase dhe i teknikës së prodhimit. Ajo lidhet tanë me kërkësat e shtresës së re shoqërore, asaj feudale.

Ndërtimet e kësaj periudhe, që kufizohen midis ndërtimeve të vona bizantine dhe të hershme turke, qeramika së bashku me qeramikën e ndërtimit dhe monedhat bizantine



të gjetura në një numër jo të vogël tregojnë se në shekujt e mesjetës së hershme dhe të mesme (VII-XV) qyteti i fortifikuar i Beratit ka qenë një qendër e rëndësishme qytetare me një nivel të mirë ekonomik dhe me një qarkullim monetar të zhvilluar, që flet për lidhjet ekonomike që ka pasur qyteti në këtë kohë me qytete të rëndësishme të Ultësirës. Bregdetare siç ishte Durrësi.

Prania e një vargu kishash brenda dhe jashtë kalasë të ndërtuara sipas stilit bizantin të shek. XIII-XIV në formë kryqi me kupolë dhe të pajisura me afreske, ikona dhe objekte kulti të një niveli të lartë artistik janë një tregues tjetër, që flet gjithashiu për rëndësinë që kishte qyteti në këtë kohë.

Ajo që duhet vënë në dukje e theksuar, veçanërisht për periudhën e mesjetës, siç del edhe nga materiali arkeologjik dhe sistemi fortifikues është progresi që vihet re në dinamikën e zhvillimit ekonomik e kulturor të këtij qyteti. Kjo tregon se jo vetëm nuk ka ndërprerje të jetës qytetare, por në krahasin me kohën e vonë antike, ka një rritje, çka në mënyrë të qartë e tregojnë edhe rindërtimet e bëra në sistemin e fortifikimit mbrojtës të kësaj periudhe dhe monumentet e shumta të kultit. Të gjitha këto flasin për potencialin e mirë ekonomik, që gjithë qyteti në këtë kohë, pa të cilin zor se mund të realizoheshin ato.

Qyteti i fortifikuar i Beratit, si të gjitha qytetet e tjera të territorit tonë, në etapën protofeudale dhe më pas, veçanërisht në shek. XI-XIII, me zhvillimin e marrëdhënieve feudale, është bërë një qytet feudal shqiptar i lidhur me popullsinë vendase arbërore, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e kombësisë shqiptare. Ai do të bëhet në shek. XIV siç dëshmojnë burimet e shkruara, pronë e familjes feudale shqiptare të Muzakajve.

Qyteti iliro-arbëror i Beratit në tërësinë e tij, në fortifikimet, në lëndën arkeologjike, monumentet e kultit e deri në qarkullimin e dukshëm monetar do të bëhet një qendër e rëndësishme ekonomiko-administrative, peshkopale dhe ushtarake që së bashku me vazhdimësinë e banimit dhe atë etnike jep shembullin e një qendërbanimi gjithnjë në rritje nga lashtësia në mesjetë.

Në këtë studim, nëpërmjet rezultateve të gërmimeve arkeologjike katërvjeçare dhe burimeve më kryesore historike përpoqëm të japid një tablo të përgjithshme të jetës së këtu

tij qyteti në periudha të ndryshme të ekzistencës së tij. Jemi të ndërgjegjshëm se nuk i kemi zgjidhur me këtë rast të gjitha problemet që lidhen me këtë qytet. Gërmimet arkeologjike, që nuk janë shteruese, pa dyshim do të sjellin të dhëna të reja për studimin urbanistik të qytetit dhe do të krijojnë mundësi më të mëdha për një studim edhe më të plotë e të gjithanshëm, i parë ky në aspektin ekonomik kulturnor e politik të tij.

## SUMMARY

The study of the Illyrian urban life and Illyrian-Albanian continuity constitute major problems to which our archaeology has long since been devoting special attention. For almost three decades archaeological research and observations have been conducted in a series of Illyrian bourgs and towns extending almost in the whole territory of southern Illyria and in Epirus (Rosujë, Xibër, Kala e Irmajt, Prishtinë, Symizë, Belsh, Scodra, Lissus, Zgërdhesh, Bylis, Klos, Kaninë, Aulonë, Buthrotum, Amantia, Antigoneza, etc.). The data of excavations and the study of the fortifications of these towns have created a totally new view on the Illyrian civilization during the establishment of the slave-owning order in Illyria.

These excavations have made possible for the scholars to prove that the protourban habitations had been founded in the 7th-5th centuries B.C. on the basis of an inner economical and social development. A series of questions have been laid down for solution on a broader factual basis, such as the problem of the origin of the formation of the Illyrian town, town's various stages of development, its character, its general and special fundamental features, its chronology, etc. The further tracing of life in the late antiquity period and the Middle Ages is of special importance for lightening the problem of the genesis of the Albanians on an ancient Illyrian basis in their historical territory. It is historically and archaeologically proved that many of our ancient towns es-

pecially the big and important towns of Scodra, Lissus, Dyrrhachium, Buthrotum, etc. thanks to their favourable geographical and strategical positions, though in other less favourable conditions and with a changed economy and way of living, have incessantly lived on.

The archaeological excavations in a series of habitations of the late antiquity period and the early Middle Ages (Shurdhah, Lissus, Scodra, Berat, Buthrotum, Onhezm (Sarandë), Bylis, Pogradec, Blacë, Symizë, Paleokastër, Zharrëz, etc.) speak of a dense population at that time, who had resisted to the assimilating policy of the Roman empire and had become a living force in the period of transition from the slave-owning to the feudal order.

Tracing the Illyrian-Albanian continuity a special attention has been concentrated upon the excavations, especially in those towns which have not ceased to exist.

Such has been the Illyrian-Arbri town of Berati, where we have conducted archaeological excavations, the results of which are presented in this monography. Relying on these excavations it has been defined that the Illyrian town on the hill of the Castle of Berati was founded by the end of the 4th century B.C. and the beginning of the 3rd century B.C. on the basis of an Illyrian earlier protourban habitation.

The written sources and the archaeological documentation obtained from these excavations testify to the continuity of the urban life during the ancient and the mediaeval period. The cultural layers with different deposits such as the locally produced handicraft objects, monetary circulation and building activity, reveal that Berati (Antipatrea, Antipagrai, Pulheriopolis, Belgradi) with all the zigzags caused by the historical events of the time, during the mediaeval period continued to be an important urban, administrative, military and diocesan centre.

The ruins of the fortified Illyrian-Arbri town of Berati are situated on a hill 187 m high above sea level, on the right bank of the Osumi river, precisely at that place where the river flows down from mountainous to low zones, after having run through a narrow gorge. In its southern part the hill slopes steeply onto the river, whereas in the northern side it descends gently and by means of a pass is linked with the hill of Bifta. The eastern and western sides have a declivity of 40-45°.

Berati castle, unlike any other centre of that zone has a favourable geographical position. The town defended and controlled the path along Osumi river in its middle flowing, by means of the main roads and by-roads which link this town with the inner zone of the country and the coastal lowlands.

The relief of the surrounding zone with mountain slopes, narrow gorges and valleys creates a favourable background for the cultivation of different agricultural crops, fruit growing and development of livestock. These, together with the natural roads which follow the direction of the valley of Osum, have played an important role in the life of this town.

In the written historical sources, in the region of Dassaretae including the ancient town in the castle of Berati identified with the Illyrian town of Antipatrea, there are mentioned a series of inhabited centres as Gertous, Orgesius, Castle of Irmaj, Bargullas, the Illyrian town of Dimal (see the archaeological map of the district-Fig) Close to the castle of Berati on the other bank of the river opposite the castle there is situated the castle of Gorica, which is a component part of the defence fortification system of this town. The central position occupied by the castle of Berati in relation with the other centres of this district should be pointed out.

The ruins of the castle of Berati have long since attracted the attention of foreign scholars and travellers. Foreign authors as Farlati, Pouqueville, Leake, Battifolli, Tomaseck, Prashniker etc. have left in their works even some short notes concerning this castle.

A part of them provide data that are mostly linked with the surrounding walls, the mediaeval gateways and towers as component parts of the defence fortification system of this town. Prashniker was the first that in the substructions of the fortifications of this town had noticed ruins of ancient constructions.

On the basis of these data Prashniker had put forward the thesis that «as it seems the mediaeval walls follow everywhere the ancient walls». These data provided by Prashniker are very important especially in those places where no excavations are carried out. They have contributed to a certain extend to the reconstruction of the planimetry of this town.

The up to then data have been insufficient to create an

*idea on the beginnings of life in the castle of Berati and its continuity. To complete these data there were organized systematic excavations in 1973-1975 and 1978.*

*The first archaeological excavations in this fortified town were conducted in 1973. They were mainly conducted in the square on the right of the main gateway of the town, in point «B» along the wall V between the towers 22 and 23 (Fig. 2, 3). Another excavation spot was localized on the left of the main gateway, in wall A, in the outer side of the Illyrian wall, on the left of the entrance. During the campaign of 1973, excavations were also conducted in point. «A», on the western side of the surrounding wall, in wall O between the towers 14 and 15. (Fig. 2).*

*The excavations conducted in points «B» and «C», which also continued during 1974, had a special importance. Besides providing us with many archaeological artifacts, the excavations brought to light a considerable part of the surrounding wall of the Illyrian urban period as well as elements that help us in the clarification of the defence fortification system of this town.*

*The excavations of 1975 and 1978 were conducted in the points «D», «E», «F» and «G» as well as on the right of the main gateway, in its inner side. (Fig. 2).*

*The point «D» was settled in the eastern side of the fortification of the town in wall «I» between the towers 9 and 10; point «E» in the western side of the surrounding wall, not far from the point «A», in the wall Q, between the towers 16 and 17. The point «G» was settled in the square near the red mosque, close to the surrounding wall of the southwestern side on wall «L», between the towers 11 and 12 lastly the point «F» is placed near the eastern wall of the upper town.*

*During these excavations 23 quadrates 5x5m were pickeeted and a general surface of 575 m<sup>2</sup> was explored. The depth varies in different points. From 0.75m in «G» and 1.60m in «C» it amounts to 2.50-4.60 in the points «B», «D», «E» and «F». The point «A» is an exception because the depth reaches 7.40 m and it is a place with many cultural artifacts of a mixed type.*

*Carefully observing the stratigraphy in the different points of excavations we notice that the intensity of life in the town has not been at the same level everywhere.*

The vertical stratigraphy in the main point of excavations «B» testifies to an intensive active life, and at the same time reveals that life has continued uninterruptedly from the protourban period up to late Middle Ages. In point «C», the majority of artifacts belongs to the late antiquity period, revealing that in the 4th-6th centuries A.D. this district had been more densely populated. In this sector the Illyrian urban period and that of the first centuries A.D. appear more vague. Almost the same tableau is seen in point «D» where the cultural layer of the late antiquity period and the mediaeval period are relatively well represented whereas the ceramics which belong to the first centuries of our era are very restricted and those of the Illyrian urban period are totally missing.

In the other points of excavations («A», «G», «E») the data for the first centuries of our era and the Illyrian urban period are scarce or missing.

Worthy of mention is the tableau presented by the stratigraphy of excavations in the highest point of the town «F», where the period of the first centuries A.D. are fairly well represented by the archaeological artifacts. The stratigraphic data in this point show that life should have begun during the 2nd cent. A.D. and its intensity should have been greater during late antiquity. Life has also continued in the early and late Mediaeval period. To some extend architecture proves this too. Traces of constructions and fortifications of the urban Illyrian period and its respective cultural strata were not found here.

As the archaeological data and the stratigraphy of excavations reveal, in the process of development of economic, social and cultural life of this town, four main periods are known according to which archaeological artifacts are analysed in this monography. 1) Protourban period (7th century B.C.-5th century B.C.) 2) Urban Illyrian period (3rd century B.C. -4th century A.D) 3) Late antiquity period (4th-6th century A.D.) 4) Mediaeval period (7th-15th century).

#### 1) Protourban period (end of the 7th century -5th century B.C.)

The archaeological excavations carried out in the ruins of the Illyrian town of Antipatrea are of great importance. Especially the excavations of the summer campaign of 1974

get us acquainted with a new phase with that protourban one which constitutes the first period of habitation in the hill of the fortified town of Berati. As the archaeological data reveal, some vessels fragments and two pieces of mud plaster with traces of twigs from cottages' walls are evidence of this period. They have been dug in definite stratigraphic circumstances at point «B» and clearly isolated in square 4 and partly in square 5 at a depth varying from 4.30 m. to 4.60 m. which was the last cultural layer deposited on the sterile ground formation.

The ceramics discovered in this layer (Tab. I, XLIX, L, LXIX) though limited is composed of two main groups with their distinctive features.

- 1) The locally produced ceramics
- 2) The imported ceramics

The discovery for the first time in the chronologically cultural layer of the protourban ceramics and fragments of mud plaster shed light on the ancientness of this habitation.

The fragments of mud plaster with traces of twigs used in cottages' walls (Tab. L, 6, 7) are for the time being the only evidences that speak about the character of the dwellings of this habitation.

The protourban town of Berati is not the only one in Berati district. The accidental discoveries and the systematic archaeological excavations have provided us with a rich archaeological material which comes from the open protourban habitations near Berati. As the archaeological artifact reveal, Berati is in unity with the habitations of the protourban period of our territory, which became known as the result of a new economical and social process, developed in southern Illyria in the 6-th-4th centuries B.C.

In the general classification of the protourban habitations made on the basis of the form and intensity of life, the protourban habitation of Berati ranks in the second group which includes the protourban defence habitations situated in an unfortified and naturally defended terrain.

In the ceramics of the protourban layer among others there attracts our attention the fragment of the painted ceramics of Devolli style. Different scholars, have pointed out that this kind of ceramics with such features, is also known in other centres. There should be mentioned here the ceramics of the second phase of the habitation of Ligeth (District

of Skrapari), the ceramics of the newest cavernicolous habitations of Kantundas (Qyteti Stalin -district of Berati) the ceramics which comes from the protourban layer of the Illyrian town near Selca e Roshtme, from the second underlayer of the habitation of Belshi (Belshi II. c), from Treporti, etc. In what is painted in the ceramics we notice the repetition of the elements of tradition that are part of the repertoire of the motifs inherited by the second phase of the iron age.

Its motifs have a geometric and linear character. In their combination we notice the same sequence as in the ceramics of Devolli, only that they are painted less carefully. These features distinguish our ceramics of the earlier phases and define this ceramics group as belonging to the late phase of the development of Devolli ceramics, which from its main centre of production in Korça baisin have been spread in other southern centres of our country.

The ceramics with distinct archaic features, though limited in number, urge us to look for its origin in the imported objects which came from Korinth and the regions of the southern Italia. In the inner economical and social development of this protourban habitation the geographical position has played an important role. The period that included the end of the 7th up to the 5th century B.C. for the ancient habitation of Berati was the period of inner economical and social development which was to lead to the birth and flourishing of the Illyrian town of the slave-owning type in this territory by the end of the 4th cent. and the beginning of the 3rd cent. B.C.. The cultural layer that follows the protourban layer and chronologically belongs to the 5th-4th cent. B.C., is not yet reached, constituting in this way a hiatus, the causes of which should be sought in the insufficient excavations conducted. Because of the difficulties of the terrain, the cultural layer that preceeded the Illyrian urban period of the 3rd-2nd cent. B.C. is not included in the stratigraphy, but we hope that it will be completed in the future.

## 2. The urban Illyrian period (3rd cent. B.C. -4th cent. A.D.)

The Illyrian Antipatrea, mentioned for the first time by Polyb is identified by the majority of scholars with the cast-

te of Berati. From an extract of this ancient author who describes the events of 216 B.C. on the Illyrian-Roman wars we learn that the Illyrian commander Skerdilajd, in 216 B.C. immediately after the peace with the Etois, on the one side had conquered Piseu a small town in Pelagoni, on the other side had gained the support though promises of some towns of Desarata, Krysondyon, Geruntin and Antipatrea which were in the hands of the Macedonians.

From another extract of Tit Livus we learn that Roman Legat Luc Apusti attacked Antipatrea in 200 B.C. Knowing that the surrounding walls were strong and the town big, the nobility of the town refused to give it up without a fight. The Roman Legat invaded the town through armed clashes and after killing everyone over 16 years of age he let his army plunder and set the town on fire. This evidence from Tit Livus, though seemingly exaggerated, reveals that the population did not surrender willingly, but held their ground heroically against the roman armies.

One of the periods best represented in the Illyrian-Arbëri town of Berati is the urban Illyrian period which begins with the birth of the town by the end of the 4th cent. and the beginning of the 3rd cent. B.C. and goes on up to the beginnings of the late antiquity.

Since the first campaign of excavation there were uncovered different parts of the surrounding wall that belongs to the Illyrian urban period. Up to now the finest and best preserved part of the wall is that discovered in point «B».

The inner side of this wall was followed for a distance of 27 m and had north-eastern -outh-western. 4 to 6 complete rows of quadratic blocks with a general height that moves from 1.50 m to 2.65 and a thickness of 3.2m-3.35m are preserved.

The Illyrian wall is built of limestone blocks of irregular shapes, in such a way as to create a footing. It is built with two outer facings, with filling inside, consisting of chips of stone remaining from the dressing of larger blocks.

## 1. Surrounding walls of the Illyrian urban period

The hill of the fortified town of Berati, has the form of a scalene triangular, encircled with walls that form the long curved sides, the eastern side with a length of 600 m and

the northwestern and the southwestern sides with a length of 400 each. Thus the surrounding walls of the Illyrian urban period adapted to the configuration of the hill terrain reach a length of 1400 m linear.

The inner side of the wall is constructed with relatively big stones, the length of which at certain places amounts to 2.84-3.40 m.

The sides of the blocks have square or rectangle forms, the latter being more widely used. They are placed one over the other without mortar.

It is noticed that in the arrangement of the blocks in parallel lines in general, no visible difference exists in their heights, and this fact defines their quadratic isogonic style (Fig. 13,14) which is among the most widely used styles in the Illyrian fortifications of our country and generally belongs to the 3rd cent. B.C. But it must be said that in the technique of the construction of these walls there are noticed influences of the pseudoisogonic style. In some other cases the alignment in a straight line is not preserved everywhere because of the use of the cogged blocks.

From the viewpoint of the technique of construction, these walls are similar to the walls of the Illyrian period of the castle of Gorica and the castle of Prishta. From the observations in the whole length of the wall of the Illyrian urban period discovered in the point B we noticed that the blocks with convex surfaces do not form separate parts but are distributed in the same wall together with the front flat face. This fact leaves no doubt for the existence of two different periods of construction.

The outer and inner facing of the wall are connected with transversal blocks, (diatons) at almost equal distances. The transversal blocks of the lower row are placed next to two blocks with the long side facing outwards at a distance of 2.93 m. In the third row they are again placed at equal distance of about 3 m. Here the wall is 3.12-3.35 m thick.

The use of transversal blocks and engravings with side bands are elements also used in the building of other towns in the south — Illyrian and Epirus territories, as in Zgerdhesh, Lissus, Antigonea, Irmaj, etc.

